A.S.C.A.P
Nr 533/1 Prot.
Datë më 02 08 202_

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Nr. 4049/3 Prot. Tiranë, më 31.7.2024

Lënda: Për ndjekje dhe kompetencë

**AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**
**Rruga "Naim Frashëri", Nr.37**
**Tiranë**

**AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**
**Rruga "Aleksandër Moisiu", përballë IKV-së**
**Tiranë**

Në përgjigje të shkresës së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar me nr. 533 prot., datë 21.06.2024, me lëndë: "Për miratimin e programeve mësimore për arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të orientuar me drejtim artistik" regjistruar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS), me nr. 4049 prot., datë 25.6.2024, bashkëlidhur gjeni për njohje dhe zbatim urdhrin nr. 367, prot., datë 18.07.2024, "Për miratimin e programeve mësimore të kurrikulës artistike, të klasave të caktuara me drejtim artistik në arsimin bazë dhe programeve mësimore të arsimit të mesëm të lartë të orientuar me drejtim artistik".

Duke ju falënderuar,

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**Erzen Tola**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT - TIRANË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

# KURRIKULA ARTISTIKE

**Programet e degës: MUZIKË NË VAZHDIM - AML**

**Specialitet: Kanto, Violë, Kontrabas, Fagot, Saxophon, Korno, Trombë, Bastuba, Fizarmonikë, Kitarë, Flaut, Klarinetë, Oboe, Perkusion, Harpë.**

**Për klasat: X-XI-XII**

**Tiranë, 2024**

# PËRMBAJTJA

1. HYRJE ....................................................................................3

2. QËLLIMI I DEGËS MUZIKË ....................................................................................3

3. TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR SPECIALITETET ....................................................................................4

3.1. TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR SPECIALITETET SEKONDARE ....................................................................................5

3.2. TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR LËNDËT TEORIKE ARTISTIKE ....................................................................................5

3.3. TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR LËNDËT PRAKTIKE ARTISTIKE....................................................................................6

4. UDHËZIME METODIKE TË PËRGJITHSHME....................................................................................6

4.1. UDHËZIME METODIKE PËR INSTRUMENTISTËT ....................................................................................7

4.2. UDHËZIME METODIKE PËR LËNDËT TEORIKE DHE TEORIKE – PRAKTIKE....................................................................................9

4.3. LËNDËT E SPECIALITETIT....................................................................................11

**PËRMBAJTJA E PROGRAMIT**

## 1. HYRJE

Muzika, së bashku me mësimin e llojeve të tjera të artit në shkollat artistike është bërë objekt i një trajtimi të specializuar e profesional, e cila kërkon një vëmendje të posaçme edhe ndaj dokumentacionit bazë dhe përdorimit të tij në procesin konkret të edukimit artistik. Kjo e bën të domosdoshëm plotësimin e dokumenteve kryesore sikurse është edhe kurrikula artistike për trajtimin e lëndëve, ku do të përfshiheshin detyrimisht udhëzimet e nevojshme që nga përmbajtja muzikore, metodologjitë dhe vlerësimi i nxënësve në çdo nivel dhe cikël.

Në një kuadër të tillë, hartimi i kurrikulës artistike për mësuesit e degës muzikë është menduar të jetë një udhërrëfyes i përgjithshëm për të orientuar lëndët teorike, teorike praktike dhe specialitete për çdo klasë, nivel dhe cikël shkollor për të bërë të mundur unifikimin dhe orientimin e të gjitha përmbajtjeve mësimore përmes tematikave, metodologjive dhe vlerësimit në momente të veçanta të procesit mësimor.

Kështu, të gjitha lëndët që zhvillohen në degën "Muzikë" AML, do të tregojnë në mënyrë sa më konkrete e të qartë lidhjen mes pjesëve të programuara të kurrikulës; mundësinë që ato të trajtohen në mënyrë organike e si pjesë të njëra tjetrës dhe bashkëveprimin e pashmangshëm të proceseve të krijimtarisë, interpretimit muzikor dhe përjetimit emocional të artit muzikor.

## 2. QËLLIMI I DEGËS MUZIKË

Qëllimi kryesor i arsimit në këtë degë është zhvillimi dhe formimi muzikor e artistik i nxënësve për t'u perfeksionuar në veprimtari të ndryshme që lidhen me muzikën, si dhe krijimi i një personaliteti për të jetuar dhe për t'u përballuar me sfidat e ndryshme. Për të

realizuar këtë, shkollat artistike, dega muzikë u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi;

- mundësi për të zhvilluar kompetencat profesionale të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat;
- mundësi për të lehtësuar përparimin drejt arsimimit të mëtejshëm dhe drejt punësimit;
- mundësi mbështetje për t'u njohur me zhvillimet artistike bashkëkohore;
- mundësi mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, përqendrimit dhe punës artistike;
- mundësi mbështetje për t'u zhvilluar dhe për t'u formuar artistikisht duke i shërbyer vetes dhe komunitetit ku jetojnë, përmes pjesëmarrjes në veprimtari të ndryshme artistike;
- mundësi mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës artistike të punës individuale dhe në grup.

## 3. TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR SPECIALITETET

- Kanto
- Violë
- Kontrabas
- Flaut
- Oboe
- Klarinetë
- Fagot
- Saxophon
- Korno
- Trombë
- Trombon

- Kitarë
- Fizarmonikë
- Perkusion
- Harpë
- Bastuba

### 3.1. TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR SPECIALITETET SEKONDARE

- Instrument sekondar për pianistët - Harpë, kitarë bas, perkusion, instrument popullor
- Instrument Sekondar për instrumentistët – Piano

### 3.2. TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR LËNDËT TEORIKE ARTISTIKE

- Solfezh
- Harmoni
- Analizë muzikore e veprave
- Orkestracion
- Histori muzike
- Folklor muzikor


ASCAP

### 3.3. TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR LËNDËT PRAKTIKE ARTISTIKE

- Muzikë në ansambël – Vokale, Instrumentale
- Kor
- Orkestër - Harqesh, Frymë, Simfonike
- Praktikë mësimore

## 4. UDHËZIME METODIKE TË PËRGJITHSHME

Një mësues do të ketë sukses në punën e tij nëse e do shumë profesionin, ka një vesh muzikor shumë të mirë, durim, dhe implementim teknikash i të qenurit një mësues profesionist.

- Inkurajon e diskuton me durim e pasion me nxënësit për të arritur rezultatet e pritshme.
- Punon sistematikisht dhe i drejton në rrugën e saktë të studimit.
- Mësuesi duhet të përqendrohet në identifikimin e nivelit të nxënësit , aftësive të tyre , duke përdorur metodat e vlerësimit e kështu përcakton rrugën e punës me gjithë secilin.
- Përfshin një repertor të pasur e të përshtatshëm për gjithë secilin në stil e periudha të ndryshme.
- Inkurajon nxënësit në përfshirjen e tyre në aktivitete koncertale.
- Aplikon teknologjinë duke përdorur burime online dhe mjete digjitale për të shtuar një dimension të ri orës së mësimit.

Qëllimi kryesor i udhëzimeve metodologjike është të krijojë një mjedis mësues- nxënës aq dinamik dhe inkurajues. Kjo përfshin një kombinim të aftësive teknike, emocionale dhe analitike që do të ndihmojë nxënësit të zhvillojnë me dashuri e pasion të qëndrueshëm artin e të kënduarit.

## 4.1. UDHËZIME METODIKE PËR INSTRUMENTISTËT

Për të arritur një nivel sa më të mirë të lojës në instrument, nxënësi duhet edukuar të studiojë në mënyrë sa më sistematike. Në këtë proces, puna e mësuesit duhet të jetë e vazhdueshme, e thelluar dhe e lidhur ngushtë me vëzhgimin psikologjik e emocional të nxënësit, që nga hapat e para të formimit, deri në plotësimin e mjaftueshëm të tij. Për të pasur rezultate sa më të mira, trajtimi psiko emocional duhet të shtrihet gjatë gjithë vitit dhe të synojë, në radhë të parë, një administrim sa më të mirë të orës së mësimit. Përshkrimi i tematikave në të gjithë instrumentet muzikor shihet si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor të "formimit artistik te nxënësit". Realizimi i repertorit është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e lojës në instrument. Programi përmban kompleksitet i cili përbëhet nga elemente si:

- Funksionimi fizik
- Ndjeshmëria ritmike
- Ndjeshmëria muzikore
- Aftësitë emocionale
- Temperamenti
- Kujtesa muzikore
- Vullneti dhe karakteri
- Aftësi performuese në skenë

Zbërthimi i këtyre kompleksiteteve krijon kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë dhe vlerat në funksion të kompetencave artistike. Po ashtu, ndërthurja e kërkesave teknike të lojës në instrument me kërkesat artistike të veprave të veçanta, do t'i jepte orës së mësimit më shumë frymëmarrje dhe do ta bënte atë më të pëlqyeshme për nxënësin.

Në lidhje me zbatimin praktik të programit artistik, është i nevojshëm ndërgjegjësimi i nxënësit me kuptimin e tij, rëndësinë që ka secila pjesë në formimin sistematik të nxënësit dhe mundësitë që krijojnë ato për avancimin e tij gradual. Kështu, ushtrimet, etydet dhe pjesët e tjera artistike të programit duhet t'u përgjigjen grup moshave të ndryshme dhe, nga ana tjetër, t'u japin mundësi individëve më të përparuar të ecin lirshëm e pa sforcime.

Përzgjedhja e veprave duhet bërë me kujdes përpos përgatitjes, talentit dhe ecurisë së secilit nxënës. Duhet këmbëngulur në kultivimin e shijeve të sakta të lojës. Pas studimit të ngadaltë, nxënësi duhet nxitur për të luajtur (manovruar) më shpejt me materialet, por gjithnjë pa e tepruar dhe nën kontrollin e mësuesit, me perspektivën drejt vetëkontrollit.

Nxënësi duhet të ndërgjegjësohet e të perceptojë me siguri të lartë atë çfarë ai prodhon, si dhe të nxitet për të performuar në skenë.

Është mirë që në momente të caktuara të realizimit të programit, të planifikohen forma të veçanta të kontrollit të dijeve e të nivelit të nxënësit. Këto do të ishin mbështetje e sigurt për shkallët e tjera të realizimit dhe do ta ndihmonin nxënësin t'i kuptonte nga afër kërkesat e mëtejshme të mësuesit. Për këtë, edhe kontrolli i materialeve teknike dhe i pjesëve të tjera artistike të programit duhet të përputhet me shkallët e studimit të tyre: ngadalë (ushtrim e kontroll në detaje); pak më shpejt (vërtetim i studimit të saktë të materialit dhe siguri për më tej); më shpejtë ( trajtim i materialit në tempin e kërkuar nga partit) . Sipas kësaj dinamike, edhe kontrolli i përgjithshëm i dijeve do të ishte një fazë e rëndësishme në formimin e nxënësit dhe do të shërbente për një menaxhim më të mirë të mundësive dhe mangësive të tij për të ardhmen.

Për arritjen e një niveli të mirë te nxënësit, mësuesi duhet të bëjë kujdes në zgjedhjen e programit sipas nivelit të tij (duke marrë parasysh problemet teknike dhe përshtatjen e materialit artistik me karakterin e nxënësit).

Mësuesi duhet të punojë me nxënësin në mënyrë që ai të shpalosë dhe vlerat e tij individuale, në mënyrë që të mos jetë thjesht një kopje e mësuesit (mbështetur gjithmonë në materialet plotësuese teknike), por të jetë në gjendje që të arrijë një performancë sa më të bukur.

## 4.2. UDHËZIME METODIKE PËR LËNDËT TEORIKE DHE TEORIKE – PRAKTIKE

Udhëzimet dhe metodat didaktike janë të domosdoshme të ndërthuren me njëra tjetrën gjatë gjithë orës së mësimit, në përputhje me nivelin e dijeve, objektivat e lëndës, por edhe në funksion të risive të reja që mund të përdoren nga mësimdhënësit dhe nxënësit. Disa metoda përmendim:

- Metoda e shpjegimit.
- Metoda e bisedës.
- Metoda e leximit dhe punës me tekst.
- Metoda e punës me kompjuter për veprat kryesore.
- Metoda e të mësuarit dhe të nxënit ndërveprues.
- Metoda e diskutimit të lirë dhe debatit.

Për disa lëndë të tjera si Folklori, Solfezhi, Harmonia, Analiza e formës, Muzika e dhomës, Orkestra, Edukimi koral, Dirigjimi etj., metodologjia është specifike dhe bazohet në përmbajtjet mësimore (pjesë për dëgjim apo interpretim) që përzgjedh mësuesi në klasë. P.sh : Për të arritur një nivel të lartë edhe për një interpretim të saktë nxënësi duhet të deshifrojë veprën si nga ana teknike ashtu edhe muzikale.

Një moment tjetër është dëgjimi i literaturës muzikore e cila nuk duhet të mungojë në klasë. Dëgjimi i literaturës muzikore zhvillohet duke veçuar pjesët më të vështira teknike dhe duke i analizuar me mënyra dhe forma të ndryshme studimi .

Çdo mësimdhënës është i lirë të përzgjedhë nga metoda të ndryshme, për ta bërë sa më efikase procesin mësimor në klasë.

## UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi në shkollat artistike dega “Muzikë” AML, është procesi gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet mbi bazë të kritereve të caktuara, për të matur dhe për të vlerësuar të gjitha aspektet e procesit ***të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve*** ndaj muzikës, por edhe ***interpretimit/performancës artistike.*** Qëllimi kryesor i vlerësimit në degën “Muzikë” është:

- Të sigurojë informacion të plotë për arritjet e nxënësit në formimin teorik muzikor, teoriko – praktik dhe të specialitetit.
- Të sigurojë informacion për shkallën e realizimit të rezultateve të pritshme të të mësuarit në kulturën artistike.
- Të motivojë nxënësit për arritje më të larta.

Për të realizuar qëllimin e tij vlerësimi duhet të jetë: *i drejtë/i paanshëm/i ndershëm, i plotë/objektiv.* **Paanshmëria/ndershmëria** e vlerësimit garantohet nga përdorimi i kritereve të unifikuara për vlerësimin e nxënësit. Është detyrë e shkollës dhe e mësuesit që të garantojë kushtet e përshtatshme dhe motivuese të të mësuarit, duke e trajtuar procesin e vlerësimit si pjesë e procesit të të mësuarit dhe të mësimdhënies. Për këtë arsye, mësuesi duhet të planifikojë dhe të ndërtojë situata të mësuari që u japin mundësi nxënësve të realizojnë njohuritë e kurrikulës artistike në fushën e formimit muzikor - artistik si dhe t'u japë atyre mundësinë për të demonstruar shkallën e arritjes së këtyre njohurive dhe aftësive. Vlerësimi në muzikë shpreh kritere të njësuara artistike për:

- vlerësimin e njohurive teoriko-muzikore;
- krijimin e shprehive teknike;
- zotërimin e elementeve teknike sipas specialiteteve përkatëse;
- zhvillimin e potencialit interpretativ muzikor - artistik.

Mësuesi, në përputhje me parimet themelore dhe kriteret e vlerësimit, siguron kriteret e vlerësimit, të cilat përcaktohen si të domosdoshëm për të gjykuar në lidhje me njohuritë apo performancën muzikore të nxënësve.

### 4.3. LËNDËT E SPECIALITETIT.

- Klasa 10 -12 programi mësimor do të realizohet në dy periudha Shtator - Janar dhe Shkurt - Qershor.
- Vlerësimi kryhet me notë nga mësuesi i specialitetit, në bashkëpunim edhe me komisionin përmes kontrolleve teknike dhe saxhove.
- Çdo specialitet duhet të realizojë përgjatë çdo periudhe 2 kontrolle teknike, d.m.th 4 kontrolle teknike në vit.
- Çdo specialitet duhet të realizojë përgjatë çdo periudhe 1 saxho, d.m.th 2 saxho në vit.
- Nxënësit që fillojnë për herë të parë specialitetin në klasë të dhjetë (10) NUK zhvillojnë saxho dhe kontroll teknik në periudhën e parë (I). Vlerësimi në këto klasa do të jetë i vazhdueshëm nga mësuesi i specialitetit.
- Në fund të periudhës së (II) nxënësi zhvillon provimin përfundimtar (saxho) .

*Shënim:* Vlerësimi i nxënësve kryhet nga një komision, i cili përbëhet nga mësues të të njëjtit ekip lëndor. Vlerësimi i nxënësve në kontrolle teknike dhe saxho bëhet nga komisioni ku është i përfshirë dhe mësuesi i lëndës, i cili ka të drejtën e një note. Nxënësit që do të zhvillojnë lëndët me zgjedhje dhe lëndët sekondare nuk zhvillojnë kontrolle teknike, por vetëm saxho. ***Në rast se nxënësi ka kontestim note, ngrihet një komision tjetër vlerësues .***

Në provimin përfundimtar të specialitetit (saxho) dhe provimit të formimit teorik praktik nxënësit e klasës së XII-të, vlerësohen nga komisioni përzgjedhës i IA-së.

Disa kritere matës që ky komision duhet të mbajë parasysh janë:

- realizimi i veprës që luan ose këndon;
- memorie artistike gjatë interpretimit;
- pastërtia intonative e ritmike;
- stilistika dhe muzikaliteti gjatë ekzekutimit të veprave;
- impostim e lirshmëri të aparatit vokal, trupit me instrumentin apo përvetësimit të teknikës së frymëmarrjes.

## LËNDËT TEORIKE

Historia e Muzikës, Analiza e formës, Harmonia. Vlerësimi kryhet në dy periudha Shtator - Janar dhe Shkurt - Qershor.

## LËNDËT TEORIKE – PRAKTIKE

Muzika e dhomës, Orkestra, Kor, Performanca artistike. Vlerësimi kryhet në dy periudha Shtator - Janar dhe Shkurt - Qershor Shënim: Vlerësimi i nxënësve kryhet me notë nga mësuesi dhe me saxho. Këto lëndë nuk zhvillojnë Kontrolle Teknike , por vetëm dy saxho në vit.

**Dega Muzikë**

**Lënda: Solfezh**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Akordet | **Nxënësi:**<br>- Bën përsëritje e përgjithshme e A5 , A6 , A65 , D7 D65 , D43 , D2; |
| - Septakordet | - njeh gradin II7, ndërtimi, kalimi në D për t'u zgjidhur me T;<br>- njeh gradin II65, ndërtimi, kalimi në D për t'u zgjidhur me T;<br>- njeh gradin II43, ndërtimi, kalimi në D për t'u zgjidhur me T;<br>- njeh gradin II2 kalimi në D për t'u zgjidhur në T;<br>- ndërton septakordin e gradit të VII7 ndërtimi dhe zgjidhje në T;<br>- njeh gradin VII65 ndërtimin dhe zgjidhja në T;<br>- njeh gradin VII43 ndërtimi dhe zgjidhja në T;<br>- njeh gradin VII2 ndërtimi dhe zgjidhja në T6; |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Njeh temën me variacione | **Nxënësi:**<br>- përsëritjen e përgjithshme të D7, II7 dhe VII7;<br>- shkallën kromatike maxhore;<br>- shkallën kromatike minore; |

| | |
|---|---|
| - Sistemi i përgjithshëm i çelësave | - njeh rrethin e kuintave;<br>- identifikon shkallën La+ dhe Fa#- në 3 forma;<br>- njeh shkallën Mi+ dhe Do- në 3 forma;<br>- ndërton shkallën Si+, Sol#- në 3 forma;<br>- njeh shkallën Reb+, Sib- në 3 forma;<br>- njeh shkallën Fa#+, Re#- në 3 forma;<br>- identifikon shkallën Solb+, Mib- në 3 forma;<br>- identifikon shkallën Do#+, La#- në 3 forma;<br>- ndërton shkallën Dob+, Lab- në 3 forma; |
| - Format muzikore. | - njeh formën e rondos; |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Akordet | **Nxënësi:**<br>- përsëritjen e përgjithshme;<br>- shkallën kromatike maxhore;<br>- shkallën kromatike minore;<br>- akordet;<br>- septakordet; |
| - Transporti muzikor | - njeh  transportin me anën e semitonit kromatik;<br>- njeh transportin me shkrim me anë të intervalit;<br>- realizon transport me anë të çelësave.; |

| | |
|---|---|
| - Modulacioni | - modulacionin e gradit të parë; |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

- Gjatë procesit mësimor në lëndën solfezh mësuesi në çdo orë duhet të bëjë dëgjime melodike për të zhvilluar veshin melodik.
- T'i jepet rëndësi aspektit melodik për edukimin e veshit muzikor përmes dëgjimit, intonimit të akordeve përfshirë gradin II7 dhe gradin VII7.
- Të punojë ushtrime jashtë tekstit për të përforcuar njohuritë e marra.
- Të zhvillojë diktate melodike e ritmike.
- Të punojë veçmas figura ritmike.
- Të krijojë ushtrime të ndryshme duke përdorur çelësa të ndryshëm.
- Të përvetësojë karakteristikat e ndërtimit të shkallës kromatike maxhore dhe minore;
- Të punojë ushtrime jashtë tekstit për të përforcuar njohuritë e marra.
- Të zhvillojë diktate melodike e ritmike. Të punojë veçmas figura ritmike
- Të ndërtojë ushtrime duke aplikuar teknikat e ndryshme të transportit.
- Të japë ushtrime leximi dhe këndimi.
- Të punojë ushtrime jashtë tekstit për të përforcuar njohuritë e marra.
- Të realizojë diktate melodike me një e dy zëra si dhe diktate ritmike

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN**

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- lexon ushtrime të thjeshta me çelësa;
- lexon ushtrime me figurat ritmike të mësuara;
- realizon transporte të thjeshta;
- realizon diktat të thjeshtë melodik e ritmik;
- njeh shkallët kromatike maxhore/minore.

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- krijon transporte të thjeshta;
- njeh figura të ndryshme ritmike dhe me kombinime kohësh e vlerash;
- lexon ushtrime me figurat ritmike të mësuara;
- realizon pjesërisht diktatet melodike me një e dy zëra dhe diktat ritmik.

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- krijon transporte të llojeve të ndryshme;
- këndon ushtrime melodike në çelësa të ndryshëm;
- realizon diktate melodike e ritmike;
- lexon e këndon ushtrime *a prima vista;*
- këndon ushtrimet duke ruajtur intonacionin.

**Materiale dhe burime mësimore:**

| |
|---|
| - Diktate melodike Llaudin<br>- Diktate melodike Noel Gallon |

**Dega Muzikë**

**Lënda: Harmoni**

**Klasa: 11-12**

| Tematikat klasa 11 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Harmonia si mjet i rëndësishëm shprehës dhe shkenca e harmonisë.<br>- Kuintakordi kryesor dhe vendosja e tij në formacionin koral 4-zanor.<br>- Vendosja e akordit në pozicion të ngushtë dhe të gjerë. Spostimi i kuintakordi.<br>- Tonaliteti dhe funksionet kryesore tonika , subdominanta dominanta dhe logjika e zhvillimit harmonik.<br>- Lidhja e kuintakordeve kryesore ,lidhja harmonike, lidhja melodike . | **Nxënësi:**<br>- ndërton kuintakordet kryesore në një shkallë maxhore ose minore harmonike;<br>- ndërton në formacion koral 4 zanor dhe i vendos në klavir tre funksionet kryesorë, Tonikë, Subdominantë dhe Dominantë;<br>- vendos akordet kryesore në pozicion të ngushtë dhe të gjerë;<br>- ndërton lidhje harmonike dhe lidhje melodike ndërmjet tre funksioneve kryesore;<br>- harmonizon një bas të dhënë ose një melodi me tre funksionet kryesore në klavir; |

| | |
|---|---|
| - Harmonizimi i basit, harmonizimi i melodisë me përdorimin i tri funksioneve kryesore kapërcimi i tercave. | - analizon nga vepra të ndryshme të cilat ndërtohen me akordet kryesore të një shkalle muzikore; |
| **Përmbysjet e akordeve kryesore .**<br>- Kadencat :Kuartseksakordi i kadencës.<br>- Seksakordet e funksioneve kryesore.<br>- Kuartseksakordet kalues dhe ndihmës.<br>- Septakordi i dominantës dhe përmbysjet dhe zgjidhjet e tij. | - kupton ç'farë është kandenca në muzikë dhe llojet e tyre;<br>- ndërton kuartsekstakordin e kadencës K64 gjatë shembujve të dhënë;<br>- ndërton dhe lidh harmonikisht sekstakordet A6 e tre funksioneve kryesore;<br>- harmonizon një bas të dhënë ose një melodi me përmbysjet e tre funksioneve kryesorë në klavir;<br>- analizon nga vepra të ndryshme të cilat ndërtohen me seksakordet e akordeve kryesore të një shkalle muzikore;<br>- ndërton dhe lidh harmonikisht kuartsekstakordet A64 e tre funksioneve kryesore duke evidentuar kush janë A64 kalues dhe A64 ndihmës dhe mënyrën e përdorimit të tyre;<br>- harmonizon një bas të dhënë ose një melodi me përmbysjet e tre funksioneve kryesorë në klavir, duke përdorur dhe A64 kalues dhe ndihmës;<br>- ndërton Dominant septakordi D7 dhe kush janë përmbysjet dhe zgjidhjet e tij në Tonikë; |
| - Sistemi i plotë funksional i tonalitetit maxhor dhe minor (harmonik).<br>- Akordet sekondare .<br>- Kuintakordi dhe seksakordi i gradit të dytë | - kupton sistemin e plotë funksional të një tonaliteti, kush janë të gjithë akordet e një shkalle maxhore ose minore dhe roli i tyre në harmonizimin e ushtrimeve ose veprave muzikore; |

| | |
|---|---|
| - Septakordi i gradit të dytë dhe përmbysjet e tij. Kuintakordi i gradit të gjashtë.<br>- Kadenca e ndërprerë. | - ndërton akordin e gradës së dytë II , II 6 dhe II 7 me të gjitha përmbysjet bashkë me zgjidhjet gjatë ndërtimit muzikor;<br>- ndërton akordin e gradës së gjashtë VI , roli dhe zgjidhjet e tij gjatë ndërtimit muzikor. |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Sistemi i plotë funksional i tonalitetit maxhor dhe minor (harmonik).<br>- Kuintakordi i gradit të tretë.Kuintakordi dhe sekstakordi i gradit të shtatë. Septakordi i gradit të shtatë dhe përmbysjet e tij.<br>- Nonakordi i dominantes.<br>- Dominanta me sekstë.<br>- Tonaliteti minor natyral, kthesa frigjane.<br>- Sekuenca tonale diatonike.<br>- Tingujt joakordikë kalues, ndihmës, përshpejtues dhe vonues. | **Nxënësi:**<br>- kupton sistemin e plotë funksional të një tonaliteti , kush janë të gjithë akordet e një shkalle maxhore ose minore dhe roli i tyre në harmonizimin e ushtrimeve ose veprave muzikore;<br>- ndërton akordin e gradës së tretë III , roli dhe zgjidhjet e tij gjatë ndërtimit muzikor;<br>- ndërton akordin e gradës së shtatë VII ose VII7 me të gjitha përmbysjet bashkë me zgjidhjet gjatë ndërtimit muzikor;<br>- ndërton dominant nonakordin D9 dhe zgjidhjet e tij në Tonikë;<br>- ndërton dominantën me sektë D6 dhe zgjidhjet e tij në Tonikë;<br>- ndërton akordet tipike që karakterizojnë minorin natyral , kthesën frigjane dhe skemat e harmonizimit të saj;<br>- kupton , analizon dhe harmonizon shembuj me sekuenca tonale diatonike;<br>- kupton dhe analizon kush janë tingujt joakordik; |



ASCAP

| | |
|---|---|
| - Tipat e marrëdhënieve tonale - sistemi kromatik.<br>- Dubël dominanta në kadencë dhe në brendësi të ndërtimit muzikor.<br>- Sekuencat kromatike. Mënyra e realizimit të tyre.<br>- Modulacioni dhe llojet e tij.<br>- Modulacioni në tonalitetet e afërta të grupit subdominant (S).<br>- Modulacioni në tonalitetet e afërta të grupit dominant (D). | - kupton ndërtimin e sistemit kromatik dhe akordet që ndërtohen mbi këtë sistem;<br>- ndërton akordin e dubël dominantës me të gjitha përmbysjet bashkë me zgjidhjet gjatë ndërtimit muzikor ose kadencë;<br>- kupton dhe analizon shembuj me sekuenca kromatike;<br>- kupton dhe ndërton modulacione në tonalitetet e afërta ; |
| **Harmonizimi modal:**<br>- Veçoritë e harmonizimit në modet e muzikës popullore shqiptare.<br>- Veçoritë e harmonizimit sinfoxhaz.<br>- Veçoritë e harmonizimit në muzikën pop,rrock e tjerë | - kupton dhe analizon shembuj me mode diatonik ose kromatik;<br>- kupton dhe analizon kush janë elementët kryesorë të harmonisë në muzikën sinfoxhaz;<br>- kupton dhe analizon kush janë elementët kryesorë të harmonisë në muzikën pop , rrock e tjerë. |

**Shënim**: Duhet pasur kujdes që gjatë klasës së 11, temat mësimore të zhvillohen në mënyrë më të zgjeruar, duke u thelluar në ndërtimin e lidhjeve të tre funksioneve kryesore, pasi këta nxënës fillojnë teorinë e solfezhit në klasë të 10-të.

Temat që i takojnë pjesës së dytë të përmbajtjes lëndore në klasën e 12-të të jenë më pak të reduktuara për këtë kategori nxënësish.

**UDHËZIME METODOLOGJIKE:**

Gjatë procesit mësimor në lëndën harmoni mësuesi duhet të japë vazhdimisht në çdo orë mësimore ndërtimin dhe lidhjen e akordeve që ka tema , shembuj të harmonizuar dhe detyra me skema ose ushtrime me melodi ose bas të dhënë, sipas tematikës së mësipërme e cila duhet të ndiqet dhe të korrigjohet nga mësuesi me rigorozitet gjatë praktikës mësimore e cila zhvillohet në grupe të veçanta .

Mësuesi i lëndës harmoni merr nga traktate harmonie të autorëve të ndryshëm , pjesë nga vepra të repertorit klasik ose përgatit ushtrime të zgjidhura në formacion 4 zanor, duke paraqitur tek nxënësi vetëm 2 ose 3 zëra, duke i lënë nxënësit të plotësojnë zërat që mungojnë . Për disa tema nxënësit e kësaj grup moshe thjeshtë analizojnë dhe kuptojnë nga ushtrime dhe shembuj të zgjidhur ose pjesë nga literatura botërore të cilat paraqesin zhvillimin harmonik nga kompozitorët klasik botëror dhe shqiptar. Gjatë gjithë vitit shkollor jepen ushtrime dhe analiza harmonike në mënyrë që nxënësi të mos krijojë ndërprerje të mendimit formues artistik që lidhet me lëndën harmoni.

Mësuesi i lëndës harmoni duhet të njohë, të drejtojë e të nxisë veprimtarinë krijuese dhe realizuese të nxënësit, kërkohet përgatitje dhe përgjegjësi maksimale për zbatimin me sukses të programit. Ai duhet të njohë mirë përmbajtjen e programit, si dhe të jetë vazhdimisht i interesuar për të kualifikuar veten në mënyrë individuale, të krijojë një bazë të fuqishme materiale për ti paraprirë zhvillimit normal të orëve të mësimit, të transmetojë qartë përmbajtjen e temës për detyrën e re te nxënësi. Nxënësve u krijohet mundësia për të njohur e studiuar harmoninë korale, lidhjen e akordeve dhe të jetë i aftë për të hedhur në klavir detyrat dhe për të analizuar vepra të ndryshme të cilat jepen në mënyrë progresive gjatë dy viteve që zhvillohet lënda . Detyrat ose shembujt muzikorë vazhdimisht duhet të luhen në piano ose të këndohen si ushtrime korale nga nxënësit .

Gjithashtu nxënësi duhet të orientohet të frekuentojë koncerte artistike me tematikë muzikën serioze dhe të zhvillojë një mendim kritik për rolin e harmonisë në këto vepra.

Në fund të lëndës nxënësi duhet të jetë i qartë për procesin e harmonizimit si zhvillohet ai dhe kush janë kriteret për një harmonizim sa më të saktë të një melodie muzikore .

Për ata nxënës të cilët shfaqin prirje dhe kanë interes për shkrimin digjital me programe të shkrimit muzikor disa detyra sidomos gjatë klasës së 12 , mësuesi mund ti orientojë këta nxënës drejtë këtyre programeve sipas njohurisë që ka vetë, por gjithmonë pasi nxënësi ka një ecuri shumë të mirë dhe të qëndrueshme gjatë 2 viteve .

## UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:

Për vlerësimin e nxënësit duhet puna e simestrit gjatë së cilit nxënësi ka punuar çdo javë ushtrimet, skemat dhe analizat e dhëna për detyrë shtëpie dhe një test i cili bëhet çdo fund kapitulli me tematikë përmbledhëse,e cila pasqyrohet me një harmonizim basi dhe melodie nga nxënësi gjatë 45 minutave në klasë .

Duhet pasur kujdes gjatë klasës se XI që temat mësimore të zhvillohen në mënyrë të zgjeruar dhe duke u thelluar më shumë në ndërtimin dhe lidhjen e tre funksioneve kryesore, sidomos për nxënësit që fillojnë teorinë e Solfezhit në klasën e X.

Gjithashtu temat që i takojnë pjesës së dytë në klasën e XII të jenë pak më të reduktuara për këtë grup nxënësish.

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- ndërton kuintakordet bazë dhe i hedh në formacion 4 zanor ;
- harmonizon ushtrimet e dhëna por nuk i zgjidh saktë ato ;
- analizon me gabime skemat harmonike në veprat muzikore nga autorë të ndryshëm.

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- ndërton kuintakordet bazë dhe përmbysjet e tyre dhe i hedh në formacion 4 zanor ;
- harmonizon ushtrimet e dhëna me disa gabime të vogla;



ASCAP

| |
|---|
| - analizon me disa gabime skemat harmonike në veprat muzikore nga autorë të ndryshëm.<br><br>**Niveli SHUMË MIRË**<br>**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**<br><br>- ndërton kuintakordet bazë dhe sekondar , përmbysjet e tyre dhe septakordet dhe i hedh në formacion 4 zanor;<br>- harmonizon ushtrimet e dhëna saktë dhe luan skemat ose ushtrimet në piano;<br>- analizon saktë skemat harmonike në veprat muzikore nga autorë të ndryshëm. |
| **Materiale dhe burime mësimore:**<br><br>Teksti Harmonia për shkollat e mesme Vath Cangu ose Sander Cefa dhe literaturë nga kompozitorë klasik ose shqiptar .<br><br>Për plotësimin e informacionit teorik didaktik mund të përdoren dhe traktate harmonie nga vendet e tjera të europës dhe botës të cilat janë në përputhje me këtë program dhe grup moshë. |

**Dega Muzikë**

**Lënda: Analizë e veprave muzikore.**

**Klasa: 11-12**

| Tematikat klasa 11 | Rezultatet e të nxënit |
| --- | --- |
| **Objekti i lëndës:**<br><br>Konceptet formë muzikore, stil, gjini.<br><br>**Elementet kryesore të muzikës:**<br><br>- melodia,<br>- harmonia,<br>- ritmi.<br><br>**Funksionet e pjesëve në formën muzikore:**<br><br>- hyrja,<br>- tema,<br>- pjesa lidhëse,<br>- pjesa e mesit,<br>- repriza,<br>- koda<br>- parti lidhës (pjesa lidhës) | **Nxënësi :**<br><br>- njeh rolin e analizës së veprës;<br>- kupton kush janë konceptet bazë të formës;<br>- njeh elementet kryesore të muzikës;<br>- tregon funksionet e pjesëve në formën muzikore;<br>- shpjegon qartë për secilin funksion dhe rolin që kanë në një vepër;<br>- kupton logjikën e zhvillimit të formave muzikore. |
| - Periudha: | - njeh përcaktimin e periudhës; |



ASCAP

| | |
|---|---|
| - fjalia,<br>- motivi,<br>- fraza,<br>- llojet e ndryshme të periudhave;<br>- periudha si formë më vete. | - dallon veçoritë e periudhës;<br>- tregon raportet melodike-tematike;<br>- shpjegon pjesët më të vogla si fraza dhe motivi;<br>- njeh llojet e periudhave; |
| **Forma dypjesëshe e thjeshtë.**<br>- Sinjalet e para të:<br>- Midisit<br>- Reprizës | - njeh përcaktimin e formës dypjesëshe;<br>- tregon veçoritë e kësaj forme;<br>- njeh llojet e formës dypjesëshe; |
| **Forma tripjesëshe e thjeshtë.**<br>- Pjesa parë (ekspozimi)<br>- Midisi<br>- Repriza<br>- Llojet e midisit në trepjesëshin e thjeshtë. | - njeh përcaktimin e formës trepjesëshe;<br>- tregon veçoritë e kësaj forme;<br>- njeh llojet e formës trepjesëshe. |
| **Forma tripjesëshe e përbërë.**<br>- Llojet e tri pjesëshit të përbërë.<br>- Midisi episod dhe trio. | - njeh përcaktimin e formës trepjesëshe të përbërë;<br>- tregon veçoritë e kësaj forme;<br>- njeh llojet e formës trepjesëshe të përbërë; |
| **Forma rondosë**<br>- Plani i përgjithshëm. | - njeh përcaktimin e rondosë;<br>- dallon veçoritë e kësaj forme; |

| | |
|---|---|
| - Pjesët përbërëse të formës rondo.<br>- Refreni<br>- Episodi | - shpjegon zhvillimin e rondosë si formë muzikore; |
| **Tema me variacione.**<br>- Variacionet me bass ostinatto<br>- Variacionet zbukuruese.<br>- Variacionet e lira.<br>- Variacionet e tjera. | - tregon planin e përgjithshëm të temës me variacone;<br>- njeh mënyrat kryesore të variacionit;<br>- njeh llojet e ndryshme të variacioneve. |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| **Forma e sonatës**<br>**Pjesët përbërëse të sonatës:**<br>- hyrja,<br>- ekspozicioni,<br>- përpunimi,<br>- repriza,<br>- koda.<br>**Llojet e ndryshme të sonatës.**<br>- Sonata pa përpunim.<br>- Sonata me episod në vend të përpunimit. | **Nxënësi :**<br>- tregon formën e sonatës si forma më e përkryer muzikore;<br>- arrin të zbulojë dhe analizojë pjesët përbërëse të sonatës;<br>- dallon llojet e formës së sonatës; |

| | |
|---|---|
| **2. Rondo – sonata** | - tregon planin e rondo – sonatës;<br>- njeh pjesët përbërëse të saj;<br>- arrin të kuptoj ndërthurjen e dy formave muzikore rondo dhe sonatë. |
| **Format klasike.**<br>- Suita e vjetër.<br>- Suita e re. | - njeh formën e suitës;<br>- njeh zhvillimin e kësaj forme;<br>- dallon llojet e ndryshme të suitave. |
| **Cikli sonato – sinfonike:**<br>- sonata,<br>- simfonia,<br>- koha e parë e koncertit,<br>- muzika e dhomës. | - njeh ciklin sonato simfonik;<br>- dallon dhe analizon me përpikmëri kohën e parë të sonatës, simfonisë dhe koncertit;<br>- njeh nga afër dhe analizon veprat e muzikës së dhomës; |
| **Format e lira njëkohëshe:**<br>- fantazia;<br>- balada;<br>- rapsodia;<br>- poema sinfonike. | - përvetëson formën në të cilën ndërtohen veprat një kohëshe;<br>- përcakton formën e ndërtimit të veprave një kohëshe. |
| - Format muzikore në gjinitë e mëdha vokale dhe muzikore skenike. | - njeh ndërtimin e veprave të mëdha vokale;<br>- tregon pjesët përbërëse të gjinisë së operës;<br>- arrin të analizojë formën e ndërtimit të pjesëve përbërëse të operës. |

| | |
|---|---|
| - Njohuri të përgjithshme mbi operën dhe dramaturgjinë e saj.<br>- Format vokale në opera:<br>- Aria,<br>- Recitativi,<br>- Ansamblet,<br>- Kori,<br>- Baleti. | |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Metodat didaktike janë të domosdoshme të ndërthurën me njëra tjetrën gjatë gjithë orës së mësimit, në përputhje me nivelin e dijeve, objektivat e lëndës, por edhe në funksion të teknologjive të reja që mund të përdoren nga mësimdhënësit dhe nxënësit. Disa metoda përmendim:

- metoda e shpjegimit;
- metoda e bisedës;
- metoda e analizës së veprave nëpërmjet partitura të ndryshme;
- metoda e të mësuarit dhe të nxënit ndërveprues;
- metoda e diskutimit të lirë dhe debatit.

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN**

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- dallon shumë mirë formën muzikore;
- përcakton saktë karakteristikat e formës dhe veprës që ka analizë;
- tregon teorinë e formave muzikore në orën e leksionit me anë të testimeve me shkrim e gojë;
- shpjegon saktë analizat e veprave të ndryshme në orën e praktikës që shoqëron çdo temë të re në lëndën e analizës.

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- dallon mirë formën muzikore gjatë analizës;
- përcakton karakteristikat e veprave muzikore;
- është relativisht korrekt me programin mësimor;
- njeh në mënyrë të përgjithshme teorinë e analizës.

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- arrin të përcaktojë, me ndihmën e mësuesit, karakteristikat e veprave muzikore;
- arrin të njohë me vështirësi format muzikore;
- nuk tregon saktë teorinë e analizës;
- nuk është i qartë në praktikat e analizës.

**Materiale dhe burime mësimore:**

- Teksti shkollor;
- laptop;

| |
|---|
| - videoprojektor;<br>- dëgjim audio (bluetooth speaker audio);<br>- shembuj të ndryshëm partiturash. |

**Dega Muzikë**

**Lënda: Orkestracion**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 12 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| **Llojet e orkestrave** | **Nxënësi:**<br>- kupton rolin e orkestracionit në muzikë;<br>- njeh orkestrën e harqeve, orkestrën e vogël simfonike dhe orkestrën e madhe simfonike;<br>- njeh partiturën e orkestrës dhe vendosjen e instrumenteve në partiturë;<br>- njeh instrumentet me transport;<br>- transkripton fraza të shkurtra muzikore për instrumentet me transport;<br>- njeh çelësat që përdoren për çdo instrument të orkestrës;<br>- transkripton melodi të thjeshta në çelsat e solit, basit, altit dhe të tenorit; |

| | |
|---|---|
| **Grupi i harqeve** | - njeh instrumentet me hark: violinë, violë, violonçel dhe kontrabas;<br>- kupton se si janë të ndërtuara instrumentet me hark;<br>- njeh akordimin, regjistrin, lojën muzikore, mundësitë, kufizimet dhe teknikat ekzekutive të harqeve;<br>- kupton rolin kryesor të harqeve në orkestër;<br>- transkripton melodi të thjeshta për instrumentet me hark; |
| **Mënyrat e orkestrimit në orkestrën e harqeve** | - njeh mënyrat e bashkimeve në meloditë e harqeve dhe rolin në orkestër;<br>- njeh mënyrat e bashkimeve në harmonitë e harqeve dhe rolin në orkestër;<br>- transkripton për orkestër harqesh një pjesë të shkurtër pianistike; |
| **Grupi i instrumenteve frymorë dhe të drunjta** | - njeh instrumentet frymore të drunjta: flaut, piccolo, oboe, korno angleze, llojet e klarinetave, fagot dhe kontrafagot;<br>- kupton se si janë të ndërtuara instrumentet frymore të drunjta;<br>- njeh akordimin, regjistrin, lojën muzikore, mundësitë, kufizimet dhe teknikat ekzekutive të instrumenteve frymore të drunjta;<br>- kupton rolin e instrumenteve frymore të drunjta në orkestër;<br>- transkripton melodi të thjeshta për instrumentet frymore të drunjta; |
| **Bashkimi i grupeve** | - njeh mënyrat e bashkimeve në melodi të instrumenteve frymore të drunjta;<br>- njeh mënyrat e bashkimeve në harmoni të instrumenteve frymore të drunjta;<br>- transkripton për një formacion me instrumente të drunjta një pjesë të shkurtër pianistikë; |

| | |
|---|---|
| | - njeh orkestrimin për grupin e harqeve dhe atë të instrumenteve frymorë<br>- të drunjta, që të luajnë në grup: melodi, akorde dhe plane harmonike të ndryshme;<br>- transkripton melodi të thjeshta për harqe dhe instrumente frymore të drunjta, duke i grupuar në forma dhe pozicione të ndryshme; |
| **Grupi i tunxhit** | - njeh instrumentet frymorë të tunxhit: korno, trombë, trombon, tuba;<br>- kupton se si janë të ndërtuara instrumentet frymorë të tunxhit;<br>- njeh akordimin, regjistrin, lojën muzikore, mundësitë, kufizimet dhe teknikat ekzekutive të instrumenteve frymorë të tunxhit;<br>- kupton rolin e instrumenteve frymorë të tunxhit në orkestër;<br>- transkripton melodi të thjeshta për instrumentet frymorë të tunxhit; |
| **Bashkimi i grupeve** | - njeh mënyrat e bashkimeve në melodi të instrumenteve frymorë të tunxhit;<br>- njeh mënyrat e bashkimeve në harmoni të instrumenteve frymorë të tunxhit;<br>- transkripton për një formacion me instrumente frymorë të tunxhit një pjesë të shkurtër pianistike;<br>- njeh orkestrimin për grupin e instrumenteve frymorë të tunxhit dhe grupeve të tjera, që të luajnë në grup: melodi, akorde dhe plane harmonike të ndryshme; |
| **Grupi i instrumenteve me goditje (perkusion), pickim dhe tastierë.** | - njeh si janë të ndërtuara instrumentet me goditje, pickim dhe tastierë të akordueshme dhe të pa-akordueshme: timpanët, kampaneli, ksilofoni, çelesta, harpa, piano dhe vibrafoni; |

| | |
|---|---|
| | - kupton se si janë të ndërtuara instrumentet me goditje, pickim dhe tastierë të akordueshme: timpanët, kampaneli, ksilofoni, çelesta, harpa, piano dhe vibrafoni;<br>- kupton se si janë të ndërtuara instrumentet me goditje, pickim dhe tastierë të pa-akordueshme: triangolo, kastanjetat, tamburo, dajrja, pjatat, gran-kasa dhe tam-tami;<br>- njeh akordimin, regjistrin, lojën muzikore, mundësitë, kufizimet dhe teknikat ekzekutive të instrumenteve me goditje, pickim dhe tastierë;<br>- kupton rolin e instrumenteve me goditje, pickim dhe tastierë në orkestër;<br>- njeh shkrimin muzikor të instrumenteve me goditje, pickim dhe tastierë;<br>- transkripton melodi dhe ritme të thjeshta për instrumentet me goditje, pickim dhe tastierë; |
| **Baraspeshimi i forcës së tingullit dhe bashkimi i të gjitha grupeve orkestrale.** | - kupton çfarë do të thotë baraz peshim i forcës së tingullit;<br>- njeh bashkimin e timbrit të grupeve orkestrale (tutti); |
| **Disa veçori të materialit muzikor në veprat orkestrale** | - njeh llojet e dyfishimeve;<br>- njeh gërshetimin e zërave dhe të linjave;<br>- njeh ndryshimin e timbreve dhe pasimet;<br>- njeh elementët kryesorë të thurjes orkestrale: planet melodike, planet harmonike dhe pedalet orkestrale. |
| **UDHËZIME METODOLOGJIKE** | |



ASCAP

Për zbatimin e këtij programi duhet fleksibilitet nga ana e mësuesit, duke punuar dhe demonstruar me nxënësit e instrumenteve të ndryshme veçoritë timbrike të instrumenteve, si dhe përzgjedhjen e detyrave më të mira për t'u luajtur në grupe të vogla. Kështu, nxënësit dëgjojnë konkretisht gërshetimin dhe bashkëtingëllimin e instrumenteve të grupeve të veçanta për të krijuar një vizion sa më të qartë të materializimit të tingujve dhe timbrikave orkestrale.

Ora e praktikës, që shoqëron çdo temë të re në lëndën e orkestracionit, e bën të lehtë njohjen e nivelit të përgatitjeve të çdo nxënësi. Për të ilustruar shpjegimin e mësimit këshillohet të përdoren shembuj me foto - audio - video nga Cd, Dvd dhe interneti të përzgjedhura nga mësuesi.

Rekomandime për përzgjedhjen e materialeve që do të orkestrojnë në klasë:

- T. Harapi: "Minatura" ("Vals", "Një dhimbje e vogël", "Vallja e xhuxhave" etj.)
- P. Çajkovski: "Album për fëmijë"
- Tema kryesore të pjesëve që luajnë vetë nxënësit

Materiale të propozuara nga mësuesi dhe nxënësit

## UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- njeh pjesërisht grupet orkestrale dhe veçoritë timbrike të tyre;
- njeh pjesërisht cilat janë instrumentet me transport;
- përcakton pjesërisht çelësat përkatës të instrumenteve;
- njeh pjesërisht partiturat orkestrale;

- pasqyron pjesërisht përcaktimin e timbrikës së veçantë të grupeve të ndryshme në detyrat e praktikës;
- orkestron duke ruajtur mjaftueshëm: radhën në partiturë; shtrirjen e tingullit të instrumenteve; teknikat instrumentale (mundësitë dhe kufizimet); balancat e tingëllimit për grupin e harqeve, për grupin e të drunjtave, të tunxhit, për grupe dhe formacione orkestrale të ndryshme si dhe për të gjithë formacionin orkestral;

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- njeh mirë grupet orkestrale dhe veçoritë timbrike të tyre;
- njeh mirë cilat janë instrumentet me transport;
- përcakton mirë çelësat përkatës të instrumenteve;
- njeh mirë partiturat orkestrale;
- pasqyron mirë përcaktimin e timbrikës së veçantë të grupeve të ndryshme në detyrat e praktikës;
- orkestron duke ruajtur mirë: radhën në partiturë; shtrirjen e tingullit të instrumenteve; teknikat instrumentale (mundësitë dhe kufizimet); balancat e tingëllimit për grupin e harqeve, për grupin e të drunjtave, të tunxhit, për grupe dhe formacione orkestrale të ndryshme si dhe për të gjithë formacionin orkestral;

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- njeh shumë mirë grupet orkestrale dhe veçoritë timbrike të tyre;
- njeh shumë mirë cilat janë instrumentet me transport;
- përcakton shumë mirë çelësat përkatës të instrumenteve;
- njeh shumë mirë partiturat orkestrale;

- pasqyron shumë mirë përcaktimin e timbrikës së veçantë të grupeve të ndryshme në detyrat e praktikës;

orkestron duke ruajtur shumë mirë: radhën në partiturë; shtrirjen e tingullit të instrumenteve; teknikat instrumentale (mundësitë dhe kufizimet); balancat e tingëllimit për grupin e harqeve, për grupin e të drunjtave, të tunxhit, për grupe dhe formacione orkestrale të ndryshme si dhe për të gjithë formacionin orkestral;

**Materiale dhe burime mësimore:**

- Sistem audio / video
- Laptop ose Pc

**Literaturë:**

- Simoni, Gjon. Orkestrimi Për shkollën e mesme të muzikës, Shtëpia botuese e librit shkollor, Tiranë, 1977;
- shembuj nga partiturat e kompozitorëve të huaj të periudhave të ndryshme (të botuara ose të disponueshme në www.imslp.org);
- shembuj nga partiturat e kompozitorëve shqiptarë të periudhave të ndryshme; (të botuara ose të disponueshme në bibliotekën e Univesitetit të Arteve)
- shembuj audio / video të instrumenteve dhe veprave të përzgjedhura nga Cd - Dvd të ndryshme, nga interneti ose në bibliotekën online të Univesitetit të Arteve.

**Literaturë plotësuese:**

- Adler, Samuel. The Study of Orchestration, Wrth edition, W. W. Norton & Company, 2016 (me shembuj audio-video)
- Gjoni, Simon. Instrumentat dhe arti i orkestrimit, Toena, Tiranë, 2003

**Mjete plotësuese**

| |
|---|
| - Software për notizim muzikor si Finale, Sibelius ose Dorico. |

**Dega Muzikë**

**Lënda: Historia e muzikës**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| **Muzika në Antikitet**<br>- Kultura muzikore tek popujt e lashtë. | **Nxënësi:**<br>- analizon lindjen dhe zhvillimin e muzikës;<br>- shpjegon karakteristikat e zhvillimit të muzikës tek popujt e lashtë;<br>- njeh instrumentet e para muzikore; |
| **Muzika në Mesjetë**<br>- Korali Gregorian;Teoria muzikore në Mesjetë (Guido D'Arecio);Muzika laike;Muzika polifonike. | - shpjegon risitë e periudhës në mesjetë;<br>- tregon teoritë muzikore të periudhës;<br>- njeh muzikën polifonike dhe veçoritë e saj; |
| **Muzika në Rilindje**<br>- ***Rilindja*** dhe kushtet historike, sociale e kulturore të kësaj periudhe: | - njeh karakteristikat e periudhës;<br>- njeh veprat e kompozuara dhe autorët;<br>- tregon gjinitë kryesore që u zhvilluan në këtë kohë. |

| | |
|---|---|
| - Arritja më e rëndësishme e artit muzikor të Rilindjes ***Opera***.<br>- Muzika instrumentale. | |
| **Periudha Baroke**<br>- A.Koreli, A. Vivaldi, J.S.Bach;ZH.F.Hendel.<br>- Reforma e operës (K.V.Gluk) | - analizon veçoritë e periudhës;<br>- njeh kompozitorët kryesor;<br>- vlerëson tiparet e veçanta të kompozitorëve dhe të stileve që ata kanë përdorur, duke krijuar një qëndrim artistik individual. |
| **Periudha Klasike**<br>- F.J.Hajden;<br>- V.A.Moxart;<br>- L.V.Bet'hoven. | - analizon veçoritë e periudhës;<br>- njeh kompozitorët dhe veprat kryesore;<br>- tregon saktë tiparet e përgjithshme dhe të veçanta të zhvillimit të muzikës klasike; |
| **Periudha Romantike**<br>- K.M.Veber; F.Shubert; R. Shuman; F.Shopen. | - njeh periudhën e Romantizmit dhe përfaqësuesit e saj;<br>- shpjegon karakteristikat e artit romantik nëpërmjet njohjes së veprave muzikore;<br>- përdor një terminologji të saktë muzikore, duke krijuar një fjalor të pasur artistik; |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| **Muzika vokale dhe instrumentale në Romantizëm.**<br>F. Mendelson; V.Belin; Xh. Rosini; G. Donixeti; N.Paganini; Hektor Berlioz; Franc List;J. Brams; Xh. | **Nxënësi:**<br>- njeh kompozitorët kryesor; |

| | |
|---|---|
| Verdi; Sh. Guno; Zh. Bize; R. Vagner; E. Grig; B. Smetana; A. Dvorzhak; M. Glinka; M.Musorgski, A.Borodin, R. Korsakov; P. I.Çajkovski. | - vlerëson tiparet e veçanta të kompozitorëve dhe të stileve që ata kanë përdorur, duke krijuar një qëndrim artistik individual;<br>- mban mend veprat më të mira;<br>- tregon gjinitë kryesore që u zhvilluan në këtë kohë; |
| **Verizmi**<br>- P. Maskanji; R. Leonkavalo;Xh. Puçini. | - analizon veçoritë e periudhës;<br>- njeh kompozitorët kryesorë;<br>- dallon veprat më të mira. |
| **Muzika finlandeze**<br>- J. Sibelius | - shpjegon muzikën finlandeze në gjysmën e parë të shekullit XX;<br>- tregon për jetën dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë;<br>- dallon veprat kryesore të tij; |
| **Muzika hungareze**<br>- B. Bartoku | - tregon për kompozitorët më të shquar hungarezë në gjysmën e parë të shekullit XX;<br>- shpjegon jetën dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë;<br>- dallon veprat kryesore të tij. |
| **Neoklasiçizmi**<br>- I. Stravinski | - tregon jetën dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së tij;<br>- tregon veprat kryesore të tij;<br>- dallon tiparet e neoklasicizmit; |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Kultura muzikore shek. XX. | **Nxënësi :**<br>- shpjegon jetën dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së autorëve; |

| | |
|---|---|
| - B. Britten; A. Berg; A. Shenberg; A. Vebern; G.Maler; R. Shtraus; P. Hindmith; S. Rahmaninov; D. Shostakoviç; S. Prokofiev; G. Gershvin; M. Ravel; C.Saint-Saens; C. Debussy | - dallon veprat kryesore të tyre;<br>- përvetëson karakteristikat individuale të tyre;<br>- vlerëson tiparet e veçanta të kompozitorëve dhe të stileve që ata kanë përdorur, duke krijuar një qëndrim artistik individual; |
| **Kultura muzikore shqiptare në periudhën e:**<br>- Mesjetës,<br>- Rilindjes.<br>- Në periudhën e Pavarësisë.<br>- Kënga Himn (partizane). | - analizon lindjen dhe zhvillimin e muzikës shqiptare;<br>- shpjegon risitë e periudhave në muzikën shqiptare;<br>- njeh veprat më të mira; |
| - Kënga dhe romanca shqiptare.<br>- Gjinitë e mëdha të muzikës vokale shqiptare:<br>- opera e parë shqiptare "Mrika";<br>- "Lulja e Kujtimit";<br>- "Skënderbeu" . | - njeh këngët, romancat dhe operat kryesore;<br>- njeh kompozitorët që shkruan në këto gjini;<br>- tregon zhvillimin e gjinisë operistike. |
| **Muzika e baleteve shqiptare:**<br>- baleti i parë shqiptar - "Halili dhe Hajria";<br>- "Delina";<br>- "Cuca e maleve". | - shpjegon zhvillimin e baletit shqiptar;<br>- njeh baletet dhe kompozitorët përkatës;<br>- analizon baletet kryesore. |
| **Muzika instrumentale shqiptare:** | - tregon gjinitë kryesore instrumentale;<br>- njeh kompozitorët kryesor të muzikës instrumentale; |

| | |
|---|---|
| - Miniatura.<br>- Balada.<br>- Sonata<br>- Muzika e dhomës<br>- Koncertet instrumentale<br>- Rapsoditë<br>- Uvertura<br>- Suita<br>- Vallja simfonike<br>- Poemi simfonik<br>- Simfonitë. | - shpjegon veçoritë për secilën gjini;<br>- dallon stilet duke krijuar një qëndrim artistik individual. |
| - Muzika e filmit<br>- Përfaqësuesit e saj | - tregon zhvillimin e muzikës së filmit;<br>- njeh kompozitorët kryesorë;<br>- dallon stilet e tyre. |
| - Muzika kosovare<br>**Përfaqësuesit e saj** | - tregon zhvillimin e muzikës së filmit;<br>- njeh kompozitorët kryesor;<br>- dallon risitë e secilit kompozitor. |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Metodat didaktike janë të domosdoshme të ndërthurën me njëra tjetrën gjatë gjithë orës së mësimit, në përputhje me nivelin e dijeve, objektivat e lëndës, por edhe në funksion të teknologjive të reja që mund të përdoren nga mësimdhënësit dhe nxënësit. Disa metoda përmendim:

- metoda e shpjegimit;
- metoda e bisedës;
- metoda e leximit dhe punës me tekst;
- metoda e punës me kompjuter për veprat kryesore;
- metoda e të mësuarit dhe të nxënit ndërveprues;
- metoda e diskutimit të lirë dhe debatit.

## UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- dallon shumë mirë muzikën që studion sipas periudhave historike muzikore dhe përfaqësuesit e saj;
- përcakton saktë karakteristikat e veprave muzikore sipas periudhave historike muzikore;
- shpjegon qartë dhe natyrshëm lindjen dhe zhvillimin e operës, baletit dhe të gjinive të tjera instrumentale;
- shpreh qartë dhe natyrshëm shijet artistike nëpërmjet dëgjimit të literaturës muzikore;
- vlerëson duke mbajtur një qëndrim të drejtë ndaj veprave muzikore sipas periudhave historike muzikore.

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- dallon mirë muzikën sipas periudhave historike muzikore dhe përfaqësuesit e saj;
- përcakton karakteristikat e veprave muzikore sipas periudhave historike muzikore;
- shpjegon lindjen dhe zhvillimin e operës, baletit dhe gjinive të tjera instrumentale;
- shpreh shijet artistike nëpërmjet dëgjimit të literaturës muzikore;

- vlerëson duke mbajtur një qëndrim ndaj veprave muzikore sipas periudhave historike muzikore.

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- arrin të flasë me vështirësi për muzikën sipas periudhave historike muzikore dhe përfaqësuesit e saj;
- arrin të përcaktojë, me ndihmën e mësuesit, karakteristikat e veprave muzikore sipas periudhave historike muzikore;
- përshkruan, me ndihmën e mësuesit, lindjen dhe zhvillimin e operës, baletit dhe gjinive të tjera instrumentale sipas periudhave historike muzikore;
- flet jo qartë për veprat muzikore nëpërmjet dëgjimit të literaturës muzikore.

**Materiale dhe burime mësimore:**

- Teksti shkollor;
- laptop;
- video projektor;
- dëgjim audio (bluetooth speaker audio);
- foto dhe video ilustruese.

**Dega Muzikë**

**Lënda: Folklor Muzikor**

**Klasa: 10-11**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| **Folklori ynë muzikor.**<br>- Mjetet shprehëse të muzikës , ritmika.<br>- Ritmet e thjeshta<br>- Ritmet e përbëra<br>- Ritmet e përziera<br>- Ritmet e çrregullta dhe të lira | **Nxënësi:**<br>- njeh elementët ritmikë që karakterizojnë folklorin tonë muzikor;<br>- njeh dhe lexon ritmet e thjeshta , të përbëra dhe të përziera në shembujt e e muzikës tonë folklorike .<br>- gjen saktë në shembujt e ndryshëm muzikorë: ritmet (5,6,7,8,9,10,11,12 pjesëtuese); |
| **Organografia ;**<br>- Veglat muzikore të popullit tonë<br>- Mjetet trupore të kumbimit.<br>- Veglat Idiofone.<br>- Veglat membranofone<br>- Veglat aerofone<br>- Veglat kordofone dhe veglat kordofone me hark<br>- Veglat e temperuara<br>- Formacionet dhe ansamblet popullore. | - dallon instrumentet popullore muzikore sipas grupeve që janë klasifikuar dhe krahinën së cilës i përkasin , lojës dhe ndërtimit që kanë;<br>- analizon zhvillimin e folklorit muzikor në tërësinë e tij në periudha të ndryshme, duke nxjerrë veçoritë përkatëse të instrumenteve sipas trevave ; |

| | |
|---|---|
| **Lirika popullore :**<br>- Këngët e djepit.<br>- Këngët e punës.<br>- Këngët e dasmës.<br>- Këngët e kurbetit .<br>- Këngët e epikës legjendare.<br>- Cikli i kreshnikëve.<br>- Baladat.<br>- Këngët e rilindjes kombëtare, periudha e pavarësisë. | - njeh dhe kupton tematikën letrare të folklorit tonë duke dhënë dhe karakteristikat letrare dhe muzikore të çdo grupi këngësh të cilat janë dhe të notizuara sipas këtyre kritereve që janë renditur . |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Melodika e muzikës tonë popullore dhe elementët përbërës të saj.<br>- Shtirja e joneve të muzikës tonë popullore:<br>- jonet bikortale; jonet trikordale; tetrakordale ;<br>- pentakordale; jonet hegzakordale.<br>- strukturat tonalo-modale; Shkallët tetratonike;<br>- Shkallët pentatonike; shkallët hegzatonike; | **Nxënësi:**<br>- kupton Shkallët që përbëjnë folklorin tonë muzikor;<br>- kupton kush janë jonet popullore , si ndërtohen dhe klasifikohen ato;<br>- ekzekuton me zë ose instrument këto jone në mënyrë sa më praktike dhe të qartë;<br>- ekzekuton me zë ose instrument shembuj të ndryshëm nga folklori jonë muzikor të cilët kanë në ndërtimin e tyre këto jone; |
| **Modet e lashta diatonike:**<br>- modi jonian; | - kupton kush janë modet e lashta diatonike, historiku i tyre dhe si ndërtohen dhe klasifikohen ato; |

| | |
|---|---|
| - modi dorian ; modi frigjan ;modi lidian ;<br>- modi miksolidian ;modi euljan ; modi lokrian;<br>**Modet kromatik:**<br>- shkalla kromatike tërthori i dytë , Perdet e ahengut qytetar (muzikës popullore)<br>**Perdet:**<br>- dyqah, zir , gjyse, raas , sergjah , huzam, nervish , divan, sabahi, leva , nihaved , divan. | - ekzekuton me zë ose instrument këto mode në mënyrë sa më praktike dhe të qartë;<br>- ekzekuton me zë ose instrument shembuj të ndryshëm nga folklori jonë muzikor të cilët kanë në ndërtimin e tyre këto mode diatonike;<br>- kupton kush janë modet kromatik , historiku i tyre dhe si ndërtohen dhe klasifikohen ato;<br>- ekzekuton me zë ose instrument këto mode në mënyre sa më praktike dhe të qartë;<br>- ekzekuton me zë ose instrument shembuj të ndryshëm nga folklori jonë muzikor të cilët kanë në ndërtimin e tyre këto mode kromatik ; |
| - Vështrim i përgjithshëm rreth polifonisë sonë popullore .<br>- Vështrim i përgjithshëm rreth muzikës tonë popullore qytetare me instrumente. Modulacionet në muzikën tonë popullore.<br>- Vështrim i përgjithshëm rreth drejtshkrimit dhe transkiptimit të muzikës sonë popullore. | - shpjegon karakteristikat dhe vlerat e muzikës homofonike dhe polifonike dhe vendin që zë ajo në muzikën tonë popullore folklorike;<br>- argumenton shembuj konkretë të folklorit muzikor nga treva të ndryshme;<br>- kupton procesin e transkiptimit ose notizimit të muzikës problemet dhe detajet që duhet të ketë parasysh . |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Gjatë procesit mësimor në lëndën folklor muzikor mësuesi duhet të njohë nxënësin me tematikat kryesore që e karakterizojnë atë duke vënë në dukje veçoritë dhe karakteristikat e tij .

Nxënësi duhet të kuptojë ritmet dhe shkallët muzikore kryesore mbi të cilat mbështetet folklori jonë muzikor, gjithashtu duhet të njohë instrumentet popullor me të cilët është luajtur muzika popullore shqiptare në të gjithë trevat shqiptare dhe si ka evoluar ajo deri në ditët tona Ora mësimore herë pas here duhet të shoqërohet me këndimin praktik të pjesëve muzikore folklorike që i gjejmë nga studiues të ndryshëm të folklorit të cilat duhet të analizohen për nga struktura ritmike , melodike dhe letrare duke nxjerrë në pah veçoritë kryesore . Për kapitullin ritmika mësuesi duhet të referohet në shembuj të ndryshëm nga lënda teori solfezhi dhe shembuj muzikor p.sh. nga Morfologjia ose autorë të ndryshëm shqiptar të cilët kanë botime të tilla . E njëjta gjë dhe për kapitujt melodika dhe lirika popullore duke analizuar me specifikat e secilit kapitull. Gjithashtu nxënësi duhet të orientohet të ndjekë muze etnografike me tematikë artin popullor ku mund të gjenden dhe instrumente muzikore ose detaje nga kultura muzikore shekullore shqiptare.

Në fund të lëndës nxënësi duhet të jetë i qartë se çfarë përfaqëson folklori muzikor shqiptar dhe kush janë elementët kryesor të tij gjithashtu njohuritë gjatë dy viteve dhe programi i lëndës folklor muzikor të jetë një parantezë të plotë për ata nxënës të cilët do të zhvillojnë më tej studimet akademike në këtë fushë . Mësuesi i lëndës folklor muzikor duhet të njohë, të drejtojë e të nxisë veprimtarinë krijuese dhe realizuese të nxënësit, kërkohet përgatitje dhe përgjegjësi maksimale për zbatimin me sukses të programit.

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:**

**Klasa 10**

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- kupton ndërtimin e ritmeve;
- kupton kush janë instrumentet popullor shqiptar;
- kupton si zhvillohet lirika popullore në folklorin tonë muzikor;
- bëhet pjesë aktive e klasës kur shembujt muzikor luhen ose këndohen gjatë orës mësimore .

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- kupton ndërtimin e ritmeve dhe i specifikon ato sipas grupit ku bëjnë pjesë;
- kupton kush janë instrumentet popullor shqiptar dhe si ndërtohen ato;
- kupton si zhvillohet lirika popullore në folklorin tonë muzikor dhe kush është tematika kryesore e saj;
- është pjesë aktive e klasës kur shembujt muzikor luhen ose këndohen gjatë orës mësimore .

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- kupton ndërtimin e ritmeve dhe i specifikon ato sipas grupit ku bëjnë pjesë;
- kupton kush janë instrumentet popullor shqiptar dhe si ndërtohen ato , loja instrumentale e tyre dhe zona ku i gjejmë këto instrumenta;
- kupton si zhvillohet lirika popullore në folklorin tonë muzikor dhe kush është tematika kryesore e saj duke i analizuar dhe nga ana letrare shembujt që jepen gjatë orës së mësimit;
- është pjesë aktive e klasës kur shembujt muzikor luhen ose këndohen gjatë orës mësimore .

**Klasa 11**

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- kupton ndërtimin e joneve popullore;
- kupton kush janë modet diatonik dhe modet kromatik;
- kupton kush është muzika polifonike dhe homofonike;
- bëhet pjesë aktive e klasës kur shembujt muzikor luhen ose këndohen gjatë orës mësimore .

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- kupton ndërtimin e joneve popullore dhe si ndërtohen ato;
- kupton kush janë modet diatonik dhe modet kromatik dhe si ndërtohen ato;
- kupton kush  është muzika polifonike dhe homofonike bashkë me veçoritë dhe karakteristikat e tyre;
- bëhet pjesë aktive e klasës kur shembujt muzikor luhen ose  këndohen gjatë orës mësimore .

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- kupton ndërtimin e joneve popullore  si ndërtohen ato dhe ku i gjejmë në shembujt e dhënë;
- kupton kush janë modet diatonik dhe modet kromatik si ndërtohen ato dhe ku i gjejmë në shembujt e dhënë;
- kupton kush  është muzika polifonike dhe homofonike bashkë me veçoritë dhe karakteristikat e tyre;
- bëhet pjesë aktive e klasës kur shembujt muzikor luhen ose  këndohen gjatë orës mësimore;
- shfaq interes për mënyrën e transkiptimit muzikor .

**Materiale dhe burime mësimore:**

Morfologjia R. Sokoli , Organografia  P. Miso R. Sokoli ,  Folklori Letrar .

**Dega Muzikë**

**Lënda: Muzikë në ansambël (Vokale dhe instrumentale)**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| **Vepra muzikore nga kompozitorë të huaj:**<br>- Wolfgang Amadeus Mozart.Franz Joseph Hayden.<br>- Antonio Salieri.Carl Philipp Emanuel Bach.<br>- Ludwig Van Beethoven.Richard Wagner.Claude Debussy.<br>- Pyotr Ilyich Tchaikovsky.Frederic Chopin.Antonio Vivaldi. | **Nxënësi:**<br>- njeh veprën dhe analizën e periudhës, stilit dhe teknikën;<br>- kupton stilin dhe shkallën e vështirësisë teknike të veprës;<br>- përcakton metodat e studimit për të realizuar veprën teknikisht edhe muzikalisht. |
| **Vepra muzikore nga kompozitorë të huaj:**<br>- Hector Berlioz.Georges Bizet.Johannes Brahms.<br>- Antonin Dvorak. Edvard Greig. Franz List.<br>- Gustav Mahler.Giacomo Puccini.Franz Schubert.<br>- Robert Schumann. Giuseppe Verdi. | - luan pastër nga ana intonative dhe teknikisht;<br>- interpreton bukur dhe në karakter veprën, luan saktë ritmikisht, luan qartë melodikisht edhe me tingull të plotë;<br>- ekzekuton stilin në të cilin bën pjesë autori edhe realizon karakterin e veprës së këtij autori; |
| **Vepra muzikore nga kompozitorë të huaj:**<br>- Johann Sebastian Bach.George Frederic Handel. | - punon në drejtim të bashkëtingëllimit të lojës në grupe, vetëm në këtë mënyrë;<br>- realizohet një vepër me nivel të lartë artistike;<br>- demonstron aftësi gjatë performimit në skenë; |

| | |
|---|---|
| - George Philipp Telemann.Domenico Scarlatti.Henry Pucell.Arcangelo Corelli.Jean Philippe Romean.<br>**Vepra nga kompozitorë shqiptarë**<br>- I Spahiu.Agim Krajka.Aleksander Peci.<br>- Simon Gjoni.Prenk Jakova.<br>- Tonin Hrapi.Feim Ibrahimi.Tonin Rrota.<br>- Isak Shehu. Nikolla Zoraqi.Cesk Zadeja. | |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| **Vepra nga kompozitorë të huaj**<br>- Wolfgang Amadeus Mozart.Franz Joseph Hayden.<br>- Antonio Salieri.Carl Philipp Emanuel Bach.<br>- Ludovig Van Beethoven.Richard Ëagner.Claude Debussy.<br>- Pyotr Ilyich Tchaikovsky.Frederic Chopin.Antonio Vivaldi. | **Nxënësi:**<br>- njeh veprën dhe analizën e periudhës, stilit dhe të teknikës;<br>- kupton stilin dhe shkallën e vështirësisë teknike të veprës;<br>- përcakton metodat e studimit për të realizuar veprën teknikisht edhe muzikalisht. |
| **Vepra nga kompozitorë të huaj**<br>- Hector Berlioz.Georges Bizet.Johannes Brahms.<br>- Antonin Dvorak.Edvard Greig.Franz List.<br>- Gustav Mahler.Giacomo Puccini.Franz Schubert. | - luan pastër nga ana intonative edhe teknikisht;<br>- interpreton bukur dhe në karakter veprën, luan saktë ritmikish, luan qartë melodikish edhe me tingull të plotë; |

| | |
|---|---|
| - Robert Schumann.Giuseppe Verdi. | - ekzekuton stilin në të cilin bën pjesë autori edhe realizon karakterin e veprës së këtij autori. |
| **Vepra nga kompozitorë të huaj**<br>- Johann Sebastian Bach.George Frederic Handel.<br>- George Philipp Telemann.Domenico Scarlatti.Henry Pucell.Arcangelo Corelli.Jean Philippe Romean.<br>**Vepra nga kompozitorë shqiptarë**<br>- I Spahiu.Agim Krajka.Aleksander Peci.<br>- Simon Gjoni.Prenk Jakova.<br>- Tonin Hrapi.Feim Ibrahimi.Tonin Rrota.<br>- Isak Shehu. Nikolla Zoraqi.Cesk Zadeja. | - punon në drejtim të bashkëtingëllimit të lojës në grupe, vetëm në këtë mënyrë realizohet një vepër me nivel të lartë artistik;<br>- demonstron elementet artistike si: muzikalitet, stilistike, teknike, gjatë<br>- performimit në skenë; |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| **Vepra nga kompozitorë të huaj**<br>- Wolfgang Amadeus, Mozart.Franz, Joseph Hayden.<br>- Antonio Salieri, Carl Philipp, Emanuel Bach.<br>- Ludwig Van Beethoven, Richard Wagner, Claude Debussy.<br>- Pyotr Ilyich Tchaikovsky, Frederic Chopin, Antonio Vivaldi. | **Nxënësi:**<br>- Njeh vepren dhe analizimin e periudhes, stilit dhe te teknikes.<br>- Kupton stilin dhe shkallen e veshtiresise teknike te vepres.<br>- Percakton metodat e studimit per te realizuar vepren teknikishte edhe muzikalisht |

| | |
|---|---|
| **Vepra nga kompozitorë të huaj**<br>- Hector Berlioz.Georges Bizet.Johannes Brahms.<br>- Antonin Dvorak.Edvard Greig.Franz List.<br>- Gustav Mahler.Giacomo Puccini.Franz Schubert.<br>- Robert Schumann.Giuseppe Verdi. | - luan paster nga ana intonative edhe teknikish.<br>- interpreton bukur dhe ne karakter vepren, luan sakte ritmikish, luan qarte melodikish edhe me tingull te plote.<br>- ekzekuton stilin ne te cilin ben pjese autori edhe realizone karakterin e vepres se ketij autori. |
| **Vepra nga kompozitorë të huaj**<br>- Johann Sebastian Bach.George Frederic Handel.<br>- George Philipp Telemann.Domenico Scarlatti.Henry Pucell.Arcangelo Corelli.Jean Philippe Romean.<br>**Vepra nga kompozitorë shqiptarë**<br>- I Spahiu.Agim Krajka.Aleksander Peci.<br>- Simon Gjoni.Prenk Jakova.<br>- Tonin Hrapi.Feim Ibrahimi.Tonin Rrota.<br>- Isak Shehu. Nikolla Zoraqi.Cesk Zadeja. | - punon ne drejtim te bashketingellimit te lojes ne grupe, vetem ne kete menyre realizohet nje veper me nivel te larte artistike.<br>- demostron elementetartistike si: muzikalitet, stilistike, teknike, gjate performimit ne skene. |

**UDHEZIME METODOLOGJIKE**

Për të arritur një nivel të lartë edhe për një interpretim të saktë nxënësi duhet të deshifrojë veprën si nga ana teknike ashtu edhe muzikale.

Një nga detyrat kryesore që duhet të bëjë nxënësi është dëgjimi i literaturës muzikore(e cila nuk duhet të mungojë as edhe në klasë).

Duke veçuar pjesët më të vështira teknike dhe duke i studiuar me mënyra dhe forma të ndryshme studimi.

Pasi ka realizuar këto metoda duhet punuar nga ana muzikale.

**UDHEZIME PER VLERESIMIN**

Vlerësimi i muzikës në ansambël pavarësisht se luhet në grupe, vlerësimi bëhet nga ana e pedagogut sipas aftësive dhe frekuentimit që bën secili nxënës në orën e mësimit.

Vlerësimi përcaktohet në tri nivele.

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- nxënësi luan jo korrektë në ritëm, me tingull mesatar, me intonacion jo të këndshëm dhe me **Shkallë** shpejtësie të dobët.
- forma e vetme që gjithë secili pasqyron nivelin e tij artistik është skena ku ata interpretojnë.

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- luan relativisht mirë ritmikisht, me tingull të plotë dhe me intonacion të pastër.

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- nxënësi luan me të gjitha elementet e mësipërme.

**Materiale dhe burime mësimore:**

Instrumenti, Lexhio, Partiturë, Sistem audio-video TIK, Internet.

**Dega Muzikë**

**Lënda: Kor**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Warm up. Vokaliza dhe ushtrime ritmike për të realizuar ngrohjen e aparatit të të kënduarit. | **Nxënësi:**<br>- njohin dhe realizojnë me saktësi vokalizat dhe ushtrimet ritmike e trupore që shërbejnë si warm up; |
| - Kanone të ndryshëm për të pregatitur ansamblin në këndimin me shumë zëra. | - njohin sa më mirë partin e sektorit ku bën pjesë dhe më pas e këndojnë atë saktësisht; |
| - Vepra me dy, tre dhe katër zëra nga kompozitorë të ndryshëm shqiptar dhe të huaj.<br>- P.Jakova, Ç.Zadeja, Lv.Beethoven, L.Kurti, M.Koliqi, T.Daija, J.S.Bach, etj | - këndojnë saktësisht partin e sektorit ku bëjnë pjesë pavarësisht presionit të zërave të tjerë, kur këndojnë së bashku; |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Warm up. Vokaliza dhe ushtrime ritmike për të realizuar ngrohjen e aparatit të të kënduarit. | **Nxënësi:**<br>- Realizojnë një tingëllim sa më të pastër në veprat me dy, tre dhe katër zëra; |
| - Kanone të ndryshëm për të pregatitur ansamblin në këndimin me shumë zëra. | - njohin dhe interpretojnë me saktësi partin e tyre pavarësisht presionit të zërave të tjerë; |

| | |
|---|---|
| - Vepra me dy, tre dhe katër zëra nga kompozitorë të ndryshëm shqiptar dhe të huaj.<br>- P.Jakova, Ç.Zadeja, Lv.Beethoven, L.Kurti, M.Koliqi, T.Daija, J.S.Bach, G.Gershëin,<br>- **M.Jackson, Carl Orff, L.Bernstain, etj.** | - krijojnë siguri në interpretimin e partit të sektorit ku bëjnë pjesë.<br>- interpretojnë me saktësi vepra të të gjitha kohërave dhe stileve që bëjnë pjesë në repertorin e korit; |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Warm up. Vokaliza dhe ushtrime ritmike për të realizuar ngrohjen e aparatit të të kënduarit. | **Nxënësi:**<br>- njohin dhe zbërthejnë me saktësi partet korale të sektorit ku ai bën pjesë; |
| - Kanone të ndryshëm për të pregatitur ansamblin në këndimin me shumë zëra. | - njohin dhe zbërthejnë me saktësi partet korale ritmike dhe inovative; |
| - Vepra me dy, tre dhe katër zëra nga kompozitorë të ndryshëm shqiptar dhe të huaj.<br>- P.Jakova, Ç.Zadeja, Lv.Beethoven, L.Kurti, M.Koliqi, T.Daija, J.S.Bach, G.Gershëin,<br>- M.Jackson, Carl Orff, L.Bernstain, J. Papulias. | - këndojnë të sigurt në ansambël duke ruajtur balancat e tingëllimit;<br>- interpretojnë me saktësi vepra të të gjitha kohërave dhe stileve që bëjnë pjesë në repertorin e korit; |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

- Për të arritur një tingëllim sa më profesional të ansamblit koral mësuesi dirigjent duhet të punojë më parë me zërat e veçantë (sopran, alt, tenor, bass) dhe më pas të bëjë bashkimin gradual të zërave, deri në bashkimin përfundimtar të zërave.



ASCAP

- Mësuesi dirigjent duhet të përzgjedhë me kujdes repertorin që do të interpretojë ansambli koral duke e përshtatur atë me aftësitë dhe mundësitë e nxënësve që marrin pjesë në të.

Veprat e përzgjedhura duhet ti përshtaten grup moshës dhe mundësive shprehëse emocionale të nxënësve që marrin pjesë në ansamblin koral.

## UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- janë pjesë aktive në zhvillimin e provave në sektor dhe njohin shumë mirë repertorin;
- mësojnë dhe interpretojnë me saktësi inovative dhe emocionale veprat e stileve të ndryshme që bëjnë pjesë në repertorin e ansamblit koral;
- performojnë me një nivel të lartë bashkëtingëllimi në koncerte apo aktivitete të ndryshme që organizon shkolla.

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- janë pjesë aktive në zhvillimin e provave në sektor dhe njohin mirë repertorin;
- mësojnë dhe interpretojnë në nivel mesatar veprat e stileve të ndryshme që bëjnë pjesë në repertorin e ansamblit koral;
- performojnë me një nivel të mirë në koncerte apo aktivitete të ndryshme që organizon shkolla.

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- është jo aktiv në zhvillimin e provave në sektor dhe nuk njeh mirë repertorin;
- nuk është në gjendje të interpretojë pastër partin e sektorit të tij kur janë të gjithë zërat së bashku;
- nuk është në gjendje të interpretojë me saktësi inovative veprat e stileve të ndryshme që janë pjesë e ansamblit koral.

**Materiale dhe burime mësimore:**

Vepra të ndryshme korale nga kompozitorë të njohur shqiptarë dhe të huaj.

P.Jakova, C. Zadeja, F.Ibrahimi, L.v.Beethoven, G.Verdi, J.Papulias, M. Jackson, G. Gershëin, R. Schumann, J. Brahms.

**Dega Muzikë**

**Lënda: Orkestër (Harqe-Frymë-Sinfonike)**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10-11-12 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Periudha baroke<br><br>- Periudha klasike<br><br>- Periudha romantike - moderne/bashkëkohore | **Nxënësi:**<br>- zbërthen partet orkestrale, me saktësi ritmike dhe pastërti inovative;<br>- krijon bashkëpunim dhe pavarësi në lojën në orkestër;<br>- thellon njohjen e stileve dhe gjinive të ndryshme muzikore, sipas karakteristikave të periudhës dhe kompozitorëve, duke studiuar dhe interpretuar partet orkestrale në instrumentin e tij;<br>- njeh lojën e interpretimit në ansambël duke u bërë kompetent në gjykimin dhe vlerësimin e saj;<br>- gjykon në mënyrë kritike dhe të drejtë mesazhin muzikor të veprës; |

| | |
|---|---|
| - Muzika shqip | - i përgjigjet kërkesave historike - artistike dhe stilistike që kërkon lënda, analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke i evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal;<br>- krijon besimin tek vetja, në rolin që ndërmerr gjatë lojës në ansambël;<br>- zhvillon punë të detajuar me instrumentistët e frymës për një intonacion gjithmonë korrekt;<br>- përjeton konkretisht veprat muzikore, përmes interpretimit në ansambël;<br>- komunikon dhe shprehet nëpërmjet interpretimit muzikor në mënyrë të vazhdueshme duke ndjekur dirigjentin;<br>- njeh veçoritë e muzikës që luan, për ti dhënë veprës karakterin e duhur;<br>- vendos harkata të sakta duke unifikuar ekzekutimin e të gjitha grupeve;<br>- luan në ansambël duke ruajtur balancat e tingëllimit, si dhe veçoritë stilistike të veprës;<br>- krijon raporte të drejta të tingëllimit në grupin e tij dhe midis grupeve të tjera të orkestrës;<br>- zotëron karakteristikat e orkestrantit, i cili duhet të luajë në instrument e të dëgjojë njëkohësisht instrumentet rrotull tij; |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Metodologjia e përdorur udhëhiqet nga parime të përgjithshme sipas të cilave mësimi duhet të jetë:

- i orientuar drejt ekzekutimit muzikor: teknika duhet të jetë funksionale për zgjidhjen e problemeve të lojës muzikore në orkestër dhe thellimin e studimit individual;
- i finalizuar me praktikën kolektive muzikore: pjesët e studiuara nga nxënësit duhet të përgatiten nga mësuesi në bazë të formacionit orkestral dhe nivelit teknik të tyre;
- i dobishëm për zhvillimin e aftësisë për të dëgjuar, analizuar dhe vlerësuar: për zhvillimin e një ndërgjegjeje analitike dhe kritike;
- i përshtatshëm për zhvillimin e kreativitetit individual: që të aktivizojë nxënësin nga të gjitha këndvështrimet dhe ta drejtojë atë drejt muzikalitetit shprehës dhe komunikues.

**Udhëzime praktike:**

- Ushtrime sinkronizimi në orkestër duke luajtur shkallë muzikore me teknika, dinamika dhe temp të ndryshueshëm nga mësuesi që i dirigjon (legato – staccato, forte – piano, accelerando – ritenuto, corona, etj).
- Sipas periudhës përkatëse mësuesi dirigjent shpjegon stilistikën, specifikat përkatëse dhe karakterin e veprës që nxënësit do të luajnë.
- Zbërthimi i partiturave me anë të leximit “a prima vista”.
- Punimi i parteve të grupeve të veçanta në orkestrën e harqeve, duke përcaktuar harkatat.
- Puna me grupet, duke kërkuar pastërti në intonacion, e më pas lidhja e të gjitha grupeve.
- Puna me orkestrën e harqeve për lojën e saktë dhe për evidentimin e karakterit të veprave.
- Nxënësi interpreton në orkestër, duke ndjekur partin orkestral dhe lojën e mësuesit dirigjent.
- Provat orkestrale zhvillohen duke u kujdesur që tempi i veprës gjatë provave të jetë i përshtatshëm për të gjithë nxënësit, deri sa të arrihet siguria e duhur për të luajtur veprën me tempin e saj.
- Sipas numrit të nxënësve instrumentistë që janë në orkestër për vitin shkollor përkatës, mund të përdoren pjesë për formacione më të reduktuara - nga okteti deri në duo.

**Përzgjedhja e repertorit**

- Mësuesi mund të përzgjedhë repertor origjinal ose transkriptime për orkestër të stileve dhe epokave të ndryshme, nga periudha e muzikës klasike deri në muzikën bashkëkohore, duke përfshirë edhe muzikën e kompozitorëve shqiptarë:
- Periudha baroke dhe klasike: vepra për orkestër ose transkriptime (Vivaldi, Corelli, Bach, Haydn, Mozart, Beethoven e të tjerë).
- Periudha romantike: vepra për orkestër ose transkriptime (Schumann, Gounod, Strauss, Sousa, Ëagner, Tchaikovsky, Mendelssohn, Rossini, Verdi, Grieg, e të tjerë).
- Periudha moderne dhe bashkëkohore: vepra për orkestër ose transkriptime (Holst, Jenkins, Copland, Shostakovich, Briten, Bartok, Dvorak, Holst, Bernstein, Gershëin, Williams, Morricone e të tjerë).
- Muzika shqiptare: vepra për orkestër ose transkriptime nga kompozitorët shqiptarë (Jakova, Zadeja, Daija, Gjoni, Harapi, Zoraqi, Simoni, Dh. Leka, Ibrahimi, Laro, Kushta, Dizdari, Peci, Krajka, Zaharjan, I. Shehu, Tole, Sina, Kraja, Cene, Naçi e të tjerë.)
- Repertori mund të përzgjidhet edhe sipas kërkesave artistike që mund të lindin për realizimin e koncerteve dhe aktiviteteve që
- Organizon shkolla në kuadër të festave zyrtare apo evenimenteve të ndryshme (binjakëzimet midis shkollave, festivale, etj.).

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN**

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- njeh dhe luan me saktësi të mjaftueshme partin e tij pas përfundimit të të gjitha provave orkestrale të çdo vepre;
- ruan mjaftueshëm balancat në tingëllim;
- ruan mjaftueshëm raportin e tingëllimit midis tij, grupit të tij dhe grupeve të tjera orkestrale;
- i afrohet me lojën e tij karakterit të veprave;
- ndjek mjaftueshëm njëkohësisht partin orkestral, harkatat dhe gjestet e mësuesit dirigjent.

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- njeh mirë dhe luan partin e tij pas përfundimit të të gjitha provave orkestrale të çdo vepre;
- ruan mirë balancat në tingëllim;
- ruan raportin e tingëllimit midis tij, grupit të tij dhe grupeve të tjera orkestrale;
- thekson mirë karakterin e veprave dhe muzikalitetin e pjesëve të veçanta;
- ndjek mirë njëkohësisht partin orkestral, harkatat dhe gjestet e mësuesit dirigjent.

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- njeh shumë mirë dhe luan saktë partin e tij pas përfundimit të të gjitha provave orkestrale të çdo vepre;
- ruan shumë mirë balancat në tingëllim;
- ruan shumë mirë raportin e tingëllimit midis tij, grupit të tij dhe grupeve të tjera orkestrale;
- thekson shumë mirë karakterin e veprave dhe muzikalitetin e pjesëve të veçanta;
- ndjek shumë mirë njëkohësisht partin orkestral, harkatat dhe gjestet e mësuesit dirigjent.

**Materiale dhe burime mësimore:**

- Lexhio për provat e orkestrës;
- Partiturat e kompozitorëve të huaj të periudhave të ndryshme (të botuara ose të disponueshme në www.imslp.org);
- Partiturat e kompozitorëve shqiptarë të periudhave të ndryshme; (të botuara ose të disponueshme në bibliotekën e Universitetit të Arteve)

| |
|---|
| - Shembuj audio - video të veprave që do të luhen, të marra nga: Cd - Dvd të ndryshme; nga interneti; nga biblioteka online e Universitetit të Arteve |

**Dega Muzikë**

**Lënda: Piano**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - **4-6 Shkallë**<br>- maxhore-minore<br>- arpezhe,<br>- erca,<br>- seksta, decima<br>- oktava, akorde | **Nxënësi:**<br>- realizon teknikisht shkallën;<br>- luan me tingull të plotë e të pastër;<br>- luan rrjedhshëm dhe shkathët;<br>- krijon pavarësinë e duarve dhe bashkëveprimin e tyre; |
| **8-10 etyde** nga autorët:<br>- Czerny: Etyde op.740<br>- Clementi: Gradus ad Parnasum<br>- Moszkowski: Etyde op. 72<br>- Moscheles: Etyde op. 70 | - luan në tempin e duhur;<br>- realizon etydet teknikisht dhe muzikalisht;<br>- përvetëson më mirë teknikat e duhura;<br>- përvetëson një teknikë më të lartë; |



ASCAP

| | |
|---|---|
| - Chopin: Etyde op.10, op.25<br>- Liszt: Etyd | |
| - Bach: Prelude e Fuga, Klavir i temperuar mire, 48 Prelude dhe Fuga<br>- Bach: Suita Angleze<br>- Handel: Suita E Dur, C Moll<br>- Jean Filip Ramean: Gavotte met Variaties<br>- Bach: Partita1-6 | - realizon për tingull të pastër e të kultivuar;<br>- njeh stilet përkatëse të autorëve;<br>- realizon karakterin e sonatës;<br>- kultivon shijen artistike; |
| - Scarlatti: Sonata<br>- Mozart: Sonata<br>- Beethoven: Sonata<br>- Beethoven: Koncerte nr. 1,2<br>- Mendelssohn: Koncerte nr.1, 2<br>- Bartok: Sonatina<br>- Bach: Koncerte E Dur, A Dur | - realizon për tingull të pastër e të kultivuar;<br>- njeh stilet përkatëse të autorëve;<br>- realizon karakterin e sonatës;<br>- kultivon shijen artistike;<br>- zbërthen pasazhet teknike më të vështira;<br>- qartësohet për mënyrat e ndryshme të studimit;<br>- realizon më së miri elementet artistike të veprës;<br>- luan me temperament, të transmetojë emocion;<br>- realizon lojë brilante. |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - **4-6 Shkallë**<br>- maxhore-minore | **Nxënësi:**<br>- realizon teknikisht shkallën; |

| | |
|---|---|
| - arpezhe,<br>- terca,<br>- seksta, decima<br>- oktava, akorde | - luan me tingull të plotë e të pastër;<br>- luan rrjedhshëm dhe shkathët;<br>- krijon pavarësinë e duarve dhe bashkëveprimin e tyre; |
| **8-10 etyde** nga autorët:<br>- Czerny: Etyde op.740, vol 3,4<br>- Clementi: Gradus ad Parnasum<br>- Moszkowski:Etyde 15 etyde op.72 Moscheles:Etyde<br>- Chopin: Etyde op.10, op.25<br>- Liszt:Etyde trashendentale<br>- Rachmaninoff: Etyde Tablo op.23, nr.1,2,3 Debussy:12 Etyde<br>- Scriabin: Etyde op.2, nr1, op.8,nr.2,11 | - luan në tempin e duhur;<br>- realizon etydet teknikisht dhe muzikalisht;<br>- përvetëson më mirë teknikat e duhura;<br>- përvetëson një teknikë më të lartë; |
| - **Bach:** Prelude e Fuga Klavir i temperuar mire (Prelud dhe Fuga), vol.1,2<br>- Bach: Partita 1-6<br>- Handel: Suita nr.5, E Dur, nr.7, C Moll | - realizon për tingull të pastër e të kultivuar;<br>- njeh stilet përkatëse të autorëve;<br>- realizon karakterin e stilit barok;<br>- kultivon shijen artistike; |
| - Scarlatti: Sonata<br>- Mozart: Sonata<br>- Mozart:Koncerte<br>- Mozart:Fantazi e sonata C moll | - realizon për tingull të pastër e të kultivuar;<br>- njeh stilet përkatëse të autorëve;<br>- realizon karakterin e sonatës;<br>- kultivon shijen artistike; |

| | |
|---|---|
| - Grieg:Sonata op.7<br>- Beethoven:35 Sonata<br>- Beethoven: Koncerte nr.1,2,3<br>- Beethoven:32 Variacione C moll<br>- Mendelssohn: Koncerte nr.1, 2<br>- Bartok: Sonatina<br>- Bach: Koncerte E Dur, A Dur 2<br>- Ravel:Sonatina<br>- Shostakovich:Koncert F Dur | - zbërthen pasazhet teknike më të vështira;<br>- qartësohet për mënyrat e ndryshme të studimit;<br>- realizon më së miri elementet artistike të veprës;<br>- luan me temperament, të transmetojë emocion;<br>- realizon lojë brilante; |
| - Beethoven:Rondo Caprioccoso op.129, Fantazi op.77<br>- Schubert: Impromtus op.142, nr.1,2<br>- Mendelssohn: Rondo capriccioso E Dur<br>- Schumann:Fantastike op.12, Romance op.28, nr.2<br>- Schumann: Novelette op.21, nr1,2,3,4,5,6,7 Schumann: Intermezo<br>- Schumann: Arabesque op.18<br>- Schumann:Papilllon op.2(Fluturat)<br>- Schumann:Romance op.28,nr.1,2,3<br>- Chopin:Ballada,Scerco,Prelude, Nocturne,Valse,Tarantella op.43, Poloneze op.26, nr.2, Variacione brillante op.12 | - zbërthen pasazhet teknike më të vështira;<br>- qartësohet për mënyrat e ndryshme të studimit;<br>- realizon më së miri elementet artistike të veprës;<br>- luan me temperament, të transmetojë emocion;<br>- realizon lojë brilante;<br>- realizon programin teknikisht dhe muzikalisht;<br>- |

| | |
|---|---|
| - Brahms: Ballada op.10, nr.2<br>- Brahms: Rapsodi op.79<br>- Debussy:Prelude libri i pare<br>- Debussy:Jardins sous la pluie<br>- Kabalevsky:Prelude op.38<br>- Kabalevsky:Sonata op.46, nr.3<br>- Faure: Nocutne op.33, op.37, op.97<br>- Faure:Imptromtus op.31, nr.2,op.34<br>- Faure:Tema me variacione op.73<br>- Faure:Vals capric op.30<br>- Shostakovich: 24 Prelue op.24<br>- Shostakovich: Loja fantasike op.5<br>- Prokofiev: 10 pjese op.12<br>- Prokofiev: Tregimet e gjysges plake op.31<br>- Ravel: Le Tombeau de Couperin<br>- Bartok:Suita op.14, Improviz op.20<br>- Scriabin:Prelude op.11<br>- Schoenberg: Pjese per pino op.33<br>- Rachmaninoff: Prelude op.23, op.32<br>- Liszt: Consolations, Loja e ujit | |

| | |
|---|---|
| - Zadeja: Tokata, Humoreska, Monologu i Arbanit, Teme me variacione<br>- Harapi: Teme me variacione<br>- Ibrahimi: Tokata<br>- Paparisto: Scerco<br>- Vorpsi: Variacione | |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - shkallë<br>- maxhore ose minore,<br>- arpezhe, terca,<br>- seksta, decima,<br>- oktava, akorde | **Nxënësi:**<br>- realizon teknikisht shkallën;<br>- luan me tingull të plotë e të pastër;<br>- luan rrjedhshëm dhe shkathët;<br>- krijon pavarësinë e duarve dhe bashkëveprimin e tyre; |
| - **6-8 Etyde** nga autorët:<br>- Schumann Paganini:Etyde op.3, op10<br>- Arensky: Etyde op.36, op 41<br>- Moszkowsky: Etyde op. 72, op.48<br>- Chopin: Etyde op.10, op.25<br>- Liszt: Etyde koncerti<br>- Rachmaninoff: Etyde op.33, op.39 | - zbërthen në mënyrë individuale çdo pasazh teknik;<br>- trajton etydet nga ana muzikore;<br>- rrit shprehitë virtuoze e interpretative; |

| | |
|---|---|
| - Debussy: Etyde: 3-Pour les Quartes, 4-Pourles Sixtes, 5-Pour les Octaves, 6-Pour les notes repetees<br>- Scriabin: Etyde op.12, op.45<br>- Saint Saens: 6 Etyde op.52 | |
| - Bach: Tokata<br>- Bach: Prelude e Fuga Klavir i temperuar mire, vol.1,2<br>- Bach: Tokata<br>- Bach: Partita D dur, Cmoll,E moll<br>- Bach: Fantazi kromatike e Fuge<br>- Bach: Koncerti Italian<br>- Bach: Koncerti D moll | - koncepton strukturën muzikore;<br>- respekton aplikaturat që janë të vendosura;<br>- realizon linjat e zërave dhe nxjerrjen e temave dhe temave të përmbysura;<br>- realizon legaton e bukur, portaton; |
| - Mozart: Fantazi KV.475<br>- Mozart: Sonata KV.457 C moll<br>- Mozart: Koncerte<br>- Beethoven: Sonata<br>- Beethoven: Koncerte<br>- Beethoven: 32 Variacione C moll<br>- Brahms: Sonata nr.1,2<br>- Grieg: Sonata E moll<br>- Grieg: Koncert op.16<br>- Schumann: Sonata op.22, nr.2 | - qartësohet për ndërtimin muzikor të veprave;<br>- realizon për tingull të pastër e të kultivuar;<br>- njeh stilet përkatëse të autorëve;<br>- realizon karakterin e sonatës;<br>- kultivon shijen artistike luan me shije të hollë artistike;<br>- realizon punën individuale për rritur fantazinë dhe për t'i dhënë mundësi zhvillimit të pavarësisë së mendimit muzikor |

| | |
|---|---|
| - Prokofiev: Sonata nr,1 D dur<br>- Scriabin: Sonata op.6,nr.1, op19,nr.2, op.23, nr.3, op.30,nr.4<br>- Mendelssohn: Koncert nr.1, op.25<br>- Mendelssohn: Capricio brillante op.22<br>- Mussorgsky: Tablo nga Ekspozita<br>- Britten: Koncert op,13, nr.1<br>- Stravinski: Koncert piano e orkester<br>- Gershwin: Rapsodia blu | |
| - Schumann: Karnavali Vienez op.26<br>- Schumann: Papionet op.2,<br>- Chopin: Prelude op.28, Poloneze op.44,Nocturne op.27, op.48, Imptomtus op.51, op.36, Ballada nr.1-4, Scerco op.31, nr.2<br>- Brahms:Pjese per piano op.76, nr.1, Intermezo op. 116, op.117, op.118, Scerzo op.4, Rapsodi op.79, nr.1,2<br>- C.Frank: Prelude, Choral at Fugue op.18<br>- C Frank: Prelude, Air et final<br>- G.Faure: Barkarole nr 5,op.66<br>- G.Faure:Vals capriccio op.38,op.59, op.62<br>- A.Honegger: Trois pieces | - realizon zbërthimin teknik dhe etapat e punës praktike që duhet të bëjë;<br>- njeh formën muzikore;<br>- organizon mirë lojën në tërësi pa anashkaluar detajet;<br>- realizon veprën me te gjitha komponentët e saj.<br>- tregon forcë interpretative, virtuozitetin, vë në funksion aftësitë krijuese të tij, bashkëngjitur me njohurit të fituara në vitet e shkollimit. |

| | |
|---|---|
| - A.Honegger: Hommage a Ravel<br>- Debussy: Ballada, Nocturne, Suite “Pour le Piano” (Prelude, Sarabande, Toccata)<br>- Grieg: Balada op.24<br>- Ravel: Jeux d’ean, Sonatina<br>- Ravel: Valses nobles et sentimentales<br>- A.Roussel: Suiteop.14<br>- Stravinsky: Serenade<br>- Rachmaninoff: Variacione me nje teme te Chopinit op.22<br>- Bartok: Valle Rumune, Suita op.14<br>- Liszt: Sonetet e Petrarkes nr.2<br>- Liszt: Rapsodi hungareze<br>- Zadeja: Koncert, Tokata<br>- Harapi: Koncert, Rapsodi nr.1, Teme me variacione<br>- P.Gaci: Suita<br>- N.Zoraqi: Koncert<br>- K.Lara: Rapsodi | |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Për arritjen e nivelit sa më të lartë, mësuesit dhe nxënësit duhet të kenë të qartë fazën e punës në të cilën kanë hyrë.

Klasa X është një vit i rëndësishëm, pasi nxënësi kalon nga arsimi bazë (AMU) në atë të mesëm të lartë ( AML). Këtë vit ora e mësimit duhet të ketë intensitet, të mos bëhet monotone, po të zgjojë interes te nxënësi. Koncepti i veprave hyn në një fazë të re. Duhet këmbëngulur në kultivimin e shijeve të sakta të lojës. Pas studimit të ngadaltë, nxënësi duhet nxitur për të luajtur (manovruar) më shpejt me materialet, por gjithnjë pa e tepruar dhe nën kontrollin e mësuesit, me perspektivën drejt vetëkontrollit. Nxënësi duhet të ndërgjegjësohet e të perceptojë me siguri të lartë atë çfarë ai prodhon. Të nxitet për të performuar në skenë.

**Klasa XI është një urë lidhëse mjaft e rëndësishme midis klasave X-XII. Mësuesi duhet të këmbëngulë në elementet bazë, që duhet të njohë Nxënësi:**

- ✓ *procesi i njohjes;*
- ✓ *procesi i përvetësimit;*
- ✓ *procesi i interpretimit.*

Pas një studimi mekanik, vazhdon puna për kualifikimin e tingullit, për zgjidhjen e kolpeve të harkut, për zgjidhjen e vibratos së kultivuar si elemente artistike. Mësuesi/ja duhet të ketë një komunikim të mirë me nxënësit, duhet të njohë aftësitë e nxënësit për të përcaktuar programin që nxënësi do të luajë në provimin e vitit.

**Klasa XII** është viti kur nxënësit mbyllin ciklin e një pune 12-vjeçare dhe përgatiten për shkollën e lartë. E gjithë puna shumëvjeçare synon në formimin e plotë me dijet e aftësitë tekniko-muzikore dhe ideoartistike. Element i rëndësishëm i kësaj faze është ruajtja e konsolidimi i nivelit të arritur. Nxënësit nuk duhet të heqin dorë nga ushtrimet ditore, pavarësisht nga rritja që kanë. Mësuesit duhet të programojnë orën e mësimit në mënyrë të tillë që të dëgjojnë në çdo orë mësimi repertorin mekanik të nxënësit. Demonstrimi në instrument nga mësuesit është i domosdoshëm për të konkretizuar problemet që dalin. Nxënësit duhet të ballafaqohen me skenën dhe nxënësit e tjerë, duke organizuar koncerte ose orë mësimi në grup.

Qëllimet e mësuesit  rrisin paralelisht dhe qëllimet e  nxënësit.

Duke qenë që ky vit do jetë dhe viti i parë i ciklit të mesëm, nxënësi duhet të ushtrojë një punë sistematike, për më tepër që ky vit ka ngarkesë në globalin e vet. Në këtë periudhë duhet insistuar që nxënësi t'i kushtojë vëmendje të veçantë problemeve të karakterit teknik, kolpeve të harkut, problemeve të vibratos etj.

Të gjitha këto elemente kur nuk kërkohen nga mësuesi sistematikisht në orën e mësimit, nxënësi do përpiqet ti asimilojë vetë, duke krijuar mangësi në përgatitjen e materialeve tekniko-muzikore.

Kriter kryesor mbetet ngritja cilësore në përgjithësi e ekzekutimit, prandaj dhe nxënësi duhet të drejtohet jo me drejtë një studimi mekanik,

por të logjikshëm duke ju bërë të qartë mënyrat e studimit për secilën vepër si ato të karakterit teknik dhe ato muzikal.

Në lojën e tij nxënësi duhet të reflektojë efektshëm muzikal në ekzekutim dhe interpretim, nëpërmjet ekspresivitetit, shpërthimeve emocionale, kontrasteve dinamike, etj ...

Organizimi i provave me piano në këto momente është shumë i rëndësishëm, ku mësuesi duhet të jetë shumë planësh, i cili duhet të ketë dhe njohuri për partin e pianos, ose partin (shoqërues ), duhet të ketë kërkesë apo kritere ndaj propocioneve të tingullit të linjave që ka vepra, ndërthurjen tekniko-muzikale të saj, në mënyrë që vepra të tingëllojë sa më e plotësuar dhe sinkronizuar.

Të insistohet në të gjitha nuancat dinamike që ka partitura, si: aksente, sforcandot, pedalin e pianos, etj.

Mësuesi duhet të ketë rritur dhe kriteret dhe kërkesat sipas stileve dhe epokave, qofshin të karakterit barok, klasik, romantik, kontemporan, kërkesat për gjinitë e sonatës, romancës, valles, baladës, etj.

Realizimi i një programi sasior dhe cilësor i programit për çdo vit ose vit pas viti dhe përvetësimin e tij, duke evidentuar dhe luftuar me këmbëngulje çdo pasaktësi që mund të na ketë kaluar qoftë dhe jashtë koshiencës tonë.

Në këtë stad aktual që nxënësi ka vit pas viti, kriteret janë më të mprehta dhe sigurisht që kërkojnë një vëmendje të veçantë të trajtimit ty tyre, por mbi të gjitha kërkojnë një përkushtim dhe përgatitje të lartë profesionale nga mësuesi në ciklin 9-vjeçar, për realizimin e një programi sa më të plotë, sigurisht që do të sjellë një vijueshmëri normale te nxënësit në këtë cikël.

Kur flasim për nxënës që kanë kapërcyer normal dhe pa mangësi kërkesat dhe kriteret e domosdoshme siç janë: > loja me një tingull të qartë dhe akoma dhe më të plotë, >me një vibrato të formuar dhe ekspresive, > saktësi ritmike dhe intovative, >konsolidim të elementëve teknik në :capo taste (në vendosje të përkujdesshme të dorës së majtë),

>impostim të mirë të tercave, sekstave dhe oktavave, >përdorimin e disa kolpeve të harkut, staccato, spicato, etj .......

Kriteret vazhdojnë me sasinë e detyruar të ushtrimeve të llojeve të ndryshme, sipas programit të planifikuar.

Mbi bazën ose kriteret e një loje me kërkesë , lojë e organizuar tek një sonatë e plotë, apo kohë nga suitat e Bachut, kërkesa teknike dhe interpretative , bën diferencat në nxënës shumë të mirë, nxënës mesatar dhe nën-mesatar.

Mësuesi duhet ta inkuadrojë nxënësin me kërkesat dhe kriteret që ka cikli i mesëm.

Mësuesi nuk duhet të neglizhojë në asnjë mënyrë mangësitë e konstatuara, mos kurimi i tyre në kohën e duhur, bëhet pengesë serioze si për nxënësin ashtu dhe për vetë mësuesin.

Kriteri i pasqyrimit rrjedhshëm të lojës në tastierë, siguria dhe temperamentit, përdorimi i kolpeve të ndryshme të harkut, janë kritere të domosdoshme dhe të pa shmangshme në punën tone.

Nxënësi duhet te ketë hyrë në brendi te problemeve të karakterit muzikal, sidomos në kultivimin e dijeve të drejta të lojës .

Vibrato duhet të jetë plotësuar dhe përmirësuar në shumëllojshmërinë e saj, gjithmonë në përshtatshmëri të veprës që luan. Rëndësi dhe kriter mbetet dhe pjesëmarrja nëpër koncerte, ansamble, lojë solo, apo dhe muzikë dhome. Ballafaqimi me publikun është domosdoshmëri.

Padyshim që detyrë dhe kriter kryesor mbetet, arritja e teknikës së dorës së djathtë, kryesisht nëpërmjet fletores (shevcik), duke përvetësuar çdo kolp harku. Gjithashtu nxënësi duhet të fitojë llojshmëri e ekspresivitet në ngjyrat e harkut, gjithmonë në varësi të veprave që luan.

Fortësia e tingullit duhet të jetë më e fortë, materialet teknike luhen drejt definicionit të tyre, nxënësi duhet të formojë shijen e vet muzikore, mbi bazën e një logjike ndaj elementeve tekniko-muzikore që ka një vepër. Duhet të jetë i vetëdijshëm për sa i përket stilit, epokës së tij.

Kriteret në vitin final, kanë ardhur sipas një pune të kujdesshme pedagogjike e bërë nga mësuesi i aftë, i cili ka punuar me pasion, ka bërë që nxënësi të ketë fituar një bagazh profesional të plotë, ku të pasqyrohet një lojë bindëse, ku spikasin rrjedhshëm treguesit e një loje me saktësi teknike, temperament dhe siguri.

Tani nxënësi duhet të njohë veprën në tërësinë e saj, epokat, kërkesat ndaj rrymave të ndryshme të muzikës.

Nxënësi duhet të dijë, të organizojë mirë një studim racional të pasazheve teknike ashtu dhe ato të kënduara (kantilenat), me tingull të gjerë, të ngrohtë, plastik dhe ekspresiv.

Të zgjidhë probleme të mprehta të interpretimit. Nxënësi duhet të zgjidh në mënyrë të logjikshme ose të logjikojë qartë, qoftë dhe nga pjekuria që ka fituar në vite apo dhe nga ndikimi i jashtëm që ai ka.

Me zbatimin e kritereve dhe me përgatitjen që nxënësi duhet të ketë, në sajë të një udhëheqje të aftë pedagogjike, nxënësi duhet të jetë në gjendje t'i përgjigjet kërkesave që do ketë përpara, si vazhdimin e studimeve në Universitetin e Arteve apo dhe në studimet e tyre jashtë shkollave Shqiptare , drejt atyre Evropiane.

## UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

**Nxënësi/ja është i nivelit MJAFTUESHEM kur:**

- nuk njeh veprën në përgjithësi dhe nuk ka siguri të materialit;

- nuk ka tingull të pastër;
- nuk ka të zbërthyera elementet teknike;
- nuk frazon, dhe nuk bën muzikë.

**Nxënësi/ja është i nivelit MESATAR kur:**

- nxënësi ka fituar llojshmëri ndaj elementeve teknike muzikore;
- i paraprin elementeve kryesore të interpretimit;
- logjikon ndërtimin e një vepre muzikore;
- është i vetëdijshëm për lojën që bën.

**Nxënësi/ja është i nivelit të LARTE kur:**

- ka kontroll dhe luan etyde të karaktereve të ndryshme
- luan cilësisht pasazhe me vështirësi të lartë teknike;
- ka organizim të lojës;
- spikat rrjedhshëm treguesit e një loje me saktësi teknike;
- ka temperament, siguri dhe pasion;
- ka rritje të sensibilitetit muzikor;
- luan me stil duke njohur brendinë dhe karakteristikat e veprës;
- njeh epokën e veprave, baroke, klasike dhe romantike;
- luan me tingulli të bukur;
- është i sigurt dhe ka aftësi krijuese të vetat.

| **Materiale dhe burime mësimore:** |
| --- |
| Piano, Lexhio, Metronom, Partiturë, Internet. |

**Dega: Muzikë**

**Lënda:  Violinë**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
| --- | --- |
| - Shefcik op. 2, op. 3, op. 8, op. 9 Shradik.<br>- Iftinki, ushtrime gishtash.<br>- **Dancla, shkolla e teknikës moderne.** | **Nxënësi:**<br>- luan materialet me qëllim formimin sa më të mirë teknik të nxënësit për të mbushur mangësitë; |
| - **8-10 Shkallë maxhore e minore**<br>- Me 7 arpezhet.<br>- Dopio-akordet përkatëse (terca, seksta, oktava), sipas metodave Alard, Gregorian Flech. | - luan pjesët muzikore pastër;<br>- luan me progresion ritmik dhe figurativ;<br>- luan dopio-akordet me intonacion të pastër dhe tingull të qartë;<br>- realizon tempin e ngadaltë me temp brilant; |
| - **10-12 etyde** nga autorët:<br>- Kreutzer.<br>- Mazas (fl. II-III) op. 36. | - luan përmendsh etydet dhe pjesë të tjera;<br>- realizon mirë teknikisht dhe muzikalisht etydin apo kapriçon;<br>- ka nocione të qarta në frazimin logjik; |

| | |
|---|---|
| - Dancla.<br>- Rode: 24 kapricio op. 22.<br>- Wieniavski: etyde për 2 violina, op. 18<br>- Paganinni 24 Capriccio etj. | - luan në tempet e duhura; |
| - Sonata paraklasike oseklasike<br>- 1 sonatë e plotë<br>- Hendel: sonata nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6.<br>- Tartini.<br>- Vivaldi.<br>- Corelli "La Foglia",<br>- Vitali "Ciacona".<br>- Bach me 6 sonata për violinë e piano.<br>- Moxart sonata për piano e violinë etj. | - njeh karakterin e veprës në stilin dhe epokën e autorit;<br>- punon për arritjen e një tingulli të pastër;<br>- realizon për vibraton sipas karakterit të veprës;<br>- realizon për dinamikën;<br>- luan me piano që në fillim të materialit, në rast se kemi sonata të Mozartit; |
| - Koncerte ose vepër ciklike<br>- Autorët:<br>- Hayden: do+.<br>- Moxart: Koncertet.<br>- Bach: mi+.<br>- Teleman: 12 fantazi për violinë solo.<br>- Beriot: nr. 1,<br>- Mendelson: koncert në Mi -, etj. | - realizon programin në përputhje me etapat e punës praktike të përcaktuara;<br>- ushtrohet për arritje tekniko-muzikore nëpërmjet:<br>- frazimit,<br>- karakterit teknik,<br>- zbërthimit emocional;<br>- performon në piano si instrument shoqërues; |

| | |
|---|---|
| ***Shënim.*** Një koncert të plotë me 3 kohë, të shpërndara ose jo në 2 semestra. | |
| **Pjesë nga autorë të huaj e shqiptarë - Bravurë klasike, romantike ose kontemporane.**<br>- Moxart<br>- Kraisler<br>- Weiniavski<br>- Novocek<br>- Paganini<br>- Sarasate<br>- Tchaikovski<br>- Dvorak<br>- Mendelson<br>- Bela-Bartok etj.<br>- P. Gaci<br>- A. Peci<br>- T. Daija<br>- Paparisto etj. | - përgatitet për daljen në publik;<br>- realizon performancë artistike, duke i harmonizuar saktë elementet tekniko-muzikore;<br>- ndjen personalitetin e vet në lojë;<br>- transmeton emocione. |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |

| | |
|---|---|
| - Shkallë muzikore<br>- 8-10 shkallë maxhore e minore<br>- 7 arpezhet dhe dopio-akordet përkatëse (terca, seksta, oktava) të autoreve<br>- Alard,<br>- Gregorian,<br>- Flech etj. | **Nxënësi:**<br>- luan me të gjitha kriteret e kërkuara në vitin paraardhës duke i pasuruar ato me cilësitë e:<br>- tingullit,<br>- legatos,<br>- brilancës së tempit dhe anës virtuoze. |
| Etyde dhe kapriçio<br>**10-12 etyde** nga autorët:<br>- Kreutzer: 42 etyde,<br>- Mazas (fl. II-III),<br>- Dancla: etyde, op. 73,<br>- Rode: 24 kapriçio, op. 22,<br>- Wieniavski: shkolla moderne, op. 10,<br>- Paganini: 24 kapriçio, op. 1,<br>- Dont: 24 kapriçio, op. 35, etj. | - luan përmendësh etydet apo kapriçot;<br>- realizon teknikisht dhe muzikalisht etydet dhe kapriçot;<br>- luan pastër dhe me frazim logjik;<br>- respekton dinamikën;<br>- luan në tempin e duhur;<br>- performon artistikisht në përfundim të çdo etydi. |
| - Bach: Sonata dhe partita për violinë solo<br>**2 kohë kontraktuese nga:**<br>- Partita e J. S Bach për violinë solo. | - realizon teknikat e lojës së Bachut, ku spikasin teknika e akordeve, legatos, detaches (me kombinime harkatash); evidentimi i linjave dhe i zërave kryesorë etj., e cila kërkon një bashkëveprim dhe ndërgjegje të teknikave të të dyja duarve. |

| | |
|---|---|
| **Sonata paraklasike ose klasike (vepër ciklike)**<br><br>- Tartini Sonata.<br>- Follia A. Corelli Sonata<br>- Mozart: sonata për piano e violinë.<br>- Bethoven: sonata për piano e violinë. | - realizon dinamikën;<br>- ushtrohet në piano si element partneriteti (sonata e Moxartit, Bethovenit).<br>- realizon vibraton sipas karakterit të pjesës, |
| **Koncerte ose vepër ciklike**<br><br>- Autorët:<br>- Mozart: La+, Re+, Sol+.<br>- Bach: koncert me 2 violina në RE-.<br>- Teleman: fantazi për violinë solo.<br>- Mendelson: koncert në Mi-.<br>- E. Lalo: sinfoni espanjole.<br>- M. Bruch: koncert në Sol-.<br>- Weiniavski: koncert Nr. 2.<br>- Sait-Saens koncert etj.<br><br>***Shënim*.** Një koncert të plotë të shpërndarë ose jo në 2 semestrat. | - realizon programin në përputhje me etapat e punës praktike të përcaktuara nga mësuesi;<br>- kupton formën muzikore nga ana kompozicionale;<br>- realizon veprën me të gjithë komponentët teknikë e muzikorë;<br>- luan pjesën muzikore me ekspresivitet dhe temperament;<br>- zhvillon individualitet në ekzekutimin e materialit. |
| - Pjesë nga autorë të huajdhe shqiptarë<br>- Bravurë klasike, romantike ose kontemporane. | - përgatitet për daljen në publik; |

| | |
|---|---|
| - Moxart.<br>- Beethoven.<br>- Kraisler.<br>- Wieniavski.<br>- Sarasate.<br>- Paganini.<br>- Novocek.<br>- Cajkovski.<br>- Dvorak.<br>- Bela-Bartok.<br>- Bloch.<br>- P. Gaci.<br>- T. Daija.<br>- A. Peci.<br>- Th. Gaqi etj. | - realizon performancë artistike, duke i harmonizuar saktë elementet tekniko-muzikore;<br>- zhvillon personalitetin e vet në lojë;<br>- transmeton përmes lojës emocionet; |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallë muzikore<br>- 8-10 shkallë maxhore e minore<br>- Deri në 6 shenja shartimi, me 7 arpezhe dopio-akorde (terca, seksta, oktava, decima) sipas metodave Flech, Galamian, | **Nxënësi:**<br>- Realizon teknikisht e ritmikisht shumë mirë, duke arritur një nivel gjithnjë e në rritje të:<br>- tingullit, |

| | |
|---|---|
| | - legatos,<br>- intonacionit etj. |
| - Etyde ose Kapricio<br>- 6 etyde ose kapriçio nga autorët:<br>- Kreutzer - 42 etyde.<br>- Rode - 24 kapricio, op. 22.<br>- Dont - 24 kapricio.<br>- Weiniavski - shkolla moderne, op. 10.<br>- Paganin - 24 kapricio, op. 1.<br>- Mazas Fl II-III | - luan përmendsh;<br>- realizon saktë teknikisht dhe muzikalisht etydet ose kapriçot;<br>- luan në tempin e duhur;<br>- luan me dinamikë të qartë;<br>- performon në mënyrë artistike;<br>- realizon 1 kapriçio nga: Weiniavski ose Paganinit që është i barabartë me 2 etyde të Kreutzer, Dont, Rode. |
| **Bach: Sonata dhe partita për violinë solo**<br>- (2 kohë kontrastuese)<br>- nga 3 sonatat ose<br>- 3 partita për violinë solo - J.<br>- S. Bach. | - realizon materialin duke arritur të kuptojë dhe dëgjojë zërat e veçantë dhe shkrirë ato në funksion të idesë;<br>- realizon shumë mirë elementet e teknikës së violinës dhe cilësinë e tingullit. |
| **Sonatë klasike, romantike ose kontemporane:**<br>- 1 sonatë të plotë me përmasa të mëdha nga autorët:<br>- Mozart - sonatat për piano e violinë.<br>- Bethoven sonatat  për piano e violinë. | - realizon sonatën brenda semestrit;<br>- realizon në një shkallë më të lartë elementet koncertale tekniko – muzikale;<br>- luan me kritere shumë të qarta të stilit dhe karakterit të veprës. |

| | |
|---|---|
| **Koncerte ose vepër ciklike:**<br><br>- Moxart: koncertet në La+, Sol+ etj.<br>- Weiniavski: koncert në Re- nr. 2.<br>- Bruch: koncert në Sol-.<br>- E. Lalo: simfoni espanjole.<br>- Sait-Saens koncert.<br>- P. Tchaikovsy koncert.<br>- J. Sibelius.<br>- L.V.Beethoven. | - realizon programin në përputhje me etapat e punës praktike të përcaktuara nga mësuesi;<br>- kupton formën muzikore nga ana kompozicionale;<br>- realizon veprat me të gjithë komponentët teknikë e muzikorë;<br>- luan pjesët muzikore me ekspresivitet dhe temperament;<br>- krijon individualitet në ekzekutimin e materialit. |
| **Pjesë nga autorë të huaj dhe shqiptarë-bravurë klasike, romantike ose kontemporane.**<br><br>- Moxart.<br>- Bethoven.<br>- Kraisler.<br>- Sarasate.<br>- Weiniavski.<br>- Tchajkovski.<br>- Dvorak.<br>- Bela-Bartok.<br>- Bloch, | - përgatitet për daljen në publik;<br>- realizon performancë artistike, duke i harmonizuar saktë elementet tekniko-muzikore;<br>- krijon personalitetin e vet në lojë;<br>- është krijues nëpërmjet emocioneve që transmeton. |

| | |
|---|---|
| - A. Paparisto.<br>- P. Gaci.<br>- T. Daija.<br>- N. Zoraqi.<br>- A. Peci, etj. | |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Ky program është vazhdimësi e punës së nxënësit dhe mësuesit përgjatë arsimit bazë AMU.

Përmes studimit dhe zhvillimit të këtyre programeve, rritet cilësia interpretative në të gjitha veprat që nxënësi do të` studiojë dhe do të interpretojë.

Duke qenë se nxënësit në ciklin e mesëm vijnë nga arsimi bazë( AMU), mjaft probleme të aparatit fizik, intonacionit, teknikës dhe interpretimit emocional janë përmbushur. Problemi kryesor që del në pah në klasën X, është njohja e nxënësit në mënyrë më të detajuar me stilet e ndryshme muzikore, të cilat ai do t'i hasë gjatë interpretimit të tij, p.sh,: njohja me stilin para klasik, barok, klasik, romantik etj. Kjo duhet të arrihet me anë të dëgjimit të këtyre veprave në CD ose të dëgjimi i tyre përmes internetit. Mirë është që nxënësi të dëgjojë muzikë klasike dhe para klasike në mënyrë sistematike. Arritja e një intonacioni perfekt dhe teknik të pëlqyeshëm, është e domosdoshme që nxënësi të studiojë çdo ditë ushtrimet e gishtave, shkallët, si dhe etydet, sidomos studim të detajuar duhet të kërkohet për momentet polifonike, si tek etydet dhe materialet ciklike (sonata, koncerte). Nxënësi duhet të lexojë mjaft mirë aprima vista dhe këtë duhet ta arrijë nga leximi i shumë partiturave, në mënyrë që të jetë i aftë të luajë me orkestër ose ansambël muzikor.

Një aspekt shumë i rëndësishëm i perceptimit të veprave muzikore nga ana e nxënësit është dhe demonstrimi i tyre nga mësuesi. Me anë të këtij ballafaqimi, nxënësi krijon idenë e përgjithshme të stilit, të tempeve, të mënyrës emocionale në realizimin e veprës muzikore.

Gjithashtu, nxënësi mund t'i dëgjojë veprat në fonoteka të ndryshme ose t'i sigurojë ato përmes internetit. Gjithmonë nxënësi duhet të jetë përzgjedhës (seleksionues) në zgjedhjen e interpretuesve të këtyre veprave, të cilët duhet të jenë interpretues shumë të mirë të veprave të autorëve vendës ose të huaj. Një mënyrë shumë efikase dhe kontemporane e të studiuarit është "memories practice", ose punimi individual i nxënësit, pa instrument, vetëm me partiturën. Një mënyrë e tillë studimi e njeh më mirë nxënësin me veprën, formën e ndërtimit të saj, harmoninë, si dhe ndihmon në përvetësimin përmendsh të veprës në një kohë më të shkurtër.

## UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi i nxënësit në kontrollet teknike dhe saxho do të bëhet nga komisioni i përbërë nga të gjithë mësuesit që kanë nxënës në klasën përkatëse (me jo më pak se 3 veta).

- Mësuesi i lëndës për njohjen e drejtë për drejtë të punës së nxënësit në klasë, ka të drejtë të ulë ose të ngrejë një notë.
- Në kontrolle teknike dhe saxho pjesëmarrja e mësuesve që kanë nxënës në klasën përkatëse është e detyruar.
- Vlerësimi do të bëhet nga nota 1(një) deri në notën 10(dhjetë). Vlerësimi me 4(katër) nuk është kalues.
- Në rastet kur nxënësi paraqet justifikim( për arsye të ndryshme), për të mos shlyer detyrimet vjetore, merret vendim nga drejtoria e shkollës.
- Vlerësimi përfundimtar i nxënësit, do të dalë si rezultat i mbledhjes dhe i përpjesëtimit matematikor të notave të vëna nga anëtarët e komisionit plus notën e mësuesit të lëndës.

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

**luan jo korrekt**

- me ritëm,
- me tingull mesatar,

- me intonacion jo të këndshëm,
- me shkallë shpejtësie të ulët e me disa gabime.

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- luan mirë
- ritmikisht,
- me tingull e me intonacion,
- pastër e me pak gabime.

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- luan *shumë mirë* në të gjitha elementet e mësipërme

**Materiale dhe burime mësimore:**

Violinë, Lexhio, Partiturë, Sistem audio-video TIK, Internet

**Dega: Muzikë**

**Lënda: Violë.**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - **Shkallë** muzikore<br>- 4 shkallë muzikore maxhore dhe minore (arpezhe, terca, seksta dhe oktava) | **Nxënësi:**<br>- realizon teknikisht shkallën;<br>- luan rregullisht ushtrime gishtash. |
| - Etyde<br>- etyde nga:<br>- "Shradik"<br>- "Shevcik"<br>- "Kreyzer"<br>- "Campagnoli"<br>- Carse" nr. 3 | - realizon teknikisht etydet;<br>- respekton tempet e kërkuara;<br>- interpreton në mënyrë artistike. |
| - Suitë nr. 1<br>- "Prelud"<br>- Alumannde"<br>- "Corrente"<br>- "Sarabande" | - interpreton stilin barok.<br>- respekton tempet e kërkuara;<br>- interpreton në mënyrë artistike |

| | |
|---|---|
| - "Minuette"<br>- "Gigue" | |
| - Eccles"<br>- Sonatë në Re minor<br>- Marcello-Sonatë Sol minor<br>- Vivaldi- Sonatë Si b maxhor etj. | - interpreton mirë stilin para klasik;<br>- realizon një tingull të qartë dhe të pastër nga ana e intonacionit. |
| **Koncert**<br>- Handeshkin - Koncert Do maxhor<br>- Teleman – Koncert<br>- Zelter - Koncert Mi b maxhor. | - interpreton stilin klasik;<br>- respekton tempet dhe ngjyrat artistike;<br>- zhvillon brenda veprës aftësitë individuale krijuese. |
| **Bravura**<br>- Schumann – "Ëndërrim" / "Këngë pa fjalë" etj. | - u përmbahet stileve të ndryshme të autorëve. |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - **Shkallë**<br>- Shkallë maxhore dhe minore.<br>- Me arpezhe terca dhe octava .<br>- Nga "Flesh",sistemi i shkallëve maxhore | - realizon teknikisht shkallën;<br>- realizon intonacionin tek tercat dhe oktavat;<br>- luan rregullisht ushtrime gishtash; |
| **10 etyde nga:**<br>- "Shradik" | - realizon teknikisht etydet;<br>- respekton tempet; |

| | |
|---|---|
| - "Shevcik"<br>- "Hofmeister"<br>- "Kreutzer", VI+II etj. | - interpreton artistikisht etydet;<br>- realizon siç duhet etydet me dopio akorde. |
| **Suitë nr.2 – Bach, kohët:**<br>- Prelud<br>- Corrente<br>- Allemande<br>- Sarabande<br>- Minnette<br>- Gigue | - Studion stilin barok;<br>- studion pjesët me polifoni;<br>- realizon një interpretim korrekt me ritmet e duhura të suitës. |
| - A. Vivaldi.<br>- A. Korrelli - sonata dhe kamera.<br>- Telleman - sonatë në La minore etj. | - realizon stilin para klasik;<br>- realizon qartësinë e tingullit. |
| - Hoffmeister - koncert.<br>- Hayden - koncert në sol maxhor etj. | - studion stilin klasik;<br>- realizon interpretim të saktë të partiturës; |
| - Paparisto – romancë.<br>- Skënderi -melodi popullore etj. | - luan me karakter veprat; |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - shkallë:<br>- maxhore (nga Flesh) | - realizon shkallën në mënyrë të përsosur teknikisht dhe në drejtim të intonacionit; |



ASCAP

| | |
|---|---|
| - minore (nga Flesh) | |
| **Etyde nga:**<br>- Kreytzer.<br>- Derit.<br>- Palashko | - realizon në mënyrë profesionale etydet, sidomos ato polifonike; |
| **Suitë nr. 3 - Bach:**<br>- Prelud.<br>- Allemande.<br>- Gigue.<br>- Sarabande.<br>- Corente. | - interpreton me mjeshtëri suitën e Bachut, me të gjitha kërkesat teknike e muzikale; |
| - M.Glinka -Sonatë Re minor.<br>- F. Shubert - Arpegiona.<br>- A. Moxart - Sonatë minore. Vitali - Ciacone. | - luan, duke vënë në pah karakteristikat e stilit romantik, sidomos te sonata Re minor e Glinkës; |
| - Shtamitz – Koncert Re Maxhor<br>- A.Moxart- Koncert La Maxhor<br>- Hayden – Koncert Do Maxhor | - përsos lojën interpretative drejtim teknik dhe emocional; |
| - Shuman – Nokturn<br>- Etj. | - realizon gjatë lojës stilin romantik. |

## UDHËZIME PËR METODOLOGJINË

Duke qenë se nxënësit në ciklin e mesëm vijnë nga arsimi bazë ( AMU) mjaft probleme të aparatit fizik, intonacionit, teknikës dhe interpretimit emocional, janë kapërcyer. Problemi kryesor që del në pah në klasën X është njohja e nxënësit në mënyrë më të detajuar me stilet e ndryshme muzikore, të cilat ai do t'i hasë gjatë interpretimit të tij, p.sh.: njohja me stilin para klasik, barok klasik. Kjo duhet të arrihet me anë të dëgjimit të këtyre veprave në CD, ose dëgjimit të tyre përmes internetit. Mirë është që nxënësi të dëgjojë muzikë klasike dhe para klasike në mënyrë sistematike. Për arritjen e një intonacioni të përsosur dhe një teknike të pëlqyeshme, është e domosdoshme që nxënësi të studiojë çdo ditë ushtrimet e gishtave, shkallët, si dhe etydet, sidomos studim të detajuar duhet të kërkohet për momentet polifonike, si tek etydet dhe te materialet ciklike (sonata, koncerte). Nxënësi duhet të lexojë mjaft mirë dhe këtë duhet të arrijë te leximi i shumë partiturave, në mënyrë që të jetë i aftë të luajë me orkestër ose ansambël muzikor. Një aspekt shumë i rëndësishëm i perceptimit të veprave muzikore nga ana e nxënësit është dhe demonstrimi i tyre nga mësuesi. Me anë të këtij ballafaqimi, nxënësi krijon idenë e përgjithshme të stilit, të tempeve, të mënyrës emocionale në realizimin e veprës muzikore.

Gjithashtu, nxënësi mund t'i dëgjojë veprat në fonoteka të ndryshme ose t'i sigurojë ato përmes internetit. Gjithmonë nxënësi duhet të jetë seleksionues në zgjedhjen e interpretuesve të këtyre veprave, të cilët duhet të jenë interpretues shumë të mirë vendës ose të huaj. Një mënyrë shumë efikase dhe kontemporane e të studiuarit është "memories practice" ose punimi individual i nxënësit, pa instrument, vetëm me partiturën. Një mënyrë e tillë studimi, e njeh më mirë nxënësin me veprën, formën e ndërtimit të saj, harmoninë, si dhe bën përvetësimin përmendësh të veprës në një kohë më të shkurtër.

Gjatë mësimit të instrumentit violë, një praktikë interesante është edhe ballafaqimi i një fragmenti të luajtur nga nxënësi me instrumentin e violës me luajtjen e të njëjtit fragment nga mësuesi në instrumentin e pianos. Me anë të kësaj praktike, nxënësi arrin të qartësojë dhe të pastrojë intonacionin e tij. Rol shumë të rëndësishëm luan bashkëpunimi i nxënësit me mësuesin shoqërues të pianos. Ky bashkëpunim do të jetë vendimtar në diplomën e fundit për nxënësin.

Duke qenë se programi i nxënësit të klasës XII është mjaft i rënduar dhe i gjatë në kohë, është e rekomandueshme të alternohet studimi fizik me dëgjimin muzikor të veprave në CD ose internet. Gjithashtu, "master klasat" e organizuara në Akademinë e Arteve kanë rezultuar shumë të suksesshme me nxënësit e këtyre klasave, pasi ata kanë përvetësuar përvojën më të mirë didaktike të pedagogëve vendës dhe të huaj.

## UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel kur:**

- ka një pozicion normal të duarve;
- saktëson kalimet e pozicioneve në mënyrë të rregullt, sidomos të lojës së shkallëve, (lojë me kërkesa impostimi dhe intonacioni të tercave, sekstave dhe oktavave};
- ka kontroll të llojeve të ushtrimeve apo etydeve;
- ka agjilitet të dorës së majtë;
- luan me potencë tingulli;
- përvetëson teknikën e dorës së djathtë;
- ka pastërti intonative;
- ka kualitet tingulli;
- luan cilësisht vlerat ritmike;
- luan me ritmin e duhur dhe pa kompromise;
- ka kontroll fizik të instrumentit;
- lëviz natyrshëm nëpër pozicione, duke filluar nga krahët tek gishtat;
- luan me vetëdije dhe qetësi;



ASCAP

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- Nxënësi ka fituar llojshmëri ndaj elementeve teknik dhe muzikor;
- i paraprin elementeve kryesore të interpretimit;
- logjikon ndërtimin e një vepre muzikore;
- është i vetëdijshëm për lojën që bën;

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- njeh mirë përdorimin e zonave të ndryshme të harkut;
- nuk ka tingull të pastër;
- nuk ka vibrato me pretendime;
- nuk ka të zbërthyera elementet teknike;

**Materiale dhe burime mësimore:**

Violë, Lexhio, Partiturë, Sistem audio-video TIK, Internet

**Dega: Muzikë**

**Lënda: Violonçel**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - 4 **Shkallë**<br>- maxhore,<br>- minore,<br>- arpezhe,<br>- terca,<br>- seksta,<br>- oktava | **Nxënësi:**<br>- realizon teknikisht shkallën;<br>- luan me tingull të plotë e të pastër;<br>- luan rrjedhshëm dhe shkathet;<br>- krijon pavarësinë e duarve dhe bashkëveprimin e tyre; |
| - 8-10 etyde nga Shevçik –<br>- Ushtrime ndihmëse:<br>- Poper<br>- Grutzmajer<br>- Docauer<br>- Sadlo<br>- Fitzenhagen etj. | - luan në tempin e duhur;<br>- realizon aplikaturën e etydit;<br>- përvetëson më mirë mënyrën e vendosjes në “capo-taste” të dorës së majtë;<br>- luan me intonacion të pastër sidomos etydet dyzanore; |
| **Suita :** | - respekton aplikaturat;<br>- realizon linjat e zërave dhe të arrijë unifikimin e tyre; |

| | |
|---|---|
| - I, II, III, | - realizon legaton e mirë nëpërmjet kthesave të harkut; |
| - Hendel - sonatë Fa +<br>- Boccherini - sonatë Do +<br>- Hervelois<br>- Koreli: temë me variacione<br>- etj. | - realizon për tingull të pastër e të kultivuar;<br>- njeh stilet përkatëse të autorëve;<br>- realizon vibraton e vazhdueshme dhe të rregullt në funksion të karakterit të sonatës;<br>- kultivon shijen artistike; |
| - Romberg: Re +<br>- Golterman: La –<br>- Saint-Seans: La –<br>- Hajden: Do + etj. | - realizon veprën teknikisht dhe muzikalisht;<br>- studion përmes mënyrave të ndryshme për pasazhet e vështira;<br>- realizon lojën e organizuar nga ana e mendimit muzikor; |
| - R. Sokoli<br>- Y. Skënderi<br>- A. Paparisto<br>- Poper<br>- Çajkovski<br>- Ç. Zadeja etj. | - realizon veprat nga ana teknike dhe emocionale;<br>- realizon karakteret përkatëse;<br>- luan duke krijuar individualitetin e vet; |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - 4-6 **Shkallë**<br>- maxhore-minore<br>- arpezhe, | **Nxënësi:**<br>- luan me tingull të njëjtë në pjesën e poshtme të tastierës; |

| | |
|---|---|
| - terca,<br>- seksta,<br>- oktava<br>- me aplikacione të ndryshme | - luan e të përvetësojë mirë ndërrimin e telit dhe kthesat e harkut;<br>- luan në definicionin e tyre; |
| **8-10 etyde nga autorët:**<br>- Shevçik- ushtrime për dorën e djathtë<br>- Ficenhagen<br>- Duport<br>- Poper<br>- Merk<br>- Franchom: etyde ose kapriçio<br>- Piatti: etyde ose kapriço etj. | - realizon kolpet e ndryshme të harkut;<br>- realizon një intonacion të pastër sidomos në dy zanore;<br>- luan në ritëm e precizion realizon melodikisht etydet muzikore; |
| **Suita II ose III (e ndarë në dy semestra)** | - realizon sa më mirë gjatë lojës ndjeshmërinë e gishtit në tel;<br>- ndan qartë frazat dhe frymëmarrjet;<br>- bën dallimin e karaktereve të ndryshme të çdo kohë (valleje); |
| - Koreli-variacione<br>- Bethoven-sonatë nr.2.<br>- Boelman- variacione etj. | - zbaton me përpikëri partiturën sipas orientimit të mësuesit;<br>- zbërthen nga ana teknike sidomos kohët e shpejta;<br>- plotëson lojën e vet me shprehitë interpretative; |

| | |
|---|---|
| | - luan me kërkesa maksimale artistike, duke i kushtuar rëndësi dinamikës; |
| - Golterman: La-<br>- Saint- Saens koncert nr 1<br>- Boccherini-Si bemol maxhor<br>- Lalo: Re – etj. | - zbërthen pasazhet teknike më të vështira;<br>- qartësohet për mënyrat e ndryshme të studimit;<br>- realizon më së miri elementet artistike të veprës;<br>- luan me temperament, të transmetojë emocion;<br>- realizon lojë brilante. |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - 2-3 **Shkallë**<br>- maxhore ose minore arpezhe.<br>- terca<br>- seksta<br>- oktava me aplikatura të ndryshme | **Nxënësi:**<br>- luan në perfeksion intonativ;<br>- luan me saktësi e tingull të njëjtë;<br>- luan rrjedhshëm dhe shkathët; |
| - Poper<br>- Duport<br>- Piatti: etyde ose kapriçi<br>- Franchom: etyde ose kapriçio | - zbërthen në mënyrë individuale çdo pasazh teknik;<br>- trajton etydet nga ana muzikore;<br>- rrit shprehitë virtuoze e interpretative sidomos te kapriçiot; |
| - Bach: suitat 2 ose 3.<br>- Reger: suita e parë. | - koncepton strukturën muzikore;<br>- luan me rigorozitet aplikaturat e dhëna, të cilat shërbejnë për realizimin sa më të mirë të mendimit muzikor; |

| | |
|---|---|
| | - përsos akordet nga ana inovative e interpretative; |
| - Breval<br>- Grig<br>- Bethoven: La+<br>- Brams: Mi-<br>- Shubert: arpezhione<br>- etj. | - qartësohet për ndërtimin muzikor të veprave;<br>- realizon gjendjen emocionale nga njëra kohë në tjetrën;<br>- përfiton vibrato të llojeve të ndryshme sipas veprave përkatëse;<br>- luan me shije të hollë artistike;<br>- konsolidon intuitën muzikore në prova me piano; |
| - Lalo: Re-<br>- Hajden: Do +<br>- Hajden: Re +<br>- Boccherini: si bemol +<br>- Çajkovski:variacione “Rococo” etj. | - realizon zbërthimin teknik dhe etapat e punës praktike që duhet të bëjë;<br>- njeh formën muzikore;<br>- organizon mirë lojën në tërësi pa anashkaluar detajet;<br>- realizon partin e pianos; |
| - Boccherini – rondo<br>- R. Dhomi – rondo<br>- Foure – elegji<br>- Y.Skënderi - këngë popullore<br>- T. Harapi – këngë etj. | - përsos elementin virtuoz;<br>- realizon vetë veprën nga ana e mendimit ideo artistik;<br>- performon në skenë. |
| **UDHËZIME METODOLOGJIKE**<br><br>Për arritjen e nivelit sa më të lartë, mësuesit dhe nxënësit duhet të kenë të qartë fazën e punës në të cilën kanë hyrë. | |

Klasa X është një vit i rëndësishëm, pasi nxënësi kalon nga arsimi bazë (AMU) në atë të mesëm të lartë ( AML). Këtë vit ora e mësimit duhet të ketë intensitet, të mos bëhet monotone, po të zgjojë interes te nxënësi. Koncepti i veprave hyn në një fazë të re. Duhet këmbëngulur në kultivimin e shijeve të sakta të lojës. Pas studimit të ngadaltë, nxënësi duhet nxitur për të luajtur (manovruar) më shpejt me materialet, por gjithnjë pa e tepruar dhe nën kontrollin e mësuesit, me perspektivën drejt vetëkontrollit. Nxënësi duhet të ndërgjegjësohet e të perceptojë me siguri të lartë atë çfarë ai prodhon. Të nxitet për të performuar në skenë.

Klasa X është një urë lidhëse mjaft e rëndësishme midis klasave X-XII. Mësuesi duhet të këmbëngulë në elementet bazë, që duhet të njohë **nxënësi:**

- procesi i njohjes;
- procesi i përvetësimit;
- procesi i interpretimit.

Pas një studimi mekanik, vazhdon puna për kualifikimin e tingullit, për zgjidhjen e kolpeve të harkut, për zgjidhjen e vibratos së kultivuar si elemente artistike. Mësuesi/ja duhet të ketë një komunikim të mirë me nxënësit, duhet të njohë aftësitë e nxënësit për të përcaktuar programin që nxënësi do të luajë në provimin e vitit.

Klasa XII është viti kur nxënësit mbyllin ciklin e një pune 12-vjeçare dhe përgatiten për shkollën e lartë. E gjithë puna shumë vjeçare synon në formimin e plotë me dijet e aftësitë tekniko-muzikore dhe ideoartistike. Element i rëndësishëm i kësaj faze është ruajtja e konsolidimi i nivelit të arritur. Nxënësit nuk duhet të heqin dorë nga ushtrimet ditore, pavarësisht nga rritja që kanë. Mësuesit duhet të programojnë orën e mësimit në mënyrë të tillë që të dëgjojnë në çdo orë mësimi repertorin mekanik të nxënësit. Demonstrimi në instrument nga mësuesit është i domosdoshëm për të konkretizuar problemet që dalin. Nxënësit duhet të ballafaqohen me skenën dhe nxënësit e tjerë, duke organizuar koncerte ose orë mësimi në grup.

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN**

**Nxënës/i,-ja arrin nivel shumë të mirë kur:**

- ka një pozicion normal të duarve;
- saktëson kalimet e pozicioneve në mënyrë të rregullt, sidomos të lojës së shkallëve, (loje me kërkesa impostimi dhe intonacioni të tercave, sekstave dhe oktavave}.
- ka kontroll të llojeve të ushtrimeve apo etydeve;
- ka agjilitet të dorës së majtë;
- luan me potencë tingulli;
- përvetëson teknikën e dorës së djathtë;
- ka pastërti intovative;
- ka kualitet tingulli;
- luan cilësisht vlerat ritmike;
- luan me ritmin e duhur dhe pa kompromise;
- ka kontroll fizik të instrumentit;
- lëviz natyrshëm nëpër pozicione, duke filluar nga krahët tek gishtat;
- luan me vetëdije dhe qetësi.

**Nxënës/i,-ja arrin nivelin mesatar kur:**

- Nxënësi ka fituar llojshmëri ndaj elementeve teknik dhe muzikor.
- I paraprin elementeve kryesore të interpretimit.
- Logjikon ndërtimin e një vepre muzikore.

| |
|---|
| - Është i vetëdijshëm për lojën që bën<br><br>**Nxënës/i,-ja arrin nivelin e ulët kur:**<br><br>- Nuk njeh mirë përdorimin e zonave të ndryshme të harkut.<br>- Nuk ka tingull të pastër.<br>- Nuk ka vibrato me pretendime.<br><br>**Nuk ka të zbërthyera elementet teknike.** |
| **Materiale dhe burime mësimore:**<br><br>Violonçel, Lexhio, Partiturë, Sistem audio-video TIK, Internet |

**Dega Muzikë**

**Lënda: Kontrabas.**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Shkallë muzikore:<br>- shkallë maxhore ose minore; | **Nxënësi:**<br><br>- realizon teknikisht shkallën; |

| | |
|---|---|
| - harmonike melodike;<br>- me arpezh relative deri në pozicionin 4 e 1/2 me nota 4-she;<br>- tempi 60,harkata të ndryshme. | - luan me tingull të plotë e të pastër;<br>- luan rrjedhshëm dhe shkathët;<br>- krijon pavarësinë e duarve dhe bashkëveprimin e tyre; |
| **Etyde nga metoda teknike:**<br>- I. Bille - Metodë për kontrabas a 4 e 5 corde ( ricordi ).<br>- *"Primo corso",* fq. 92, duke njohur pozicionet dhe Shkallët sipas pozicioneve maxhore, minore, arpezh, dhe relativet e tyre.<br>- *Secondo corso"*- Ushtrimet 1-9 me të gjitha variantet.<br>- Rabbath - "Neë technique" – vëllimi I.<br>- Ë. Sturm - "110 etyde për kontrabas", vëllimi 2, nr. 1, 2, 3, 5, 6, 13, 35, 47, 56, 59, 60, 80, 83.<br>- F. Simandl, "30 etyde", fashikulli I.<br><br>***<u>Shënim.</u>*** Sasia e etydeve do të jepet në varësi të nivelit të nxënësve. | **Nxënësi:**<br>- luan në tempin e duhur;<br>- realizon aplikaturën e etydit;<br>- luan me intonacion të pastër etydet; |
| **Program artistik:** | **Nxënësi:** |

| | |
|---|---|
| - S. Sans - pjesë të vogla.<br>- F. Boaden - petite suitë.<br>- Giovannin - adagio, ballo, sarabanda, nga Sonata në La minore.<br>- Schlemuller - minuet | - realizon veprën teknikisht dhe muzikalisht;<br>- studion përmes mënyrave të ndryshme për pasazhet e vështira;<br>- njeh dhe realizon strukturën e veprës;<br>- realizon lojën e organizuar nga ana e mendimit muzikor;<br>- zbërthen veprat nga ana teknikedhe emocionale;<br>- evidenton karakteret përkatëse;<br>- luan duke krijuar individualitetin e vet; |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - **Shkallë** muzikore:<br>- Shkallë dhe arpezhe mbi bazë pozicionesh:<br>- maxhore e minore dhe lidhja e tyre relative<br>- shkallë maxhore ose minore<br>- me arpezh relative deri në pozicionin 4 e 1/2 me nota 4-she<br>- Tempi 60, harkata të ndryshme | **Nxënësi:**<br>- realizon teknikisht shkallën;<br>- luan me tingull të plotë e të pastër;<br>- luan rrjedhshëm dhe shkathët;<br>- krijon pavarësinë e duarve dhe bashkëveprimin e tyre; |
| **Metoda teknike:**<br>- Bille - Metoda “Primo corso” deri te pozicioni i shtatë, faqe 91.<br>- Bille - Metoda “Secondo corso”, të gjithë kapitujt.<br>- Simandl, fashikulli i parë dhe i dytë. | **Nxënësi:**<br>- luan në tempin e duhur;<br>- realizon aplikaturën e etydit;<br>- luan me intonacion të pastër etydet; |

| | |
|---|---|
| - Metoda “Primo corso pratico”, nga fq. 51 deri në fund.<br>- A. Slama - etyde.<br>- Sturm -110 etyde,op 20, nga numrat:<br>- 4 - 22,<br>- 38,40, 48<br>- 53 - 58,<br>- 61 - 65,<br>- 82, 84 ,87, 88,<br>- 95, 96, 99, 107 | |
| **Program artistik:**<br>- Giovaninno - sonata në la minore për kontrabas e piano.<br>- sonata në fa maxhore.<br>- M. Dare - Gavota.<br>- B. Hummel - sonatina për<br>- kontrabas e piano.<br>- T.Pitfield - sonatina për kontrabas e piano | **Nxënësi:**<br>- realizon veprën teknikisht dhe muzikalisht;<br>- realizon përmes mënyrave të ndryshme për pasazhet e vështira;<br>- njeh mirë strukturën e veprës;<br>- realizon lojën e organizuar nga ana e mendimit muzikor;<br>- zbërthen veprat nga ana teknike dhe emocionale;<br>- evidenton karakteret përkatëse;<br>- luan duke krijuar individualitetin e vet. |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |



ASCAP

| | |
|---|---|
| - **Shkallë** muzikore:<br>- **Shkallë dhe arpezhe** mbi bazë pozicionesh:<br>- maxhore e minore dhe lidhja e tyre relative<br>- 2 oktave me figura e variante të ndryshme sipas: Sturm, Bille, Simandl etj. | **Nxënësi:**<br>- realizon teknikisht shkallën;<br>- luan me tingull të plotë e të pastër;<br>- luan rrjedhshëm dhe shkathët;<br>- krijon pavarësinë e duarve dhe bashkëveprimin e tyre. |
| - Metoda teknike<br>- Bille - Metoda për kursin e 3-të dhe për kursin e 4-t normal.<br>- Bille - Metoda e 4-t, kurs plotësues, fq. 7-24.<br>- F. Simandl - "Neë method" vëllimi i 2-të deri fq. 18.<br>- Sturm -110 etyde, op. 20. Mund të zgjidhen rreth 20 etyde nga numrat:<br>- 17, 18, 21, 26, 28, 29,<br>- 32, 33, 34, 36, 37<br>- 42, 43, 45,46,49,50,51,57,<br>- 62, 63, 64, 66, 76, 77, 86, 89, 90,<br>- 92, 93, 100, 106, 108, 109. | **Nxënësi:**<br>- luan në tempin e duhur;<br>- realizon aplikaturën e etydit;<br>- luan me intonacion të pastër etyde; |
| **Programi Artistik:**<br>- J.S. Bach - gavota për kontrabas | - realizon veprën teknikisht dhe muzikalisht;<br>- realizon përmes mënyrave të ndryshme për pasazhet e vështira; |

| | |
|---|---|
| - dhe piano.<br>- H. Genzmer - sonatina.<br>- Andersen - sonatina.<br>- Marcello - 6 sonata.<br>- P. Breuer - sonatina.<br>- A. Kapuzzi - Koncert në Re maxhore.<br>- G. Jacobs - "A little concert". | - njeh strukturën e veprës;<br>- realizon lojën e organizuar nga ana e mendimit muzikor;<br>- zbërthen veprat nga ana teknike dhe emocionale;<br>- evidenton karakteret përkatëse luan duke krijuar individualitetin e vet; |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE:**

Për arritjen e nivelit sa më të lartë, mësuesit dhe nxënësit duhet të kenë të qartë fazën e punës në të cilën kanë hyrë.

**Klasa X** është një vit i rëndësishëm, pasi nxënësi kalon nga arsimi bazë ( AMU) në atë të mesëm të lartë(AML). Këtë vit ora e mësimit duhet të ketë intensitet, të mos bëhet monotone, po të zgjojë interes te nxënësi. Koncepti i veprave hyn në një fazë të re. Duhet këmbëngulur në kultivimin e shijeve të sakta të lojës. Pas studimit të ngadaltë, nxënësi duhet nxitur për të luajtur (manovruar) më shpejt me materialet, por gjithnjë pa e tepruar dhe nën kontrollin e mësuesit, me perspektivën drejt vetëkontrollin. Nxënësi duhet të ndërgjegjësohet e të perceptojë me siguri të lartë atë çfarë ai prodhon. Të nxitet për të performuar në skenë.

**Klasa XI** është një urë lidhëse mjaft e rëndësishme midis klasave X-XII. Mësuesi duhet të këmbëngulë në elementet bazë, që duhet të njohë **nxënësi:**

- procesi i njohjes;
- procesi i përvetësimit;
- procesi i interpretimit.

| |
|---|
| Pas një studimi mekanik, vazhdon puna për kualifikimin e tingullit, për zgjidhjen e kolpeve të harkut, për zgjidhjen e vibratos së kultivuar si elemente artistike. Mësuesi/ja duhet të ketë një komunikim të mirë me nxënësit, duhet të njohë aftësitë e tyre për të përcaktuar programin që ata do të luajnë në provimin e vitit. **Klasa XII** është viti kur nxënësit mbyllin ciklin e një pune 12-vjeçare dhe përgatiten për shkollën e lartë. E gjithë puna shumëvjeçare synon në formimin e plotë me dijet e aftësitë tekniko-muzikore dhe ideoartistike. Element i rëndësishëm i kësaj faze është ruajtja e konsolidimi i nivelit të arritur. Nxënësit nuk duhet të heqin dorë nga ushtrimet ditore, pavarësisht nga rritja që kanë. Mësuesit duhet të programojnë orën e mësimit në mënyrë të tillë që të dëgjojnë në çdo orë mësimi repertorin mekanik të nxënësit. Demonstrimi në instrument nga mësuesit është i domosdoshëm për të konkretizuar problemet që dalin. Nxënësit duhet të ballafaqohen me skenën dhe nxënësit e tjerë, duke organizuar koncerte ose orë mësimi në grup. |
| **UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:**<br>**Kriteret e vlerësimit të nxënësve në kontrollin teknikë dhe saxho:**<br>***Nxënës/i,-ja arrin nivelin mirë kur:***<br>- luan ritmikisht mirë;<br>- luan me tingull dhe intonacion relativisht të pastër;<br>- luan me pak gabime.<br>- Nxënës/i,-ja arrin **nivel shumë** të mirë kur:<br>- ka duar të impostuara mirë;<br>- luhet me tingull të pastër;<br>- luhet me ritëm dhe intonacion të pastër;<br>- impostimi është një garanci për problemet e avancuara që do të ketë klasa e XI-të;<br>- njeh pozicione të ndryshme; |

- përdor pulsin me ndërrim harkatash të thjeshta;
- përvetëson pozionet nga 1-4;
- realizon mësimin e vibratos;
- Zgjeron njohuritë për mënyrat e përdorimit të harkut.

Nxënësit që vijnë nga instrumente të tjerë

Kriteret e vlerësimit të nxënësve në kontrolle teknike dhe saxho

**Nxënës/i,-ja arrin nivelin Mjaftueshëm kur:**

- nuk luan korrekt,
- luan pa ritëm;
- luan me tingull mesatar dhe nën- mesatar;
- luan me intonacion jo të këndshëm.
- luan me shkallë shpejtësie të ulët.
- Kur nuk luan përmendësh

**Nxënës/i,-ja arrin nivelin mirë kur:**

- luan ritmikisht mirë;
- luan me tingull dhe intonacion relativisht të pastër;
- luan me pak gabime.

**Nxënës/i,-ja arrin nivel shumë të mirë kur:**

- konsolidon elementet kryesore;

| |
|---|
| - impostohet shumë mirë;<br>- përvetësohet pastërtia e tingullit;<br>- përvetësohet pastërtia e kalimeve;<br>- përvetësohen disa mënyra të kolpeve të harkut;<br>- nxirren kolpe të harkut të qarta;<br>- përvetësohet vibratoja dhe zhvillimi dinamik i shkallëve;<br>- realizohen tipet e ndryshme të ushtrimeve si në detashe, stakato dhe legato;<br>- realizohet përdorimi i zonave të ndryshme të harkut.<br><br>**Shënim:** Vlerësimi i nxënësit bëhet nga komisioni, mësuesi i lëndës ka të drejtën e një note! |
| **Materiale dhe burime mësimore:**<br><br>Kontrabas, Lexhio, Partiturë, Sistem audio-video TIK, Internet |

**Dega Muzikë**

**Lënda: Flaut.**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - **Shkallë** të thjeshta | **Nxënësi:** |

| | |
|---|---|
| - Shkallë deri në 4 shenja # (Dieziz) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar.<br>- Shkallët deri në 4 shenja b (Bemol) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar deri në një Oktavë.<br>- Dominant, Septacordi per shkallet maxhore dhe Septacordi I zvogeluar per minoret,<br>- Metoda e Shkalleve nga Tafanel Goubert | - Realizon në mënyrë të veçantë shkallët përmendësh dhe me tingull te plotë.<br>- Praktikon frymëmarrjen dhe frymënxjerrjen e rregullt (diafragmën).<br>- Përdor lirshëm atakun (goditjen) dhe nxjerrjen e tingullit.<br>- Përvetëson pozicionet nga okatava e parë deri në të tretën.<br>- Luan Shkallët e arpezhet, intervalet me ritëm mesatar të shpejtë: legato e stakato.<br>- Ushtron dominant septacordin dhe atë të zvogëluar.; |
| **3 etyde në muaj**<br>- Metoda E. Prill.<br>- P. F. Artaud.<br>- E. Kohler (fillestarë).<br>- Wastall.<br>- Simon Hunt.<br>- H. Pllatonov për fillestarët.<br>- Metoda A. C. Petersen.<br>- Harris ushtrime teknike | **Nxënësi:**<br>- luan saktë aplikaturat;<br>- përvetëson elementet teknike, si: tingullin, goditjen, frymëmarrjen;<br>- respekton aplikaturat dhe dinamikën;<br>- interpreton me kualitet timbrik intonativ; |
| - Programi Artistik<br>- 3 duete për flaut<br>- Aria - W. A. Moxart. | - luan duetet në klasë së bashku me mësuesen ose me shokët e klasës;<br>- përvetëson pjesët në klasë, nga ana ritmike, dhe kohë pas kohe nga ana e lojës melodike dhe interpretative; |

| | |
|---|---|
| - Flauti magjik - W. A. Moxart.<br>- Gavotte - J. S. Bach.<br>- Minuet - J. S. Bach.<br>- Polonaise - J. S. Bach.<br>- Andantino - F. Rust.<br>- Minuetto - J. Hajden.<br>- Rondo - J. F. Dandrieu.<br>- Andante, Espressivo F.Mendelson.<br>- Melodi Shuman<br>- Romance Shubert<br>- Aria - J. Andersen.<br>- Polonaise - Th. Oesten.<br>- Nina- Nana - P. Gaci.<br>- “Malësori i vogël” - T. Harapi.<br>- Melodi - Ç. Zadeja. | - punon me prioritet dhe mënyra të ndryshme vështirësitë që shfaqen në materialin artistik;<br>- zbërthen me korrektësi materialin muzikor nga ana ndërtimore, teknike dhe emocionale;<br>- kërkon elementet e para të interpretimit artistik, duke zbuluar<br>- karakteristikat e secilit autor;<br>- realizon lojën me ngjyra dhe emocionalitet;<br>- praktikon mësimin e pjesëve përmendsh; |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallë muzikore<br>- Shkallët maxhore e minore me katër shenja me # (Diezis) dhe b (Bemola) me (dy oktava) në ritëm mesatar dhe të shpejtë. | **Nxënësi:**<br>- luan Shkallët me tingull të plotë e pa gabime;<br>- luan Shkallët detashe në format stakato e legato;<br>- luan pa gabime arpezhet dhe përmbysjet e tyre; |

| | |
|---|---|
| - Shkallë kromatike në metrin 2/4 e 1/4 në tempe mesatare. Metoda e shkalleve nga Tafanel | |
| **Ushtrime dhe etyde 3 ushtrime në muaj**<br>- E. Prill.<br>- E. Kohler: Fashikulli i parë.<br>- E. Kohler: Romantik.<br>- Soussman: Etyde.<br>- F. Caratge: 12 etyde.<br>- G. Gariboldi: Op. 132.<br>- Harris: Ushtrime teknike.<br>- L. Moyse- Ushtrime për Flaut: Fashikulli i parë. | **Nxënësi:**<br>- realizon gjatë lojës aplikaturat, frymëmarrjen, ritmikën e ushtrimit etj;<br>- respekton dinamikën e ushtrimeve;<br>- realizon frymëmarrjen mbi bazën e logjikës muzikore dhe teknike;<br>- luan etydet me ndjenjë, pastër e pa gabime;<br>- Luan tingullin dhe intonacionin e pastër. |
| - Repertori Muzikor<br>- 2 duete për flaut nga:<br>- Zhiga nga Sonata në Famaxhor, Moxart<br>- Moxart- Sonate<br>- Minuetto nga J. S. Bach: I, II, III<br>- Bethoven:Pjesë nga ciklivokal<br>- H. Bokerini: Minuetto<br>- Hendel: Sonata<br>- Teleman: Sonata Nr. 1 dhe 2 | **Nxënësi:**<br>- praktikon duetet, në fillim me mësuesin dhe, në një fazë të dytë;<br>- luan me nxënës të tjerë bashkëmoshatarë;<br>- ushtron kuptimin ritmik të pjesëve dhe, më pas, tërësinë e tyre melodike;<br>- zbërthen pjesët nga pikëpamja e formës muzikore;<br>- punon me mënyra të ndryshme vështirësitë teknike që shfaqen në materialin muzikor;<br>- evidenton karakteristikat e autorëve të veçantë. |

| | |
|---|---|
| - A. Vivaldi Sonatë Fa maxhor.<br>- A. Vivaldi- Koncert Nr. 4. 5, 6<br>- M. Blavet- Vol. I Sonata Flaut.<br>- Fils – Koncert<br><br>**Pjesë shqiptare** | |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallë muzikore<br>- me diezis e bemola,<br>- minoret përkatëse,<br>- arpezhet e tyre, në mënyrat stakato e legato.<br>- Metodat Tafanel - Goubert dhe ushtrime të përditshme nga Soussman, op. 43. | **Nxënësi:**<br><br>- Luan **Shkallët** në mënyrë të saktë, pastër e përmendsh, duke prekur gjithë tastierën e flautit;<br>- luan përmbysjet, si: kuartola, triola e septola me legato e stakato;<br>- ka një organizim të mirë e të qartë të shkallëve e arpezheve; |
| **Ushtrime dhe etyde**<br><br>- 3 etyde në muaj si më poshtë:<br>- E. Kohler: Fash. II, op. 33.<br>- Fustenau.<br>- V. Pllatonov.<br>- L. Moyse: 1-2-3.<br>- Berbiguer - 18 etyde. | **Nxënësi:**<br><br>- aftësohet në zbatimin e përpiktë të aplikaturave;<br>- kushton një vëmendje të veçantë nuancave shprehëse;<br>- respekton dinamikën e ushtrimeve dhe etydeve;<br>- dallon unifikimin e regjistrave;<br>- zbaton kërkesat për një frymëmarrje të lirshme e të natyrshme. |

| | |
|---|---|
| - Th. Bochm: Op. 15.<br>- J. Andersen: Op. 21. | |
| **Programi Artistik 2 duete për flaut**<br>- 2 kohë sonate.<br>- 1 kohë koncerti me kadencë.<br>- Minuete.<br>- Suita.<br>- Pjesë solo për flaut.<br>- Dopppler fantazi.<br>- Pjesë nga autorë shqiptarë.<br>- Sonata Teleman në Fa maxhor dhe Si b maxhor.<br>- J.S. Bach: Sonatat<br>- F. Hendel: Sonata<br>- C. Ph. E. Bach: Sonata solo.<br>- W. A. Mozart: Sonata<br>- W. A. Mozart: Koncerte.<br>- A. Vivaldi: Nga V. VI i koncerteve.<br>- L. Vinci – Sonatë.<br>- Haydn – Koncert J.<br>- J. Quantz: Koncert në sol maxhor.<br>- Stamitz: Koncert G- Dur | - Luan duetet në klasë së bashku me mësuesen ose me shokët e klasës;<br>- Luan pjesët për flaut e piano , duke krijuar një harmonizim të plotë të<br>- dy instrumenteve;<br>- luan mirë nga ana ritmike e melodike dhe shpreh natyrën koncertale të lojës në instrument;<br>- praktikon mësimin e pjesëve përmendsh;<br>- shpreh në mënyrë të konsoliduar elementet e tingëllimit, si: pastërtia timbrike, tejshkueshmëria, vibrimi dhe ngjyrat e interpretimit;<br>- evidenton karakteristikat e autorëve të veçantë të pjesëve;<br>- zbërthen veçoritë e formës muzikore.<br>- punon për të evidentuar individualitetin e autorëve dhe tregon qartë karakteristikat e epokës historike.<br>- zbërthen teorikisht e praktikisht veçoritë e formës muzikore dhe i bën ato pjesë organike të interpretimit muzikor. |

| | |
|---|---|
| - E. Kohler: Koncert.<br>- P. Gaci: Baladë.<br>- Paparisto: Romancë.<br>- L. Dizdari: Romancë. Nikolla Zoraqi/ Romance Tish Daija /Rapsodi.<br>- F. Devienne/ Sonate per flaur dhe Piano<br>- F. Poulence/ Sonate | |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE:**

Për të arritur një nivel sa më të mirë të lojës në instrument, nxënësi duhet edukuar të studiojë në mënyrë sa më sistematike. Në këtë proces, puna e mësuesit duhet të jetë e vazhdueshme, e thelluar dhe e lidhur ngushtë me vëzhgimin psikologjik e emocional të nxënësit, që nga shkallët e para të formimit, deri në plotësinë e mjaftueshme të tij. Për të pasur rezultate sa më të mira, trajtimi psiko emocional duhet të shtrihet gjatë gjithë vitit dhe të synojë, në radhë të parë, një administrim sa më të mirë të orës së mësimit. Po ashtu, ndërthurja e kërkesave teknike të lojës në instrument me kërkesat artistike të veprave të veçanta, do t'i jepte orës së mësimit më shumë frymëmarrje dhe do ta bënte atë më të pëlqyeshme për nxënësin.

Në lidhje me zbatimin praktik të programit, do të ishte i nevojshëm ndërgjegjësimi i nxënësit me kuptimin e tij, rëndësinë që ka secila pjesë në formimin sistematik të nxënësit dhe mundësitë që krijojnë ato për avancimin e tij gradual. Kështu, ushtrimet, etydet dhe pjesët e tjera artistike të programit duhet t'u përgjigjen grup moshave të ndryshme dhe, nga ana tjetër, t'u japin mundësi individëve më të përparuar të ecin lirshëm e pa sforcime. Është mirë që, në momente të caktuara të realizimit të programit, të planifikohen forma të veçanta të kontrollit të dijeve e të nivelit të nxënësit. Këto do të ishin mbështetje e sigurt për shkallët e tjera të realizimit dhe do ta ndihmonin nxënësin t'i kuptonte nga afër kërkesat e mëtejshme të mësuesit. Për këtë, edhe kontrolli i materialeve teknike dhe i pjesëve të tjera artistike të programit duhet të përputhet me shkallët

e studimit të tyre: ngadalë (ushtrim e kontroll në detaje); pak më shpejt (vërtetim i studimit të saktë të materialit dhe siguri për më tej); më shpejt e, së fundi trajtim i materialit në tempin e kërkuar nga të partitura. Sipas kësaj dinamike, edhe kontrolli i përgjithshëm i dijeve do të ishte një fazë e rëndësishme në formimin e nxënësit dhe do të shërbente për një menaxhim më të mirë të mundësive dhe mangësive të tij për të ardhmen.

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:**

Vlerësimi në kontrollet teknike dhe në saxho bëhet në mënyrë kolegjiale. Për njohjen e drejtpërdrejtë të punës së nxënësit në klasë, mësuesi i lëndës ka të drejtë të ulë ose të ngrejë një notë.

Mbi bazën e **3 notave, 2 kontrolleve teknike dhe 1 saxho**, vendoset nota semestrale.

**Nxënës/i, -ja arrin nivelin Mjaftueshëm, kur:**

**luan jo korrekt;**

- *luan me ritë;*
- luan me tingull mesatar;
- luan me intonacion jo të këndshëm;
- me shkallë shpejtësie të ulët e me disa gabime.

**Nxënës/i,-ja arrin nivelin Mirë, kur:**

- luan mirë;
- *ritmikisht,*
- *me tingull e me intonacion, të pastër e me pak gabime.*

**Nxënës/i, -ja arrin nivelin Shumë Mirë, kur:**

| |
|---|
| - luan shumë mirë në të gjitha elementet e mësipërme.<br><br>*Shënim:* ***Pjesët mund të zëvendësohen nga ana e mësuesit specialist me pjesë të të njëjtit nivel.*** |
| **Materiale dhe burime mësimore:**<br><br>Flaut, Lexhio, Partiturë, Sistem audio-video TIK, Internet |

**Dega Muzikë**

**Lënda: Oboe në vazhdim.**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Të gjitha **Shkallë**t muzikore<br>- Maxhore dhe minore, me (# e b). **Shkallë**t kromatike. | **Nxënësi:**<br>- luan pastër dhe pa gabime **Shkallë**t gjer në regjistrat e lartë;<br>- luan përmbysjet me kuartola, triola,legato dhe stakato;<br>- luan përmbysjet arpexhit, dominant septakordit;<br>- realizon **Shkallë**t me një tingull të plotë dhe me intonacion të pastë. |
| - Etyde<br>- Bllat - etyde. Videman - etyde. | **Nxënësi:**<br>- luan me një tingull të pastër; |

| | |
|---|---|
| - Salviani **-** ushtrime për mekanizmin dhe tonalitetet – volumi 1 | - luan ritmikisht saktë ushtrimet;<br>- realizon një frymëmarrje të lirshme dhe mbi bazën e një logjike muzikore;<br>- realizon mirë frakturat ritmike të etydit. |
| **L . Dizdari - romancë. A . Paparisto - këngë epike**. | - zbërthen strukturën e çdo pjese për sa i përket anës teknike dhe lojës së saktë të figurave ritmike; |
| - **G . F. Teleman** - sonatë në sol minore.<br>- **T. Albinoni** - koncert në do maxhore. | - zbërthen çdo pjesë muzikore mbi bazën shkrimore dhe emocionale;<br>- njeh kompozitorët që kanë shkruar pjesët;<br>- luan pjesën muzikore saktë në ritëm dhe intonacion;<br>- interpreton pjesët me ndjenjë dhe emocion. |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Të gjitha **Shkallë**t muzikore<br>- Maxhore dhe minore, me (# e b).<br>- **Shkallë**t kromatike. | **Nxënësi:**<br>- luan pastër dhe pa gabime **Shkallë**t gjer në regjistrat e lartë;<br>- realizon me saktësi elementet teknike të shkallës, siç janë; *tercat, triolat, arpezhet dhe dominant septakordet*;<br>- luan përmbysjet e *arpezheve dhe dominant sep-takordeve*;<br>- shoqërohen këto elemente teknike të domosdoshme nga elementet muzikore, si: portato, legato, piano, forte dhe me forma të tjera studimi;<br>- realizon **Shkallë**t me një tingull të plotë dhe me intonacion të pastër. |
| - Etyde | - luan me një tingull të pastër; |

| | |
|---|---|
| - Ferling - etyde.<br>- Brod - etyde.<br>- **Bach -** etyde dhe duete, volumi 1 | - luan ritmikisht saktë ushtrimet;<br>- realizon një frymëmarrje të lirshme dhe mbi bazën e një logjike muzikore;<br>- realizon mirë frakturat teknike të etydit; |
| - **P. Gaci** - këngë epike.<br>- A . Paparisto - *romancë.* | - realizon strukturën e çdo pjese për sa i përket anës teknike dhe lojës së saktë të figurave ritmike; |
| - Cimaroza - Introducione, në 4 kohë<br>- B. Marcelo - koncert me 3 kohë. | - realizon çdo pjesë muzikore mbi bazën shkrimore dhe emocionale;<br>- njeh kompozitorët që kanë shkruar pjesët;<br>- luan pjesën muzikore saktë në ritëm dhe intonacion;<br>- interpreton pjesët me ndjenjë dhe emocion. |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| **Të gjitha Shkallët muzikore**<br>- Maxhore dhe minore, me (# e b).<br>- Shkallët kromatike. | **Nxënësi:**<br>- luan pastër dhe pa gabime **Shkallë**t gjer në regjistrat e lartë;<br>- realizon me saktësi elementet teknike të shkallës , siç janë: *tercat, triolat, arpezhet dhe dominant septakordet*;<br>- luan përmbysjet e arpezheve dhe dominant sep-takordeve;<br>- realizon këto elemente teknike të domosdoshme me elementet muzikore, si: *portato, legato, piano, forte* dhe me forma të tjera studimi;<br>- realizon **Shkallë**t me një tingull të plotë dhe me intonacion të pastër; |
| **Etyde** | - luan me një tingull të pastër;<br>- luan ritmikisht saktë ushtrimet; |

| | |
|---|---|
| - J. H. Luft - 24 etyde. Brod - 48 etyde. Faldi - 15 etyde. | - realizon një frymëmarrje të lirshme dhe mbi bazën e një logjike muzikore;<br>- realizon mirë frakturat teknike të etydit.0. |
| - **P. Gaci** - baladë.<br>- **A . Paparisto** - romancë. **J . Minga** – variacione. **P . Gaci** - koncert. | - realizon strukturën e çdo pjese për sa i përket anës teknike dhe lojës së saktë të figurave ritmike; |
Inkurajon praktikën e rregullt dhe performancën solo si dhe në ansamble. Performanca është një pjesë kyçe e procesit të mësimit, e cila ndihmon në ndërtimin e vetëbesimit dhe në zhvillimin e aftësive skenike.

Siguron që mësuesi të jepi vlerësime të rregullta dhe kritika konstruktive, duke theksuar si sukseset ashtu edhe zonat për përmirësim. Kjo ndihmon në motivimin e nxënësve dhe në orientimin e tyre drejt përmirësimit të vazhdueshëm.

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:**

**Niveli MJAFTUESHEMN**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- Demonstron njohuri bazë të teorisë muzikore dhe aftësi teknike në trombon.
- Arrin të luajë etydet dhe pjesët e caktuara me gabime, dhe temp jo si është në shkruar në part.



ASCAP

- Tregon përpjekje për të përdorur dinamikat dhe artikulacionin, edhe pse nuk është gjithmonë i qartë ose i saktë.
- Përfshin elementë bazë të interpretimit muzikor, por pa thellësi ose ndjenjë të fortë të stilistikës.
- Luan me kapacitet të reduktuar të frymëmarrjes dhe frymë nxjerrrjes.
- Nuk arrin të artikulojë notat sipas aplikaturave të part.
- Posturën dhe pozicionimin në instrument nuk e ka të rregullt.

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- Demonstron njohuri të mira të teorisë muzikore dhe teknikë të fortë në instrument.
- Luajnë etydet dhe pjesët e caktuara pa vështirësi dhe me numër të kufizuar të gabimeve.
- Përdor dinamikat dhe artikulacionin në mënyrë efektive për të shtuar shprehinë në performancën e tyre.
- Tregon aftësi të mira interpretuese, duke përfshirë ndjenjën e frazimit dhe stilistikës, edhe pse mund të ketë vend për përmirësim.
- Mbështet me diafragmë materialin tekniko-melodik dhe luan me tingull të pastër dhe lirshëm .

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- Tregon njohuri të thella të teorisë muzikore dhe zotëron teknikë të avancuar në trombon.
- Performon etydet dhe veprat e caktuara me precizon të lartë, fluencë dhe pa gabime.
- Demonstron përdorim të avancuar të dinamikave dhe artikulacionit, duke i integruar ato në mënyrë që të shtojnë thellësinë dhe dimensionin në muzikë.
- Evidenton një nivel të lartë të interpretimit muzikor, duke treguar sensibilitet të thellë ndaj stilistikës, karakterit dhe kontekstit muzikor, si dhe aftësi për të tërhequr dhe mbajtur vëmendjen e dëgjuesit.

| |
|---|
| - Luan programin përmendësh |
| **Materiale dhe burime mësimore:**<br><br>Trombon, lexhio, partiturë, internet , Intonator etj. |

**Dega Muzikë**

**Lënda: Bastuba**

**Klasa:10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - **Shkallë**t me 4 shenja # dhe Bemol me dy oktava<br>- ( arpezhe, me përmbysje , Intervalet ( terca kuarta )<br>- Legato ,<br>- Staccato ,<br>- Detache | **Nxënësi:**<br>- zotëron regjistrat e mesëm të ulët, me pedale, në një gamë prej dy deri në tre oktavë;<br>- përvetëson aftësi që të mund luaj në 3 dhe shkalle diatonike, me artikulacione të ndryshme;<br>- luan në të gjithë çelësat e shkallëve kromatike me artikulimet e më poshtme:legatto edhe stakato, dhe me alternim ndërmjet këtyre të dyjave. |
| **Etyde:** | - forcon teknika themelore dhe të avancuara të frymëmarrjes;<br>- përmirëson kohëzgjatjen dhe intonacionin; |

| | |
|---|---|
| - William Bell -Metoda e plotë Tuba/Baritone e William J. Bell; Mel Culbertstons<br>- Giulio Marco Bordogni –Studime Bordogni;<br>- Giuseppe Concone – Vëllimi 1;<br>- JB Arban –Metoda e plotë për Tuba dhe Baritone;<br>- C. Kopprasch –60 Etyde<br>- Wesley -Studime me regjistër të ulët; Gilles Milliére<br>- Ushtrime në dy oktava; Walter Hilgers Rutina e perditshme;<br>- Roger Bobo -Bach për Tuba dhe Euphonium;<br>- William<br>- Presser -16 etyde për Euphonium;<br>- Paul Nauer -60 Etyde për Euphonium; M. Schossberg - | - përvetëson aftësi që lejojnë ekzekutimin e të njëjtave shkallë me ritme që i përkasin masave të përbëra 6/8, 9/8 dhe 12/8 + 5/8 dhe 7/8;<br>- kryen arpezhet në gjendjen e tyre themelore, duke përfshirë të gjitha përmbysjet;<br>- përvetëson aftësi për zhvillimin e kujtesës nëpërmjet kryerjes së lëvizjeve ose studimeve;<br>- |
| - Pjesë të Huaja :<br>- Alexej Lebedjeë - Koncert (Allegro);<br>- Lebedjeë - Koncerti nr. 1;<br>- Phillipe Catalinet<br>- Legjenda; D. Schostakoviç -Adage; - | - zhvillon shprehitë ekzekutive;<br>- interpreton fraza të qarta;<br>- luan me tingull të plotë;<br>- luan në stilin e veprës; |

| | |
|---|---|
| - GP Telemann – Sonata; Eugéne Bigot -<br>- Carillon dhe Bourdon; Alec Ëilder<br>- Sonata;<br>- Leonard Dumitru -Sonata për Tuba Solo. | |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallë me 4-5 shenja # dhe Bemol me dy oktava<br>- (arpezhe, me përmbysje , Intervalet ( terca kuarta )<br>- Legato ,<br>- Staccato ,<br>- Detache.<br>- Dominanta dhe Diminuita | **Nxënësi:**<br>- luan Shkallët saktë teknikisht me tempe të shpeja ;<br>- artikulon materialin teknik në të gjitha mënyrat ;<br>- zhvillon tingullin në të gjitha regjistrat;<br>- përdor në mënyrë eficinte kyçin e dorës së djathtë; |
| **Etyde**<br>- William Bell -Metoda e plotë Tuba e Ëilliam J. Bell; Mel<br>- Culbertstons -Bazat 6;<br>- Giulio Marco Bordogni –Etude Bordogni; | - zgjeron gamën dhe fleksibilitetit të tingullit;<br>- përvetëson ornamente dhe shprehi muzikore;<br>- zhvillon dhe stabilizon nocionin e pulsimit dhe akordimit;<br>- përvetëson aftësi që lejojnë ekzekutimin e trilleve, grupeve dhe apoggiaturave; |
| - Giuseppe Concone – Vëllimi 1; | - përvetëson aftësi në kryerjen e artikulimit të dyfishtë dhe të trefishtë të kuptuarit dhe zotërimit të tij; |

| | |
|---|---|
| - JB Arban –Metoda e plotë për Tuba dhe Baritone; C. Kopprasch –60 Studime të zgjedhura;<br>- Jacob Wesley -Studime me regjistër të ulët; Gilles Milliére<br><br>**Ushtrime në dy oktava;**<br><br>- Walter Hilgers –Rutina e përditshme;<br>- Roger Bobo -Bach për Tuba. | - përvetëson aftësi për të kryer transpozimin e tonalitetit;<br>- përvetëson aftësi që lejojnë fillimin e zhvillimit të teknikës së trillit të buzëve; |
| - Artur Frackenpohl – Koncertino;<br>- James Hartley – Sonatina;<br>- Don Haddad – Suitë;<br>- David Uber -Legjenda e Ariut të Fjetur;<br>- Eduard Barat -Hyrje dhe vallëzim;<br>- Thomas Bversdorf - Sonata;<br>- RV Williams -Gjashtë këngët popullore angleze;<br>- GF Haendel (rreth. Winston Morris) - Sonata nr. 5; | - unifikon lojën;<br>- realizon saktë dinamikat e kërkuara;<br>- zhvillon aftësinë interpretative; |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |

| | |
|---|---|
| - **Shkallë**<br>- **Shkallët** me 6 shenja # dhe Bemol me dy oktava<br>- ( arpezhe, me përmbysje , Intervalet ( terca kuarta, kuinta, Oktava)<br>- Legato ,<br>- Staccato ,<br>- Detache . | **Nxënësi:**<br>- Përmirëson qëndrueshëm aftësitë teknike;<br>- zhvillon artikulacion të qartë dhe të saktë,<br>- është më efektiv dhe kreativ;<br>- përmirëson gjatë lojës regjistrat e ulët, të mesëm dhe të lartë ; |
| **Etyde:**<br>- Ëilliam Bell :Metoda e plotë Tuba e Ëilliam J.Bell; Giulio Marco<br>- Bordogni –Studime Bordogni;<br>- Sam Pialfian, Patrick Sheridan<br>- Giuseppe Concone – Vëllimi 1; -<br>- JB Arban –Metoda e plotë për Tuba;<br>- C. Kopprasch –60 Studime të zgjedhura;<br>- Wesley -Studime me regjistër të ulët;<br>- Gilles Milliére -Ushtrime në dy oktava. | - forcon teknika themelore dhe të avancuara të frymëmarrjes;<br>- përmirëson kohëzgjatjen e frymëmarrjes dhe intonacionit;<br>- aftësohet në përdorimin e teknologjisë moderne dhe metodave të reja të lojës;<br>- përshtat me tendencat e fundit në literaturën për Bastubës; |
| **Pjesë të huaja :**<br>- John G. Mortimer -Koncerti i Tubës; | - zhvillon shprehitë ekzekutive;<br>- interpreton frazat të qarta. |

| | |
|---|---|
| - Roger Kellaëay -Kënga e mëngjesit;<br>- Jan Koetsier -Koncertino;<br>- RV Ëilliams -Koncert për bas Tuba;<br>- Carlos Marques -Koncertino;<br>- Rodney Neëton - Kapriçio;<br>- Edward Gregson - Koncerti Tuba;<br>- Jean Aubain -Tema dhe variacioni; | - luan me tingull të plotë;<br>- luan në stilin e veprës;<br>- mëson të interpretojë melodi të qarta dhe të thjeshta të sonatës, duke u përqendruar në frymëmarrje dhe frazim;<br>- fokusohet në kontrollin e tonit dhe në dinamikën e butë për të arritur një interpretim ekspresiv;<br>- eksploron kontekstin historik të periudhave të ndryshme dhe veçoritë stilistike të muzikës;<br>- njeh formën sonate dhe strukturën e saj;<br>- fokusohet në shprehjen e ndjenjave dhe në dinamikën e pasur për të transmetuar karakterin e pjesës. |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE:**

Për arritjen e një niveli të mirë të nxënësit, mësuesi duhet të bëjë kujdes në zgjedhjen e programit sipas nivelit të nxënësit (duke marrë parasysh problemet teknike dhe përshtatjen e materialit artistik me karakterin e nxënësit).

Duhet të punojë me nxënësin në mënyrë që ai të shpalosë dhe vlerat e tij individuale, në mënyrë që të mos jetë thjesht një kopje e mësuesit. (mbështetur gjithmonë në materialet plotësuese teknike). Nxënësi duhet të jetë në gjendje që të arrijë një performancë sa më të bukur.

Praktikon teknikat e ndryshme të artikulimit si staccato, legato, dhe tenuto. Mësuesi udhëzon nxënësit të eksperimentojnë me intensitetin dhe kohëzgjatjen e artikulimit për të gjetur stilin e tyre të interpretimit.

Inkurajon praktikën e rregullt dhe performancën solo si dhe në ansamble. Performanca është një pjesë kyçe e procesit të mësimit, e cila ndihmon në ndërtimin e vetëbesimit dhe në zhvillimin e aftësive skenike.

Siguron që mësuesi të jepi vlerësime të rregullta dhe kritika konstruktive, duke theksuar si sukseset ashtu edhe zonat për përmirësim. Kjo ndihmon në motivimin e nxënësve dhe në orientimin e tyre drejt përmirësimit të vazhdueshëm.

## UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

**Niveli Mjaftueshëm**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- Demonstron njohuri bazë të teorisë muzikore dhe aftësi teknike në Bastub .
- Arrin të luajë etydet dhe pjesët e caktuara me gabime, dhe temp jo si është në shkruar në part.
- Tregon përpjekje për të përdorur dinamikat dhe artikulacionin, edhe pse nuk është gjithmonë i qartë ose i saktë.
- Përfshin elementë bazë të interpretimit muzikor, por pa thellësi ose ndjenjë të fortë të stilistikës.
- Luan me kapacitet të reduktuar të frymëmarrjes dhe frymë nxjerrrjes.
- Nuk arrin të artikulojë notat sipas aplikaturave të part.
- Posturën dhe pozicionimin në instrument nuk e ka të rregullt.

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- Demonstron njohuri të mira të teorisë muzikore dhe teknikë të fortë në instrument.
- Luajnë etydet dhe pjesët e caktuara pa vështirësi dhe me numër të kufizuar të gabimeve.
- Përdor dinamikat dhe artikulacionin në mënyrë efektive për të shtuar shprehinë në performancën e tyre.

- Tregon aftësi të mira interpretuese, duke përfshirë ndjenjën e frazimit dhe stilistikës, edhe pse mund të ketë vend për përmirësim.
- Mbështet me diafragmë  materialin tekniko-melodik dhe luan me tingull të pastër dhe lirshëm .

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- Tregon njohuri të thella të teorisë muzikore dhe zotëron teknikë të avancuar në Bastub.
- Performon etydet dhe veprat e caktuara me precizion të lartë, fluencë dhe pa gabime.
- Demonstron përdorim të avancuar të dinamikave dhe artikulacionit, duke i integruar ato në mënyrë që të shtojnë thellësinë dhe dimensionin në muzikë.
- Evidenton një nivel të lartë të interpretimit muzikor, duke treguar sensibilitet të thellë ndaj stilistikës, karakterit dhe kontekstit muzikor, si dhe aftësi për të tërhequr dhe mbajtur vëmendjen e dëgjuesit.
- Luan programin përmendësh.

**Materiale dhe burime mësimore:**

Bastuba ,  lexhio Intonator etj.

**Dega Muzikë**

**Lënda: Kitarë**

**Klasa:10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| 4 shkallë muzikore, etyde dhe materiale ndihmëse teknike | **Nxënësi:**<br>- realizon teknikisht shkallën, dhe me nota të lidhura;<br>- realizon të gjitha mënyrat e dorës së djathtë, dhe të respektojë gishtat e dorës së majtë;<br>- luan me progresion ritmik dhe dinamik;<br>- realizon teknikisht dhe muzikalisht etydet;<br>- luan në tempin e duhur;<br>- luan përmendësh;<br>- realizon figurat ritmike;<br>- luan tingull të lidhur;<br>- luan pozicionet në kitarë; |
| Kohë nga suitat paraklasike (Baroke) | - luan në tempin dhe stilin e duhur;<br>- ndjen zërat dhe linjat polifonike;<br>- kupton gjatë luajtjes në instrument vazhdimësinë dhe rrjedhshmërinë e tingullit;<br>- luan ushtrime gishtash për pasazhet e vështira; |

| | |
|---|---|
| Temë me variacione, Rondo, Capriçio,Sonatë,Suitë | - realizon tempet e kohëve te koncertet;<br>- njeh ndërtimin dhe tempet e variacioneve tek temat me variacione;<br>- ndërgjegjësohet për realizimin e programit në përputhje me etapat e punës praktike të përcaktuar nga mësuesi;<br>- realizon kërkesat tekniko- muzikore përmes frazimit, karakterit teknik dhe zbërthimit emocional; |
| - 2 Bravura | - luan në stilet dhe tempet e duhura;<br>- realizon duke nxjerrë në pah karakterin e çdo bravure;<br>- luan bukur emocionalisht dhe në mënyrë virtuoze;<br>- zhvillon personalitetin e tij në lojë. |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| 8 shkallë muzikore,etyde dhe materiale ndihmëse teknike | **Nxënësi:**<br>- luan Shkallët me apojando dhe tirando në të gjitha mënyrat;<br>- realizon ushtrimet teknike për të përvetësuar teknikën e Barres dhe të Frazholetës;<br>- realizon kalimet deri në pozicionin e 12-të.<br>- realizon teknikisht dhe muzikalisht etydet;<br>- ndjen frazimet;<br>- luan në tempin e duhur;<br>- luan me një tingull të qartë dhe brilant; |

| | |
|---|---|
| - Kohë (kontrastuese) nga suitat paraklasike | - luan në stilin e duhur;<br>- dallon tempet e kohëve të ndryshme të suitave;<br>- luan duke mbajtur notat në formë pedali;<br>- dallon qartë linjat e zërave |
| - Temë me variacione, Rondo, Capriçio,Sonatë,Suitë | - realizon tempet e kohëve te koncertet;<br>- njeh ndërtimin dhe tempet e variacioneve tek temat me variacione;<br>- ndërgjegjësohet për realizimin e programit në përputhje me etapat e punës praktike të përcaktuar nga mësuesi;<br>- realizon kërkesat tekniko- muzikore përmes *frazimit, karakterit teknik dhe*<br>- zbërthimit emocional;<br>- luan në stilin e duhur sipas epokës;<br>- luan bukur emocionalisht dhe me dinamikën e duhur;<br>- |
| - 2 Bravura | - luan në mënyrë virtuoze duke përfshirë elementet teknike dhe artistike;<br>- luan saktë për sa i përket dinamikës kontrastuese sidomos te bravurat kontemporane;<br>- luan duke i përcjellë publikut (në saxho) emocionet e tij të brendshme. |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - 8 shkallë muzikore,etyde dhe materiale ndihmëse teknike | **Nxënësi:** |

| | |
|---|---|
| | - luan të gjitha materialet ndihmëse në funksion të shkallës së vështirësisë që ka programi;<br>- përsos sa më mirë materialin duke iu përgjigjur një pasazhi të vështirë;<br>- realizon teknikisht dhe muzikalisht etydet;<br>- ndjen frazimet;<br>- luan në tempin e duhur;<br>- luan me një tingull të qartë dhe brilant;<br>- luan me kontrastet dinamike;<br>- luan me kujdes aksentet; |
| - Kohë (kontrastuese) nga suitat paraklasike | - luan në stilin e Bahut;<br>- realizon strukturën polifonike të kohëve të suitës;<br>- luan me nota dhe tinguj të zgjatur;<br>- luan ndryshimin e tempeve për secilën kohë të suitës; |
| - Temë me variacione, Rondo, Koncert,Sonatë,Suitë | - realizon tempet e kohëve te koncertet;<br>- njeh ndërtimin dhe tempet e variacioneve tek temat me variacione;<br>- ndërgjegjësohet për realizimin e programit në përputhje me etapat e punës praktike të përcaktuar nga mësuesi;<br>- realizon kërkesat tekniko- muzikore përmes frazimit, karakterit teknik dhe<br>- zbërthimit emocional.<br>- performon bukur, në mënyrë koncertale nga ana teknike dhe artistike. |
| - 2 Bravura | - luan në mënyrë virtuoze duke përfshirë elementet teknike dhe artistike; |

| | |
|---|---|
| | - luan saktë për sa i përket dinamikës kontrastuese sidomos te bravurat kontemporane;<br>- luan duke i përcjellë publikut (në saxho) emocionet e tij të brendshme. |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE:**

Për arritjen e një niveli të mirë te nxënësi i klasës X, duhen pasur parasysh disa hapa që bëjnë të mundur realizimin e programit, si: zgjedhja e materialeve teknike dhe artistike nga mësuesi për secilin nxënës (duke marrë parasysh problemet teknike dhe përshtatjen e materialit artistik me karakterin e nxënësit).

Programi do të ndahet në 3 orë mësimi gjatë javës, në mënyrë që nxënësi të jetë sa më i qartë me shpjegimin dhe të jetë vazhdimisht në proces studimi. Nxënësi merr pjesë në saxho mbasi ka kryer detyrimet e të dyja kontrolleve teknike. Në rast se nxënësi është me raport mjekësor, do të shlyejë detyrimin në një datë tjetër të caktuar nga komisioni.

Për arritjen e një niveli sa më të mirë të nxënësit të klasës XI, mësuesi duhet të bëjë kujdes në zgjedhjen e programit sipas nivelit të nxënësit. Programi do të ndahet në 3 orë mësimi. Mësuesi duhet të punojë me nxënësin në mënyrë që ai të shpalosë dhe vlerat e tij individuale. Në këtë klasë, prioritet do t'u jepet teknikave të apojandos, tirandos, si dhe 12 pozicioneve në kitarë (mbështetur gjithmonë në materialet plotësuese teknike). Nxënësi duhet të jetë në gjendje që të arrijë një performancë sa më të bukur si paraprijëse e provimit të diplomës.

Nxënësi merr pjesë në saxho mbasi ka kryer detyrimet e të dyja kontrolleve teknike. Në rast se nxënësi është me raport mjekësor, do të shlyejë detyrimin në një datë tjetër të caktuar nga komisioni.

Në klasën XII, nxënësi duhet të arrijë të deshifrojë vetë pa vështirësi gjithë programin e zgjedhur nga mësuesi. Mësuesi duhet të punojë me nxënësin me pasazhet e veçanta (aty ku nxënësi shfaq vështirësi). Prioritet të veçantë do t'i jepet performancës artistike, në mënyrë që nxënësi të realizojë sa më mirë programin e diplomës dhe të përgatitet për përballjen me publikun.

**Në klasën XII nxënësi do të shlyejë vetëm 2 kontrolle teknike dhe saxhon e semestrit të parë.**

- Rekomandime për kontrollet teknike
- Gjatë vitit shkollor zhvillohen 4 kontrolle teknike.
- Në çdo kontroll teknik luhen në mënyrë të detyruar 2 shkallë (mazhore-minore, terca,oktava,) me të gjitha mënyrat, si dhe 2 etyde.
- I gjithë programi luhet përmendsh.

**Rekomandime për saxhot**

- Gjatë vitit shkollor zhvillohen 2 saxho .
- Në çdo saxho luhet në mënyrë të detyruar:
- 1-2 kohë suite Bach, Sanz,Milan,Visee,Ëeis etj. (paraklasikë).
- 1 kohë sonatinë,sonatë ose vepër ciklike nga periudha të ndryshme stilistike.(paraklasike ose klasike,romantike etj).
- 1 bravurë (klasike, romantike, kontemporane) nga autorët: F.Tarrega,J.Ferrer,C.Henze,J.Mertz,J.Duarte,J.Sagreras,H.Teuchert,Abel Carlevaro, Metoda M. Carcassi op 60(25 etyde), Metoda Sor & Coste(Chiesa), Scarlatti,V.Lobos,Gregnani,L.Brouëer etj.
- I Gjithë programi luhet përmendësh.

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:**

Vlerësimi i nxënësit në kontrollet teknike do të bëhet nga komisioni i përbërë nga të gjithë mësuesit që kanë nxënës në klasën përkatëse (me jo më pak se 3 veta).

Vlerësimi përfundimtar i nxënësit do të dalë si rezultat i mbledhjes dhe përpjesëtimit matematikor të notave të vëna nga të gjithë anëtarët e komisionit.

Vlerësimi i nxënësit në saxho do të bëhet nga komisioni i mësuesve të caktuar nga drejtoria (me jo më pak se 3 veta). I përfshirë në vlerësimet e komisionit do të jetë edhe vlerësimi i mësuesit përkatës të nxënësit.

Vlerësimi përfundimtar i nxënësit do të dalë si rezultat i mbledhjes dhe përpjesëtimit matematikor të notave të vëna nga anëtarët e komisionit, plus notën e mësuesit të lëndës.

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- ka lëvizje me ritmin;
- ka pickim të dobët dhe tingull mesatar;
- luan me intonacion jo të këndshëm;
- nuk ka qartësi në lojë;
- luan me disa gabime.

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- luan mirë ritmikisht;
- luan me tingull e me intonacion;
- luan pastër e me pak gabime.

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- luan shumë mirë ritmikisht;

| |
|---|
| - luan me tingull te qartë dhe të lidhur;<br>- luan përmendësh dhe pa gabime;<br>- interpreton dhe luan me ndjeshmëri pjesët. |
| **Materiale dhe burime mësimore:**<br><br>Kitarë, Lexhio, Partiturë, Stol këmbe, Sistem audio-video TIK, Internet. |

**Dega Muzikë**

**Lënda: Fizarmonikë**

**Klasa:10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Shkallë muzikore<br>- Paralele me dy duart.<br>- Me linja të kundërta.<br>- Me tercë në bas.<br>- Arpezhet/akordet.<br>- Me përmbysjet e tyre. | **Nxënësi:**<br><br>- Realizon teknikisht shkallën;<br>- zhvillon tingullin;<br>- sistemon lëvizjet e kacekut;<br>- unifikon lojën me dy duar; |
| - Vepër polifonike<br>- Bach, | - evidenton temën kryesore, dytësore;<br>- ndan zërat nga njëri tjetri; |

| | |
|---|---|
| - Hendel<br>- Scarlatti<br>- Moxart, etj. | - realizon saktë aplikaturat;<br>- interpreton ornamentet e muzikës polifonike;<br>- zotëron njohuri për periudhën, kompozitorët, stilin e veprave; |
| **Etyde**<br>**Metodat:**<br>- Rakic<br>- Anzaghi<br>- Farfisa<br>- Fugazza<br>- Kramer<br>- Holminov<br>- Yaskevich etj. | - zhvillon tingullin dhe organizimin e tij në tempin e duhur;<br>- realizon përdorimin e kacekut mbi bazën e logjikës teknike e muzikore;<br>- respekton partiturën;<br>- realizon të gjithë elementet teknike dhe muzikale; |
| **Pjesë shqiptare**<br>- Krajka,<br>- F. Deda,<br>- A.Peçi,<br>- V.Filaj etj. | - realizon teknikisht pjesën, frazat, tempin;<br>- ndan në fragmente partin, duke evidentuar pasazhet e vështira, temën kryesore, dytësore, elementet shoqërues;<br>- realizon pjesën në karakterin e duhur;<br>- zhvillon aftësitë shprehëse dhe interpretative; |
| **Pjesë klasike ose romantike: uverturë, poloneze, sonate, tokatë etj.** | - realizon saktë tempin dhe frazat;<br>- njeh formën, periudhën, kompozitorët karakteristikat; |

| | |
|---|---|
| - Mozart,<br>- Rossini,<br>- Cimarosa,<br>- Bethoven<br>- Chopin<br>- Deiro<br>- Frossini etj.<br><br>**Pjesë variete:**<br><br>- Vals, tango, polka, swing, jazz,blues, rumba etj.<br>- Galliano<br>- Piazzolla<br>- Astier<br>- Marocco<br>- Shtraus<br>- Larcange<br>- Murena<br>- Richard<br>- Peshkov etj. | - interpreton veprën në stilin e duhur, duke zhvilluar më tej aftësitë interpretative individuale;<br>- përdor kacekun në bazë të mendimit muzikor;<br>- evidenton linjat e te dy duarve sipas zhvillimit të veprave;<br>- realizon kontrastet dinamike;<br>- interpreton duke përdorur regjistra të ndryshëm sipas specifikave të veprave, zhanrit dhe zhvillimit muzikor. |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallë muzikore | **Nxënësi :** |

| | |
|---|---|
| - Paralele me dy duart.<br>- Me linja të kundërta.<br>- Me tercë në bas.<br>- Arpezhet/akordet<br>- Me përmbysjet e tyre | - realizon teknikisht shkallën;<br>- unifikon lojën me dy duart;<br>- zhvillon tingullin;<br>- sistemon frazën dhe lëvizjet e kacekut; |
| **Vepër polifonike :**<br>- Bach,<br>- Hendel,<br>- Scarlatti<br>- Cimarosa etj.<br>**Etyde**<br>- Cerni,<br>- Anzaghi,<br>- Farfisa,<br>- Kramer,<br>- Heler,<br>- Rakic,<br>- Shenderev<br>- Rastelli etj. | - përdor saktë lëvizjet e kacekut;<br>- zhvillon shprehitë ekzekutive;<br>- zhvillon frazën e qartë;<br>- zhvillon shprehitë interpretative;<br>- organizon tingujt me temp të shpejtë;<br>- realizon frymëmarrjen e kacekut mbi bazën e logjikës teknike e muzikore;<br>- zhvillon aftësitë ekzkekutive; |

| | |
|---|---|
| **Pjesë shqiptare**<br><br>- A.Krajka<br>- F. Deda<br>- V.Filaj<br>- A.Peci<br>- Fejzo, etj. | - realizon teknikisht pjesën, frazat, tempin;<br>- ndan në fragmente partin sipas zhvillimit të saj;<br>- realizon pjesën në karakterin e duhur;<br>- zhvillon aftësitë shprehëse dhe interpretative; |
| - Pjesë kontemporane<br>- Zolatoriov<br>- Poterov<br>- Derbenko<br>- Doëlasz etj.<br>- **Pjesë variete:** vals, tango, samba, polka, jazz etj.<br>- Galliano<br>- Astier<br>- Vlasov<br>- Larcange<br>- Shtraus<br>- Marocco<br>- Peshkov<br>- Rugieri etj.<br>- Pjesë klasike ose romantike të transkiptuara : | - realizon gjatë interpretimit tempin dhe frazat;<br>- njeh teknikat e muzikës kontemporane;<br>- luan në karakterin e duhur;<br>- punon frazat në bazë të logjikës muzikore;<br>- interpreton pjesën në stilin e duhur duke zhvilluar më tej aftësitë interpretative individuale;<br>- lexon dhe interpreton kombinimet e akordeve në dorën e majtë;<br>- realizon shoqërimin sipas karakterit specifik të veprave;<br>- evidenton kontrastet dinamike, temat kryesore, dytësore etj. |

| | |
|---|---|
| - Moxart<br>- Mendelson<br>- Chopin<br>- Hayden etj. | |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallë muzikore me të gjitha format<br>- Maxhore dhe minore.<br>- Paralele me dy duart.<br>- Me linja të kundërta.<br>- Me terca.<br>- Me seksta.<br>- Arpezhet/akordet.<br>- Me përmbysjet e tyre. | **Nxënësi:**<br>- realizon të gjitha elementet teknike të shkallëve;<br>- realizon saktë tingujt;<br>- zhvillon tingullin;<br>- realizon në sinkron të dy duart gjatë luajtjes në instrument;<br>- unifikon të dy duart. |
| **Vepër polifonike**<br>- Bach,<br>- Moxart,<br>- Hendel<br>- Scarlatti<br>- Cimarosa etj. | - luan me tingull të plotë veprat;<br>- luan aplikaturat e caktuara;<br>- zhvillon mirë frazën duke sistemuar lëvizjet e kacekut;<br>- zhvillon shprehitë ekzekutive dhe shprehitë interpretative; |

| | |
|---|---|
| **Etyde**<br><br>**Metodat:**<br><br>- Farfisa<br>- Kramer<br>- Rastelli<br>- Holminov<br>- Heler<br>- Shenderev etj. | - realizon saktë tingujt me temp të shpejtë;<br>- realizon frymëmarrjen dhe lëvizjet e kacekut mbi bazën e logjikës teknike e muzikore;<br>- zhvillon aftësitë teknike dhe interpretative;<br>- unifikon lojën me dy duar; |
| **Vepër shqiptare:**<br><br>- A.Peçi<br>- Krajka<br>- F.Deda<br>- A.Fejzo etj | - realizon teknikisht pjesën, frazat, tempin;<br>- luan në karakterin e veprës;<br>- respekton simbolet muzikore në partiturën e veprës;<br>- realizon pjesën në karakterin e duhur; |
| **Pjesë klasike ose romantike**<br><br>- Mozart<br>- Hayden<br>- Mendelson<br>- Brahms<br>- Deiro | - njeh dhe interpreton efektet e muzikës kontemporane;<br>- realizon të gjitha elementet teknike dhe artistike të veprave;<br>- realizon saktë frazat dhe i kombinon ato me lëvizjet e kacekut;<br>- interpreton pjesën në stilin specifik të veprave, epokave dhe zhanreve, duke zhvilluar më tej aftësitë interpretative individuale;<br>- interpreton me gjeste sipas karakterit të veprave;<br>- realizon në mënyrë korrekte dinamikat e partiturës; |



ASCAP

| | |
|---|---|
| - Frossini etj<br><br>**Pjesë kontemporane**<br><br>- Poterov<br>- Doëlasz<br>- Derbenko<br>- Semenov<br>- Angelis etj<br><br>**Pjese variete**<br><br>- Galliano<br>- Piazzolla<br>- Astier<br>- Rugieri<br>- Marocco<br>- Larcange<br>- Magnante<br>- Frossini<br>- Richard<br>- Deiro etj | - zhvillon më tej aftësitë vetë krijuese të interpretimit;<br>- përvetëson në nivel të lartë teknikat e kacekut, lojën me regjistrat. |
| **UDHEZIME METODOLOGJIKE** | |

Për arritjen e nivelit sa më të lartë, mësuesit dhe nxënësit duhet të kenë të qartë fazën e punës në të cilën kanë hyrë. Klasa X është një vit i rëndësishëm, pasi nxënësi është fillestar dhe janë hapat e parë të mësimit të instrumentit. Këtë vit ora e mësimit duhet të ketë intensitet, të mos bëhet monotone, po të zgjojë interes te nxënësi.

Përzgjedhja e veprave duhet bërë me kujdes sipas përgatitjes, talentit dhe ecurisë së secilit nxënës. Duhet këmbëngulur në kultivimin e shijeve të sakta të lojës. Pas studimit të ngadaltë, nxënësi duhet nxitur për të luajtur (manovruar) më shpejt me materialet, por gjithnjë pa e tepruar dhe nën kontrollin e mësuesit, me perspektivën drejt vetëkontrollit. Nxënësi duhet të ndërgjegjësohet e të perceptojë me siguri të lartë atë çfarë ai prodhon. Të nxitet për të performuar në skenë.

Klasa XI është një urë lidhëse mjaft e rëndësishme midis klasave X-XII. Mësuesi duhet të këmbëngulë në elementet bazë, që duhet të njohë **nxënësi:** procesi i njohjes; procesi i përvetësimit; procesi i interpretimit.

Pas një studimi mekanik, vazhdon puna për kualifikimin e tingullit, për zgjidhjen e kolpove të kacekut, për zgjidhjen e artikulacionit duke respektuar partiturën. Mësuesi/ja duhet të ketë një komunikim të mirë me nxënësit, duhet të njohë aftësitë e tyre për të përcaktuar programin që ata do të luajnë në provimin e vitit. Klasa XII është viti kur nxënësit mbyllin ciklin e një pune 3-vjeçare dhe përgatiten për shkollën e lartë. E gjithë puna shumë vjeçare synon në formimin e plotë me dijet e aftësitë tekniko-muzikore dhe ideoartistike. Element i rëndësishëm i kësaj faze është ruajtja e konsolidimi i nivelit të arritur. Nxënësit nuk duhet të heqin dorë nga ushtrimet ditore, pavarësisht nga progresi që kanë. Mësuesit duhet të programojnë orën e mësimit në mënyrë të tillë që të dëgjojnë në çdo orë mësimi repertorin mekanik të nxënësit.

Demonstrimi në instrument nga mësuesit është i domosdoshëm për të konkretizuar problemet që dalin. Nxënësit duhet të ballafaqohen me skenën dhe nxënësit e tjerë, duke organizuar koncerte ose orë mësimi në grup.

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:**

Vlerësimi në saxho bëhet me komision të përbërë nga mësuesit e instrumentit të fizarmonikës.

Nxënësi arrin nivelin Mjaftueshëm, kur interpreton :

- me ritëm jo korrekt;
- me tingull të dobët;
- me shkallë shpejtësie të ulët;
- nuk respekton partiturën;
- lojë jo të unifikuar mirë;
- impostim problematik;

**Nxënësi arrin nivelin Mirë kur:**

- luan mirë teknikisht dhe muzikalisht;
- frazim të rregullt;
- tingull të plotë;
- unifikim të duarve;
- impostim korrekt;
- artikulim mesatar;

**Nxënësi arrin nivelin Shumë Mirë kur:**

- realizon programin me të gjitha elementet teknike dhe interpretative të një niveli të lartë.

**Materiale dhe burime mësimore:** Fizarmonikë, lexhio, partiturë, internet etj.

Fizarmonikë, lexhio, partiturë, internet etj.

**Dega Muzikë**

**Lënda: Perkusion**

**Klasa:10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Të gjitha **Shkallët** muzikore:<br>- maxhore dhe minore, deri në shtatë shenja në armaturë (# dhe b);<br>- Shkallët kromatike | **Nxënësi:**<br>- luan pastër dhe pa gabime Shkallët gjer në regjistrat e lartë;<br>- realizon përmbysjet me triola dhe legato gjatë luajtjes;<br>- luan përmbysjet e arpezheve;<br>- realizon Shkallët me tingull të mirë, pozicion të mirë dhe me teknikë; |
| - M. Goldenberg (ksilofon) -Etyde.<br>- G. Capitani (snare drum) -etyde.<br>- G. Capitani - Ushtrime për teknikën dhe pozicionin. | - luan mirë teknikisht;<br>- luan saktë dhe në ritëm;<br>- realizon një pozicion të lirshëm dhe mbi bazën e një logjike muzikore;<br>- lexon duke organizuar mirë frakturat teknike të etydit; |
| - M.Goldenberg“FlautiMagjik”-<br>- (W. A. Moxart), ksilofon.<br>- M. Goldenberg - “Sherezade”<br>- (Koncert koha e 4-t), Snare<br>- Drum. | - luan duke nxjerrë në pah karakteristikat kryesore tekniko – muzikore;<br>- zbërthen strukturën e çdo pjese për sa i përket;<br>- organizon anën teknike dhe lojës së saktë të figurave ritmike;<br>- interpreton në instrument duke zhvilluar muzikalitetin. |

| | |
|---|---|
| - G. Capitani – "Master the Drums". | |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Të gjitha **Shkallë**t muzikore:<br>- maxhore dhe minore,deri në shtatë shenja në armaturë (# dhe b);<br>- Shkallët kromatike | **Nxënësi:**<br>- realizon pjesët muzikore, duke punuar me një pozicion të plotë dhe me një teknikë të mirë;<br>- realizon me saktësi teknike elementet teknike;<br>- si: tercat, triolat, arpezhet etj.;<br>- shoqëron elementet teknike me elementet muzikore: legato, piano, forte dhe me forma të tjera studimi; |
| - Wm.f. Ludwig (snare drum) - etyde.<br>- Ian Wright (timpan) - etyde.<br>- M. Goldenberg (ksilofon) - etyde | - luan saktë në ritëm;<br>- realizon një teknikë shumë të lirshme;<br>- lexon dhe organizon mirë frakturat teknike të etydit; |
| - Ian Wright - Fanfare, (timpan).<br>- M.Goldenberg - Bach koncert violine në La minor (adaptuar për ksilofon).<br>- G. Capitani - "Master the drums", ( bateri).<br>- M.Goldenberg– "Third simphony"- Ë. Schuman, (snare drum). | - luan pjesët e programit duke nxjerrë në pah karakteristikat kryesore tekniko – muzikore;<br>- zbërthen strukturën e çdo pjese nga ana teknike dhe nga loja e figurave ritmike;<br>- zhvillon muzikalitetin duke demonstruar teknikat e interpretimit, idetë dhe emocionet e veprës që luan |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |



ASCAP

| | |
|---|---|
| - Të gjitha **Shkallët** muzikore :<br>- maxhore & minore, deri në shtatë shenja në armaturë ( # & b );<br>- **Shkallët** kromatike | **Nxënësi:**<br>- realizon Shkallët me një teknikë të plotë dhe të pastër;<br>- realizon me saktësi teknike, elementet teknikë të shkallës përmes tercave, triolave dhe kuartolave;<br>- shoqëron elementet teknike nga elementet muzikore, si: *legato, piano, forte* dhe me forma të tjera studimi, të cilat zhvillojnë teknikën e shpejtë të kyçeve dhe të gishtërinjve; |
| - Wm.f. Ludwig - Snare drum,24 etyde.<br>- Ian Wright – Timpan, 20 etyde.<br>- G. Capitani – Srum teknik, (bateri)30 etyde. | - luan mirë në teknikë;<br>- luan saktë dhe në ritëm;<br>- realizon një pozicion të lirshëm dhe mbi bazën e një logjike muzikore;<br>- lexon duke organizuar mirë frakturat teknike të etydit; |
| - M.goldenberg - “Pique Dame”, snare drum.<br>- M. Goldenberg - duete në snare drum.<br>- M. Goldenberg - Paganini koncert për violinë, adaptuar për ksilofon.<br>- M. Goldenberg “Petrouchka”, I. Stravinsky, adaptuar për ksilofon.<br>- Ian Wright - “Alla Marchia”, për timpan.<br>- Ian Wright - rondino, për timpan.<br>- G. Capitani – “Master of Drum”, për bateri. | - luan duke nxjerrë në pah karakteristikat kryesore tekniko – muzikore;<br>- zbërthen strukturën e çdo pjese për sa i përket anës teknike dhe lojës së saktë të figurave ritmike;<br>- interpreton në instrument duke zhvilluar muzikalitetin. |

## UDHËZIME METODOLOGJIKE:

Me mbylljen e këtij cikli mësimor disa vjeçar, nxënës/i,-ja ka marrë bazat kryesore të formimit muzikor dhe atij instrumental perkusionit. Përzgjedhja e programit teknik dhe muzikor është bërë mbi bazën e një përvoje disavjeçare në mësimdhënie.

Materialet e lëndës së perkusionit janë bazuar mbi përzgjedhjen e elementeve teknike dhe muzikore , si dhe nga metodat e autorëve tanë dhe të huaj.

- Metoda 1 – 2 dhe 3 – 4, e cila është një përmbledhje bazë e teknikave të ekzekutimit në këtë instrument.
- Metoda e Wm. f. Lutwig.
- Metoda “Modern school for snare drum” - Morris Goldenberg.
- Metoda “Master the Drums” - Gianluca Capitani etj.

janë metoda që në përmbajtjen e tyre kanë elementet bazë teknike dhe muzikore që do t’i shërbejnë një perkusionisti të ardhshëm. Pas përfundimit të këtij cikli mësimor, në nivelin më të lartë vlerësues, duke paraqitur vlerat e tij më të larta, nxënësi është i aftë të konkurrojë për në Akademinë e Arteve të Bukura.

Në perkusion bëjnë pjesë veglat me goditje, p.sh.: snare (trumpet), ksilofon, timpan, drums, baterietj.

## UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:

Vlerësimi në kontrollet teknike dhe në saxho bëhet në mënyrë kolegjiale. Për njohjen e drejtpërdrejtë të punës së nxënësit në klasë, mësuesi i lëndës ka të drejtë të ulë ose të ngrejë një notë. Mbi bazën e **3 notave, 2 kontrolleve teknike dhe 1 saxho**, vendoset nota semestrale.

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

**luan jo korrekt;**

- luan me ritëm;
- luan me tingull mesatar, me intonacion jo të këndshëm, me shkallë;
- luan me shpejtësi të ulët e me disa gabime.

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- luan mirë;
- luan ritmikisht;
- luan me tingull e me intonacion,;
- luan pastër e me pak gabime.

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- luan *shumë mirë* në të gjitha elementet e mësipërme.

***Shënim.*** Pjesët mund të zëvendësohen nga ana e mësuesit specialist me pjesë të të njëjtit nivel.

**Materiale dhe burime mësimore:**

Perkusion, lexhio, partiturë, internet etj.

**Dega Muzikë**

**Lënda: Harpë**

**Klasa:10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Ushtrime me dorën e majtë.<br>- Ushtrime me dorën e djathtë.<br>- Tri ushtrime me dy duar.<br>- **Metoda:** Grossi Method book – Ricordi<br>- 3 pjesë për tu zgjedhur nga titujt e mëposhtëm<br>- Old Tunes for NeW<br>- Harpists (Dilling, M.) T. Presser.<br>- 30 Little Classics (Dilling, M.) T. Presser.<br>- Suzuki Harp Vol. 1 (Suzuki, S.) Alfred Publishing.<br>- First Grade Pieces for the Harp: pt. 1 (Grandjany, M. - Ëeidensaul, J.) Fischer.<br>- Fun From the First Vol. 1 (Milligan, S.) Lyon and Healy.<br>- Lovely Levers Vol. 1: pt. 1 (Reit, A.) Grey Lake. Etj. | **Nxënësi:**<br>- Njihet me telat e instrumentit;<br>- kupton lirshmërinë e krahëve;<br>- mëson pozicionet e duarve në harpë;<br>- luan pastër me duar veç;<br>- luan pastër veprën;<br>- luan saktë lojën në dy zëra;<br>- organizon një mendim muzikor të rrjedhshëm;<br>- luan pastër ritmet e thyera;<br>- punon me kujdes për impostim të saktë të materialit; |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |



ASCAP

| | |
|---|---|
| - 2 **Shkallë**<br>- Shkallë + (maxhor). (DO+, Sol+ Re+ Fa+ Sib+ etj) duar bashkë 1-2 oktavë<br>- Shkalla - (minor). (LA- Re- Mi- etj)<br><br>**Etyde – të marra nga metodat**<br><br>**Pjesë nga autorë të huaj:**<br><br>- Trois Pieces Faciles (Grandjany, M.) Marks.<br>- Angelus (Renie, H. - Grandjany, M.) Marks.<br>- Ground in F (Purcell, H. - Thompson) Barclay & Barclay.<br>- Chaconne in C (Handel, G. - Loye) Lemoine.<br>- Air Varie (Handel, G. - Milligan, S.) Lyon and Healy<br>- Lovely Levers Vol. II (Reit, A.) Grey Lake<br>- The Magic Road: pt. 2(Gustavson, N.)<br>- Solos: (Pedal Harp)<br>- Solfeggietto (Bach, C.P.E.)<br>- Tëo French Folk Songs (Grandjany, M.) Durand<br>- Le Bon Petit Roi D'Yvetot (Grandjany, M.) Durand<br>- Siciliana (Respighi,O.) | - unifikon duart gjatë luajtjes;<br>- luan në temp real dhe të njëjtë për të gjitha ushtrimet;<br>- luan pastër veprën;<br>- luan saktë lojën në dy zëra;<br>- realizon tingëllimet, duke njohur karakteristikat e veprës dhe të stilit barok;<br>- lexon saktë dhe pastër partiturën;<br>- punon për frazim dhe për qartësi e vazhdimësi të mendimit muzikor;<br>- luan pastër ritmet e thyera;<br>- punon me kujdes për impostim të drejtë të materialit; |

| | |
|---|---|
| - Pavane et Bransles (Francisque, A.)<br>- Epices (Andres,B.) Durand etj | |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - 2 **Shkallë**<br>- Shkallë + (maxhor). (DO+, Sol+ Re+ Fa+ Sib+ etj) duar bashkë 1-2 oktavë<br>- Shkalla - (minor). (LA- Re- Mi- etj)<br><br>**Etyde – të marra nga metodat**<br>**Pjesë nga autorë të huaj:**<br><br>- Trois Pieces Faciles (Grandjany, M.) Marks.<br>- Angelus (Renie, H. - Grandjany, M.) Marks.<br>- Ground in F (Purcell, H. - Thompson) Barclay & Barclay.<br>- Chaconne in C (Handel, G. - Loye) Lemoine.<br>- Air Varie (Handel, G. - Milligan, S.) Lyon and Healy<br>- Lovely Levers Vol. II (Reit, A.) Grey Lake<br>- The Magic Road: pt. 2(Gustavson, N.)<br>- Solos: (Pedal Harp)<br>- Solfeggietto (Bach, C.P.E.) | **Nxënësi:**<br><br>- unifikon duart gjatë luajtjes;<br>- luan në temp real dhe të njëjtë për të gjitha ushtrimet;<br>- luan pastër veprën;<br>- luan saktë lojën në dy zëra;<br>- realizon tingëllimet, duke njohur karakteristikat e veprës dhe të stilit barok;<br>- lexon saktë dhe pastër partiturën;<br>- punon për frazim dhe për qartësi e vazhdimësi të mendimit muzikor;<br>- luan pastër ritmet e thyera;<br>- punon me kujdes për impostim të drejtë të materialit; |

| | |
|---|---|
| - Tëo French Folk Songs (Grandjany, M.) Durand<br>- Le Bon Petit Roi D'Yvetot (Grandjany, M.) Durand<br>- Siciliana (Respighi,O.)<br>- Pavane et Bransles (Francisque, A.)<br>- Epices (Andres,B.) Durand etj | |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE:**

Nxënësit në këtë fillim të një instrumenti të ri, duhet të nisi dhe të fitoj të njëjtat elemente primare. Nxënësi duhet të fitoj mjaft elemente primarë të shkollimit, si i sensit të punës së detajuar, nga detyrat që merr nga mësuesi, mënyrën e studimit. Nxënësit duhet të marrin bazat e një impostimi të saktë dhe të lirshëm të duarve, dhe të mund ti realizojë këto baza gjatë studimit. Nxënësi duhet të radhisë studimin me ushtrime ditore të gishtave, shkallët me gjithë kompleksitetin e kërkesave si dhe kërkesat që kanë ushtrimet dhe pjesët në drejtim të realizimit total.

Mësuesi mbetet shumë i rëndësishëm, pasi duhet të shpjegojë me kritere të drejta dhe vendosjen në tonalitete të ndryshme me anë të përdorimit të pedaleve të Harpës. Në procesin mësimorë, mësuesi duhet të kërkojë një tingull më të ngjeshur e më të plotë, gjithashtu të kërkojë një tingull me ekspresivitet. Tani duhet të synojmë në kriteret për të realizuar tipe të ndryshme ushtrimesh, si *legatura, frazime, axhilitete* etj. Në sajë të zhvillimit tekniko-muzikor, nxënësi duhet të jetë më i përgjegjshëm për lojën që bën, më i lidhur me studimin, duhet aktivizuar në jetën koncertale si dhe duhet të dëgjojnë njëri-tjetrin. Tani repertori në tërësi duhet të luhet akoma me kërkesat e një tingulli më të plotë, me një agjilitet gishtash me kërkesë të avancuar tekniko-muzikale. Nxënësi duhet të fitojë patjetër lëvizshmëri normale dhe të lirshme në tela, disa lloje legaturash, tingull të shëndoshë, gjithashtu dhe rritja e cilësisë së tingullit në ushtrimet më të komplikuara.

Nxënësi duhet të luajë një program të plotë, duke filluar që nga shkallët në tërësi dhe të përforcojë cilësisht ushtrimet gjatë kontrolleve të njëpasnjëshme.

Mësuesi jo me të gjithë ka të njëjtin rezultat.

Kjo e ka bazën tek brumi i nxënësve, tek veçoritë e përgjithshme të tij. Për arritjen e nivelit sa më të lartë, mësuesit dhe nxënësit duhet të kenë të qartë fazën e punës në të cilën kanë hyrë.

**Klasa X** është një vit i rëndësishëm, pasi nxënësi kalon nga arsimi bazë (AMU) në atë të mesëm të lartë ( AML). Këtë vit ora e mësimit duhet të ketë intensitet, të mos bëhet monotone, po të zgjojë interes te nxënësi. Koncepti i veprave hyn në një fazë të re. Duhet këmbëngulur në kultivimin e shijeve të sakta të lojës. Pas studimit të ngadaltë, nxënësi duhet nxitur për të luajtur (manovruar) më shpejt me materialet, por gjithnjë pa e tepruar dhe nën kontrollin e mësuesit, me perspektivën drejt vetëkontrollit. Nxënësi duhet të ndërgjegjësohet e të perceptojë me siguri të lartë atë çfarë ai prodhon. Të nxitet për të performuar në skenë.

**Klasa X** është një urë lidhëse mjaft e rëndësishme midis klasave **X-XII.** Mësuesi duhet të këmbëngulë në elementet bazë, që duhet të njohë **nxënësi**:

- procesi i njohjes;
- procesi i përvetësimit;
- procesi i interpretimit.

Pas një studimi mekanik, vazhdon puna për kualifikimin e tingullit, përdorimin e pedaleve, si dhe elemente të tjera artistike. Mësuesi/ja duhet të ketë një komunikim të mirë me nxënësit, duhet të njohë aftësitë e nxënësit për të përcaktuar programin që nxënësi do të luajë në provimin e vitit.

**Klasa XII** është viti kur nxënësit mbyllin ciklin dhe përgatitjen për shkollën e lartë. E gjithë puna shumëvjeçare synon në formimin e plotë me dijet e aftësitë tekniko-muzikore dhe ideoartistike. Element i rëndësishëm i kësaj faze është ruajtja e konsolidimi i nivelit të arritur. Nxënësit nuk duhet të heqin dorë nga ushtrimet ditore, pavarësisht nga rritja që kanë. Mësuesit duhet të programojnë orën e mësimit në mënyrë të tillë që

të dëgjojnë në çdo orë mësimi repertorin mekanik të nxënësit. Demonstrimi në instrument nga mësuesit është i domosdoshëm për të konkretizuar problemet që dalin. Nxënësit duhet të ballafaqohen me skenën dhe nxënësit e tjerë, duke organizuar koncerte ose orë mësimi në grup.

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:**

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- nuk luan korrekt;
- luan pa ritëm;
- luan me tingull mesatar;
- luan me intonacion jo të këndshëm;
- luan me shkallë shpejtësie të ulët;
- nuk luan përmendesh.

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- njeh mirë pozicionet e duarve dhe luan relativisht saktë;
- luan me një tingull të gjerë e të plotë;
- përvetëson mësimet mbi pedalet e harpës;
- realizon një lojë me vetëkontroll;
- realizon axhilitetin gjatë lojës;
- luan me fraza, lirshëm dhe me organizime të pjesshme.

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- saktëson kalimet e pozicioneve në mënyrë të rregullt, sidomos të lojës së shkallëve;
- ka kontroll dhe luan etyde të karaktereve të ndryshme;
- luan cilësisht vlerat ritmike;
- ka organizim të lojës;
- spikat rrjedhshëm treguesit e një loje me saktësi teknike;
- ka temperament, siguri dhe pasion;
- ka rritje të sensibilitetit muzikor;
- luan me stil duke njohur brendinë dhe karakteristikat e veprës;
- njeh epokën e veprave, baroce, klasike dhe romantike;
- luan me potencë tingulli;
- është i sigurt dhe ka aftësi krijuese të vetat.

**Materiale dhe burime mësimore:** Harpë, lexhio, partiturë, internet etj.

**Dega Muzikë**

**Lënda: Piano Sekondare**

**Klasa:10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Ushtrime me dorën e majtë.<br>- Ushtrime me dorën e djathtë.<br>- Tri ushtrime me dy duar.<br>- Ushtrime me 2 duar: Bayer Cherni.<br><br>**Metoda: Tomson Lemoir**<br>- Gnesina<br>- Dy Bach - Minuet me dy zëra, maxhor ose minor.<br><br>**Dy sonatina**<br>- Haslinger,<br>- Pleyel,<br>- Klementi etj.<br><br>**Dy pjesë nga autorët tanë:**<br>- G. Avrazi<br>- T. Harapi<br>- F. Ibrahimi | **Nxënësi:**<br>- njihet me tastierën;<br>- kupton lirshmërinë e krahëve;<br>- mëson pozicionet e duarve në piano;<br>- luan pastër me duar veç.<br>- luan pastër veprën;<br>- luan saktë lojën në dy zëra;<br>- organizon një mendim muzikor të rrjedhshëm.<br>- luan pastër ritmet e thyera;<br>- punon me kujdes për impostim të drejtë të materialit. |

| | |
|---|---|
| - Ç. Zadeja. | |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - 2 **Shkallë**<br>- Shkallë Do + (maxhor).<br>- Shkalla La - (minor).<br>- Sol + (maxhor).<br>**Etyde – Cherni Etyd - Cherni Do + Etyde – Cherni, Bayer,**<br>- Lemoir.<br>- Bach - Prelud (DV)<br>- Bach - Minuet ose prelude (DB)<br>- Bach - Prelud + ose –<br>**Dy pjesë nga autorë të huaj:**<br>- Sonatina<br>- Klementi<br>- Bethoven,<br>- Chimaroz.<br>**Dy pjesë nga autorët tanë:**<br>- G. Avrazi | **Nxënësi:**<br>- unifikon duart gjatë luajtjes;<br>- luan në temp real dhe të njëjtë për të gjitha ushtrimet;<br>- luan pastër veprën;<br>- luan saktë lojën në dy zëra;<br>- realizon tingëllimet, duke njohur karakteristikat e veprës dhe të stilit barok;<br>- lexon saktë dhe pastër partiturën;<br>- punon për frazim dhe për qartësi e vazhdimësi të mendimit muzikor;<br>- luan pastër ritmet e thyera;<br>- punon me kujdes për impostim të drejtë të materialit; |

| | |
|---|---|
| - T. Harapi<br>- F. Ibrahimi<br>- T. Daija<br>- Ç. Zadeja. | |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - 2 shkallë<br>- Shkallë Do + (maxhor).<br>- Shkalla La - (minor).<br>- Sol + (maxhor).<br>- **Etyde – Cherni** Etyd - Cherni Do + Etyde – Cherni, Bayer,<br>- Lemoir.<br>- Bach - Prelud (DV)<br>- Bach - Minuet ose prelude (DB)<br>- Bach - Prelud + ose –<br><br>**Dy pjesë nga autorë të huaj:**<br><br>- Sonatina<br>- Klementi<br>- Bethoven,<br>- Chimaroz. | **Nxënësi:**<br>- unifikon duart gjatë luajtjes;<br>- luan në temp real dhe të njëjtë për të gjitha ushtrimet.<br>- luan pastër veprën;<br>- luan saktë lojën në dy zëra;<br>- realizon tingëllimet, duke njohur karakteristikat e veprës dhe të stilit barok.<br>- lexon saktë dhe pastër partiturën;<br>- punon për frazim dhe për qartësi e vazhdimësi të mendimit muzikor;<br>- luan pastër ritmet e thyera;<br>- punon me kujdes për impostim të drejtë të materialit. |

| | |
|---|---|
| **Dy pjesë nga autorët tanë:**<br><br>- G. Avrazi<br>- T. Harapi<br>- F. Ibrahimi<br>- T. Daija<br>- Ç. Zadeja. | |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Duke shpjeguar qartë dhe saktë të gjithë hapat që duhen për arritjen e një niveli të caktuar, pra të kërkesave metodike, shpesh duhen përdorur metoda të ndryshme demonstrimi nga mësuesi, pasi nxënësit kanë arritur një zhvillim të dukshëm psikomotor dhe impostimi natyral mbi tastierë.

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:**

Vlerësimi në saxhot simestrale bëhet në mënyrë kolegjiale, por mësuesi ka të drejtë të ngrejë ose të ulë një notë, nxënësit sepse bën punë individuale gjatë orës së mësimit.

**Materiale dhe burime mësimore:**

Partitura, sistem audio-video, TIK.

**Dega Muzikë**

**Lënda: Kitarë (instrument sekondar)**

**Klasa:10**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - 4 shkallë muzikore, etyde dhe materiale ndihmëse teknike | **Nxënësi:**<br>- realizon teknikisht shkallën, dhe me nota të lidhura;<br>- realizon të gjitha mënyrat e dorës së djathtë, dhe të respektojë gishtat e dorës së majtë;<br>- luan me progresion ritmik dhe dinamik;<br>- realizon teknikisht dhe muzikalisht etydet;<br>- luan në tempin e duhur;<br>- luan përmendësh;<br>- realizon figurat ritmike;<br>- luan tingull të lidhur;<br>- luan pozicionet në kitarë; |
| - Kohë nga suitat para klasike (Baroke) | - luan në tempin dhe stilin e duhur;<br>- ndjen zërat dhe linjat polifonike;<br>- kupton gjatë luajtjes në instrument vazhdimësinë dhe rrjedhshmërinë e tingullit;<br>- luan ushtrime gishtash për pasazhet e vështira; |

| | |
|---|---|
| **Temë me variacione,**<br>- Rondo,<br>- Capriçio,<br>- Sonatë,<br>- Suitë | - realizon tempet e kohëve te koncertet;<br>- njeh ndërtimin dhe tempet e variacioneve tek temat me variacione;<br>- ndërgjegjësohet për realizimin e programit në përputhje me etapat e punës praktike të përcaktuar nga mësuesi;<br>- realizon kërkesat tekniko- muzikore përmes frazimit, karakterit teknik dhe zbërthimit emocional; |
| - 2 Bravura | - luan në stilet dhe tempet e duhura;<br>- realizon duke nxjerrë në pah karakterin e çdo bravure;<br>- luan bukur emocionalisht dhe në mënyrë virtuoze;<br>- zhvillon personalitetin e tij në lojë. |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE:**

Për arritjen e një niveli të mirë te nxënësi i klasës X, duhen pasur parasysh disa hapa që bëjnë të mundur realizimin e programit, si: zgjedhja e materialeve teknike dhe artistike nga mësuesi për secilin nxënës (duke marrë parasysh problemet teknike dhe përshtatjen e materialit artistik me karakterin e nxënësit).

Programi do të ndahet në 3 orë mësimi gjatë javës, në mënyrë që nxënësi të jetë sa më i qartë me shpjegimin dhe të jetë vazhdimisht në proces studimi. Nxënësi merr pjesë në saxho mbasi ka kryer detyrimet e të dyja kontrolleve teknike. Në rast se nxënësi është me raport mjekësor, do të shlyejë detyrimin në një datë tjetër të caktuar nga komisioni.

Rekomandime për saxhot

Gjatë vitit shkollor zhvillohen 2 saxho .

| |
|---|
| Në çdo saxho luhet në mënyrë të detyruar:<br><br>1-2 kohë suite Bach, Sanz,Milan,Visee, Weis etj. (paraklasikë).<br><br>1 kohë sonatinë,sonatë ose vepër ciklike nga periudha të ndryshme stilistike.(paraklasike ose klasike, romantike etj).<br><br>1 bravurë (klasike,romantike,kontemporane) nga autorët: F.Tarrega,J.Ferrer,C.Henze,J.Mertz,J.Duarte,J.Sagreras,H.Teuchert,Abel Carlevaro, Metoda M.Carcassi op 60(25 etyde), Metoda Sor & Coste(Chiesa), Scarlatti,V. Lobos,Gregnani, L. Brouëer etj.<br><br>I Gjithë programi luhet përmendësh. |
| **UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:**<br><br>Vlerësimi i nxënësit në kontrollet teknike do të bëhet nga komisioni i përbërë nga të gjithë mësuesit që kanë nxënës në klasën përkatëse (me jo më pak se 3 veta).<br><br>Vlerësimi përfundimtar i nxënësit do të dalë si rezultat i mbledhjes dhe përpjesëtimit matematikor të notave të vëna nga të gjithë anëtarët e komisionit.<br><br>Vlerësimi i nxënësit në saxho do të bëhet nga komisioni i mësuesve të caktuar nga drejtoria (me jo më pak se 3 veta). I përfshirë në vlerësimet e komisionit do të jetë edhe vlerësimi i mësuesit përkatës të nxënësit.<br><br>Vlerësimi përfundimtar i nxënësit do të dalë si rezultat i mbledhjes dhe përpjesëtimit matematikor të notave të vëna nga anëtarët e komisionit, plus notën e mësuesit të lëndës.<br><br>**Niveli MJAFTUESHËM**<br>**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**<br><br>- ka lëvizje me ritmin; |

- ka pickim të dobët dhe tingull mesatar;
- luan me intonacion jo të këndshëm;
- nuk ka qartësi në lojë;
- luan me disa gabime.

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- luan mirë ritmikisht;
- luan me tingull e me intonacion;
- luan pastër e me pak gabime.

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- luan shumë mirë ritmikisht;
- luan me tingull te qartë dhe të lidhur;
- luan përmendësh dhe pa gabime;
- interpreton dhe luan me ndjeshmëri pjesët.

**Materiale dhe burime mësimore:**

Kitarë, Lexhio, Partiturë, Stol këmbe, Sistem audio-video TIK, Internet.

**Dega Muzikë**

**Lënda: Kitarë bas (Lëndë sekondare)**

**Klasa:10**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - **Shkallë** maxhore dhe minore.<br>- harmonike melodike.<br>- me arpezh, relative deri në pozicionin 6-te, me nota 4-she, 8-she.<br>- Tempi 40, me shpejtësi që shkon në rritje. | **Nxënësi:**<br>- realizojë teknikisht shkallën;<br>- luaj me tingull të qartë dhe me intonacion;<br>- luaj rrjedhshëm dhe korrekt;<br>- krijojë pavarësinë e duarve dhe koordinimin e tyre; |
| **8-10 etyde nga**<br>- Shevçik - Ushtrime ndihmëse:<br>- Poper<br>- Grutzmajer<br>- Docauer<br>- Sadlo<br>- Fitzenhagen etj. | - luaj në tempin e duhur;<br>- realizojë aplikaturën e etydit;<br>- përvetësojë më mirë mënyrën e vendosjes në "capo-taste" të dorës së majtë;<br>- luaj me intonacion të pastër sidomos etydet dyzanore; |
| - A. Sklarevski – Bass Playing Technique, nr. 1, 2, 3, 4, 5. 11, 12, 13 14, 15.<br>- G. Gulloto – Il manuale del basso elettrico. | - realizojë teknikisht dhe muzikalisht etydet;<br>- realizojë aplikaturën e etydit;<br>- luajë me intonacion korrekt etydet; |

| | |
|---|---|
| - J. Goldsby – The Jazz bass book.<br>- M. Anesa – Bass System.<br>- Ray Brown's Bass Method.<br><br>Shënim: Sasia e etydeve do të jepet në varësi të nivelit të nxënësve | |
| - M. Bozzi – Late at night.<br>- Slam Stewart - Humoresque.<br>- Rey Brown – Red Hot Moon.<br>- Oscar Pettiford – Simple Truth.<br>- S. Clarke – School Days.<br>- R. Carter – Pastels. | - realizojë veprën teknikisht dhe muzikalisht;<br>- ketë artikulim sa më të mirë të frazave muzikore;<br>- njohë mirë strukturën e veprës;<br>- ketë koordinim sa më të mirë të dy duarve;<br>- zbërthejë veprat nga ana teknike dhe emocionale;<br>- evidentojë karakterin stilistik përkatës;<br>- luajë duke krijuar individualitetin e tij/saj. |

Programi i studimit fillon me fokusimin në katër fusha të rëndësishme: ritëm, tonalitet, timbër dhe stil. Nxënësit do të mësojnë të aplikojnë teoritë e mësuara për të ekzekutuar linjat e basit në stile të ndryshme. Praktikat javore do të zhvillohen mbi ushtrime me bazë shkallësh muzikore, dëgjime pjesësh të ndryshme dhe studim veprash të basistëve të njohur. Nxënësit do të mësojnë teknikat dhe stilet e ekzekutimit të mjeshtërve të basit, përfshirë këtu: John Patitucci-in, Alexis Sklarevski-n, Maurizio Bozzi-n, Stanley Clarke-un, Dave Holland-in.

Nxënësit do të luajnë linja funksionale të "walking bass lines", si dhe linja në tonalitete të ndryshme. Nxënësit do të mësojnë të njohin dhe të luajnë në progresion në tonalitete të ndryshme, pjesë të xhazit standard.

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:**

**Nxënësi/ ja arrin nivelin e ulët, kur:**

**luan jo korrekt me ritëm,**

- me tingull jo të qartë,
- me gabime në intonacion,
- me shkallë shpejtësie të pasaktë dhe me disa gabime.

**Nxënësi/ja arrin nivelin mesatar, kur:**

- luan *mirë* ritmikisht,
- me tingull të qartë dhe me intonacion,
- me një lojë të pastër me pak gabime.

**Nxënësi/ja arrin nivelin e lartë, kur:**

- luan *shumë mirë* në të gjitha elementet e mësipërme.

**Materiale dhe burime mësimore:**

Kitarë Bas, Lexhio, Partiturë, Fisha jack, Amplifikator, Sistem audio-video TIK, Internet.

**Dega: Muzikë**

**Lënda: Kitarë elektrike (instrument sekondar)**

**Klasa:10**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Shkallë muzikore<br>- shkallë maxhore dhe minore.<br>- harmonike melodike.<br>- me arpezh, relative deri në pozicionin 6-te, me nota 4-she, 8-she.<br>- Tempi 40, me shpejtësi që shkon në rritje. | **Nxënësi:**<br>- realizojë teknikisht shkallën;<br>- luaj me tingull të qartë dhe me intonacion;<br>- luaj rrjedhshëm dhe korrekt;<br>- krijojë pavarësinë e duarve dhe koordinimin e tyre; |
| - Kenny Dorham – Blue Bossa<br>- Bart Haward – Fly me to the moon<br>- Luis Armstrong – When the saints go marching .<br>- Jozef Zawinul - Mercy, Mercy, Mercy.<br>- Planet Groove – Mark Maxwell | - luaj në stilin Bossa Nova;<br>- luaj në stilin swing;<br>- realizojë rhythm change;<br>- luajë në stilin funky;<br>- improvizojë thjeshtë në stilet e lart përmendura. |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE:**

Nxënësit do të mësojnë të aplikojnë teoritë e mësuara për të ekzekutuar modet dhe shkallet pentatonike në stile të ndryshme. Praktikat javore do të zhvillohen mbi ushtrime me bazë shkallësh muzikore, dëgjime pjesësh të ndryshme, transkriptim dhe studim veprash të kitaristëve të njohur. Nxënësit do të mësojnë teknikat dhe stilet e ndryshme, përfshirë këtu: Bossa Nova, Samba, Swing, Funky, Balade, Blues, Rock.

**Metoda:** Jazz Guitar Chord Bible, Abersold Jazz Play-A –Long(Volume 1), David Hamburger – The complete Electric Blues Guitar method, William G. Leavit - A modern method for guitar, Volume 2,Dave Celentano-Essential Blues, Joe Pass, Steve Hall/Ron Manio - Scale and Modes,Nick Nolan-Rock Lead etj.

## UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:

**Nxënësi/ ja arrin nivelin e ulët, kur:**

**luan jo korrekt me ritëm,**

- me tingull jo të qartë,
- me gabime në intonacion,
- me shkallë shpejtësie të pasaktë dhe me disa gabime.

**Nxënësi/ja arrin nivelin mesatar, kur:**

- luan *mirë* ritmikisht,
- me tingull të qartë dhe me intonacion,
- me një lojë të pastër me pak gabime.

**Nxënësi/ja arrin nivelin e lartë, kur:**

- luan *shumë mirë* në të gjitha elementet e mësipërme.

## Materiale dhe burime mësimore:

Kitarë, Lexhio, Partiturë, Fisha jack, Amplifikator, Footswitch, Sistem audio-video TIK, Internet.

**Dega Muzikë**

**Lënda: Violë (Lende me zgjedhje)**

**Klasa:10**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| **Materiale Teknike**<br>- Menyra e akordimit<br>- Pozicionet e duarve (impostimi)<br>- Ushtrime teknike<br>- Shkallët me ritëm të ngadaltë dhe mesatar deri në pozicionet e capotastit | **Nxënësi:**<br>- realizon në mënyrë të veçantë impostimin;<br>- mban trupin drejt dhe përdor lirshëm krahët dhe parakrahët;<br>- përdor lirshëm pulsin e dorës së djathtë dhe nxjerrjen e tingullit;<br>- përvetëson pozicionet në tastierën e instrumentit;<br>- luan ushtrime gishtash; |
| **Shkalle dhe Ushtrime**<br>- Shkalle ( Sistemi- Flesh)<br>- Campagnoli<br>- Kreuser<br>- Kaiser | - luan saktë;<br>- përvetëson elementet teknike, si: tingullin dhe vlerat e notave;<br>- respekton saktësisht leximin në çelësin muzikor në telat sol, re la dhe mi.<br>- Interpreton me kualitet intonativ.<br>- Zhvillon ushtrime për shkathtësinë e duarve; |
| **Programi Artistik**<br>- Eccles- Sonate (kohe I-II) | - realizon kalimet e ndryshme nëpër tela;<br>- nxënësi fillon dhe luan në instrumentin e kontrabasit nëpërmjet repertorit të ndryshëm; |

| | |
|---|---|
| - Hendel – Sonate (kohe I-II)<br>- Bach – Suita per solo Violë<br>- Vivaldi – koncert (kohasI)<br>- Zeits- Koncert<br>- Teleman - Koncert<br>- Moxart -Vals<br>- Bethoven – Rose vals etj. | - emonstrohet nga mësuesi pjesë së bashku me nxënësin duke realizuar bazat kryesore të lojës në instrument si dhe elementet zbukurues;<br>- puna 1-vjeçare me nxënësin e violoncelit finalizohet duke performuar përmendësh. |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Për të arritur një nivel sa më të mirë të lojës në instrument e Violës, nxënësi duhet edukuar të studiojë në mënyrë sa më sistematike. Në këtë proces, puna e mësuesit duhet të jetë e vazhdueshme, e thelluar dhe e lidhur ngushtë me vëzhgimin psikologjik e emocional të nxënësit, që nga shkallët e para të formimit, deri në plotësinë e mjaftueshme të tij. Për të pasur rezultate sa më të mira, trajtimi psiko emocional duhet të shtrihet gjatë gjithë vitit dhe të synojë, në radhë të parë, një administrim sa më të mirë të orës së mësimit. Po ashtu, ndërthurja e kërkesave teknike të lojës në instrument me kërkesat artistike të veprave të veçanta, do t'i jepte orës së mësimit më shumë frymëmarrje dhe do ta bënte atë më të pëlqyeshme për nxënësin.

Është mirë që, në momente të caktuara të realizimit të programit, të planifikohen forma të veçanta të kontrollit të dijeve e të nivelit të nxënësit. Këto do të ishin mbështetje e sigurt për shkallët e tjera të realizimit dhe do ta ndihmonin nxënësin t'i kuptonte nga afër kërkesat e mëtejshme të mësuesit. Për këtë, edhe kontrolli i materialeve teknike dhe i pjesëve të tjera artistike të programit duhet të përputhet me shkallët e studimit të tyre: ngadalë (ushtrim e kontroll në detaje); pak më shpejt (vërtetim i studimit të saktë të materialit dhe siguri për më tej); më shpejt e, së fundi, trajtim i materialit në tempin e kërkuar nga partitura. Sipas kësaj dinamike, edhe kontrolli i përgjithshëm i dijeve do të ishte një fazë e rëndësishme në formimin e nxënësit dhe do të shërbente për një menaxhim më të mirë të mundësive dhe mangësive të tij për të ardhmen.

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:**

Vlerësimi në saxho bëhet në mënyrë kolegjiale. Për njohjen e drejtpërdrejtë të punës së nxënësit në klasë, mësuesi i lëndës ka të drejtë të ulë ose të ngrejë një notë.

**Mbi bazën e 2 notave dhe 2 saxho, vendoset nota simestrale.**

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur luan jo korrekt:**

- me ritëm,
- me tingull mesatar,
- me intonacion jo të këndshëm,
- me shkallë shpejtësie të ulët e me disa gabime.

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur luan mirë:**

- ritmikisht,
- me tingull e me intonacion, pastër e me pak gabime.

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- luan shumë mirë në të gjitha elementet e mësipërme.

**Shënim:** Pjesët mund të zëvendësohen nga ana e mësuesit specialist me pjesë të të njëjtit nivel.

| Materiale dhe burime mësimore: |
|---|
| Violë, Lexhio, Partiturë, Sistem audio- video TIK, Internet. |

**Dega Muzikë**

**Lënda: Contrabas|(Lende me zgjedhje)**

**Klasa:10**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Materiale Teknike<br>- Mënyra e akordimit<br>- Pozicionet e duarve (impostimi)<br>- Ushtrime teknike<br>- Shkallët me ritëm të ngadaltë dhe mesatar deri në pozicionin e pestë. | **Nxënësi:**<br>- realizon në mënyrë të veçantë impostimin;<br>- mban trupin drejt dhe përdor lirshëm krahët dhe parakrahët;<br>- përdor lirshëm pulsin e dorës së djathtë dhe nxjerrjen e tingullit;<br>- përvetëson pozicionet në tastierën e instrumentit;<br>- luan ushtrime gishtash; |
| - **Shkallë** dhe Ushtrime<br>- **Shkallë**<br>- Ushtrime nga Metoda të ndryshme si;<br>- Marderovsky | - luan saktë;<br>- përvetëson elementet teknike, si: tingullin dhe vlerat e notave;<br>- respekton saktësisht leximin në çelësin muzikor në telat sol, re la dhe mi;<br>- interpeton me kualitet intonativ; |

| | |
|---|---|
| - Kummer<br>- L.Lazri<br>- Docauer etj. | - zhvillon ushtrime për shkathtësinë e duarve. |
| **Programi Artistik**<br>- Marcello – Sonate (kohe I-II)<br>- Vivaldi - Sonate (kohe I-II)<br>- Bach – Suita per solo v/cello<br>- Shmyler<br>- Kummer<br>- Marderovsky<br>- Varljanov<br>- Bakllanova<br>- Y.Skenderi (Autore Shqiptare)<br>- Filip Koleka (Autore Shqiptare)<br>- Bukinik etj. | - realizon kalimet e ndryshme nëpër tela;<br>- nxënësi fillon dhe luan në instrumentin e kontrabasit nëpërmjet repertorit të ndryshëm;<br>- demonstrohet nga mësuesi pjesë së bashku me nxënësin duke realizuar bazat kryesore të lojës në instrument si dhe elementet zbukurues;<br>- puna 1-vjeçare me nxënësin e violoncelit finalizohet duke performuar përmendsh. |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Për të arritur një nivel sa më të mirë të lojës në instrument e Kontrabasit, nxënësi duhet edukuar të studiojë në mënyrë sa më sistematike. Në këtë proces, puna e mësuesit duhet të jetë e vazhdueshme, e thelluar dhe e lidhur ngushtë me vëzhgimin psikologjik e emocional të nxënësit, që nga shkallët e para të formimit, deri në plotësinë e mjaftueshme të tij. Për të pasur rezultate sa më të mira, trajtimi psiko emocional duhet të shtrihet gjatë gjithë vitit dhe të synojë, në radhë të parë, një administrim sa më të mirë të orës së mësimit. Po ashtu, ndërthurja e kërkesave

teknike të lojës në instrument me kërkesat artistike të veprave të veçanta, do t'i jepte orës së mësimit më shumë frymëmarrje dhe do ta bënte atë më të pëlqyeshme për nxënësin.

Është mirë që, në momente të caktuara të realizimit të programit, të planifikohen forma të veçanta të kontrollit të dijeve e të nivelit të nxënësit. Këto do të ishin mbështetje e sigurt për shkallët e tjera të realizimit dhe do ta ndihmonin nxënësin t'i kuptonte nga afër kërkesat e mëtejshme të mësuesit. Për këtë, edhe kontrolli i materialeve teknike dhe i pjesëve të tjera artistike të programit duhet të përputhet me shkallët e studimit të tyre: ngadalë (ushtrim e kontroll në detaje); pak më shpejt (vërtetim i studimit të saktë të materialit dhe siguri për më tej); më shpejt e, së fundi, trajtim i materialit në tempin e kërkuar nga partitura. Sipas kësaj dinamike, edhe kontrolli i përgjithshëm i dijeve do të ishte një fazë e rëndësishme në formimin e nxënësit dhe do të shërbente për një menaxhim më të mirë të mundësive dhe mangësive të tij për të ardhmen.

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:**

Vlerësimi në saxho bëhet në mënyrë kolegjiale. Për njohjen e drejtpërdrejtë të punës së nxënësit në klasë, mësuesi i lëndës ka të drejtë të ulë ose të ngrejë një notë.

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur luan jo korrekt:**

- me ritëm,
- me tingull mesatar,
- me intonacion jo të këndshëm,
- me shkallë shpejtësie të ulët e me disa gabime.

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur luan mirë:**

- ritmikisht,
- me tingull e me intonacion, pastër e me pak gabime.

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- luan shumë mirë në të gjitha elementet e mësipërme.

**Shënim:** Pjesët mund të zëvendësohen nga ana e mësuesit specialist me pjesë të të njëjtit nivel.

**Materiale dhe burime mësimore:**

Kontrabas, Lexhio, Partiturë, Sistem audio- video TIK, Internet.



ASCAP

**Dega: Muzikë**

**Lënda: Performancë Artistike (Xhaz)**

**Klasa:10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Modet e shkallës maxhore për notat C, F, G, Bb, D, Eb (me nota 8-she drejt dhe me swing feel).<br>- Shkallët pentatonike dhe shkallët blues me swing feel për notat C, F, G, Bb, D, Eb<br>- Septakordet, voicings / arpezhe në skemën harmonike II – V – I me simbolet e tyre përkatëse, në tonalitetet maxhore dhe minore.<br>- 1001 licks – Jack Shneidman (ushtrime melodike jazz). | **Nxënësi:**<br>- realizon teknikisht, modet, akordet, arpezhet dhe ushtrimet licks;<br>- interpreton me tingull të qartë dhe me intonacion;<br>- interpreton rrjedhshëm dhe ritmikisht korrekt;<br>- interpreton me swing feel;<br>- njeh dhe deshifron simbolet e akordeve;<br>- njeh formën e pjesëve që luan;<br>- komunikon dhe shprehet në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet interpretimit muzikor vetjak, me anë të riformulimit ritmiko - melodik të temave, duke përdorur sinkopa dhe variacione melodike |
| - Duke Ellington - C Jam Blues<br>- Bart Haward – Fly me to the moon<br>- Duke Ellington – It Don't Mean a Thing | - njeh dhe interpreton formën Blues;<br>- interpreton në stilin Swing;<br>- interpreton në stilin Bossa Nova |
| - Jozef Zawinul - Mercy, Mercy, Mercy.<br>- Kenny Dorham – Blue Bossa | - interpreton në stilin Funk;<br>- interpreton nduke krijuar individualitetin e tij/saj. |

| | |
|---|---|
| - Van Young – Beautiful love<br>- Antonio Carlo Jobim – Girl from Ipanema<br>- Milt Jackson - Bag's Groove<br>- 2 pjesë/këngë të lehta me zgjedhje, shqiptare ose të huaja (Pop, Rock, RnB, etj) | - improvizon thjeshtë në stilet e lartpërmendura |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Modet e shkallës maxhore për notat A, E, Ab, B, Gb, Db, (me nota 8-she drejt dhe me swing feel)<br>- Shkallët pentatonike dhe shkallët blues me swing feel për notat A, E, Ab, B, Gb<br>- Septakordet, voicings / arpezhe në skemën harmonike II – V – I me simbolet e tyre përkatëse, në tonalitetet maxhore dhe minore<br>- 1001 licks – Jack Shneidman (ushtrime melodike jazz). | **Nxënësi:**<br>- realizon teknikisht, modet, akordet, arpezhet dhe ushtrimet licks;<br>- interpreton me tingull të qartë dhe me intonacion;<br>- interpreton rrjedhshëm dhe ritmikisht korrekt;<br>- interpreton me swing feel;<br>- njeh dhe deshifron simbolet e akordeve;<br>- njeh formën e pjesëve e që luan;<br>- komunikon dhe shprehet në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet<br>- interpretimit muzikor vetjak, me anë të riformulimit ritmiko - melodik të temave, duke përdorur sinkopa dhe variacione melodike |
| - G.Gershwin – Summertime<br>- Herbie Hancock – Chameleon<br>- Thelonious Monk – Blue Monk<br>- Song for my father – Horace Silver<br>- G.Gershwin – I've got rhythm. | - njeh dhe të interpreton formën Rhythm Change<br>- interpreton në formën Blues<br>- interpreton në stilin Swing;<br>- interpreton në stilin Bossa Nova; |

| | |
|---|---|
| - George Shearing – Lullaby of birdland<br>- Eden Ahbez – Nature boy<br>- Herbie Hancock – Watermelon man<br>- 2 pjesë/këngë të lehta me zgjedhje, shqiptare ose të huaja (Pop, Rock, RnB, etj) | - interpreton në stilin Ballad Jazz<br>- interpreton në stilin Funk;<br>- improvizon në stilet e lartpërmendura;<br>- interpreton nduke krijuar individualitetin e tij/saj. |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Thellimi dhe praktikimi i njohurive teknike dhe stilistike gjatë praktikës në formë pune në grup: Laborator Interpretimi Jazz dhe Ansambël Combo Jazz.<br>- Zbatim i formave të muzikës jazz;<br>- Zbatim i stileve të muzikës jazz;<br>- Lexim a prima vista i repertorit të dhënë;<br>- Ngjyrat dhe dinamikat sipas stilit të pjesës;<br>- Pjesë solo nga muzikantë të njohur jazz (të transkriptuara) mbi repertorin e dhënë;<br>- Relacionet midis instrumenteve gjatë interpretimit;<br>- Improvizim mbi skemat harmonike të pjesëve;<br>- Organizim dhe koordinim për interpretimin e pjesëve në Ansambël Combo Jazz, sipas modeleve | **Nxënësi:**<br>- deshifron "a prima vista" pjesët e marra në klasë;<br>- interpreton me tingull të qartë dhe me intonacion;<br>- njeh dhe deshifron simbolet e akordeve;<br>- interpreton rrjedhshëm dhe ritmikisht korrekt;<br>- interpreton me swing feel;<br>- njeh formën e pjesëve që luan;<br>- organizon performancën e grupit paraprakisht;<br>- krijon bashkëpunim dhe pavarësi në lojën në ansambël;<br>- komunikon dhe shprehet në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet interpretimit muzikor vetjak, me anë të riformulimit ritmiko - melodik të temave, duke përdorur sinkopa dhe variacione melodike;<br>- krijon besimin tek vetja, në rolin që ndërmerr gjatë lojës në ansambël;<br>- njeh lojën e interpretimit në ansambël duke u bërë kompetent në gjykimin dhe vlerësimin e saj |

| | |
|---|---|
| performuese të njohura me rythm section dhe instrumente melodike;<br>- Performancë në Ansambël Combo Jazz | |
| - Miles Davis - All Blues<br>- Carlo Jobim – Aqua de beber<br>- Fats Waller – Ain’t misbehaving<br>- Eddie Harris – Cold duck time<br>- G.Gershwin – But not for me<br>- Joseph Kosma – Autumn leaves<br>- Sonny Rollins – St.Thomas<br>- Charlie Parker – Billie Bounce<br>- Herbie Hancock – Cantalupe Island.<br>- Paul Desmond – Take Five<br>- 2 pjesë/këngë të lehta me zgjedhje, shqiptare ose të huaja (Pop, Rock, RnB, etj) | - interpreton në formën Blues<br>- interpreton në stilin Swing;<br>- interpreton në stilin Bossa Nova;<br>- interpreton në stilin Latin<br>- interpreton në stilin Ballad Jazz<br>- interpreton në stilin Funk;<br>- improvizon në stilet e lartpërmendura;<br>- interpreton nduke krijuar individualitetin e tij/saj. |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Qëllimi i lëndës është të pajisë nxënësit me aftësitë e nevojshme për interpretimin në stilet e muzikës Jazz, duke i dhënë edhe bazat e duhura për interpretimin e teknikave dhe stileve të ndryshme të muzikës së lehtë (Pop, Blues, Rhythm and Blues, Rock, Funk, Latin, Fusion etj.) në mënyrë që të mund të përdorin këto njohuri në kontekstin profesional, si në performancat skenike, ashtu edhe në studiot e regjistrimit.

Për të bërë të mundur përvetësimin e programit mësimor dhe arritjen e niveleve sa më të larta në ekzekutimin muzikor, mësuesit dhe nxënësit duhet të kenë të qartë fazën e punës në të cilën kanë hyrë. Repertori i caktuar përgjatë viteve është orientues. Pjesët mund të ndryshohen në bazë të subjektivitetit profesional të mësuesit apo sipas specialitetit dhe avancimit teknik të nxënësve.

Klasa e 10-të dhe e 11-të

Në dy vitet e para të lëndës Jazz, mësimi duhet të jetë individual për çdo nxënës, pavarësisht specialitetit dhe nivelit përkatës. Për arritjen e një niveli të mirë te nxënësit e klasës së 10-të dhe 11-të, duhen pasur parasysh disa hapa që bëjnë të mundur realizimin e programit, si: zgjedhja e materialeve teknike dhe artistike nga mësuesi për secilin nxënës në bazë të specialitetit përkatës, duke marrë parasysh problemet teknike dhe përshtatjen e materialit artistik me nivelin teknik të nxënësit. Praktikat javore do të zhvillohen mbi ushtrimet teknike të dhëna, deshifrim, dëgjime pjesësh të ndryshme nga muzikantë të njohur jazz dhe interpretim të repertorit jazz. Mësimi në klasë dhe ushtrimi në shtëpi duhet të kryhet gjithmonë me metronom, duke u kujdesur gjithmonë për swing fill-in (për pjesët që e kërkojnë). Nxënësit do të mësojnë teknikat dhe stilet e ndryshme si solist dhe në ansambël sipas tematikës, duke përdorur edhe baza muzikore gjatë interpretimit.

- Për nxënësit me baza teknike dhe teorike, që janë të regjistruar në instrumentet në vazhdim, programi i lëndës Jazz bazohet mbi aftësitë e tyre në solfezh dhe mbi teknikën vetjake mbi instrument. Programi i studimit fillon me fokusimin në këto fusha të rëndësishme: ritëm, harmoni, tonalitet, timbër, formë, stil dhe improvizim. Nxënësit do të mësojnë të aplikojnë teoritë e mësuara për të ekzekutuar shkallët - modet, akordet - arpezhet në stile të ndryshme. Ushtrimet licks do të interpretohen në klasë “a prima vista” dhe një pjesë prej tyre (sipas preferencave të nxënësit apo mësuesit), duhet të të ushtrohen si detyrë shtëpie nga nxënësi, të transportuara në tonalitete të tjera.

- Nxënësit fillestarë duhet të ushtrohen duke kënduar fillimisht shkallët, modet dhe arpezhet dhe ushtrimet licks në formë “warm up-i”, si dhe ushtrime të thjeshta ritmike dhe poliritmike. Për mbarëvajtjen e vitit shkollor është shumë i rëndësishëm, komunikimi dhe mundësisht, bashkëpunimi i mësuesit të lëndës Jazz me mësuesit e specialitetit dhe të solfezhit.

- Nxënësit fillestarë në kanto, fizarmonikë, kitarë dhe instrumente frymorë duhet të ushtrohen fillimisht duke mësuar të këndojnë në gjuhë origjinale dhe me diksion të qartë repertorin e caktuar në program. Më pas, nxënësit instrumentistë mund të praktikojnë gradualisht në instrument sipas përparimit vetjak, ndërsa nxënësit e kantos duhet të vazhdojnë me programin duke ushtruar vokalisht repertorin.

- Nxënësit fillestarë në perkusion, duhet të ushtrohen fillimisht me ushtrime ritmike në tambur (snare) dhe / ose në pjata (high-hat, ride) dhe më pas mund të luajnë gradualisht në bateri (drums) në stilet e repertorit të caktuar në program.

- Nxënësit fillestarë në kontrabas, duhet të ushtrohen vetëm me notat rrënjë të akordeve, duke i luajtur ritmikisht sipas stilit të caktuar në program. Në bazë të përparimit vetjak në instrument, mësuesi duhet të shtojë kompleksitetin e lojës instrumentale sipas stilit përkatës.

Klasa e 12-të

Laborator Interpretimi Jazz

Në vitin e tretë të lëndës Jazz nxënësit konsolidojnë njohuritë dhe shprehitë e fituara në dy vitet e mëparshme. Mësimi do të zhvillohet në formë praktike me grupe (nga duo deri në kuintet), të cilat mësuesi duhet t'i caktojë në mënyrë funksionale sipas specialiteteve që nxënësit kanë, për arritjen e realizimit të repertorit në ansambël combo. Gjatë punës në grup do të analizohen veprat dhe interpretimet e tyre nga regjistrimet e muzikantëve jazz të mirënjohur.

Detyra klase

- Nxënësit duhet të dëgjojnë së bashku një regjistrim të zgjedhur nga mësuesi për çdo pjesë të re, dhe ta luajnë së bashku temën "a prima vista" (edhe në unison) duke provuar edhe të improvizojnë.

- Nxënësit, duhet të deshifrojnë së bashku në klasë simbolet e akordeve që ndodhen në vepër dhe duke u bazuar mbi to, të shkruajnë arpezhe dhe shkallë - mode të shkurtra sipas rradhës për çdo masë.

| |
|---|
| - Nxënësit duhet të luajnë së bashku për çdo pjesë, arpezhet dhe shkallët e deshifruara në klasë apo në detyrat e shtëpisë, me ritmin e pjesës përkatëse.<br><br>- Nxënësit duhet të luajnë së bashku solot e transkriptuara nga secili prej tyre në detyrat e shtëpisë.<br><br>Detyra shtëpie<br><br>- Nxënësit duhet të mësojnë temën dhe formën e veprës; ta ushtrojnë sipas shijes muzikore vetjake, duke përdorur variacione ritmike melodike dhe sinkopa.<br><br>- Nxënësit, duhet të deshifrojnë simbolet e akordeve që ndodhen në vepër dhe duke u bazuar mbi to, të shkruajnë arpezhe dhe shkallë - mode të shkurtra sipas rradhës për çdo masë.<br><br>- Nxënësit, duhet të transkriptojnë solo të shkurtra të zgjedhura nga regjistrimet e muzikantëve jazz të mirënjohur për pjesët e programit artistik.<br><br>- Ansambël Combo Jazz<br><br>Për çdo pjesë duhet të vendoset plani i organizimit për interpretimin në ansambël combo. Mësuesi cakton skemën e lojës në ansambël dhe udhëzon secilin interpretues mbi modelet performuese jazz të njohura, duke marre parasysh këto elementë: introduksion; tema; improvizimet solistike mbi skemën harmonike (chorus) të temës; interplay; ndaleset ritmike, shkëmbimet solistike: me 4 masa (trading fours) dhe me tetë masa (trading eights), tema (në mbyllje të pjesës); finalet (mbylljet) e organizuara dhe të sinkronizuara të pjesëve;<br><br>Kur nxënësit të kenë krijuar eksperiencën e nevojshme, do të jenë ata që do të vendosin organizimin e performancës duke luajtur edhe pjesë të tjera që kanë mësuar në dy vitet e mëparshme. Në këtë mënyre do të aftësohen edhe për performancat e improvizuara (jam sessions). |
| **UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:** |

| |
|---|
| **Niveli MJAFTUESHËM**<br>**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**<br>- interpreton me saktësi të mjaftueshme ushtrimet e caktuara;<br>- ka luhatje në leximin e notave, akordeve dhe ritmit duke bërë gabime;<br>- interpreton dhe improvizon me vështirësi pjesët e repertorit duke pasur pasiguri në tingull - intonacion, harmoni, ritëm dhe stilistikë;<br>- ka njohuri të kufizuara mbi simbolet, akordet, shkallët, modet, format dhe stilet jazz;<br>**Niveli MIRË**<br>**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**<br>- interpreton mirë ushtrimet e caktuara;<br>- kryen lexim të mirë të notave, akordeve dhe ritmit;<br>- interpreton dhe improvizon mirë pjesët e repertorit me tingull - intonacion, harmoni, ritëm dhe stilistikë të mirë;<br>- ka njohuri të mira mbi simbolet, akordet, shkallët, modet, format dhe stilet jazz;<br>**Niveli SHUMË MIRË**<br>**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**<br>- interpreton shumë mirë ushtrimet e caktuara;<br>- kryen lexim shumë të mirë të notave, akordeve dhe ritmit;<br>- interpreton dhe improvizon shumë mirë pjesët e repertorit me tingull - intonacion, harmoni, ritëm dhe stilistikë të arritur;<br>- ka njohuri shumë të mira për simbolet, akordet, shkallët, modet, format dhe stilet jazz; |
| **Materiale dhe burime mësimore:** |

| |
|---|
| lexhio, partitura, pc / laptop, internet, mixer audio live, mikrofon, statitv mikrofoni, kabëll xlr, boks-e audio.<br><br>Sipas specialiteteve që nxënsit do të kenë: piano akustike / elektrike, bateri (drum-set), kitarë akustike / elektrike, kitarë bas, kontrabas, kabllo me fisha jack, amplifikator për kitarë, amplifikator për bas |

**Dega: Muzikë**

**Lënda: :Performacë (me zgjedhje Shkrimi Digjital Muzikor)**

**Klasa:10 (Periudha e parë)**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Programet digjitale të shkrimit muzikor Finale, Sibelius dhe aplikacione të ndryshme .<br>- Funksionimi i softeve.<br>- Ndërtimi i një parti të ri .<br>- Proceset bazike : copy paste, ndryshimi i vlerave të notave pushimet tabelat ndihmese për çfarë shërbejnë dhe si funksionojnë<br>- Ndryshimet dhe përcaktimet e kohës dhe tonalitetit | **Nxënësi:**<br>- njeh këto programet;<br>Shkruan :<br>- melodi ose pjesë muzikore nga repertori i kompzitorëve klasik ose shqiptar, duke filluar me melodi të thjeshta me një zë ose një instrument;<br>- Pasuron<br>- pas çdo ore mësimore partitura për piano trio , kuartete deri në partet orkestrale për orkestrat sinfonike .<br>- ndërton saktë figura të rregullta dhe të çrregullta ritmike;<br>- përdor pushimet; |

| | |
|---|---|
| - Shenjat e ngjyrimit dhe lidhjet e vlerës një zë dhe në disa zëra<br>- Shkrimi i melodive për instrumente të ndryshëm<br>- Përdorimi i figurave të rregullta dhe ndërtimi i figurave ritmike të çrregullta<br>- Shkrimi i pjesëve muzikore të thjeshta për instrumente të ndryshëm<br>- Ndërtimi i partiturave orkestrale me disa instrumente dhe etradimi i parteve në vehte .<br>- Ruajtja e materialeve në formate të ndryshme Pdf ,Audio, midi ose JPG dhe printimi i tyre .<br>- Përdorimi i këtyre softeve në formatin audio-studio dhe ndryshimi i instrumenteve gjatë procesit të shkrimit digjital. | - ndryshon tonalitetet;<br>- vendos shenjat e ngjyrimit, lidhjet e vlerës dhe të gjithë komponentët që ka partitura në origjinal;<br>- shkruan në mënyrë digjitale nxjerr partet solistike për çdo instrument;<br>- shkruan në mënyrë digjitale dhe bën ruajtjen e të dhënave dhe në formate të tjera si p.sh.PDF, AUDIO, JPG e tjerë . |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Gjate procesit mësimor në lëndën Shkrimi Digjital Muzikor e cila zhvillohet gjatë një semestri shkollor përkatësisht gjatë periudhës së parë , mësuesi i jep detyra nxënësve për çdo javë mësimore duke marrë shembuj nga literatura botërore dhe ajo shqiptare duke zgjedhur gjithmonë shembuj të cilët i përmbahen dhe janë në funksion të temave dhe hapave që duhen ndjekur në përvetësimin e këtyre softeve që shërbejnë për digjitalizimin muzikor .

| |
|---|
| Mësuesi i lëndës Shkrimi Digjital Muzikor duhet të njohë, të drejtojë e të nxisë veprimtarinë krijuese dhe realizuese të nxënësit, kërkohet përgatitje dhe përgjegjësi maksimale për zbatimin me sukses të programit. Ai duhet të njohë mirë përmbajtjen e programit, si dhe të jetë vazhdimisht i interesuar për të kualifikuar veten në mënyrë individuale, të krijojë një bazë të fuqishme materiale për ti paraprirë zhvillimit normal të orëve të mësimit, të transmetojë qartë përmbajtjen e temës për detyrën e re te nxënësi |
| **UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:**<br><br>Nxënës/i,-ja është i nivelit të MJAFTUESHËM<br><br>• Shkruan një pjesë muzikore periudhë ose temën e një vepre për piano ose instrumenta të ndryshëm me gabime dhe di kush janë funksionet bazike të programit që ai përdor .<br><br>Nxënës/i,-ja është i nivelit të MIRË Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:<br><br>• Shkruan një pjesë muzikore periudhë ose temën e një vepre për piano ose instrumenta të ndryshëm me disa gabime të vogla dhe i ka të qarta kush janë funksionet bazike të programit që ai përdor .<br><br>Nxënës/i,-ja është i nivelit SHUMË TË MIRË Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:<br><br>Shkruan një pjesë muzikore periudhë ose temën e një vepre për piano ose instrumenta të ndryshëm në parte orkestrale në mënyrë të saktë , dhe i ka të qarta kush janë funksionet bazike të programit që ai përdor , duke i vënë në funksion të gjitha proceset që kërkon shkrimi muzikor digjital . |
| **Materiale dhe burime mësimore:** |

| |
|---|
| Për plotësimin e informacionit teorik didaktik mund të përdoren video treguese nga youtube të cilat janë në përputhje me këtë program dhe grup moshë duke treguar njëkohësisht dhe risitë që sjellin këto softuerë në shkrimin digjital të muzikës .. |

**Dega: Muzikë**

**Performancë (Produksioni Muzikor )**

**Klasa:10 periudha e dyte**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Historia dhe Zhvillimi i Produksionit Muzikor | **Nxënësi:**<br>- përshkruan zhvillimin historik të produksionit muzikor, duke filluar nga regjistrimet e para deri te teknologjia digjitale e sotme;<br>- njeh kontributet kyçe të inovatorëve dhe artistëve të ndryshëm që kanë formuar fushën e produksionit muzikor;<br>- diskuton ndikimin e ndryshimeve teknologjike në mënyrën se si krijohet dhe konsumohet muzika; |
| - Bazat e Akustikës dhe Teorinë e Zërit | - shpjegon konceptet themelore të akustikës, përfshirë valët e zërit, frekuencat, dhe intensitetin;<br>- identifikon dhe përshkruan karakteristikat e ndryshme të zërit, si toni, timbri, dhe dinamika; |

| | |
|---|---|
| | - aplikon njohuritë bazë të akustikës në kontekstin e regjistrimit dhe prodhimit muzikor; |
| - Prezantimi i Softuerëve DAW (Digital Audio Workstations) | - njeh dhe përshkruajë funksionet kryesore të një DAW, si Logic Pro, Ableton Live, ose Pro Tools;<br>- kupton rrjedhën e punës bazë në një DAW, duke përfshirë regjistrimin, editimin, miksimin dhe eksportimin e audio-s;<br>- identifikon dhe përdorë mjete të ndryshme brenda DAW-së për krijimin e muzikës; |
| - Kuptimi i Signal Flow dhe Setup-it të Studio-s | - përshkruan rrjedhën e sinjalit audio, nga burimi i zërit deri te regjistrimi i tij në një DAW;<br>- identifikon dhe shpjegon rolin e pajisjeve të ndryshme në studio, si mikrofonët, monitorët, interfejsat e audio-s, dhe pajisjet e tjera periferike. |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Gjate procesit mësimor në lëndën Produksioni Muzikor e cila zhvillohet gjatë një semestri shkollor përkatësisht gjatë periudhës së dytë , mësuesi i jep detyra nxënësve për çdo javë mësimore duke marrë shembuj nga literatura botërore dhe ajo shqiptare duke zgjedhur gjithmonë shembuj të cilët i përmbahen dhe janë në funksion të temave dhe hapave që duhen ndjekur në përvetësimin e këtyre softeve që shërbejnë për produksionin audio .

Mësuesi i lëndës Produksioni Muzikor duhet të njohë, të drejtojë e të nxisë veprimtarinë krijuese dhe realizuese të nxënësit, kërkohet përgatitje dhe përgjegjësi maksimale për zbatimin me sukses të programit. Ai duhet të njohë mirë përmbajtjen e programit, si dhe të jetë vazhdimisht i interesuar për të kualifikuar veten në mënyrë individuale, të krijojë një bazë të fuqishme materiale për ti paraprirë zhvillimit normal të orëve të

mësimit, të transmetojë qartë përmbajtjen e temës për detyrën e re te nxënësit . Nxënësit mund të kërkohen të regjistrojnë një pjesë të thjeshtë muzikore, duke përdorur teknikat e mësuara në leksionet e para dhe në vazhdim.

Kjo mund të përfshijë zgjedhjen e mikrofonit të duhur, vendosjen e tij, dhe përpunimin bazë të audio-s në DAW.

- Përdorimi i një DAW për të krijuar një pjesë të thjeshtë muzikore, duke demonstruar kuptimin e ritmit, harmonisë, dhe strukturës

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:**

Për vlerësimin e nxënësit duhet puna e simestrit gjatë së cilit nxënësi ka punuar çdo javë detyrat që janë dhënë në funksion të çdo tematike dhe problematike që shfaq përdorimi i këtyre softeve Audio rekording .

**Nxënës/i,-ja është i nivelit të MJAFTUESHËM kur:**

- Demonstron njohuri bazë dhe kuptim të koncepteve kyçe të diskutuara në mësim , por mund të ketë vështirësi në zbatimin e tyre në praktikë.
- Kryen detyra dhe projekte me një nivel të kufizuar të pavarësisë dhe kreativiteti, dhe rezultatet përmbushin kërkesat minimale.
- Përdor teknikat e prodhimit muzikor dhe softuerin DAW në një nivel fillestar, duke treguar një përpjekje për të aplikuar aftësitë e mësuara.
- Ka vështirësi në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të thjeshta të prodhimit muzikor dhe mund të ketë nevojë për ndihmë të vazhdueshme.

**Nxënës/i,-ja është i nivelit të MIRË kur:**

- Demonstron njohuri të mira dhe kuptim të thellë të koncepteve të kursit dhe është në gjendje t'i zbatojë ato në një gamë të gjerë situatash.
- Përfundon detyrat dhe projekte me një nivel të lartë të pavarësisë, duke treguar aftësi për të menduar në mënyrë kritike dhe për të zgjidhur probleme në mënyrë kreative.
- Përdor teknikat e prodhimit muzikor dhe softuerin DAW me kompetencë dhe siguri, duke prodhuar rezultate të cilësisë së mirë që tregojnë një kuptim të mirë të miksim dhe masteringut.

- Demonstron aftësi të mira të komunikimit dhe bashkëpunimit në projektet e grupit, duke kontribuar në mënyrë efektive në arritjen e objektivave të përbashkëta.

**Nxënës/i,-ja është i nivelit SHUMË TË MIRË kur:**

- Demonstron një kuptim të shkëlqyeshëm dhe të thellë të të gjitha koncepteve dhe teknikave të diskutuara në kurs, duke i aplikuar ato në mënyrë inovative në projekte komplekse.
- Përfundon detyrat dhe projekte me nivel të lartë të pavarësisë dhe origjinaliteti, duke treguar aftësi të shkëlqyera analitike dhe zgjidhjeje të problemeve.
- Përdor teknikat e prodhimit muzikor dhe softuerin DAW në një nivel të lartë profesional, duke prodhuar rezultate që tregojnë një kuptim të thellë të artit dhe shkencës së produksionit muzikor.
- Demonstron aftësi të jashtëzakonshme të komunikimit, liderimit dhe bashkëpunimit, duke udhëhequr dhe insipiruar të tjerët në projektet e grupit dhe duke kontribuar në një mjedis të pasur mësimor. **Materiale Burimore , Mesimore**

**Materiale dhe burime mësimore:**

- **Softuerët (DAWs dhe Plugins):**
- **Cubase PRO :** I njohur për përdorimin e tij në muzikën elektronike dhe performancat live.
- **Pro Tools:** I konsideruar si standardi i artë në industrinë e regjistrimit profesional.
- **Logic Pro X:** Preferuar nga kompozitorët dhe prodhuesit për mjedisin e tij të pasur dhe intuitiv.
- **FL Studio:** I njohur për ndërfaqen e tij të përdorueshme dhe shumëllojshmërinë e veglave për prodhimin e muzikës elektronike.
- **Native Instruments Komplete:** Një paketë e gjerë e instrumenteve virtuale dhe efekteve që ofron një gamë të gjerë tingujsh për prodhimin muzikor.

**Dega: Muzikë**

**Lënda: Performancë (Kompozicion)**

**Klasa: 11-12**

| Tematika 11 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Procesi i kompozimit dhe elementët përbërës së tij..<br>- Motivi: ndërtimi, harmonizimi, përdorimi dhe fatura e shoqërimit<br>- Shoqërimi i motivit dhe tipet e tij .Trajtimi i zërit shoqërues në një motiv.<br>- Ndërtimi i fjalisë muzikore .Trajtimi i fjalive muzikore të ndërtuara nga nxënësit .<br>- Ndërtimi i Temës (periudhës) muzikore dhe format e ndryshme të saj . | **Nxënësi:**<br>- mëson teorikisht dhe praktikisht çfarë është motivi, fraza (fjalia) në muzikë dhe do të kompozojë motive , fjali të thjeshta muzikore ose tema muzikore duke u bazuar në modele të marra nga literatura botërore dhe ajo shqiptare .<br>- njeh për secilin prej modeleve që do të kryhen analiza kompozicionale duke arsyetuar në mënyrë progresive zhvillimin dhe trajtimin e tyre, në funksion të procesit të kompozimit me gjithë elementët përbërës që duhen , ku përfshihen : harmonizimi , fatura shoqëruese , zëri shoqërues e të tjerë .<br>- Njeh ndërtimin e fjalisë muzikore që do të marrë një vëmendje të veçantë. Më tej do të vazhdohet me *Periudhën* dhe strukturimin e saj. Ndërtimi i fjalisë dhe periudhës do të arsyetohet nga këndvështrimi harmonik dhe kontrapunktik. |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Njeh formën dy pjesësh (Gjinia e Këngës)<br>- kompozon pjesë të tillë duke pasur parasysh ndërtimin , harmonizimin dhe frakturën shoqëruese | **Nxënësit:**<br>- krijon analiza kompozicionale duke arsyetuar në mënyrë progresive zhvillimin dhe trajtimin e tyre, në funksion të procesit të kompozimit me gjithë elementët |

| | |
|---|---|
| dhe ritmike të strofës muzikore , refrenit dhe pjesës ndërmjetëse(Bridge)të saj .<br>- Njeh formën e trepjesëshit të thjeshtë. ABA;<br>- kompozon një Miniaturë në këtë formë muzikore me të gjithë elementët teknik kompozicional që duhen për realizimin e saj . | përbërës që duhen, ku përfshihen: harmonizimi, fraktura shoqëruese, zëri shoqërues e të tjerë.<br>- ndërton fjali muzikore, *periudhën* dhe strukturimin e saj.<br>- arsyeton dhe nga këndvështrimi harmonik dhe kontrapunktik.<br>- aplikojnë procesin në mënyrë praktike duke ndërtuar vetë motive, fraza në funksion të krijimit të fjalisë dhe kombinimet e mundshme për të mbërritur në një periudhë muzikore të plotë dhe në një melodie të krijuar bukur estetikisht.<br>- krijon bazuar edhe në njohuritë që nxënësi do të ketë marrë më parë në lëndë të tjera, sidomos në Harmoni dhe Analizën e Formës, informacioni i sipërpërmendur do të materializohet në krjimin e temave, këngëve dhe pjesëve dy deri tre – pjesore, për një deri në disa instrumente apo zëra vokalë. |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE:**

Gjate procesit mësimor në lëndën Kompozicion e cila zhvillohet gjatë dy viteve shkollore klasa 11-12 , mësuesi i jep detyra nxënësve për çdo javë mësimore duke u mbështetur në shembuj nga literatura botërore dhe ajo shqiptare duke zgjedhur gjithmonë shembuj të cilët i përmbahen dhe janë në funksion të temave dhe hapave fillestare dhe në vijim që duhen ndjekur në përvetësimin e procesit të kompozimit muzikor.

Mësuesi i lëndës kompozicion duhet të njohë, të drejtojë e të nxisë veprimtarinë krijuese dhe realizuese të nxënësit, kërkohet përgatitje dhe përgjegjësi maksimale për zbatimin me sukses të programit. Ai duhet të njohë mirë përmbajtjen e programit, si dhe të jetë vazhdimisht i interesuar të transmetojë qartë përmbajtjen e temës mësimore për detyrën e re tek nxënësi.

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:**

Për vlerësimin e nxënësit duhet puna e simestrit gjatë së cilit nxënësi ka punuar çdo javë detyrat që janë dhënë në funksion të çdo tematike që mbart procesi i krijimit muzikor Kompozicioni .

**Klasa 11 -12**

**Nxënës/i,-ja është i nivelit të MJAFTUESHËM**

- përpiqet të kompozojë një motiv , periudhë ose temë me gabime .

**Nxënës/i,-ja është i nivelit të MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- kompozon një motiv , periudhë ose temë me disa gabime të vogla

**Nxënës/i,-ja është i nivelit SHUMË TË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- kompozon një motiv , periudhë ose temë saktë dhe bukur .

**MATERIALE DHE BURIME MËSIMORE:**

Toni Harapi pjese per piano për fëmijë.

Çesk Zadeja- miniatura në piano.

Ramadan Sokoli- miniatura në piano

P.I.Cajkovski- miniatura në piano

R.Shuman-këngë lirike.



ASCAP

| |
|---|
| Aurorë/Kompozitorë të ndryshëm të periudhës klasike dhe romantike, shqiptarë dhe të huaj. |

**Dega: Muzikë**

**Performancë (Dirizhim)**

**Klasa:10**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Roli i Dirigjentit në organizimin e provave si dhe gjatë performancës artistike | **Nxënësi :**<br>- Njihen me rolin e Dirigjentit si profesioni kryesor në organizimin e provave korale e skenike, si dhe performancën artistike |
| - Teknika e drejtimit e skemës me 2 lëvizje:<br>- (koha 2/8,2/4,5/8,6/8).Koncepti teknik i frymëmarrjes gjatë drejtimit të performancës vokale e korale | - përvetësojnë praktikisht dhe me saktësi të gjitha ritmet që drejtohen në skemën me dy lëvizje. (koha 2/8,2/4,5/8,6/8) |
| - Teknika e drejtimit të skemës me 3 lëvizje:<br>- ( koha 3/8,3/4,7/8,9/8). Koncepti teknik i frymëmarrjes gjatë drejtimit të performancës vokale e korale | - përvetësojnë praktikisht dhe me saktësi të gjitha ritmet që drejtohen në skemën me tre lëvizje. (koha 3/8,3/4,7/8,9/8). |
| - Teknika e drejtimit e skemës me 4 lëvizje:<br>- ( koha 4/8,4/4,9/8,12/8). | - përvetësojnë praktikisht dhe me saktësi të gjitha ritmet që drejtohen në skemën me katër lëvizje. (koha 4/8,4/4,9/8,12/8). |

| | |
|---|---|
| - Koncepti teknik i frymëmarrjes gjatë drejtimit të performancës vokale e korale | |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Për të arritur një përvetësim me nivel të lartë të bazave teknike të dirigjimit të skemave me 2, 3 dhe 4 lëvizje, si dhe konceptin teknik të frymëmarrjes gjatë interpretimit, mësuesi i lëndës, zhvillon në mënyrë praktike drejtimin te çdo nxënës. Çdo nxënës drejton një pjesë e cila këndohet nga nxënësit e tjerë, dhe kjo metodë e bën me efikas përjetimin dhe përvetësimin e koncepteve teknike

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN**

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- Janë pjesëmarrës në zhvillimin teorik dhe praktik të lëndës.
- Mësojnë të praktikojnë skemat teknike, duke u njohur edhe me partitura konkrete vokale të zgjedhur nga mësuesi i lëndës, sipas skemave përkatëse.
- Mëson të drejtojë një ansambël, si dhe drejtohet nga nxënësi tjetër në të njëjtën kohë dhe kjo bën që të rriten dhe të zhvillohen me nivel të lartë njohuritë teknike dhe praktike.
- Mëson shumë mirë skemat teknike të ritmeve të thjeshta (2/4,3/4,4/4) të përbëra(6/8,9/8,12/8) e të përziera(5/8,7/8,9/8,12/8)...

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- Pjesëmarrja në mësimin teorik dhe praktik nuk është e plotë.
- Nuk përvetëson me saktësi konceptin e skemave teknike të dirigjimit

- Nuk përvetëson praktikisht drejtimin e një pjesë korale..

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- Nuk ka frekuentuar mësimin teorik e praktik në më shumë gjysmën e programit.
- Nuk është në gjendje të tregojë rolin dhe përgjegjësinë që ka dirigjent në një performancë artistike.
- Nuk është në gjendje te shpjegoje teorikisht e as praktikisht skemat teknike te dirigjimit.

**Materiale dhe burime mësimore:**

Vepra të thjeshta Korale nga autorë shqiptarë dhe të huaj, që kanë kohët me skemat bazë teknike, që përzgjidhen nga mësuesi i lëndës.

P. Jakova, C.Zadeja, K.Trako, M.Vako, John Rutter etj.

**Dega: Muzikë**

**Performancë Muzikore (Muzikal )**

**Klasa:10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Fillon me njohjen e vokalit dhe aparatit vokal. | **Nxënësi:** |

| | |
|---|---|
| - Dëgjim dhe këndim për kënaqësi.<br>- Këndon këngë të thjeshta që ndihmojnë në mësimin e frymëmarrjes.<br>- Në fillim përqendrimi në qëllimet afatgjata:<br>- Mësimi i të kënduarit është proces intelektual dhe fizik, prandaj është mirë të këndohen këngë të thjeshta.<br>- Të këndohet me dëshirë duke u praktikuar në grupe. | - mëson e njeh vokalin dhe aparatin vokal;<br>- fillon të kuptojë rëndësinë e frymëmarrjes në këngë;<br>- fillon të këndojë këngë të thjeshta si solo dhe në grup;<br>- dëgjon shumë këngë. |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Ushtrime të para të frymëmarrjes<br>- si dhe vokalit.<br>- Këngë shqiptare dhe fragmente<br>- Këngë nga musikal që i punohen<br>- kësaj moshe.<br>- Praktikon këngë të thjeshta dhe<br>- të huaja dhe kupton rëndësinë e<br>- shëndetit të vokalit. | **Nxënësi:**<br>- fillon të këndojë duke u mbështetur në frymë e diafragmë;<br>- fillon të zgjerojë refrenin si dhe këndon duke kuptuar përdorimin e<br>- frymës e rëndësinë e tekstit.<br>- zgjeron repertorin në këngë të lehta të huaja. Njeh rrugët për tu<br>- kujdesur për vokalin. |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |

| | |
|---|---|
| **Ushtrime për të zgjeruar vokalin të cilat janë për këngëtarët e kantos moderne.**<br>- Zgjerim i ushtrimeve e njohje me pozicionet vokale të të kënduarit.<br>- Fillon impostimin e lidhjen e tyre.<br>**Krijon programin vokal:**<br>- Këngë Shqiptare<br>- Këngë e huaj<br>- 3-Pjesë nga musikalet e njohura | **Nxënësi:**<br>- fiton zgjerimin e vokalit, arrin të këndojë në pozicionin e modernes;<br>- arrin të kuptojë e të përdor 3 pozicionet e të kënduarit: gjoks, i mesit dhe falcet;<br>- arrin të këndojë e të përdorë mikrofonin, të artikulojë fjalët dhe të<br>- ruaj intonacionin e saktë; |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

- Mësuesi të njohë e të dijë të implementojë teknikat vokale të të kënduarit modern.
- Punon sistematikisht me durim dhe pasion, me gjithësecilin.
- Inkurajon nxënësit në koncerte e aktivitete muzikore.
- Implementon repertor të pasur dhe arrin të transmetojë punën e bërë në klasë, të realizuar në muzikale të plota në skenë me komponentët e një muzikali: këngë - kërcim - teatër.

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:**

**Vlerësohet kur:**

- Demonstron intepretimin përmes një vokali i cili di te japi emocion.

| |
|---|
| - Këndon e duke zbatuar teknikat e vokalit.<br>- Ka intonacion e ritëm i saktë.<br>- Artikulon mirë, pozicion trupi dhe mbajtje e mikrofonit e saktë.<br>- Interpreton në mënyrë skenike, bukur me muzikalitet dhe interpretim aktorial. |
| **Materiale dhe burime mësimore:** |

**Dega: Muzikë**

**Lënda: Kitarë (instrument sekondar me zgjedhje)**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Shkallë muzikore, etyde dhe materiale ndihmëse teknike | **Nxënësi:**<br>- ka impostim të mirë të duarve;<br>- realizon teknikisht Shkallët maxhore dhe minore;<br>- realizon të gjitha mënyrat e dorës së djathtë dhe të respektojë gishtat e dorës së majtë në metodat përkatëse;<br>- realizon teknikisht etydet; |

| | |
|---|---|
| | - luan në tempin e duhur;<br>- luan figurat ritmike;<br>- luan me tingull të lidhur. |
| - 1-2 Kohë nga suitat Baroke (paraklasike)<br>- Tema me variacione, Minuete,<br>- Valse (të thjeshta) | **Nxënësi:**<br>- luan në tempin dhe stilin e duhur;<br>- ndjen zërat dhe linjat polifonike;<br>- kupton gjatë luajtjes në instrument vazhdimësinë dhe rrjedhshmërinë e tingullit;<br>- luan ushtrime gishtash për pasazhet e vështira. |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallë muzikore<br>- Etyde<br>- Materiale ndihmëse teknike | **Nxënësi:**<br>- ka impostim të mirë të duarve;<br>- realizon teknikisht Shkallët maxhore dhe minore;<br>- realizon të gjitha mënyrat e dorës së djathtë, dhe të respektojë gishtat e dorës së majtë në metodat përkatëse;<br>- realizon teknikisht etydet;<br>- luan në tempin e duhur;<br>- luan figurat ritmike;<br>- luan me tingull të lidhur; |

| | |
|---|---|
| - 1-2 Kohë nga suitat Baroke (paraklasike)<br>- Tema me variacione,<br>- Minuete,<br>- Valse (të thjeshta) | - luan në tempin dhe stilin e duhur;<br>- ndjen zërat dhe linjat polifonike;<br>- kupton gjatë luajtjes në instrument vazhdimësinë dhe rrjedhshmërinë e tingullit;<br>- luan ushtrime gishtash për pasazhet e vështirë. |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallë muzikore<br>- Etyde<br>- Materiale ndihmëse teknike | **Nxënësi:**<br>- ka impostim të mirë të duarve;<br>- realizon teknikisht Shkallët maxhore dhe minore;<br>- realizon të gjitha mënyrat e dorës së djathtë, dhe të respektojë gishta dorës së majtë në metodat përkatëse;<br>- realizon teknikisht etydet;<br>- luan në tempin e duhur;<br>- luan figurat ritmike;<br>- luan me tingull të lidhur. |
| - -2 Kohë nga suitat Baroke (paraklasike)<br>- Tema me variacione<br>- Minuete<br>- Valse (të thjeshta) | **Nxënësi:**<br>- luan në tempin dhe stilin e duhur;<br>- ndjen zërat dhe linjat polifonike; |

| | |
|---|---|
| | - kupton gjatë luajtjes në instrument vazhdimësinë dhe rrjedhshmërinë e tingullit;<br>- luan ushtrime gishtash për pasazhet e vështira. |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE:**

Për arritjen e një niveli të mirë të nxënësit, mësuesi duhet të bëjë kujdes në zgjedhjen e programit sipas nivelit të nxënësit (duke marrë parasysh problemet teknike dhe përshtatjen e materialit artistik me karakterin e nxënësit).

Duhet të punojë me nxënësin në mënyrë që ai të shpalosë dhe vlerat e tij individuale, në mënyrë që të mos jetë thjesht një kopje e mësuesit. (mbështetur gjithmonë në materialet plotësuese teknike). Nxënësi duhet të jetë në gjendje që të arrijë një performancë sa më të bukur.

**Metoda e autorë veprash**: E.Boudounis,E.Assimakopoulos,J.Ferrer,C.Henze,J.Mertz,J.Sagreras,H.Teuchert,Abel Carlevaro, M. Carcassi, Metoda Sor & Coste (Chiesa),etj.

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:**

Vlerësimi në Saxhot simestrale bëhet në mënyrë kolegjiale. Mësuesi i një nxënësi të caktuar ka të drejtë të rrisë ose ulë një notë atij nxënësi në varësi të avancimit shumë-anësh vjetor në orën e tij të mësimit.

**Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur luan jo korrekt:**

- me ritëm;
- me tingull mesatar;
- me intonacion jo të këndshëm;
- me shkallë shpejtësie të ulët;

| |
|---|
| - me disa gabime.<br><br>**Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur luan mirë:**<br><br>- Ritmikisht;<br>- me tingull e me intonacion;<br>- pastër e me pak gabime.<br><br>**Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:**<br><br>- luan shumë mirë në të gjitha elementet e mësipërme. |
| **Materiale dhe burime mësimore:**<br><br>Kitarë, Lexhio, Partiturë, Stol këmbe, Sistem audio-video TIK, Internet |

**Dega: Muzikë**

**Lënda: Violinë (instrument sekondar me zgjedhje)**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Materiale teknike ndihmëse<br>- Tërheqje harku me vlera të ndryshme në 4 telat. | **Nxënësi:** |

| | |
|---|---|
| - Ushtrime gishtash, Radionov. | - realizon impostimin e duarve dhe të harkut;<br>- realizon tërheqje harku të qetë me njëtrajtshmëri dhe pastërti të tingullit në të katër telat;<br>- vendos dorën e majtë sa më drejt për të forcuar artikulacionin; |
| - Shkallë muzikore<br>- 4-5 shkallë minore ose maxhore me 1 oktavë me nga dy arpezhe dhe me forma të ndryshme<br>- harkatash nga Radionov | - zhvillon edukimin e veshit dhe intonacionit përmes ekzekutimit të shkallëve muzikore;<br>- forcon artikulacionin e dorës së majtë; |
| **Ushtrime dhe etyde**<br>- Radionov: mësimet fillestare të violinës<br>- F. Hoxha:Metoda 1 ushtrime<br>- J. Higgins: Essential<br>- elements for string | - kupton lojën teknike hap pas hapi, duke përdorur Ushtrime dhe etyde të ndryshme; |
| **Kompozime të vogla të shoqëruara me piano**<br>- 5-6 kompozime me piano<br>- F.Hoxha: Repertor pedagogjik (përmbledhje pjesësh)<br>- B.Barber: repertor përmbledhës<br>- Suzuki FL I. | - realizon lojën në instrument me të gjithë elementët e përvetësuar. |

| Tematikat klasa 11 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Materiale teknike ndihmëse<br>- Tërheqje harku me vlera të ndryshme në 4 telat<br>- Ushtrime gishtash Radionov | **Nxënësi:**<br>**-** ushtrohet çdo ditë me ushtrime me qëllim formimin e tingullit dhe të artikulacionit te gishtave; |
| - Shkallë muzikore<br>- 6 shkallë minore ose maxhore nga Radionov.<br>- 1-2 shkallë me 2 oktava | - përvetëson lojën në instrument në pozicionin e parë;<br>- realizon nëpërmjet lojës në instrument intonacion sa më të pastër; |
| **Ushtrime dhe etyde**<br>- 8 ushtrime (etyde) te ndryshme nga:<br>- Radionov Mësimet fillestare të violinës ( në vazhdim).<br>- F. Hoxha FL 1<br>- M.Ruse FL 1, etj. | - realizon nëpërmjet materialit teknik, hap pas hapi, teknikat figura të ndryshme;<br>- përvetëson gjysmëtonin ndërmjet gishtit 0-1, 2-3, si dhe 3-4; |
| - Koncerte ose kompozime të vogla të shoqëruara me piano<br>- Riding koncertino Si- pozicioni I, koha I-II-III.<br>- Kuchler koncertino la-(në stilin e Vivaldit)<br>- 5-6 kompozime me piano | - organizon njohuritë e marra gjatë lojës në instrument;<br>- ushtrohet në realizimin e frazës, ngjyrës, dinamikës;<br>- gërsheton kërkesat e mësuesit me instiktin muzikal. |

| | |
|---|---|
| - F.Hoxha- Repertor pedagogjik ( përmbledhje pjesësh)<br>- B.Barber – repertor përmbledhës<br>- Suzuki FL I-II, etj. | |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| **Materiale teknike ndihmëse**<br>- Radionov, ushtrime gishtash<br>- Konjus: ushtrime me 2 zëra<br>- Shradik: ushtrime fillestare gishtash | **Nxënësi:**<br>- realizon çdo ditë ushtrime me qëllim formimin e tingullit dhe artikulacionit të dorës së majtë; |
| - Shkallë muzikore<br>- 4-5 shkallë me 2 oktava pozicioni I dhe III me arpezhe dhe legatura të ndryshme | - realizon Shkallët teknikisht dhe ritmikisht për të arritur një nivel gjithnjë e në rritje;<br>- impostimi i dorës në pozicionin e 3-të; |
| **Etyde**<br>**8 etyde të ndryshme nga:**<br>- Volfard: 60 etyde (1-10)<br>- Radionov: etyde të zgjedhura<br>- F. Hoxha FL1-2<br>- M. Ruse FL 1-2 etj. | - luan me dinamikë dhe teknika të përcaktuara në zona të harkut;<br>- realizon elementin e vibratos; |
| - Koncertino | - vibron dhe organizon frazën muzikore gjatë luajtjes në instrument; |



ASCAP

<table>
<tr><td>
- Koha I ose II-III nga koncertinot<br>
- Riding: koncertino, Si- koha II-III<br>
- Kuchler: koncertino LA-( në stilin e Vivaldit)<br>
- Seitz: koncertino Sol+ Koha I-II-III
</td><td></td></tr>
<tr><td>
Kompozime të vogla të shoqëruara me piano<br>
- Suzuki: FL II-III<br>
- B.Barber: repertor përmbledhës<br>
- Bach: minuete<br>
- Moxart: kompozime fillestare<br>
- P.Gaci – Valle etj.
</td><td>
- realizon performancë artistike duke transmetuar emocion sipas veprave që luan dhe shfaq personalitetin e vet në lojë.
</td></tr>
<tr><td colspan="2">
UDHËZIME METODOLOGJIKE<br>
Për arritjen e një niveli të mirë te nxënësit, mësuesi duhet të bëjë kujdes në zgjedhjen e programit sipas nivelit të nxënësit (duke marrë parasysh problemet teknike dhe përshtatjen e materialit artistik me karakterin e nxënësit).<br>
Duhet të punojë me nxënësin në mënyrë që ai të shpalosë dhe vlerat e tij individuale, në mënyrë që të mos jetë thjesht një kopje e mësuesit. (mbështetur gjithmonë në materialet plotësuese teknike). Nxënësi duhet të jetë në gjendje që të arrijë një performancë sa më të bukur.<br>
Metoda e autorë veprash: Radinov, F. Hoxha, Wolfart, Riding, Vivaldi, Kuchler, Suzuki,etj.
</td></tr>
<tr><td colspan="2">
UDHËZIME PËR VLERËSIMIN
</td></tr>
</table>

Vlerësimi në Saxhot simestrale bëhet në mënyrë kolegjiale. Mësuesi i një nxënësi të caktuar ka të drejtë të rrisë ose ulë një notë atij nxënësi në varësi të avancimit shumë-anësh vjetor në orën e tij të mësimit.

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- luhet pa impostimin e duhur;
- luhet me tingull jo të pastër;
- luhet pa ritëm.

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- njeh mirë pozicionin dhe luan saktë nga ana intonative;
- luan me impostim relativisht të mirë;
- luan me një tingull me intonacion të pastër;
- luan ritmikisht mirë.

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- luan me tingull më të shëndetshëm dhe vibrato të vazhdueshme;
- rrit autoritetin gjatë lojës në instrument;
- njeh mirë zonat e harkut dhe legaturën;
- zbaton lojën e përdorimin e pulsit;
- zgjeron njohuritë për mënyrat e përdorimit të harkut;

| |
|---|
| - ushtrohet duke përdorur materialet teknike dhe muzikore përfshihet dhe pozicioni i 3-të;<br>- demonstron se ky pozicion përvetësohet sa më natyrshëm nga nxënësi;<br>- impostimi është një garanci për problemet e avancuara. |
| **Materiale dhe burime mësimore:**<br><br>Violinë, Lexhio, Partiturë, Sistem audio-video TIK, Internet. |

**Dega: Muzikë**

**Lënda: Violë (instrument sekondar me zgjedhje)**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Shkallë muzikore, etyde dhe materiale ndihmëse teknike<br>- Jan Dobins (Metodë për fillestarë)<br>- Kinsey (Ushtrime Teknike) | **Nxënësi:**<br><br>- realizon impostim të mirë të duarve;<br>- realizon teknikisht Shkallët maxhore dhe minore;<br>- realizon mënyrat e përdorimit të dorës së djathtë;<br>- respekton përdorimin e gishtave të dorës së majtë me metodën e piccikatos;<br>- realizon teknikisht etydet; |

| | |
|---|---|
| | - luan në tempin e duhur;<br>- luan figurat ritmike;<br>- luan me tingull të rrjedhësh. |
| - Jan Dobins (Metodë fillestare për violë)<br>- J.Higgins –Essential (elements for string)<br>- 5-6 kompozime me piano. Diin<br>- (Metodë me shoqërim në piano) B.Barber<br>- (Repertor përmbledhës) Suzuki -Volumi I | **Nxënësi:**<br>- luan në tempin dhe stilin e duhur;<br>- ndjen zërat dhe linjat e harkut në kalimet nëpër tela;<br>- kupton gjatë luajtjes në instrument vazhdimësinë dhe rrjedhshmërinë e tingullit;<br>- luan ushtrime për pasazhet e vështira. |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallë muzikore<br>- Jan Dobins (metodë për fillestarë)<br>- Kinsey (ushtrime Teknike) | **Nxënësi:**<br>- ka impostim të mirë të duarve;<br>- realizon teknikisht Shkallët maxhore dhe minore;<br>- realizon teknikisht etydet;<br>- luan në tempin e duhur;<br>- luan figurat ritmike;<br>- luan me tingull të lidhur; |
| - Jan Dobins (metodë fillestare për violë)<br>- J.Higgins –Essential (elements for string) | - luan në tempin dhe stilin e duhur; |

| | |
|---|---|
| - 5-6 kompozime me piano.Diin<br>- Suzuki –Volumi I-II<br>- (metodë me shoqërim në piano) B.Barber<br>- (repertor përmbledhës) | - kupton gjatë luajtjes në instrument vazhdimësinë dhe rrjedhshmërinë e tingullit;<br>- luan ushtrime gishtash për pasazhet e vështira. |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallë muzikore<br>- Etyde dhe Materiale teknike<br>- Jan Dobins (Metodë )<br>- Kinsey (Ushtrime Teknike) | **Nxënësi:**<br>- ka impostim të mirë të duarve;<br>- realizon teknikisht Shkallët maxhore dhe minore;<br>- realizon të gjitha mënyrat e përdorimit të harkut (dorës së djathtë);<br>- realizon teknikisht etydet;<br>- luan në tempin e duhur;<br>- luan figurat ritmike;<br>- luan me tingull të lidhur. |
| - Suzuki-( Volumi II-III)<br>- Michael Rose (Volum me pjesë)<br>- Farbes-(Metodë për violë dhe piano) | **Nxënësi:**<br>- luan në tempin dhe stilin e duhur;<br>- kupton gjatë luajtjes në instrument vazhdimësinë dhe rrjedhshmërinë e tingullit;<br>- luan ushtrime gishtash për pasazhet e vështira. |
| **UDHËZIME PËR VLERËSIMIN** | |

| |
|---|
| Vlerësimi në Saxhot simestrale bëhet në mënyrë kolegjiale. Mësuesi i një nxënësi të caktuar ka të drejtë të rrisë ose ulë një notë atij nxënësi në varësi të avancimit shumë-anësh vjetor në orën e tij të mësimit.<br><br>**Niveli MJAFTUESHËM**<br>**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**<br>- ka ritëm,<br>- ka tingull mesatar,<br>- ka intonacion jo të këndshëm,<br>- ka shkallë shpejtësie të ulët e<br>- ka disa gabime.<br><br>**Niveli MIRË**<br>**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**<br>- ka ritëm,<br>- ka tingull e intonacion,<br>- luan pastër e me pak gabime.<br><br>**Niveli SHUMË MIRË**<br>**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**<br>- luan shumë mirë në të gjitha elementet e mësipërme. |
| **Materiale dhe burime mësimore:** |



ASCAP

| |
|---|
| Violë, Lexhio, Partiturë, Sistem audio-video TIK, Internet. |

**Dega: Muzikë**

**Lëndët: Violonçel (instrument sekondar me zgjedhje)**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Shkallë muzikore, etyde dhe materiale ndihmëse teknike<br>- Luigj Lazri (Metodë për fillestarë)<br>- Ushtrime ose Etyde (Metoda Popper)<br>- Etj. | **Nxënësi:**<br>- realizon impostim të mirë të duarve;<br>- realizon teknikisht Shkallët maxhore dhe minore;<br>- realizon mënyrat e përdorimit të dorës së djathtë, dhe të respektojë përdorimin e gishtave të dorës së majtë me metodën e picikatos;<br>- realizon teknikisht etydet;<br>- luan në tempin e duhur;<br>- luan figurat ritmike;<br>- luan me tingull të rrjedhësh. |
| - 1-2 Pjesë (të thjeshta) nga autorë shqiptarë dhe të huaj si;<br>- Ymer Skënderi | **Nxënësi:**<br>- luan në tempin dhe stilin e duhur; |

| | |
|---|---|
| - Kummer<br>- Bakllanova<br>- Pjesë (të thjeshta) nga metoda e Suzukit | - ndjen zërat dhe linjat e harkut në kalimet nëpër tela;<br>- kupton gjatë luajtjes në instrument vazhdimësinë dhe rrjedhshmërinë e tingullit;<br>- luan ushtrime për pasazhet e vështira. |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallë muzikore<br>- Etyde nga Metoda 'Materiale teknike' Luigj Lazri<br>- Etyde nga Metoda Popper<br>- Lee etj. | **Nxënësi:**<br>- ka impostim të mirë të duarve;<br>- realizon teknikisht Shkallët maxhore dhe minore;<br>- realizon teknikisht etydet;<br>- luan në tempin e duhur;<br>- luan figurat ritmike;<br>- luan me tingull të lidhur; |
| - Bakllanova<br>- Kummer<br>- Suzuki (Volumi I - II) etj. | - luan në tempin dhe stilin e duhur;<br>- kupton gjatë luajtjes në instrument vazhdimësinë dhe rrjedhshmërinë e tingullit;<br>- luan ushtrime gishtash për pasazhet e vështira. |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallë muzikore<br>- Etyde nga Metoda 'Materiale teknike' Luigj Lazri | **Nxënësi:**<br>- ka impostim të mirë të duarve; |

| | |
|---|---|
| - Etyde nga Metoda Popper<br>- Kummer<br>- Lee etj. | - realizon teknikisht Shkallët maxhore dhe minore;<br>- realizon të gjitha mënyrat e përdorimit të harkut (dorës së djathtë);<br>- realizon teknikisht etydet;<br>- luan në tempin e duhur;<br>- luan figurat ritmike;<br>- luan me tingull të lidhur. |
| - Bakllanova<br>- Kummer<br>- Suzuki (Volumi II - III)<br>- Romberg<br>- Vivaldi etj. | **Nxënësi:**<br>- luan në tempin dhe stilin e duhur;<br>- kupton gjatë luajtjes në instrument vazhdimësinë dhe rrjedhshmërinë e tingullit;<br>- luan ushtrime gishtash për pasazhet e vështira. |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Për arritjen e një niveli të mirë te nxënësit, mësuesi duhet të bëjë kujdes në zgjedhjen e programit sipas nivelit të nxënësit (duke marrë parasysh problemet teknike dhe përshtatjen e materialit artistik me karakterin e nxënësit).

Duhet të punojë me nxënësin në mënyrë që ai të shpalosë dhe vlerat e tij individuale, në mënyrë që të mos jetë thjesht një kopje e mësuesit. (mbështetur gjithmonë në materialet plotësuese teknike). Nxënësi duhet të jetë në gjendje që të arrijë një performancë sa më të bukur.

**Metoda e autorë veprash:** Luigj Lazri, Ymer Skënderi, Popper, Kummer, Marderovsky, Lee, Vivaldi, Romberg etj.

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN**

Vlerësimi në Saxhot simestrale bëhet në mënyrë kolegjiale. Mësuesi i një nxënësi të caktuar ka të drejtë të rrisë ose ulë një notë atij nxënësi në varësi të avancimit shumë-anësh vjetor në orën e tij të mësimit.

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- ka ritëm,
- ka tingull mesatar,
- ka intonacion jo të këndshëm,
- ka shkallë shpejtësie të ulët e me disa gabime.

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- ka ritëm,
- ka tingull me intonacion,
- luan pastër e me pak gabime.

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- luan shumë mirë në të gjitha elementet e mësipërme.

**Materiale dhe burime mësimore:**

Violonçel, Lexhio, Partiturë, Sistem audio-video TIK, Internet



ASCAP

**Dega: Muzikë**

**Lënda: Kontrabas (instrument sekondar me zgjedhje)**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Shkallë muzikore, etyde dhe materiale ndihmëse teknike<br>- Luigj Lazri (Metodë për fillestarë)<br>- Ushtrime ose Etyde (Metoda Popper)<br>- Etj. | **Nxënësi:**<br>- realizon impostim të mirë të duarve;<br>- realizon teknikisht Shkallët maxhore dhe minore;<br>- realizon mënyrat e përdorimit të dorës së djathtë, dhe të respektojë përdorimin e gishtave të dorës së majtë me metodën e picikatos;<br>- realizon teknikisht etydet;<br>- luan në tempin e duhur;<br>- luan figurat ritmike;<br>- luan me tingull të rrjedhësh. |
| - 1-2 Pjesë (të thjeshta) nga autorë shqiptarë dhe të huaj si;<br>- Ymer Skënderi<br>- Kummer<br>- Bakllanova<br>- Pjesë (të thjeshta) nga metoda e Suzukit | **Nxënësi:**<br>- luan në tempin dhe stilin e duhur;<br>- ndjen zërat dhe linjat e harkut në kalimet nëpër tela;<br>- kupton gjatë luajtjes në instrument vazhdimësinë dhe rrjedhshmërinë e tingullit;<br>- luan ushtrime për pasazhet e vështira. |



ASCAP

| Tematikat klasa 11 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Shkallë muzikore<br>- Etyde nga Metoda 'Materiale teknike' Luigj Lazri<br>- Etyde nga Metoda "Popper"<br>- Etyde nga Metoda "Lee"<br>- Etyde nga Metoda "Bille" | **Nxënësi:**<br>- ka impostim të mirë të duarve;<br>- realizon teknikisht Shkallët maxhore dhe minore;<br>- realizon teknikisht etydet;<br>- luan në tempin e duhur;<br>- luan figurat ritmike;<br>- luan me tingull të lidhur; |
| - Bakllanova<br>- Kummer<br>- Suzuki (Volumi I - II) etj. | - luan në tempin dhe stilin e duhur;<br>- kupton gjatë luajtjes në instrument vazhdimësinë dhe rrjedhshmërinë e tingullit;<br>- luan ushtrime gishtash për pasazhet e vështira. |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallë muzikore<br>- Etyde nga Metoda 'Materiale teknike' Luigj Lazri<br>- Etyde nga Metoda Popper<br>- Kummer<br>- Lee etj. | **Nxënësi:**<br>- ka impostim të mirë të duarve;<br>- realizon teknikisht Shkallët maxhore dhe minore;<br>- realizon të gjitha mënyrat e përdorimit të harkut (dorës së djathtë);<br>- realizon teknikisht etydet;<br>- luan në tempin e duhur; |

| | |
|---|---|
| | - luan figurat ritmike;<br>- luan me tingull të lidhur. |
| - Bakllanova<br>- Kummer<br>- Suzuki (Volumi II - III)<br>- Romberg<br>- Vivaldi etj. | **Nxënësi:**<br>- luan në tempin dhe stilin e duhur;<br>- kupton gjatë luajtjes në instrument vazhdimësinë dhe rrjedhshmërinë e tingullit;<br>- luan ushtrime gishtash për pasazhet e vështira. |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Për arritjen e një niveli të mirë te nxënësit, mësuesi duhet të bëjë kujdes në zgjedhjen e programit sipas nivelit të nxënësit (duke marrë parasysh problemet teknike dhe përshtatjen e materialit artistik me karakterin e nxënësit).

Duhet të punojë me nxënësin në mënyrë që ai të shpalosë dhe vlerat e tij individuale, në mënyrë që të mos jetë thjesht një kopje e mësuesit. (mbështetur gjithmonë në materialet plotësuese teknike). Nxënësi duhet të jetë në gjendje që të arrijë një performancë sa më të bukur.

Metoda e autorë veprash: Luigj Lazri, Ymer Skënderi,Kujtim Laro, Popper, Kummer, Marderovsky, Lee, Vivaldi, Romberg;

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN**

Vlerësimi në Saxhot simestrale bëhet në mënyrë kolegjiale. Mësuesi i një nxënësi të caktuar ka të drejtë të rrisë ose ulë një notë atij nxënësi në varësi të avancimit shumë-anësh vjetor në orën e tij të mësimit.

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- ka ritëm,
- ka tingull mesatar,
- ka intonacion jo të këndshëm,
- ka shkallë shpejtësie të ulët e me disa gabime.

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- luan ritmikisht,
- luan me tingull e me intonacion,
- luan pastër e me pak gabime.

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- luan shumë mirë në të gjitha elementet e mësipërme.

**Materiale dhe burime mësimore:**

Kontrabas, Lexhio, Partiturë, Sistem audio-video TIK, Internet

**Dega: Muzikë**

**Lënda: Flaut (instrument sekondar me zgjedhje)**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
| --- | --- |
| - Shkallë muzikore<br>- Shkallë deri në 1 shenje # (Dieziz) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar<br>- Shkallët deri në 1 shenje b (Bemol) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar deri në një Oktavë | **Nxënësi:**<br>- realizon në mënyrë të veçantë impostimin (bokaturën);<br>- praktikon frymëmarrjen dhe frymën nxjerrjen e rregullt (diafragmën);<br>- mban trupin drejt dhe përdor lirshëm duart dhe gishtat;<br>- përdor lirshëm atakun (goditjen) dhe nxjerrjen e tingullit;<br>- përvetëson pozicionet në oktavën e parë;<br>- luan Shkallët e arpezhet, intervalet me ritëm të ngadaltë e mesatar: legato e stakato;<br>- luan ushtrime gishtash; |
| - Ushtrime dhe etyde<br>- (1 ushtrim në muaj)<br>- Metoda E. Prill<br>- E. Kohler (fillestarë)<br>- Metoda A. C. Petersen | - luan saktë aplikaturat;<br>- përvetëson elementet teknike, si: tingullin, goditjen, frymëmarrjen;<br>- respekton aplikaturat dhe dinamikën;<br>- interpreton me kualitet timbrik intonativ;<br>- zhvillon ushtime për diafragmën; |
| - Programi Artistik<br>- 1 duet për flaut | - luan duetet në klasë së bashku me mësuesen ose me shokët e klasës; |

| | |
|---|---|
| - Minuet -Moxart<br>- Minuetto - J. Hajden<br>- Melodi Shuman<br>- Romancë Shubert<br>- Nina- Nana - P. Gaci<br>- “Malësori i vogël” - T. Harapi | - përvetëson pjesët në klasë, nga ana ritmike, dhe kohë pas kohe nga ana e lojës melodike dhe interpretative;<br>- punon me prioritet dhe mënyra të ndryshme vështirësitë që shfaqen në materialin artistik;<br>- realizon elementet e para të interpretimit artistik, duke zbuluar karakteristikat e secilit autor. |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallë muzikore<br>- Shkallët maxhore e minore me dy shenja me # (Diezis) dhe b (Bemola) me (një oktavë) ngadalë dhe me ritëm mesatar | **Nxënësi:**<br>- luan Shkallët me tingull të plotë e pa gabime;<br>- luan Shkallët detashe në format stakato e legato;<br>- luan pa gabime arpezhet dhe përmbysjet e tyre; |
| - Ushtrime dhe etyde<br>- 1 ushtrim në muaj<br>- E. Prill<br>- E. Kohler: Fashikulli i parë<br>- L. Moyse- Ushtrime për Flaut Fashikulli i parë | - realizon gjatë lojës aplikaturat, frymëmarrjen, ritmikën e ushtrimit etj.;<br>- respekton dinamikën e ushtrimeve;<br>- realizon frymëmarrjen mbi bazën e logjikës muzikore dhe teknike;<br>- luan tingull me intonacion të pastër; |
| - Program artistik<br>- 1 duet për flaut nga autorë të huaj dhe shqiptar:<br>- Minuetto nga J. S. Bach: | - praktikon duetet, në fillim me mësuesin dhe në fazë të dytë luan me nxënës të tjerë bashkëmoshatarë;<br>- ushtron ritmin e pjesëve dhe më pas, tërësinë e tyre melodike;<br>- respekton dinamikën e pjesëve ; |

| | |
|---|---|
| - Shubert: Vals<br>- N. R. Korsakoff: Tema nga Scheherazade.<br>- H. Bokerini: Minuetto<br>- Hendel: Minuete<br>- Teleman: Minuete<br>- Pjesë shqiptare | - punon me mënyra të ndryshme vështirësitë teknike që shfaqen në materialin muzikor;<br>- dallon karakteristikat e autorëve të veçantë. |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - **Shkallë muzikore**<br>- Shkallë deri në 2 shenja # (Dieziz) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar.<br>- Shkallët deri në 2 shenja b (Bemol) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar deri në një oktavë | **Nxënësi:**<br>- realizon në mënyrë të veçantë impostimin (bokaturën);<br>- praktikon frymëmarrjen dhe frymë n xjerrjen e rregullt (diafragmën);<br>- mban trupin drejt dhe përdor lirshëm duart dhe gishtat;<br>- përdor lirshëm atakun (goditjen) dhe nxjerrjen e tingullit;<br>- përvetëson pozicionet në oktavën e parë;<br>- luan ushtrime gishtash; |
| **Ushtrime dhe etyde**<br>- 1 ushtrim në muaj<br>- Metoda E. Prill<br>- E. Kohler (fillestarë)<br>- Wastall | - luan saktë aplikaturat;<br>- përvetëson elementet teknike, si: tingullin, goditjen, frymëmarrjen;<br>- respekton aplikaturat dhe dinamikën;<br>- zhvillon ushtrime për diafragmën; |

| | |
|---|---|
| - Metoda A. C. Petersen | |
| - Programi Artistik<br>- 1 duet për flaut<br>- Flauti magjik - W. A. Moxart<br>- Minuet -Moxart.<br>- Minuetto - J. Hajden<br>- Melodi Tschajkovsky<br>- Melodi Shuman<br>- Romance Shubert<br>- Nina- Nana - P. Gaci<br>- Malësori i vogël - T. Harapi<br>- Melodi - Ç. Zadeja | - luan duetet në klasë së bashku me mësuesen ose me shokët e klasës;<br>- përvetëson pjesët në klasë, nga ana ritmike, dhe kohë pas kohe nga ana e lojës melodike dhe interpretative;<br>- punon me prioritet dhe mënyra të ndryshme vështirësitë që shfaqen në materialin artistik;<br>- realizon lojën me ngjyra dhe emocionalitet. |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Për të arritur një nivel sa më të mirë të lojës në instrument, nxënësi duhet edukuar të studiojë në mënyrë sa më sistematike. Në këtë proces, puna e mësuesit duhet të jetë e vazhdueshme, e thelluar dhe e lidhur ngushtë me vëzhgimin psikologjik e emocional të nxënësit, që nga Shkallët e para të formimit, deri në plotësinë e mjaftueshme të tij. Për të pasur rezultate sa më të mira, trajtimi psiko emocional duhet të shtrihet gjatë gjithë vitit dhe të synojë, në radhë të parë, një administrim sa më të mirë të orës së mësimit. Po ashtu, ndërthurja e kërkesave teknike të lojës në instrument me kërkesat artistike të veprave të veçanta, do t'i jepte orës së mësimit më shumë frymëmarrje dhe do ta bënte atë më të pëlqyeshme për nxënësin.



ASCAP

Është mirë që, në momente të caktuara të realizimit të programit, të planifikohen forma të veçanta të kontrollit të dijeve e të nivelit të nxënësit. Këto do të ishin mbështetje e sigurt për shkallët e tjera të realizimit dhe do ta ndihmonin nxënësin t'i kuptonte nga afër kërkesat e mëtejshme të mësuesit. Për këtë, edhe kontrolli i materialeve teknike dhe i pjesëve të tjera artistike të programit duhet të përputhet me shkallët e studimit të tyre: ngadalë (ushtrim e kontroll në detaje); pak më shpejt (vërtetim i studimit të saktë të materialit dhe siguri për më tej); më shpejt e, së fundi, trajtim i materialit në tempin e kërkuar nga partitura. Sipas kësaj dinamike, edhe kontrolli i përgjithshëm i dijeve do të ishte një fazë e rëndësishme në formimin e nxënësit dhe do të shërbente për një menaxhim më të mirë të mundësive dhe mangësive të tij për të ardhmen

## UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi në saxho bëhet në mënyrë kolegjiale. Për njohjen e drejtpërdrejtë të punës së nxënësit në klasë, mësuesi i lëndës ka të drejtë të ulë ose të rrisë një notë.

Mbi bazën e **2 notave dhe 2 saxho**, vendoset nota semestrale.

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur luan jo korrekt:**

- luan jo korrekt me ritëm,
- luan me tingull mesatar,
- luan me intonacion jo të këndshëm, me shkallë shpejtësie të ulët e me disa gabime.

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur luan mirë:**

- *ritmikisht,*
- *me tingull e me intonacion, pastër e me pak gabime.*

| |
|---|
| **Niveli SHUMË MIRË**<br>**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**<br>- luan shumë mirë në të gjitha elementet e mësipërme.<br>**Shënim:** Pjesët mund të zëvendësohen nga ana e mësuesit specialist me pjesë të të njëjtit nivel. |
| **Materiale dhe burime mësimore:**<br>Flaut, Lexhio, Partiturë, Sistem audio-video TIK, Internet. |

**Dega: Muzikë**

**Lënda: Oboe (instrument sekondar me zgjedhje)**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Shkallët muzikore<br>- Shkallë një oktavëshe me arpezhe përkatëse | **Nxënësi:**<br>- njihet me pjesët përbërëse të instrumentit;<br>- imposton frymëmarrjen me diafragmë;<br>- imposton bokaturën; |

| | |
|---|---|
| - Ushtrime<br>- Hinke - ushtrime fillestare | - mëson të prodhoj tingull;<br>- njihet me tastierën e instrumentit;<br>- imposton duart; |
| - Moxart<br>- Breeze easy - pjesë për oboe kapitulli i parë | - luan shkallën dhe pjesët shumë ngadalë. |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallët muzikore<br>- Shkallë një oktavëshe me arpezhe përkatëse | **Nxënësi:**<br>- luan shkallën në ritëm mesatar;<br>- luan me një tingull të pastër; |
| - Ushtrime<br>- Hinke - ushtrime fillestare | - realizon një frymëmarrje të lirshme; |
| - Moxart<br>- Breeze easy - pjesë për oboe kapitulli i parë<br>- Etj. | - luan shkallën dhe pjesët në ritëm të ngadaltë dhe mesatar;<br>- imposton në mënyrë të sigurt goditjen dhe legaton. |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - **Shkallët muzikore**<br>- Shkallë një oktavëshe me arpezhe përkatëse | **Nxënësi:**<br>- luan shkallën në ritëm dhe realizon  mirë frakturat ritmike;<br>- luan me një tingull të pastër dhe ritmikisht saktë; |

| | |
|---|---|
| | - realizon një frymëmarrje të lirshme; |
| - Ushtrime<br>- Hinke - ushtrime fillestare | - luan në instrument me tingull të plotë e intonacion të saktë; |
| - Ç.Zadeja<br>- T.Harapi<br>Moxart<br>Breeze easy - pjesë për oboe kapitulli i parë | - imposton në mënyrë të sigurt goditjen, legaton, portato dhe detashe;<br>- luan pjesën muzikore saktë në ritëm dhe intonacion. |

## UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi në saxho bëhet në mënyrë kolegjiale. Për njohjen e drejtpërdrejtë të punës së nxënësit në klasë, mësuesi i lëndës ka të drejtë të ulë ose të rrisë një notë.

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- mban trupin drejt dhe impostohet saktë në instrument;
- imposton drejt bokaturën;
- merr frymë me diafragëm dhe përvetëson teknikën e frymëmarrjes;
- prodhon tingull;
- imposton bukur dorën e majtë dhe të djathtë;
- luan me duar të impostuara mirë.

**Niveli MIRË**

| |
|---|
| **Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**<br><br>- luan me ritëm, legatura të thjeshta dhe me intonacion të pastër;<br>- fiton një siguri dhe një lirshmëri në lojë;<br>- njeh veprat.<br><br>**Niveli SHUMË MIRË**<br>**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**<br><br>- realizon kërkesat teknike – muzikore;<br>- përvetëson elementet teknike dhe të ketë një pozicion normal të duarve;<br>- harmonizon lojën e tij me atë të instrumentit shoqërues të pianos. |
| **Materiale dhe burime mësimore:**<br><br>Oboe, Lexhio, Partiturë, Sistem audio-video TIK, Internet. |

**Dega: Muzikë**

**Lënda: Fagot (instrument sekondar me zgjedhje)**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|

| | |
|---|---|
| - Shkalla Do maxhore dhe Si bemol maxhore (një oktavë)<br>- Shkalla Fa diez maxhore dhe Re bemol maxhore me (një oktavë)<br>- Shkalla Si bemol minor melodik me (një oktavë) | **Nxënësi:**<br>- luan pastër dhe pa gabime Shkallët;<br>- luan me tingull të plotë të gjitha Shkallët, si legato portato, stakato në një temp mesatar;<br>- luan në temp shkallët muzikore; |
| - 1 ushtrim nga metodat përkatëse (çdo muaj)<br>- Metodat:<br>- Julius Weissenborn fl. II. Giamperi Milde etyde | - luan duke respektuar *ritmikën* dhe<br>- aplikaturat e etydeve;<br>- luan me dinamikë të rregullt;<br>- luan duke respektuar frymëmarrjen, stakaton dhe legaton;<br>- realizon gjatë luajtjes tingull dhe intonacion të pastër; |
| - P. Dungu- melodi<br>- V. Nova – melodi<br>- Fash- sonatë | - luan pjesët shqiptare duke respektuar karakteristikat e kësaj muzike;<br>- luan duke zbërthyer çdo detaj të anës melodike dhe ritmike të pjesës. |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallë maxhore e minore me 1 shenjë:<br>- me diezis e bemola<br>- arpezhet përkatëse në mënyrat stakato e legato me temp mesatar. | **Nxënësi:**<br>- luan pastër dhe pa gabime Shkallët;<br>- luan në temp Shkallët muzikore;<br>- luan me tingull të plotë të gjitha shkallët si legato portato stakato në një temp të shpejtë, me dinamikë *p, mf, f*. |

| | |
|---|---|
| - 2 ushtrime në muaj nga metodat përkatëse<br>- Metodat:<br>- Milde - etyde. Weissenborn Nr. 2 | - luan dhe respekton *ritmikën* dhe *aplikaturat* e etydeve;<br>- luan me dinamikë të rregullt;<br>- luan duke respektuar frymëmarrjen, stakaton dhe legaton;<br>- realizon gjatë luajtjes tingull dhe intonacion të pastër; |
| - P. Gaci - melodi (nina- nana)<br>- V. Nova- melodi<br>- Marcelo - Melodi. Fash- Sonatë<br>- F. Fash - Melodi | - luan pjesët shqiptare duke respektuar karakteristikat e këtij muzike;<br>- luan duke zbërthyer çdo detaj të anës melodike dhe ritmike të pjesës;<br>- luan pjesët duke pasqyruar anën emocionale dhe karakteristikat e pjesës;<br>- luan duke respektuar kërkesat;<br>- kupton pjesën dhe kohën së cilës i përket. |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallët maxhore e minore me 2 shenja, në 2 oktava:<br>- me diezis e bemola<br>- arpezhet përkatëse në mënyrat stakato e legato me temp mesatar | **Nxënësi:**<br>- luan pastër dhe pa gabime Shkallët; Luan në temp shkallët muzikore;<br>- luan me tingull të plotë të gjitha Shkallët si legato portato stakato në një temp mesatar; |
| - 1 ushtrim në muaj nga metodat përkatëse<br>- Metodat:<br>- Milde - etyde | - luan dhe respekton *ritmikën* dhe<br>- aplikaturat e etydeve;<br>- luan me dinamikë të rregullt;<br>- luan duke respektuar frymëmarrjen, stakaton dhe legaton;<br>- realizon gjatë luajtjes tingull dhe intonacion të pastër; |

| | |
|---|---|
| - P. Gaci - melodi (nina- nana)<br>- V. Nova- melodi<br>- Melodi nga F. Teleman. Marcelo – Melodi:<br>- Moxart - Melodi<br>- D. Tukiçi - Vepër Shqiptare<br>- R. Dhomi - Romancë | - luan pjesët shqiptare duke respektuar karakteristikat e kësaj muzike;<br>- luan duke zbërthyer çdo detaj të anës melodike dhe ritmike të pjesës;<br>- luan pjesët duke pasqyruar anën emocionale dhe karakteristikat e pjesës;<br>- luan duke respektuar kërkesat;<br>- kupton pjesën dhe kohën së cilës i përket. |

**UDHËZIME PËR METODOLOGJINË**

Gjatë punës për zbatimin e programit duhet bërë kujdes që të tregohen rrugët e duhura për arritjen e objektivave, duke filluar nga materialet teknike, si edhe ato muzikore.

Për arritjen e nivelit sa më optimal, nxënësi duhet të nxitet në sistematikën e tij në mënyrë rigoroze. Puna e mësuesit duhet të jetë shumë kërkuese dhe e njëtrajtshme. Vëzhgimi psikologjik e emocional i nxënësit përbën një nga detyrat më të vështira të mësuesit. Puna për të rritur administrimin psiko emocional duhet të bëhet gjatë gjithë vitit që të kemi rezultate sa më të larta. Administrimi i orës së mësimit me intensitet dhe etapa të përcaktuara qartë do të rrisin shkallën e të nxënit dhe rendimentin e orës së mësimit. Ndërthurja e kërkesave teknike me ato artistike do ta bëjë orën e mësimit të pëlqyeshme për nxënësin. Puna e diferencuar, mbi bazën e mundësive fizike e intelektuale të çdo nxënësi, do të zhvillojë në mënyrë të drejtë e më të shpejtë nivelin e klasës. Mbi bazën e ecurisë së programit, mësuesi mund të avancojë në kërkesat e tij në lidhje me programin, në individë që e përvetësojnë atë më shpejt. Materiali didaktik duhet t'i përgjigjet nivelit që kërkon grup mosha e jo nivelit të ulët, po ashtu edhe programi artistik. Për këtë arsye bëhet zbërthimi i programit nga çdo mësues për çdo muaj dhe i miratuar nga drejtuesi specialist i shkollës. Përgatitja e nxënësit duhet të bëhet e kontrolluar edhe me variante të ndryshme për të pasur më shumë efektivitet. Gjatë zhvillimit të orëve të para, materiali teknik dhe didaktik të kërkohet në një ritëm të ngadaltë dhe duke avancuar në tempin real. Kërkesat bazë,

si: përpikëria në ritëm, konceptimi i frymëmarrjes mbi bazën e logjikës konceptuale muzikore e teknike, realizimi i aplikaturave dhe loja me koncept të drejtë me tingull të pastër, përbëjnë elementet kryesore të suksesit dhe të arritjes së rezultateve optimale.

*Shënim.* Materiali artistik, ku përfshihen koncertet dhe sonatat, veprat ciklike, mund të zëvendësohet nga ana e mësuesit të lëndës me materiale të tjera, por ato të jenë në të njëjtën shkallë vështirësie dhe të miratohen nga komisioni përkatës.

## UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur luan jo korrekt:**

- me ritëm,
- me tingull mesatar,
- me intonacion jo të këndshëm, me shkallë shpejtësie të ulët e me gabime.

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur luan:**

- me ritëm, legatura të thjeshta dhe me intonacion të pastër;
- fiton një siguri dhe një lirshmëri në lojë;
- njeh veprat.

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur luan:**

- shumë mirë në të gjitha elementet e mësipërme.

| |
|---|
| Shënim: Pjesët mund të zëvendësohen nga ana e mësuesit specialist me pjesë të të njëjtit nivel.<br><br>**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**<br><br>- Realizon kërkesat teknike – muzikore<br>- përvetëson elementet teknike dhe të ketë një pozicion normal të duarve;<br>- Harmonizon lojën e tij me atë të instrumentit shoqërues të pianos.<br>- Luan *shumë mirë* në të gjitha elementet e mësipërme.<br><br>**Shënim:** Pjesët mund të zëvendësohen nga ana e mësuesit specialist me pjesë të të njëjtit nivel. |
| **Materiale dhe burime mësimore:**<br><br>Fagot, Lexhio, Partiturë, Sistem audio-video TIK, Internet. |

**Dega: Muzikë**

**Lënda: Saxofon (instrument sekondar me zgjedhje)**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Shkallë deri në 1 shenje # (Dieziz) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar<br>- Shkallët deri në 1 shenje b (Bemol) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar deri në një Oktavë | **Nxënësi:**<br>- realizon në mënyrë të veçantë impostimin (bokaturën);<br>- praktikon frymëmarrjen dhe frymën nxjerrjen e rregullt (diafragmën);<br>- mban trupin drejt dhe përdor lirshëm duart dhe gishtat;<br>- përdor lirshëm atakun (goditjen) dhe nxjerrjen e tingullit;<br>- përvetëson pozicionet në oktavën e parë;<br>- luan Shkallët e arpezhet, intervalet me ritëm të ngadaltë e mesatar: legato e stakato; |
| - Ushtrime dhe etyde<br>- 2 ushtrime në muaj<br>- Metoda E. Prill<br>- Klosse-metodë për zhvillimin e mekanizmit | - luan saktë aplikaturat;<br>- përvetëson elementet teknike, si: tingullin, goditjen, frymëmarrjen;<br>- respekton aplikaturat dhe dinamikën;<br>- zhvillon ushtime për diafragmën; |
| - Programi Artistik<br>- 1 duet për saksofon | - luan duetet në klasë së bashku me mësuesen ose me shokët e klasës;<br>- përvetëson pjesët në klasë, nga ana ritmike, dhe kohë pas kohe nga ana e lojës melodike dhe interpretative; |



ASCAP

| | |
|---|---|
| - 1 duet të thjeshtë nga - Percetina nga Christofor Norton | - zbërthen me korrektësi materialin muzikor nga ana ndërtimore, teknike dhe emocionale;<br>- realizon elementet e para të interpretimit artistik, duke zbuluar karakteristikat e secilit autor. |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallët maxhore e minore me dy shenja me # (Diezis) dhe b (Bemola) me (një oktave) ngadalë dhe me ritëm mesatar. | **Nxënësi:**<br>- luan Shkallët me tingull të plotë e pa gabime;<br>- luan Shkallët detashe në format stakato e legato;<br>- luan pa gabime arpezhet dhe përmbysjet e tyre;<br>- realizon Shkallët muzikore në të gjitha mënyrat; |
| - Ushtrime dhe etyde<br>- 2 ushtrime në muaj<br>- Julius Weissenborn fl. II<br>- Milde gama | - realizon gjatë lojës aplikaturat; frymëmarrjen, ritmikën e ushtrimit etj.;<br>- respekton dinamikën e ushtrimeve;<br>- realizon frymëmarrjen mbi bazën e logjikës muzikore dhe teknike;<br>- luan etydet me ndjenjë, pastër e pa gabime;<br>- luan tingull me intonacion të pastër; |
| - Program artistik<br>- F. Teleman – melodi<br>- Fash- melodi | - praktikon duetet, në fillim me mësuesin dhe, në fazë të dytë luan me nxënës të tjerë bashkëmoshatarë;<br>- ushtron ritmin e pjesëve dhe më pas, tërësinë e tyre melodike;<br>- respekton dinamikën e pjesëve; |

| | |
|---|---|
| | - punon me mënyra të ndryshme vështirësitë teknike që shfaqen në materialin muzikor;<br>- dallon karakteristikat e autorëve të veçantë. |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallë muzikore<br>- Shkallët maxhore e minore me dy shenja me # (Diezis) dhe b (Bemola) me (një oktavë) ngadalë dhe me ritëm mesatar | **Nxënësi:**<br>- luan Shkallët me tingull të plotë e pa gabime;<br>- luan Shkallët detashe në format stakato e legato;<br>- luan pa gabime arpezhet dhe përmbysjet e tyre;<br>- realizon shkallet muzikore në të gjitha mënyrat; |
| - Ushtrime dhe etyde<br>- 2 ushtrime në muaj<br>- 1 etyd në muaj nga metodat përkatëse<br>- Metodat:<br>- Klosse - metodë<br>- Mule-metodë | - realizon gjatë lojës aplikaturat, frymëmarrjen, ritmikën e ushtrimit etj.;<br>- respekton dinamikën e ushtrimeve;<br>- realizon frymëmarrjen mbi bazën e logjikës muzikore dhe teknike;<br>- luan etydet me ndjenjë, pastër e pa gabime;<br>- luan tingull me intonacion të pastër. |
| - Program artistik<br>- F. Teleman - sonatë<br>- Con Cone -2- duete, me pedagogun<br>- Marcelo - sonatë | - praktikon duetet, në fillim me mësuesin dhe në fazë të dytë luan me nxënës të tjerë bashkëmoshatarë;<br>- ushtron ritmin e pjesëve dhe më pas, tërësinë e tyre melodike;<br>- respekton dinamikën e pjesëve; |

| | |
|---|---|
| | - punon me mënyra të ndryshme vështirësitë teknike që shfaqen në materialin muzikor;<br>- dallon karakteristikat e autorëve të veçantë. |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Për të arritur një nivel sa më të mirë të lojës në instrument, nxënësi duhet edukuar të studiojë në mënyrë sa më sistematike. Në këtë proces, puna e mësuesit duhet të jetë e vazhdueshme, e thelluar dhe e lidhur ngushtë me vëzhgimin psikologjik e emocional të nxënësit, që nga Shkallët e para të formimit, deri në plotësinë e mjaftueshme të tij. Për të pasur rezultate sa më të mira, trajtimi psikoe mocional duhet të shtrihet gjatë gjithë vitit dhe të synojë, në radhë të parë, një administrim sa më të mirë të orës së mësimit. Po ashtu, ndërthurja e kërkesave teknike të lojës në instrument me kërkesat artistike të veprave të veçanta, do t'i jepte orës së mësimit më shumë frymëmarrje dhe do ta bënte atë më të pëlqyeshme për nxënësin.

Është mirë që, në momente të caktuara të realizimit të programit, të planifikohen forma të veçanta të kontrollit të dijeve e të nivelit të nxënësit. Këto do të ishin mbështetje e sigurt për Shkallët e tjera të realizimit dhe do ta ndihmonin nxënësin t'i kuptonte nga afër kërkesat e mëtejshme të mësuesit. Për këtë, edhe kontrolli i materialeve teknike dhe i pjesëve të tjera artistike të programit duhet të përputhet me shkallët e studimit të tyre: ngadalë (ushtrim e kontroll në detaje); pak më shpejt (vërtetim i studimit të saktë të materialit dhe siguri për më tej); më shpejt e, së fundi, trajtim i materialit në tempin e kërkuar nga partitura. Sipas kësaj dinamike, edhe kontrolli i përgjithshëm i dijeve do të ishte një fazë e rëndësishme në formimin e nxënësit dhe do të shërbente për një menaxhim më të mirë të mundësive dhe mangësive të tij për të ardhmen.

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN**

Vlerësimi në saxho bëhet në mënyrë kolegjiale. Për njohjen e drejtpërdrejtë të punës së nxënësit në klasë, mësuesi i lëndës ka të drejtë të ulë ose të ngrejë një notë.

| |
|---|
| Mbi bazën e **2 notave dhe 2 saxho**, vendoset nota semestrale.<br><br>**Niveli MJAFTUESHËM**<br>**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur luan jo korrekt:**<br>- me ritëm,<br>- me tingull mesatar,<br>- me intonacion jo të këndshëm,<br>- me shkallë shpejtësie të ulët e me disa gabime.<br><br>**Niveli MIRË**<br>**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur luan mirë:**<br>- ritmikisht,<br>- me tingull e me intonacion, pastër e me pak gabime.<br><br>**Niveli SHUMË MIRË**<br>**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**<br>- luan shumë mirë në të gjitha elementet e mësipërme.<br><br>**Shënim:** Pjesët mund të zëvendësohen nga ana e mësuesit specialist me pjesë të të njëjtit nivel. |
| **Materiale dhe burime mësimore:**<br><br>Saksofon, Lexhio, Partiturë, Sistem audio-video TIK, Internet. |

**Dega: Muzikë**

**Lënda: Korno (instrument sekondar me zgjedhje)**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Shkallë<br>- Shkalla do maxhore-la minor<br>- Detache një oktavë | **Nxënësi:**<br>- Mëson frymëmarrjen dhe frymënxjerrjen me diafragmën;<br>- njihet me tastierën;<br>- luan në kohën 2/4 dhe 4/4 me tingull të plotë dhe intonacion; |
| - Etyde:<br>- Pascal Proust | - forcon teknika themelore dhe goditjen e notës;<br>- përmirësim i kohëzgjatjes dhe intonacionit; |
| - Vepër shqiptare :<br>- Ninulle | - luan saktë teknikisht;<br>- luan pjesët në karakterin e duhur;<br>- -zhvillon më tej aftësitë interpretative individuale; |
| **Pjesë të Huaja :**<br>- J.Horner e pershtatur "Titanic" | - interpreton frazat të qarta;<br>- luan me tingull të plotë. |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkalla sol maxhore-mi minor | - luan Shkallët saktë teknikisht; |

| | |
|---|---|
| - Legato , Staccato , Detache | - zhvillon tingullin me dinamika;<br>- përdor çelësin ndihmës; |
| - Etyde<br>- Pascal Proust<br>- Davis | - zgjeron gamën dhe fleksibilitetin e tingullit;<br>- përvetëson ornamentet dhe shprehitë muzikore; |
| **Vepër shqiptare**<br>- Ninullë-Patriotike e përshtatur | - luan pastër dhe me intonacion;<br>- luan pjesët në karakterin e tyre; |
| **Pjesë e huaj :**<br>- Melodi të ndryshme të përshtatura për Korno | - unifikon lojën;<br>- realizon saktë dinamikat e kërkuara;<br>- zhvillon aftësinë interpretative. |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallë<br>- Shkalla re maxhore-si minor, Legato , Staccato , Detache ,arpezhe | **Nxënësi:**<br>- përmirëson qëndrueshëm aftësitë teknike;<br>- zhvillon artikulacion të qartë dhe të saktë; |
| - Etyde:<br>- Proust<br>- Davis | - forcon teknika themelore të frymëmarrjes;<br>- përmirëson kohëzgjatjen e frymëmarrjes dhe intonacionit; |
| **Vepër shqiptare :** | - luan saktë teknikisht dhe muzikalisht;<br>- luan pjesët në karakterin e duhur; |



ASCAP

| | |
|---|---|
| - Josif Minga | - zhvillon më tej aftësitë interpretative individuale; |
| **Pjesë të huaja :**<br>- Materiale të thjeshta të përshtatura për Korno dhe piano | - zhvillon shprehitë ekzekutive;<br>- interpreton frazat të qarta;<br>- luan me tingull të plotë;<br>- fokuson në kontrollin e tonit dhe në dinamikën e butë për të arritur një interpretim ekspresiv. |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Për arritjen e një niveli të mirë te nxënësit, mësuesi duhet të bëjë kujdes në zgjedhjen e programit sipas nivelit të nxënësit (duke marrë parasysh problemet teknike dhe përshtatjen e materialit artistik me karakterin e nxënësit).

Duhet të punojë me nxënësin në mënyrë që ai të shpalosë dhe vlerat e tij individuale, në mënyrë që të mos jetë thjesht një kopje e mësuesit. (mbështetur gjithmonë në materialet plotësuese teknike). Nxënësi duhet të jetë në gjendje që të arrijë një performancë sa më të bukur.

Praktikon teknikat e ndryshme të artikulimit si staccato, legato, dhe tenuto. Mësuesi udhëzon nxënësit të eksperimentojnë me intensitetin dhe kohëzgjatjen e artikulimit për të gjetur stilin e tyre të interpretimit.

Inkurajon praktikën e rregullt dhe performancën solo si dhe në ansamble. Performanca është një pjesë kyçe e procesit të mësimit, e cila ndihmon në ndërtimin e vetëbesimit dhe në zhvillimin e aftësive skenike.

Siguron që mësuesi të jepi vlerësime të rregullta dhe kritika konstruktive, duke theksuar si sukseset ashtu edhe zonat për përmirësim. Kjo ndihmon në motivimin e nxënësve dhe në orientimin e tyre drejt përmirësimit të vazhdueshëm.

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN**

**Niveli MJAFTUESHEM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- Demonstron njohuri bazë të teorisë muzikore dhe aftësi teknike në Korno.
- Arrin të luajë shkallen dhe pjesët e caktuara me gabime, dhe temp jo si është në shkruar në part.
- Tregon përpjekje për të përdorur dinamikat dhe artikulacionin, edhe pse nuk është gjithmonë i qartë ose i saktë.
- Përfshin elementë bazë të interpretimit muzikor, por pa thellësi ose ndjenjë të fortë të stilistikës.
- Luan me kapacitet të reduktuar të frymëmarrjes dhe frymënxjerrjes.
- Nuk arrin të artikulojë notat sipas aplikaturave të part.
- Posturën dhe pozicionimin në instrument nuk e ka të rregullt.

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- Demonstron njohuri të mira të teorisë muzikore dhe teknikë të fortë në instrument.
- Luajnë etydet dhe pjesët e caktuara pa vështirësi dhe me numër të kufizuar të gabimeve.
- Përdor dinamikat dhe artikulacionin në mënyrë efektive për të shtuar shprehinë në performancën e tyre.
- Tregon aftësi të mira interpretuese, duke përfshirë ndjenjën e frazimit dhe stilistikës, edhe pse mund të ketë vend për përmirësim.
- Mbështet me diafragmë materialin tekniko-melodik dhe luan me tingull të pastër dhe lirshëm .

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- Tregon njohuri të thella të teorisë muzikore dhe zotëron teknikë të avancuar në instrument.
- Performon etydet dhe veprat e caktuara me precizion të lartë, fluencë dhe pa gabime.

| |
|---|
| - Demonstron përdorim të avancuar të dinamikave dhe artikulacionit, duke i integruar ato në mënyrë që të shtojnë thellësinë dhe dimensionin në muzikë.<br>- Evidenton një nivel të lartë të interpretimit muzikor, duke treguar sensibilitet të thellë ndaj stilistikës, karakterit dhe kontekstit muzikor, si dhe aftësi për të tërhequr dhe mbajtur vëmendjen e dëgjuesit.<br>- Luan programin përmendësh. |
| **Materiale dhe burime mësimore:**<br>Korno, lexhio, partiturë, internet , Intonator etj. |

**Dega: Muzikë**

**Lënda: Trombë (instrument sekondar me zgjedhje)**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - **Shkallë**<br>- Shkallet Do+, Si bemol+ me minoret përkatëse në një oktavë | **Nxënësi:**<br>- realizon në mënyrë të veçantë impostimin (bokaturën);<br>- praktikon frymëmarrjen dhe frymënxjerrjen e rregullt (diafragmën);<br>- përdor lirshëm atakun (goditjen) dhe nxjerrjen e tingullit;<br>- luan shkallët e arpezhet, me ritëm të ngadaltë e mesatar: legato e stakato; |

| | |
|---|---|
| - 2 Ushtrime në muaj:<br>- Kolin- Metoda Fillestare<br>- Veber- Fletorja e parë | - luan saktë aplikaturat;<br>- përvetëson elementet teknike, si: tingullin, goditjen, frymëmarrjen;<br>- respekton aplikaturat dhe dinamikën;<br>- interpreton me kualitet timbrik intonativ;<br>- zhvillon ushtime për diafragmën; |
| - **Vepër shqiptare** :<br>- C. Zadeja<br>- P. Gaci | - respekton të gjitha problemet teknike;<br>- interpreton sa më natyrshëm; |
| - Programi Artistik:<br>- Bach- Minuet<br>- Mendelson- Melodi<br>- Persell- Melodi | - realizon tempet e pjesëve muzikore;<br>- njeh figurat ritmike;<br>- ndërgjegjësohet për realizimin e programit në përputhje me etapat e punës praktike të përcaktuar nga mësuesi;<br>- realizon lojën me ngjyra dhe emocionalitet;<br>- praktikon mësimin e pjesëve përmendësh. |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallë Muzikore<br>- Shkallet Fa+, Mi Bemol+<br>- Me minoret përkatëse në një oktavë | **Nxënësi:**<br>- luan shkallët me tingull të plotë e pa gabime;<br>- luan shkallët detashe në format stakato e legato;<br>- realizon Shkallët muzikore e minore në të gjitha mënyrat; |

| | |
|---|---|
| - 2 Ushtrime në muaj<br>- Voxman- Fletorja I<br>- Rap- Fletorja II | - realizon gjatë lojës aplikaturat, frymëmarrjen, ritmikën e ushtrimit etj.;<br>- respekton dinamikën e ushtrimeve;<br>- realizon frymëmarrjen mbi bazën e logjikës muzikore dhe teknike;<br>- luan ushtrimet me ndjenjë, pastër e pa gabime;<br>- luan tingull me intonacion të pastër; |
| - **Vepër shqiptare**<br>- K. Laro<br>- P. Jakova | - respekton të gjitha problemet teknike;<br>- evidenton të gjitha karakteristikat kryesore dhe ndërtimin e saktë të pjesëve; |
| - Pjesë të Huaja:<br>- Humel- Romancë<br>- Hendel- Minuet<br>- Humel- Romancë | - njeh formën dhe ndërtimin të veprës që luan;<br>- njeh mirë stilin e autorit;<br>- dallon tempet e ndryshme brenda veprës;<br>- luan me rrjedhshmëri në kalimet;<br>- luan me një tingull qartë dhe i përshtatet lojës dinamike të veprës. |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallë Muzikore<br>- të gjitha Shkallët<br>- Maxhore, Minore së bashku me relativet përkatëse në një oktavë<br>- Arpezhet me temp mesatar – të shpejtë | **Nxënësi:**<br>- luan shkallët me tingull të plotë e pa gabime;<br>- luan shkallët detashe në format stakato e legato;<br>- realizon Shkallët muzikore e minore në të gjitha mënyrat; |
| - 2-3 Ushtrime në muaj | - realizon gjatë lojës aplikaturat, frymëmarrjen, ritmikën e ushtrimit etj.; |

| | |
|---|---|
| - Koprash 12 etyde<br>- Perret<br>- Voxman- Fletorja I-II | - respekton dinamikën e ushtrimeve;<br>- realizon frymëmarrjen mbi bazën e logjikës muzikore dhe teknike;<br>- luan ushtrimet me ndjenjë, pastër e pa gabime;<br>- luan tingull me intonacion të pastër; |
| - **Vepër shqiptare**<br>- V. Nova<br>- A. Grimci<br>- P. Gaci | - respekton të gjitha problemet teknike;<br>- evidenton të gjitha karakteristikat kryesore dhe ndërtimin e saktë të pjesëve; |
| - Pjesë të Huaja:<br>- Humel- Romancë<br>- Hendel- Minuet | - njeh formën dhe ndërtimin e veprës që luan;<br>- njeh mirë stilin e autorit;<br>- dallon tempet e ndryshme brenda veprës;<br>- luan me rrjedhshmëri në kalimet;<br>- luan me një tingull qartë dhe i përshtatet lojës dinamike të veprës. |

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN**

Vlerësimi në kontrollet teknike dhe në saxho bëhet në mënyrë kolegjiale. Mësuesi i lëndës, për njohjen e drejtpërdrejtë të punës së nxënësit në klasë, ka të drejtë të ulë ose të rrisë një notë.

**Niveli MJAFTUESHËM**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- luan jo korrekt
- me ritëm,

- me tingull mesatar,
- me intonacion jo të këndshëm.

**Niveli MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- luan *mirë* ritmikisht,
- me tingull e me intonacion, pastër e me pak gabime.

**Niveli SHUMË MIRË**

**Nxënës/i,-ja arrin këtë nivel, kur:**

- luan *shumë mirë* në të gjitha elementet e mësipërme.

*Shënim*. Pjesët mund të zëvendësohen nga ana e mësuesit specialist me pjesë të të njëjtit nivel.

**Materiale dhe burime mësimore:**

Trombë, lexhio, partiturë, internet , Intonator etj.

**Dega: Muzikë**

**Lënda:  Trombon (instrument sekondar me zgjedhje)**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10-12 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Shkallë muzikore<br>- Shkallë deri në 1 shenje # (Dieziz) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar<br>- Shkallët deri në 1 shenje b (Bemol) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar deri në një Oktavë. | **Nxënësi:**<br>- realizon në mënyrë të veçantë impostimin (bokaturën);<br>- praktikon frymëmarrjen dhe frymënxjerrjen e rregullt (diafragmën);<br>- mban trupin drejt dhe përdor lirshëm duart dhe gishtat;<br>- përdor lirshëm atakun (goditjen) dhe nxjerrjen e tingullit;<br>- përvetëson pozicionet në oktavën e parë. |
| - **Ushtrime dhe pjesë për Trombon**<br>- 2 ushtrime në muaj<br>- Metoda - Rubank 1-4 | **Nxënësi:**<br>- luan saktë aplikaturat;<br>- përvetëson elementet teknike, si: tingullin, goditjen, frymëmarrjen;<br>- respekton aplikaturat dhe dinamikën;<br>- interpreton me kualitet timbrik intonativ;<br>- zhvillon ushtrime për diafragmën. |
| **UDHËZIME METODOLOGJIKE:** | |



ASCAP

| |
|---|
| Për arritjen e një niveli të mirë te nxënësit, mësuesi duhet të bëjë kujdes në zgjedhjen e programit sipas nivelit të nxënësit (duke marrë parasysh problemet teknike dhe përshtatjen e materialit artistik me karakterin e nxënësit).<br><br>Duhet të punojë me nxënësin në mënyrë që ai të shpalosë dhe vlerat e tij individuale, në mënyrë që të mos jetë thjesht një kopje e mësuesit. (mbështetur gjithmonë në materialet plotësuese teknike). Nxënësi duhet të jetë në gjendje që të arrijë një performancë sa më të bukur. |
| **UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:**<br><br>Vlerësimi në Saxhot simestrale bëhet në mënyrë kolegjiale. Mësuesi i një nxënësi të caktuar ka të drejtë të rrisë ose ulë një notë atij nxënësi në varësi të avancimit shumë-anësh vjetor në orën e tij të mësimit.<br><br>- Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur luan jo korrekt:<br>- me ritëm,<br>- me tingull mesatar,<br>- me intonacion jo të këndshëm,<br>- me shkallë shpejtësie të ulët e me disa gabime.<br><br>**Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur luan mirë:**<br><br>- ritmikisht,<br>- me tingull e me intonacion,<br>- pastër e me pak gabime.<br>- Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:<br>- luan shumë mirë në të gjitha elementet e mësipërme. |

| **Materiale dhe burime mësimore:** |
|---|
| Trombon, Lexhio, Partiturë, Sistem audio-video TIK, Internet. |

**Dega: Muzikë**

**Lënda: Bastuba (instrument sekondar me zgjedhje)**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - 4 - shkallë muzikore, etyde dhe materiale ndihmëse teknike *legato dhe staccato* | **Nxënësi:**<br>- luan Shkallët dhe me tingull të qartë;<br>- realizon ushtrimet teknike për të përvetësuar teknikën e dhe të legatës;<br>- kryen frymëmarrje të mirë dhe të kontrolluar;<br>- zotëron vendosjen e mirë të bukaturës;<br>- zotëron regjistrin e ulët, të mesëm në një regjistër oktav; |
| - Ushtrime, materiale Teknike<br>- JB Arban-Libri i Parë; Roger Bobo-<br>- Zotërimi i Tubës;<br>- Rruga A-Shkallë & Arpezhet; Walter | - kryen frymëmarrje të mirë dhe të kontrolluar;<br>- zotëron vendosjen e mirë të ambukurës;<br>- zotëron regjistrin e mesit të ulët dhe të mesit të lartë në një regjistër oktavë e gjysmë; |

| | |
|---|---|
| - Hilgres-Rutina e përditshme; David<br>- Uber-Studimet e Hershme; RH Fink-<br>- Studime në Legato | - zhvillon barazinë e zërit dhe timbralit në regjistrin e një oktavë, nëpërmjet ekzekutimit të shkallëve;<br>- luan deri në dy ndryshime në çelësin madhor dhe në modalitetet e tyre përkatëse të vogla - Bb Major/G Minor ose D Major/Bb Minor dhe arpezhet e tyre përkatëse në gjendjen themelore ose deri në përmbysjen e parë;<br>- luan dy Shkallët kromatike të Bb dhe D Major me artikulacione të ndryshme: legatto dhe staccato;<br>- kryen ushtrimet me figurat ritmike në nota gjysmë, çerek dhe nota të 3/8teta me shpejtësi minimale të notave me temp të barabartë me 60/80;<br>- zotëron gishtat e përdorur për të kryer të njëjtat ushtrime ;<br>- përvetëson njohuri dhe teknika që ju lejojnë të përdorni dinamikën e mëposhtme: piano dhe i fortë;<br>- përvetëson një artikulim të qartë dhe të pastër – ushtrimeve ;<br>- luan Shkallët në të gjitha masat e thjeshta: 4/4; 3/4; 2/4; 11;<br>- fiton fleksibilitet të mirë në pjesët harmonike 1, 2, 3 dhe 5; |
| - 2 Bravura<br>- William Presser -Rondo; Gordon Jacob -<br>- Bagatelle për Tuba; Art Dedrick -Zoti Tuba në<br>- Broadway; R. Wagner (arr. George Masso)<br>- Walteŕ Edward Elgar -Dy Këngë | - njeh formën dhe ndërtimin e veprës që luan;<br>- njeh mirë stilin e autorit;<br>- dallon tempet e ndryshme brenda veprës;<br>- luan me rrjedhshmëri në kalimet;<br>- luan me një tingull qartë i cili i përshtatet lojës dinamike të veprës. |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |

| | |
|---|---|
| - 4 shkallë muzikore, etyde dhe materiale ndihmëse teknike , maxhore, minore, me intervale terca dhe quartta | **Nxënësi:**<br>- luan të gjitha materialet ndihmëse në funksion të shkallës së vështirësisë që ka programi;<br>- njeh tri pozicionet e para të kitarës;<br>- pickon qartë mbi tela dhe të ketë rrjedhshmëri në arpezhet;<br>- realizon teknikisht etydet;<br>- luan në ritmet dhe tempet e duhura;<br>- luan me kontrastet dinamike;<br>- kryen frymëmarrje të mirë dhe të kontrolluar;<br>- zotëron regjistrin e mesit të ulët, regjistrin e mesit të lartë në një oktavë e gjysmë dhe, në varësi të shkallës, mund të shkojë deri në dy oktava të plota - A Major/F mprehtë e vogël;<br>- zhvillon barazinë e zërit dhe timbralit në regjistrin e një oktavë, përmes ekzekutimit të shkallëve deri në tri ndryshime në çelësin kryesor dhe në modalitetet e tyre përkatëse të vogla - Eb Major/C Minor ose A Major/F Sharp Minor dhe arpezhet e tyre përkatëse në gjendjen themelore ose deri në përmbysjen e parë; |
| - Etyde<br>- William Bell -Metoda e plotë Tuba e William J. Bell; Giulio Marco | - interpreton stilin e autorit që do të luajë;<br>- performon bukur, në mënyrë koncertale nga ana teknike artistike; |

| | |
|---|---|
| - Bordogni –Studime Bordogni; Sam Pialfian, Patrick Sheridan<br>- Palestrën e frymëmarrjes; Giuseppe Concone – Vëllimi 1;<br>- JB Arban –Metoda e plotë për Tuba;<br>- C. Kopprasch –60 Studime të zgjedhura<br>- Jacob Wesley -Studime me regjistër të ulët;<br>- Gilles Milliére -Ushtrime në dy oktava | |
| - 2 Bravura<br>- Harold Walters -Blow the Man Down;<br>- Michel del Giudice –Abuto; Pierre Seguin –<br>- Tubavardage; Art Dedrick -A Touch of Tuba;<br>- Rodger Vaughan -Concert Piece; Walter<br>- *Skolnik -Valse Caprice.* | - njeh epokat dhe stilet e autorëve që do të luajë;<br>- luan me tingull të lidhur dhe me pak rubato;<br>- performon bukur me të gjitha elementet tekniko-profesionale;<br>- transmeton emocione;<br>- ndjen individualitetin e tij në lojë. |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - 4 shkallë muzikore, etyde dhe materiale ndihmëse teknike, intervalet ( Seconda, Terca, Quarta ecc. ) | **Nxënësi:**<br>- luan të gjitha materialet ndihmëse në funksion të shkallës së vështirësisë që ka programi;<br>- realizon teknikisht etydet;<br>- luan në ritmet dhe tempet e duhura; |

| | |
|---|---|
| | - luan me kontrastet dinamike;<br>- zotëron regjistrin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në një regjistër me dy oktavë;<br>- zhvillon barazinë e zërit dhe timbrit në regjistrin e dy oktavave, nëpërmjet ekzekutimit;<br>- ekzekuton deri në katër dhe pesë ndryshime në tonalitetin madhor dhe modalitetet e tij të vogla përkatëse; E Major/C Sharp Minor ose A B Major/F Minor Sharp; B Major/G Minor i mprehtë dhe Db Major/A Minor i mprehtë dhe arpezhet e tyre përkatëse në gjendjen themelore dhe të gjitha përmbysjet;<br>- përvetëson aftësi në mënyrë që të mund të kryej Shkallët diatonike.<br>- luan dy Shkallët kromatike të E Major, B Major, Ab Major, Db Major me të ndryshme artikulacionet: legatto dhe staccatod dhe me alternim ndërmjet këtyre;<br>- kryen shkallë me figurat ritmike në nota gjysmë, nota çerek, nota të tetëshe dhe nota të gjashtëmbëdhjetë me shpejtësi minimale të notave të barabartë me 78/120;<br>- përvetëson aftësi që lejojnë kryerjen e të njëjtave shkallë me ritme që i përkasin masave të përbëra 6/8, 9/8 dhe 12/8;<br>- zotëron gishtat e përdorur për të kryer Shkallët;<br>- përvetëson një artikulim të qartë dhe të pastër – staccato me elegancë gjatë shkallëve, studimeve dhe pjesëve;<br>- përvetëson aftësi për zhvillimin e kujtesës nëpërmjet interpretimit të fragmenteve të shkurtra muzikore; |

| | |
|---|---|
| - Pjesë , Romanca, Sonata,<br>- JS Bach -Air and Bourrée;<br>- James Hartley - Sonatina (2nd movement); Paul<br>- Holmes -Slow;<br>- Gilles Jaffe -Centone Tuba Concertante; David<br>- Uber -Summer Night; Clare Grundman -Tuba<br>- Rapsody; Benedetto Marcello - Sonata in F; G. Puccini -Nessun Dorma | - njeh epokat dhe stilet e autorëve që do të luajë;<br>- luan me tingull të lidhur dhe me pak rubato;<br>- performon bukur me të gjitha elementet tekniko-profesionale;<br>- transmeton emocione;<br>- ndjen individualitetin e tij në lojë. |

## UDHEZIME METOTOLOGJIKE

Ky program synon të zhvillojë aftësitë muzikore dhe teknike të nxënësve nëpërmjet një qasjeje të strukturuar dhe të progresive në mësimin e muzikës, duke përfshirë përvetësimin e shkallëve muzikore, ushtrimeve teknike, dhe interpretimit të veprave nga kompozitorë të ndryshëm. Programi përqendrohet tek zhvillimi i aftësive teknike në instrument, përmirësimi i artikulimit, ritmit, dhe dinamikave, si dhe njohja dhe interpretimi i stileve të ndryshme muzikore.

**Klasa 10**

- Objektivat e Mësimit: Përqendrimi zgjerohet në teknikën e legato dhe staccato, frymëmarrjen e kontrolluar, dhe zotërimin e regjistrave të ulët dhe të mesëm. Nxënësit do të zhvillojnë aftësinë për të luajtur shkallë me intervale të ndryshme dhe të kryejnë ushtrime me ritme të ndryshme.
- Materialet dhe Burimet: Vazhdon përdorimi i materialeve nga niveli 6 me shtimin e studimeve specifike në legato nga RH Fink dhe të tjerë.
- Vlerësimi: Shtohen kontrollet teknike dhe performancat e saxho-s me kërkesa për interpretim më të ndërlikuar të pjesëve muzikore.

**Klasa 11**

- Objektivat e Mësimit: Nxënësit do të punojnë me shkallë muzikore më të ndërlikuara dhe do të njihen me pozicionet e para të instrumentit. Do të theksohet interpretimi artistik dhe njohja e stileve të ndryshme muzikore.
- Materialet dhe Burimet: Shtohen materialet nga William Bell, Giulio Marco Bordogni, dhe të tjerë për të theksuar punën me regjistrin e ulët dhe fleksibilitetin.
- Vlerësimi: Kontrollet teknike do të mbulojnë një gamë më të gjerë të shkallëve dhe etydeve, si dhe interpretimi i suitëve dhe pjesëve me variacione në saxho.

**Klasa 12**

- Objektivat e Mësimit: Fokusi është në zhvillimin e aftësive për të luajtur me një regjistër të gjerë (deri në dy oktavë), përvetësimin e shkallëve diatonike dhe kromatike, si dhe interpretimin e avancuar të pjesëve muzikore si sonatat dhe romanca.
- Materialet dhe Burimet: Përdoren vepra nga JS Bach, David Uber, Gilles Jaffe, dhe të tjerë për të sfiduar dhe zhvilluar aftësitë interpretuese të nxënësve.
- Vlerësimi: Vlerësimi përfshin performancën e shkallëve të ndërlikuara, etydeve, dhe një program më të gjatë në saxho që përfshin kohë koncerti dhe sonata.

## UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

### 1. Përgatitja e Vlerësimit

- Vlerësimi do të kryhet nga një komision prej të paktën, tri mësuesve, duke përfshirë mësuesin përkatës të nxënësit.
- Të gjitha vlerësimet do të bazohen në performancat e nxënësit gjatë kontrolleve teknike dhe saxho-ve.

### 2. Kriteret e Vlerësimit

| |
| --- |
| - Vlerësimi do të mbulojë aspektet e mëposhtme me peshë specifike për secilin, të cilat do të përcaktohen në mënyrë kolegjiale nga komisioni:<br>- Ritmi (20%): Vlerësohet aftësia e nxënësit për të ruajtur ritmin dhe tempin e pjesës, si dhe për të realizuar ndryshimet ritmike me saktësi.<br>- Artikulimi dhe Intonacioni (20%): Përfshin vlerësimin e qartësisë së lojës artikulimit të notave (pickimit), dhe aftësinë për të luajtur me intonacion të saktë dhe të këndshëm.<br>- Tingulli dhe Dinamika (20%): Vlerëson cilësinë e tingullit të nxënësit, përfshirë ngrohtësinë, përmasat, dhe aftësinë për të manipuluar dinamikat e ndryshme.<br>- Qartësia dhe Saktësia (20%): Fokusohet te aftësia e nxënësit për të luajtur pa gabime, si dhe qartësia e përgjithshme e performancës.<br>- Interpretimi dhe Ndjenja Artistike (20%): Vlerëson aftësinë e nxënësit për të transmetuar ndjenjat dhe për të interpretuar muzikën në mënyrë që të lidhet me audiencën.<br>**3. Nivelet e arritjes**<br>- Mjaftueshëm: Nxënësi përmbush kërkesat minimale në të gjitha aspektet e mësipërme, por ka hapësirë të konsiderueshme për përmirësim.<br>- Mirë: Nxënësi tregon një nivel të kënaqshëm në të gjitha aspektet, duke luajtur me ritëm dhe intonacion të mirë dhe duke bërë pak gabime.<br>- Shumë Mirë: Nxënësi shfaq një nivel të lartë të aftësive në të gjitha aspektet, duke përfshirë interpretim të shquar dhe performancë pa gabime.<br>**4. Procesi i Vlerësimit**<br>- Çdo anëtar i komisionit do të japë një notë për secilin aspekt të performancës bazuar në kriteret e lartpërmendura.<br>- Notat e të gjithë anëtarëve të komisionit për secilin aspekt do të mblidhen dhe përpjesëtohen për të gjetur mesataren.<br>- Vlerësimi përfundimtar i nxënësit do të jetë mesatarja e përgjithshme e të gjitha aspekteve të vlerësuara. |
| **Materiale dhe burime mësimore:** |

| |
|---|
| Bastub, Lexhio, Intonator. |

**Dega: Muzikë**

**Lënda: Fizarmonika (instrument sekondar me zgjedhje)**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Ushtrime për dorën e djathtë, dorën e majtë, me dy duar. Metoda : Kareco, Farfisa, Anzaghi etj. | **Nxënësi:**<br>- njeh instrumentin e fizarmonikës, pjesët përbërëse, historikun;<br>- kupton përftimin e tingullit;<br>- luan me impostim të rregullt;<br>- unifikon duart. |
| - Vepër shqiptare : G.Avrazi, A.Kareco,I. Caca etj.<br>- Vepër variete : Vals, polka, tango etj.<br>- Kompozitorë : Tiersen, Deiro, Frosini, Giraud etj. | **Nxënësi:**<br>- njeh dhe luan veprat shqiptare;<br>- njeh kompozitorët shqiptarë;<br>- realizon saktë shoqërimin me dorën e majtë;<br>- përdor kacekun në mënyrë korrekte |

| | |
|---|---|
| - Gjatë vitit shkollor realizohet vetëm 1 saxho në periudhën e dytë. | - Nxënësi njeh dhe luan:<br>- një (1-) Vepër shqiptare<br>- një (1-) Vepër variete |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Vepër shqiptare :<br>- G.Avrazi, A.Kareco,I. Caca etj. | **Nxënësi:**<br>- kupton karakteristikat e muzikës shqiptare;<br>- unifikon duart;<br>- luan vepra me ritme të përziera etj. |
| - Vepër variete :<br>- Vals, polka, tango etj.<br>- Kompozitorë : Tiersen, Deiro, Frosini, Giraud etj. | **Nxënësi:**<br>- kupton karakteristikat e muzikës variete;<br>- realizon saktë shoqërimin në dorën e majtë;<br>- respekton ritmin, vlerat e notave. |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Vepër shqiptare :<br>- F. Deda, A.Kareco,I. Caca, V.Filaj etj. | **Nxënësi:**<br>- unifikon duart;<br>- luan me tingull të plotë;<br>- luan me fraza të qarta. |

| | |
|---|---|
| - Vepër variete : Tango, Vals, Polka, Rumba etj.<br>- Kompozitorë : Tiersen, , Frosini, Giraud etj. | **Nxënësi:**<br>- realizon saktë dinamikat;<br>- përdor kacekun në mënyrën korrekte;<br>- luan me artikulim të duhur. |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE:**

- Për arritjen e një niveli të mirë të nxënësit, mësuesi duhet të bëjë kujdes në zgjedhjen e programit sipas nivelit të nxënësit dhe ecurisë së tij.(duke marrë parasysh problemet teknike dhe përshtatjen e materialit artistik me karakterin e nxënësit).
- Duhet të punojë me nxënësin në mënyrë që ai të shpalosë dhe vlerat e tij individuale e të mos jetë thjesht një kopje e mësuesit (mbështetur gjithmonë në materialet plotësuese teknike).Nxënësi duhet të jetë në gjendje që të arrijë një performancë sa më të bukur.
- Për fillimin e mësimit të instrumentit mund të përdoren metoda si : Farfisa, Kareco, Anzaghi etj.

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:**

Vlerësimi në saxho bëhet me komision të përbërë nga mësuesit e instrumentit të fizarmonikës.(me jo më pak se 3 veta)

**Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur interpreton :**

- me ritëm jo korrekt;
- me tingull të dobët;
- me shkallë shpejtësie të ulët;
- nuk respekton partiturën;
- lojë jo të unifikuar mirë;

- impostim problematik.

**Nxënësi arrin nivelin mesatar kur:**

- luan mirë teknikisht dhe muzikalisht;
- frazim të rregullt;
- tingull të plotë;
- unifikim të duarve;
- impostim korrekt;
- artikulim mesatar.

**Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:**

- realizon programin me të gjitha elementet teknike dhe interpretative të një niveli të lartë.

**Materiale dhe burime mësimore:**

Fizarmonikë, partitura, lexhio, metronom, internet etj.

**Dega: Muzikë**

**Lënda:  Klarinetë (instrument sekondar me zgjedhje)**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10-11-12 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Shkallë muzikore<br>- Shkallë deri në 1 shenje # (Dieziz) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar<br>- Shkallët deri në 1 shenje b (Bemol) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar deri në një Oktavë | **Nxënësi:**<br>- realizon në mënyrë të veçantë impostimin (bokaturën);<br>- praktikon frymëmarrjen dhe frymënxjerrjen e rregullt (diafragmën);<br>- mban trupin drejt dhe përdor lirshëm duart dhe gishtat;<br>- përdor lirshëm atakun (goditjen) dhe nxjerrjen e tingullit;<br>- përvetëson pozicionet në oktavën e parë. |
| - Ushtrime dhe pjesë për klarinetë<br>- 2 ushtrime në muaj<br>- Metoda - Miller | **Nxënësi:**<br>- luan saktë aplikaturat;<br>- përvetëson elementet teknike, si: tingullin, goditjen, frymëmarrjen;<br>- respekton aplikaturat dhe dinamikën;<br>- interpreton me kualitet timbrik intonativ;<br>- zhvillon ushtime për diafragmën. |
| **UDHËZIME METODOLOGJIKE:** | |

- Për arritjen e një niveli të mirë te nxënësit, mësuesi duhet të bëjë kujdes në zgjedhjen e programit sipas nivelit të nxënësit (duke marrë parasysh problemet teknike dhe përshtatjen e materialit artistik me karakterin e nxënësit).
- Duhet të punojë me nxënësin në mënyrë që ai të shpalosë dhe vlerat e tij individuale, në mënyrë që të mos jetë thjesht një kopje e mësuesit. (mbështetur gjithmonë në materialet plotësuese teknike). Nxënësi duhet të jetë në gjendje që të arrijë një performancë sa më të bukur.

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:**

- Vlerësimi në Saxhot semestrale bëhet në mënyrë kolegjiale. Mësuesi i një nxënësi të caktuar ka të drejtë të rrisë ose ulë një notë atij nxënësi në varësi të avancimit shumë-anësh vjetor në orën e tij të mësimit.

**Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur luan jo korrekt:**

- me ritëm,
- me tingull mesatar,
- me intonacion jo të këndshëm,
- me shkallë shpejtësie të ulët e
- me disa gabime.

**Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur luan mirë:**

- ritmikisht,
- me tingull e me intonacion,
- pastër e me pak gabime.

**Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:**

- luan shumë mirë në të gjitha elementet e mësipërme.

| **Materiale dhe burime mësimore:** |
|---|
| Klarinetë, Lexhio, Partiturë, Stol këmbe, Sistem audio-video TIK, Internet. |

**Dega: Muzikë**

**Lënda: Perkusion (instrument sekondar me zgjedhje)**

**Klasa: 10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - VIC FIRTH - SNARE DRUM METHOD - Book I - Elementary<br>- L.Stone-Stick controll for snare drummer<br>- Peters-Elementary snare drum studies<br>- Single stroke, double stroke dhe paradiddle duke përdorur dinamikat f , mf, p | **Nxënësi:**<br>- vendosja e saktë e shkopinjve, duarve dhe qëndrimi në instrument;<br>- zhvillimi i koordinimit të duarve dhe këmbëve; mbajtja e trupit të relaksuar;<br>- studimi i teknikës së instrumentit nëpërmjet njohjes dhe zbatimit të "Rudiments" (International Rudiments) me ushtrime progresive ;<br>- goditjet teke, goditjet e dyfishta, thekset dhe Acakature në goditjet teke, të dyfishta dhe paradidlle. |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |



ASCAP

| | |
|---|---|
| - VIC FIRTH - SNARE DRUM METHOD - Book I – Elementary<br>- L.Stone-Stick controll for snare drummer<br>- Drum Kit - Level 1 (Beginner)<br>- Si të luash në drum set pjesën "Sweet" në stilin rock (play a long) | **Nxënësi:**<br>- Ushtrohet me FIRTH - SNARE DRUM METHOD - Book I – Elementary.<br>- zhvillimi i koordinimit të duarve dhe këmbëve, mbajtja e trupit të relaksuar;<br>- kontrolli i rikthimit të shkopit (ribound control);<br>- koordinimi dhe pavarësia e duarve dhe këmbëve;<br>- studimi i kohëve të thjeshta. |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - VIC FIRTH - SNARE DRUM METHOD - Book I - Elementary<br>- L.Stone-Mallet control;<br>- Goldemberg-Modern school for xilofono, marimba, vibrafono<br>- Drum Kit - Level 1 (Beginner);<br>- Si të luash në Drum set pjesën "Do it now" në stilin slow shuffle (play a long) | **Nxënësi:**<br>- ushtrohet meVIC FIRTH - SNARE DRUM METHOD - Book I - Elementary;<br>- zhvillimi i koordinimit të duarve dhe këmbëve;<br>- teknika bazë në marimba, ksilofon ose vibrafon dhe njohja me notat e tastierës së instrumentit;<br>- ushtrohet me 40 Essential Rudimens (40 Teknika thelbësore);<br>- koordinimi i duarve dhe këmbëve në Drum Set;<br>- luan në Marimba apo Vibrafon me dinamika, rul, legato dhe staccato. |
| **UDHËZIME METODOLOGJIKE** | |

| |
|---|
| Duke shpjeguar qartë dhe saktë të gjithë hapat që duhen për arritjen e një niveli të caktuar, pra të kërkesave metodike, shpesh duhen përdorur metoda të ndryshme demonstrimi nga mësuesi, pasi nxënësit kanë arritur një zhvillim të dukshëm psikomotor dhe impostimi natyral mbi instrumentet perkusive. |
| **UDHËZIME PËR VLERËSIMIN**<br><br>Vlerësimi në saxhiot semestrale bëhet në mënyrë kolegjiale, por mësuesi ka të drejtë të rrisë ose të ulë një notë, nxënësit sepse bën punë individuale gjatë orës së mësimit. |
| **Materiale dhe burime mësimore:**<br><br>Partitura, sistem audio-video, TIK. |

**Dega: Muzikë**

**Lënda: Harpë (instrument sekondar me zgjedhje)**

**Klasa:10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Ushtrime me dorën e majtë.<br>- Ushtrime me dorën e djathtë.<br>- Tri ushtrime me dy duar.<br>- **Metoda:** Grossi Method book – Ricordi<br>- 3 pjesë për tu zgjedhur nga titujt e mëposhtëm<br>- Old Tunes for Neë Harpists (Dilling, M.) T. Presser.<br>- 30 Little Classics (Dilling, M.) T. Presser.<br>- Suzuki Harp Vol. 1 (Suzuki, S.) Alfred Publishing.<br>- First Grade Pieces for the Harp: pt. 1 (Grandjany, M. - Ëeidensaul, J.) Fischer.<br>- Fun From the First Vol. 1 (Milligan, S.) Lyon and Healy.<br>- Lovely Levers Vol. 1: pt. 1 (Reit, A.) Grey Lake. etj | **Nxënësi:**<br>- njihet me telat e instrumentit;<br>- kupton lirshmërinë e krahëve;<br>- mëson pozicionet e duarve në harpë;<br>- luan pastër me duar veç<br>- luan pastër veprën;<br>- luan saktë lojën në dy zëra.<br>- organizon një mendim muzikor të rrjedhshëm.<br>- luan pastër ritmet e thyera;<br>- punon me kujdes për impostim të saktë të materialit. |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Ushtrime me dorën e majtë.<br>- Ushtrime me dorën e djathtë. | **Nxënësi:** |



ASCAP

| | |
|---|---|
| - Tri ushtrime me dy duar.<br>- **Metoda:** Grossi Method book – Ricordi<br>- 3 pjesë për tu zgjedhur nga titujt e mëposhtëm<br>- Old Tunes for Neë Harpists (Dilling, M.) T. Presser.<br>- 30 Little Classics (Dilling, M.) T. Presser.<br>- Suzuki Harp Vol. 1 (Suzuki, S.) Alfred Publishing.<br>- First Grade Pieces for the Harp: pt. 1 (Grandjany, M. - Ëeidensaul, J.) Fischer.<br>- Fun From the First Vol. 1 (Milligan, S.) Lyon and Healy.<br>- Lovely Levers Vol. 1: pt. 1 (Reit, A.) Grey Lake. et | - njihet me telat e instrumentit;<br>- kupton lirshmërinë e krahëve;<br>- mëson pozicionet e duarve në harpë;<br>- luan pastër me duar veç.<br>- luan pastër veprën;<br>- luan saktë lojën në dy zëra.<br>- organizon një mendim muzikor të rrjedhshëm.<br>- luan pastër ritmet e thyera;<br>- punon me kujdes për impostim të saktë të materialit. |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - 2 shkallë<br>- Shkallë + (maxhor). (DO+, Sol+ Re+ Fa+ Sib+ etj) duar bashkë 1-2 oktavë<br>- Shkalla - (minor). (LA- Re- Mi- etj)<br>- Etyde – të marra nga metodat<br>- Pjesë nga autorë të huaj:<br>- Trois Pieces Faciles (Grandjany, M.) Marks.<br>- Angelus (Renie, H. - Grandjany, M.) Marks. | **Nxënësi:**<br>- unifikon duart gjatë luajtjes;<br>- luan në temp real dhe të njëjtë për të gjitha ushtrimet.<br>- luan pastër veprën;<br>- luan saktë lojën në dy zëra;<br>- realizon tingëllimet, duke njohur karakteristikat e veprës dhe të stilit barok.<br>- lexon saktë dhe pastër partiturën;<br>- punon për frazim dhe për qartësi e vazhdimësi të mendimit muzikor. |

| | |
|---|---|
| - Ground in F (Purcell, H. - Thompson) Barclay & Barclay.<br>- Chaconne in C (Handel, G. - Loye) Lemoine.<br>- Air Varie (Handel, G. - Milligan, S.) Lyon and Healy<br>- Lovely Levers Vol. II (Reit, A.) Grey Lake<br>- The Magic Road: pt. 2(Gustavson, N.)<br>- Solos: (Pedal Harp)<br>- Solfeggietto (Bach, C.P.E.)<br>- Tëo French Folk Songs (Grandjany, M.) Durand<br>- Le Bon Petit Roi D'Yvetot (Grandjany, M.) Durand<br>- Siciliana (Respighi,O.)<br>- Pavane et Bransles (Francisque, A.)<br>- Epices (Andres,B.) Durand etj | - luan pastër ritmet e thyera;<br>- punon me kujdes për impostim të drejtë të materialit. |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

- Nxënësit në këtë fillim të një instrumenti të ri, duhet të fitoj të njëjtat elemente primare që ka mesuar dhe gjatë studimit të instrumentit të tij primarë, gjatë ciklit fillor. Nxënësi duhet të ketë fituar mjaft elemente primare të shkollimit, si i sensit te punes se detajuar, nga detyrat qe merr nga mesuesi, menyren e studimit.
- Nxënësit duhet të marrin bazat e një impostimi të saktë dhe të lirshëm të duarve, dhe të realizoj këto kërkesa gjatë studimit.
- Nxënësi duhet të rradhisë studimin me>ushtrime ditore të gishtave, >Shkallët me gjithë kompleksitetin e kërkesave si dhe kërkesat që kanë ushtrimet dhe pjesët në drejtim të realizimit total.

| |
|---|
| - Mësuesi mbetet shumë i rëndësishëm, pasi duhet të shpjegojë me kritere të drejta dhe vendosjen në tonalitete të ndryshme me anë të përdorimit të pedaleve të Harpës.<br>- Në procesin mësimorë, mësuesi duhet të kerkojë një tingull më të ngjeshur e më të plotë, gjithashtu të kërkojë një tingull me ekspresivitet.<br>- Tani duhet të synojmë që nxënësi të realizoj tipe të ndryshme ushtrimesh, si dhe teknika të ndryshme gjatë lojës si legatura, frazime, axhilitete etj.<br>- Në saj të zhvillimit tekniko-muzikor, nxënësi duhet të jetë më i përgjegjshëm për lojën që bën, më i lidhur me studimin, duhet aktivizuar në jetën koncertale si dhe duhet të dëgjojnë njëri-tjetrin.<br>- Tani repertori ne teresi duhet te luhet akoma me kerkesat e një tingulli me te plote, me nje agjilitet gishtash me kerkese te avancuar tekniko-muzikale.<br>- Nxenesi duhet te fitoje patjeter levizshmeri normale dhe te lirshme në tela, disa lloje legaturash, tingull te shendoshë, gjithashtu dhe rritja e cilesisë së tingullit në ushtrimet më të komplikuara<br>- Nxenesi duhet të luajë një program të pltë, duke filluar që nga Shkallët në tërësi dhe të përforcojë cilësisht ushtrimet gjatë kontrolleve të njëpasnjëshme.<br>- Mësuesi jo me të gjithë ka të njëjtin rezultat.<br>- Kjo e ka bazën tek brumi i nxënësve, tek vecoritë e përgjithshme të tij. |
| **UDHËZIME PËR VLERËSIMIN::**<br><br>**Nxënësi/ja është i nivelit MJAFTUESHEM**<br><br>- Kur nuk luan korrekt.<br>- Kur luan pa ritëm<br>- Kur luan me tingull mesatar. |

- Kur luan me intonacion jo të këndshëm.
- Kur luan me shkallë shpejtësie të ulët.
- Kur nuk luan përmendesh.

**Nxënësi/ja është i nivelit MESATAR**

- Njeh mirë pozicionet e duarve dhe luan relativisht saktë.
- Luan me një tingull të gjerë e të plotë.
- Përvetëson mësimet mbi pedalet e harpës.
- Realizon një lojë me vetkontroll.
- Realizon axhilitetin gjatë lojës.
- Kur luan me fraza, lirshëm dhe me organizime të pjesshme.

**Nxënësi/ja është i nivelit të LARTE:**

- Kur konsolidon elementet kryesore.
- Kur përvetëson vështirësitë teknike të instrumentit.
- Kur zotëron në një shkallë më të lartë Koordiminin e duarve gjatë lojës.
- Kur realizohen kerkesat e avncuara tekniko-muzikore dhe ka një shkathtësi gjatë përdorimit të pedaleve.
- Kur ka përgjegjësinë e një tingulli më të plotë dhe cilësor.
- Kur ka përmirësim akoma më të mirë në pozicionet dhe axhilitetit të duarve.
- Kur përgatitet plotësisht me bagazhin dhe formimin qe i duhet.
- Kur reflektohet efekshmëria muzikale gjatë interpretimit, nëpërmjet ekspresivitetit, kontrasteve dhe shpërthimeve emocionale.
- Kur përballet me volum shumë të mirë pune.

| |
|---|
| - Kur bëhet lojë e qartë, me tingull të plotë, dhe saktësi melodike dhe ritmike. |
| **Materiale dhe burime mësimore:**<br><br>Harpë, lexhio, partiturë, internet etj. |

**Dega: Muzikë**

**Lënda: Instrument Popullor (Fyell) (instrument sekondar me zgjedhje)**

**Klasa:10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Shkallë muzikore<br>- Shkallë deri në 1 shenje # (Dieziz) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar.<br>- Shkallët deri në 1 shenje b (Bemol) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar deri në një Oktavë. | **Nxënësi:**<br><br>- Realizon në mënyrë të veçantë impostimin (bokaturën).<br>- Praktikon frymëmarrjen dhe frymë n xjerrjen e rregullt (diafragmën).<br>- Mban trupin drejt dhe përdor lirshëm duart dhe gishtat.<br>- Përdor lirshëm atakun (goditjen) dhe nxjerrjen e tingullit.<br>- Përvetëson pozicionet në oktavën e parë.<br>- Luan ushtrime gishtash. |
| - Ushtrime<br>- 2 ushtrime në muaj | - luan saktë aplikaturat;<br>- përvetëson elementet teknike, si: tingullin, goditjen, frymëmarrjen; |

| | |
|---|---|
| - Metoda E. Prill.<br>- E. Kohler (fillestarë)<br>- Pjese Shqiptare | - respekton aplikaturat dhe dinamikën;<br>- interpeton me kualitet timbrik intonativ;<br>- zhvillon ushtime për diafragmën; |
| - Programi Artistik<br>- 1 duet për fyell<br>- Melodi me Fyell.<br>- Fyell Gramshi tradicional<br>- Pjese per fyell<br>- Melodi Cifteli dhe Fyell (Instrumentale)<br>- Melody me fyell dhe violinë<br>- Melodi per fyell nga autore te huaj | - luan duete në klasë së bashku me mësuesen ose me shokët e klasës;<br>- përvetëson pjesët në klasë, nga ana ritmike, dhe kohë pas kohe nga ana e lojës melodike dhe interpretative;<br>- punon me prioritet dhe mënyra të ndryshme vështirësitë që shfaqen në materialin artistik;<br>- realizon elementet e para të interpretimit artistik, duke zbuluar karakteristikat e secilit autor;<br>- realizon lojën me ngjyra dhe emocionalitet. |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallë muzikore<br>- Shkallë deri në 2 shenja # (Dieziz) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar.<br>- Shkallët deri në 2 shenja b (Bemol) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar deri në një Oktavë. | - Nxënësi/ja:<br>- realizon në mënyrë të veçantë impostimin (bokaturën);<br>- praktikon frymëmarrjen dhe frymë n xjerrjen e rregullt (diafragmën);<br>- mban trupin drejt dhe përdor lirshëm duart dhe gishtat;<br>- përdor lirshëm atakun (goditjen) dhe nxjerrjen e tingullit;<br>- përvetëson pozicionet në okatavën e parë.<br>- luan ushtrime gishtash; |
| - Ushtrime | - luan saktë aplikaturat; |

| | |
|---|---|
| - 2 ushtrime në muaj<br>- Ushtrime melodike nga metoda A.C Petersen<br>- Pjese Shqiptare.<br>- Melodi Andres Teir | - përvetëson elementet teknike, si: tingullin, goditjen, frymëmarrjen;<br>- respekton aplikaturat dhe dinamikën;<br>- interpeton me kualitet timbrik intonativ;<br>- - zhvillon ushtime për diafragmën. |
| - Programi Artistik<br>- Pjese muzikore tradicionale<br>- Melodi Cifteli dhe Fyell (Instrumentale)<br>- Melodi baritore me fyell , nga jugu<br>- Melodi te vjetra me fyell - Dibër.<br>- Muzike baroke dhe klasike | - luan duetet në klasë së bashku me mësuesen ose me shokët e klasës;<br>- përvetëson pjesët në klasë, nga ana ritmike, dhe kohë pas kohe nga ana e lojës melodike dhe interpretative;<br>- punon me prioritet dhe mënyra të ndryshme vështirësitë që shfaqen në materialin artistik;<br>- realizon elementet e para të interpretimit artistik, duke zbuluar karakteristikat e secilit autor;<br>- realizon lojën me ngjyra dhe emocionalitet. |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Shkallë deri në 3 shenja # (Dieziz) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar.<br>- Shkallët deri në 3 shenja b (Bemol) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar deri në një Oktavë. | **Nxënësi:**<br>- realizon në mënyrë të veçantë impostimin (bokaturën);<br>- praktikon frymëmarrjen dhe frymë n xjerrjen e rregullt (diafragmën);<br>- mban trupin drejt dhe përdor lirshëm duart dhe gishtat;<br>- përdor lirshëm atakun (goditjen) dhe nxjerrjen e tingullit;<br>- përvetëson pozicionet në oktavën e parë.<br>- luan ushtrime gishtash. |

| | |
|---|---|
| - Ushtrime<br>- 2 ushtrime në muaj<br>- Ushtrime melodike nga A.Peterson<br>- Melodi Hans Bodenman<br>- Wastall.<br>- Pjese Shqiptare | - luan saktë aplikaturat;<br>- përvetëson elementet teknike, si: tingullin, goditjen, frymëmarrjen;<br>- respekton aplikaturat dhe dinamikën;<br>- interpeton me kualitet timbrik intonativ;<br>- zhvillon ushtime për diafragmën. |
| - Programi Artistik<br>- Pjese nga C.M Bellman<br>- Melodi Fransk Visa<br>- Melodi Hans Bodenman<br>- Melodi baritore me fyell , nga jugu<br>- Melodi te vjetra me fyell - Diber.<br>- Muzike baroke dhe klasike<br>- Melodi Mozart | - luan duetet në klasë së bashku me mësuesen ose me shokët e klasës;<br>- përvetëson pjesët në klasë, nga ana ritmike, dhe kohë pas kohe nga ana e lojës melodike dhe interpretative;<br>- punon me prioritet dhe mënyra të ndryshme vështirësitë që shfaqen në materialin artistik;<br>- realizon elementet e para të interpretimit artistik, duke zbuluar karakteristikat e secilit autor.<br>- -realizon lojën me ngjyra dhe emocionalitet. |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Për të arritur një nivel sa më të mirë të lojës në instrument e fyellit, nxënësi duhet edukuar të studiojë në mënyrë sa më sistematike. Në këtë proces, puna e mësuesit duhet të jetë e vazhdueshme, e thelluar dhe e lidhur ngushtë me vëzhgimin psikologjik e emocional të nxënësit, që nga Shkallët e para të formimit, deri në plotësinë e mjaftueshme të tij. Për të pasur rezultate sa më të mira, trajtimi psiko emocional duhet të shtrihet gjatë gjithë vitit dhe të synojë, në radhë të parë, një administrim sa më të mirë të orës së mësimit. Po ashtu, ndërthurja e kërkesave teknike të

lojës në instrument me kërkesat artistike të veprave të veçanta, do t'i jepte orës së mësimit më shumë frymëmarrje dhe do ta bënte atë më të pëlqyeshme për nxënësin.

Është mirë që, në momente të caktuara të realizimit të programit, të planifikohen forma të veçanta të kontrollit të dijeve e të nivelit të nxënësit. Këto do të ishin mbështetje e sigurt për Shkallët e tjera të realizimit dhe do ta ndihmonin nxënësin t'i kuptonte nga afër kërkesat e mëtejshme të mësuesit. Për këtë, edhe kontrolli i materialeve teknike dhe i pjesëve të tjera artistike të programit duhet të përputhet me shkallët e studimit të tyre: ngadalë (ushtrim e kontroll në detaje); pak më shpejt (vërtetim i studimit të saktë të materialit dhe siguri për më tej); më shpejt e, së fundi, trajtim i materialit në tempin e kërkuar nga partitura. Sipas kësaj dinamike, edhe kontrolli i përgjithshëm i dijeve do të ishte një fazë e rëndësishme në formimin e nxënësit dhe do të shërbente për një menaxhim më të mirë të mundësive dhe mangësive të tij për të ardhmen

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:**

- Vlerësimi në saxho bëhet në mënyrë kolegjiale. Për njohjen e drejtpërdrejtë të punës së nxënësit në klasë, mësuesi i lëndës ka të drejtë të ulë ose të ngrejë një notë.
- Mbi bazën e 2 notave dhe 2 saxho, vendoset nota semestrale.

**Nxënës/i,-ja arrin nivelin e ulët, kur luan jo korrekt:**

- me ritëm,
- me tingull mesatar,
- me intonacion jo të këndshëm,
- me shkallë shpejtësie të ulët e me disa gabime.

**Nxënës/i,-ja arrin nivelin mesatar, kur luan mirë:**

- ritmikisht,

| |
|---|
| - me tingull e me intonacion, pastër e me pak gabime.<br><br>**Nxënës/i, -ja arrin nivelin e lartë, kur:**<br><br>- luan shumë mirë në të gjitha elementet e mësipërme.<br><br>Shënim: Pjesët mund të zëvendësohen nga ana e mësuesit specialist me pjesë të të njëjtit nivel. |
| **Materiale dhe burime mësimore:**<br><br>Fyell, Çifteli, Violine, Lexhio, Partiturë, Sistem audio- video TIK, Internet. |

**Dega: Muzikë**

**Lënda: Instrument Popullor(Çifteli) (instrument sekondar me zgjedhje)**

**Klasa:10-11-12**

| Tematikat klasa 10 | Rezultatet e të nxënit |
|---|---|
| - Njohuri mbi instrumentin popullor<br>- Mënyrat e akordimit<br>- Pozicionet e duarve (impostimi)<br>- Ushtrime kromatike ne 8 pozicione | **Nxënësi:**<br>- realizon në mënyrë të veçantë impostimin;<br>- mban trupin drejt dhe përdor lirshëm duart dhe gishtat;<br>- përdor lirshëm pulsin e dorës së djathtë dhe nxjerrjen e tingullit;<br>- përvetëson pozicionet ne tastierën e instrumentit; |

| | |
|---|---|
| - Shkallët me ritëm të ngadaltë dhe .mesatar deri në pozicionet e lartme.<br>- Ushtrime<br>- ushtrime<br>- Metode për fillestare<br>- Pjese Shqiptare<br>- Metode për fillestare<br>- Pjese Shqiptare | - luan ushtrime gishtash;<br>- luan saktë;<br>- përvetëson elementet teknike, si: tingullin dhe vlerat e notave;<br>- respekton saktësisht ritmet e thyera. |
| - Valle e Valbonës<br>- Valle e Kosovës<br>- Valle me motive Matjane | **Nxënësi:**<br>- interpeton me kualitet timbrik intonativ;<br>- zhvillon ushtime për shkathtësinë e duarve;<br>- realizon kalimet e ndryshme të intervaleve;<br>- realizon kalimet e shpeshta të intervaleve të sekondës duke bërë të mundur një lojë shumë të saktë dhe të bukur. |
| **Tematikat klasa 11** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Ushtrime kromatike në 8 pozicione<br>- Shkallët me ritëm të ngadaltë dhe mesatar deri në pozicionet e lartme.<br>- Ushtrime<br>- ushtrime | **Nxënësi:**<br>- ka impostim të mirë të duarve;<br>- realizon teknikisht Shkallët maxhore dhe minore;<br>- realizon teknikisht etydet; |

| | |
|---|---|
| - Metodë për fillestare | - luan në tempin e duhur;<br>- luan figurat ritmike;<br>- luan me tingull të lidhur; |
| - Valle e Rugovës<br>- Valle me motive të Pukës<br>- Potpuri këngësh Mirditore<br>- Këngë Matjane<br>- Këngë Dibrane | - luan në tempin dhe stilin e duhur;<br>- kupton gjatë luajtjes në instrument vazhdimësinë dhe rrjedhshmërinë e tingullit;<br>- luan ushtrime gishtash për pasazhet e vështira;<br>- demostrohet nga mësuesi pjesë, së bashku me nxënësin duke realizuar elemetet zbukurues;<br>- realizohen figura ritmike 7/8, 5-7/8;<br>- demostron figurat ritmike të përbëra . |
| **Tematikat klasa 12** | **Rezultatet e të nxënit** |
| - Ushtrime kromatike në 8 pozicione<br>- Shkallët me ritëm të ngadaltë dhe mesatar deri në pozicionet e lartme.<br>- Ushtrime<br>- ushtrime në muaj<br>- Metodë për fillestare | **Nxënësi:**<br>- realizon në mënyrë të veçantë impostimin;<br>- mban trupin drejt dhe përdor lirshëm duart dhe gishtat;<br>- përdor lirshëm pulsin e dorës së djathtë dhe nxjerrjen e tingullit;<br>- përvetëson pozicionet në tastierën e instrumentit;<br>- luan ushtrime gishtash. |
| - Valle e Valbonës<br>- Valle e Kosovës | **Nxënësi:** |



ASCAP

| | |
|---|---|
| - Valle me motive Matjane<br>- Valle e Rugovës<br>- Valle me motive të Pukës<br>- Potpuri këngësh Mirditore<br>- Këngë Matjane<br>- Këngë Dibrane<br>- | - realizon kalimet e ndryshme të intervaleve;<br>- realizon kalimet e shpeshta të intervaleve të sekondës duke bërë<br>- të mundur një lojë shumë të saktë dhe të bukur.<br>- demonstrohet nga mësuesi pjesë së bashku me nxënësin duke realizuar elementët zbukurues.<br>- realizohen figura ritmike 7/8, 5-7/8;<br>- demonstron figurat ritmike të përbëra . |

**UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Për të arritur një nivel sa më të mirë të lojës në instrument e çiftelisë, nxënësi duhet edukuar të studiojë në mënyrë sa më sistematike. Në këtë proces, puna e mësuesit duhet të jetë e vazhdueshme, e thelluar dhe e lidhur ngushtë me vëzhgimin psikologjik e emocional të nxënësit, që nga shkallët e para të formimit, deri në plotësinë e mjaftueshme të tij. Për të pasur rezultate sa më të mira, trajtimi psiko emocional duhet të shtrihet gjatë gjithë vitit dhe të synojë, në radhë të parë, një administrim sa më të mirë të orës së mësimit. Po ashtu, ndërthurja e kërkesave teknike të lojës në instrument me kërkesat artistike të veprave të veçanta, do t'i jepte orës së mësimit më shumë frymëmarrje dhe do ta bënte atë më të pëlqyeshme për nxënësin.

Është mirë që, në momente të caktuara të realizimit të programit, të planifikohen forma të veçanta të kontrollit të dijeve e të nivelit të nxënësit. Këto do të ishin mbështetje e sigurt për shkallët e tjera të realizimit dhe do ta ndihmonin nxënësin t'i kuptonte nga afër kërkesat e mëtejshme të mësuesit. Për këtë, edhe kontrolli i materialeve teknike dhe i pjesëve të tjera artistike të programit duhet të përputhet me shkallët e studimit të tyre: ngadalë (ushtrim e kontroll në detaje); pak më shpejt (vërtetim i studimit të saktë të materialit dhe siguri për më tej); më shpejt e, së fundi, trajtim i materialit në tempin e kërkuar nga partitura. Sipas kësaj dinamike, edhe kontrolli i përgjithshëm i dijeve do të ishte një fazë e rëndësishme në formimin e nxënësit dhe do të shërbente për një menaxhim më të mirë të mundësive dhe mangësive të tij për të ardhmen.

**Në përfundim Nxënësi:**

- Zotëron instrumentin e çiftelisë si instrument te dyte.
- Koncepton tërësinë e instrumentit, duke u njohur fillimisht me pjesën përbërëse të tij, si: trupi, tastiera dhe pastaj lidhjen unike të tyre.
- Merr një impostim të rregullt, duke qenë veçanërisht i vëmendshëm në lirshmërinë e tingullit, mbajtjen lirshëm të instrumentit, lirshmërinë e krahëve e të gishtave, si edhe përdorimin e pulsit.
- Fiton njohuri të mira për regjistrat e instrumentit dhe pozicionet bazë të tij.
- Përvetëson elementet teknike dhe artistike të lojës në instrument.
- Interpreton pjesët muzikore në tempet reale duke zhvilluar aftësitë krijues të tij brenda kërkesave teknike artistike.
- Zotëron dinamikën (pp, p, mf, f e ff etj.), duke e bërë atë funksionale në të gjitha lidhjet e mundshme të ritmit, tempit, koloristikës etj.
- Luan në instrument intonacion të saktë, duke u përpjekur të shmangë tingujt e përciptë dhe rrëshqitjet aksidentale të intonacionit.
- Luan në dy ose tre instrumente.

**UDHËZIME PËR VLERËSIMIN:**

- Vlerësimi në Saxhot simestrale bëhet në mënyrë kolegjiale. Mësuesi i një nxënësi të caktuar ka të drejtë të ngre ose ulë një notë atij nxënësi në varësi të avancimit shumë-anësh vjetor në orën e tij të mësimit.
- Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur luan jo korrekt:
- me ritëm,
- me tingull mesatar,
- me intonacion jo të këndshëm,
- me shkallë shpejtësie të ulët e
- me disa gabime.

| |
|---|
| - Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur luan mirë:<br>- ritmikisht,<br>- me tingull e me intonacion,<br>- pastër e me pak gabime.<br>- Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:<br>- luan shumë mirë në të gjitha elementet e mësipërme. |
| **Materiale dhe burime mësimore:**<br><br>Çifteli, Lexhio, Partiturë, Sistem audio-video TIK, Internet |